KDU 28(05)

FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME I PRISHTINËS

# BULETINI

## REVISTË HULUMTUESE, SHKENCORE E FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME

# 4

Prishtinë, 2016

# BULETINI

**REVISTË HULUMTUESE, SHKENCORE**
**E FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME**

# 4

*Boton:*
**Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë**

*Redakor përgjegjës:*
**Prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi**

*Redaksia:*
**Prof. asoc. Dr. Sulejman Osmani,** redaktor
**Mr. Besa Ismaili,** *anëtar*
**Mr. Qemajl Morina,** *anëtar*
**Dr. Islam Hasani,** *anëtar*
**Dr. Sadik Mehmeti,** *anëtar*
**Mr. Vedat Shabani,** *sekretar i redaksisë*

*Redaktor gjuhësor:*
Hysen Matoshi

*Realizimi kompjuterik:*
Nuhi Simnica

*Shtypi:* "NSH Harisi" - Prishtinë

FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME I PRISHTINËS

# B U L E T I N I

## REVISTË HULUMTUESE, SHKENCORE E FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME

# 4

Prishtinë
2016

Prof. asoc. dr. Fahrush REXHEPI

# EBU BEKRI
## NJË JETË NË SHOQËRIM TË PEJGAMBERIT A.S.

### Përmbledhje

Në një periudhë të shkurtër kohore, jo më shumë se tridhjetë vjet pas vdekjes së Pejgamberit a.s., udhëheqjen e shtetit islam e morën në dorë katër kalifët myslimanë, të njohur në burimet dhe në literaturën islame me emrin El-hulefau Err-Rrashidun (udhëheqësit apo sunduesit e drejtë). Shprehja "kalif" ka kuptimin e udhëheqësit-sundimtarit, që është sinonim i ndjekjes së rrugës së Pejgamberit a.s. në udhëheqjen e myslimanëve dhe shtetit islam. Ndërsa me 'hilafetin' nënkuptojmë udhëheqjen dhe pushtetin e myslimanëve të trashëguar nga koha e Pejgamberit a.s. Kjo nënkupton qeverisjen e shtetit islam si në aspektin e udhëheqjes së riteve fetare, ashtu edhe në aspektin e udhëheqjes së politikës dhe çështjeve të tjera të myslimanëve që kanë të bëjnë me këtë botë.[1] Pra, me shprehjen 'hilafet' nënkuptojmë udhëheqjen dhe bashkimin e dy pushteteve, atij fetar që ka të bëjë me botën tjetër dhe atij politik që ka të bëjë me zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve të myslimanëve në këtë botë.

Për këtë arsye, katër kalifët myslimanë që e kanë trashëguar Pejgamberin a.s në udhëheqjen e myslimanëve, janë quajtur udhëheqës të

[1] Dr. Seid Abdul Aziz Salim, *TarihEl-Deuletu el arabijje*, El-Iskenderije, fq.152.

drejtë për shkak se kanë ecur rrugës së vërtetë të Pejgamberit a.s., rrugës së drejtë me të cilën është i kënaqur Allahu xh.sh. për të gjithë robërit e Tij. Periudha udhëheqëse e katër kalifëve, përfshirë këtu Ebu Bekrin r.a., për nga drejtësia, toleranca, barazia dhe perspektivat tjera ishte e ngjashme me atë të kohës së Pejgamberit a.s. që krijoi stabilitet, paqe dhe mirëqenie të përgjithshme. Këto vlera nuk ishin përsëritur më asnjëherë në periudhat e mëvonshme të shtetit islam.

Këtë periudhë të suksesshme të shtetit islam gjithsesi e kanë shënuar njerëzit e mëdhenj që kanë udhëhequr në të, siç ishin katër kalifët e drejtë, koha e të cilëve konsiderohet periudhë e artë dhe më e bekuara e historisë islame. Brezi i tyre ishte brezi më i mirë i gjithë njerëzimit. Këta ishin shembull për çdo besimtar që erdhi më pas, për çdo popull, për çdo shoqëri dhe për çdo familje myslimane.

Këtë gjeneratë Allahu xh.sh. e ka lavdëruar në shumë vende në Kuran, si në ajetin**: *"Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve*** *(emigruesve)* ***dhe ensarëve*** *(mikpritësve)* ***dhe atyre që i pasuan ata në mirësi! Allahu është i kënaqur prej tyre dhe ata janë të kënaqur prej Tij"***[2]

Pejgamberi a.s. për brezin e tij të sahabëve ka thënë: *"Ata janë gjenerata më e mirë, pastaj ata që erdhën pas tyre e pastaj ata që erdhën më pas"!*[3]

Periudha e El Hulefau Err Rrashidinëve kishte filluar nga muaji Rebiul-Evvel i vitit 11 h., kur kishte vdekur Muhamedi a.s. dhe kur të gjithë myslimanët i kishin dhënë betimin Ebu Bekrit r.a. duke e njohur për udhëheqës të tyre.[4]

[2] Et Tevbe: 100.
[3] Hadith i transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
[4] Eduard Thartori, *Islami në kohë trazirash*, Prishtinë, 2008, f.5.

## Lindja e Ebu Bekrit r.a.
## dhe jeta e tij në periudhën e injorancës

Ebu Bekri r.a ka lindur në vitin 573 dhe është më i ri se Pejgamberi a.s. për rreth dy vjet e disa muaj. Kjo do të thotë se në kohën e fillimit të shpalljes së Kuranit, ai ishte 38 vjeç. Ai është rritur dhe edukuar në Mekë, të cilën kurrë nuk e kishte lëshuar, përveç për qëllime tregtie. Në mesin e popullit të tij ishte shumë i pasur, me sjellje njerëzore, i njohur për bamirësi dhe moral të përsosur.

Emri i plotë i Ebu Bekër es-Sidikut, kalifit të parë të myslimanëve është: Abudllah bin Ebi Kuhafa, Othman bin Amir, bin Amër, bin Ka'b, bin Sa'd, bin Tejm, bin Murre, bin Ka'b, bin Lu'ej, bin Galib el-Kureshi et-Tejmi. Në gjenealogjinë e Ebu Bekrit familja e tij me të Dërguarin e Allahut, Muhamedin a.s. takohen te Murre[5] një gjysh i përbashkët në lozën e tyre.

Sipas veprës së Neveviut "Tehdhibu Es Sire En Nebevije", mund të konstatojmë se emri i vërtetë i Ebu Bekrit r.a., është Abdullah, edhe pse ka mendime se emri i tij është Atik. Megjithëse, lidhur me emrin Atik të gjithë dijetarët janë të një mendimi se është llagapi i tij dhe jo emri. Sipas një hadithi të transmetuar nga Tirmidhiu, Ebu Bekri këtë llagap e ka marrë për shkak se është i liruar prej zjarrit (i liruar prej dënimit me zjarr). Sipas disa të tjerëve, këtë llagap e ka marrë për shkak të bukurisë dhe pastërtisë së fytyrës. Grupi i tretë mendojnë se me këtë llagap është quajtur për shkak se në gjenealogjinë e tij familjare s'ka pasur asgjë për të cilën do të kishte vërejtje.[6] Ebu Bekri r.a. ishte quajtur edhe me disa nofka si: Es-Siddik (përkrahës i së vërtetës) dhe El-Evvah (ai që ka frikë të vërtetë nga Allahu xh.sh.).

[5] Xhelaludin Es-Sujuti, *Historia e kalifëve (në 30 vitet e para të kalifatit*), Shkup, 2008, fq.42. (titulli origjinal, *Tarih el Hulefa*, Xhelaludin es-Sujuti).
[6] Po aty.

Nëna e Ebu Bekrit është quajtur Selma bint Sahar bin Amir bin Ka'b, kurse emri "Ummul Hajr" ishte llagapi i saj, që ka domethënien "nëna e të mirave"[7]. Kështu thotë Ez-Zuhri, ndërsa këtë e përmend edhe Ibën Asakiri.

Në periudhën e xhahilijetit Ebu Bekri r.a. ishte martuar me dy gra: me Kutejletu bint Abdul Uza, me të cilën e kishte djalin Abdullahun dhe vajzën Esmën, dhe tjetra ishte Umu Rrumman bint Amër El-kinanije, me të cilën e kishte djalin Abdurrahmanin dhe vajzën shumë të mirënjohur, më pas grua e Pejgamberit a.s., Aishen r.a.. E kishte edhe një djalë me emrin Muhamed, nga Esma bint Umejs dhe vajzën Ummu Kalthumin nga Habibe bint Harixhe bint Zejd.

Sa i përket gruas së parë, me të ishte martuar në periudhën para islame dhe nuk është e sigurt nëse ajo e kishte pranuar islamin apo jo. Mirëpo, thuhet që Ebu Bekri u nda prej saj, sepse ajo nuk deshi ta pranonte islamin. Gruaja e dytë e Ebu Bekrit njihej me emrin Umu Rrumman. Ajo e kishte pranuar islamin herët, kishte migruar me Ebu Bekrin në Medinë dhe shquhej si besimtare e përkushtuar dhe në përgjithësi shumë e dalluar.[8]

Ebu Bekri r.a. ishte prej figurave udhëheqëse më autoritare në mesin e kurejshëve. Ibni Hishami në Siren e tij për Ebu Bekrin ka thënë: "Ebu Bekri r.a. ishte figura më e lartë në mesin e kurejshitëve. Ishte me karakter të dalluar, andaj kurejshitët për shumë çështje vinin dhe kërkonin mendimin e tij".[9] Ebu Bekri r.a. ishte tregtar i suksesshëm i cili udhëtonte nëpër vende të shumta. Ai kishte udhëtuar në Sham së bashku me Ebu Talibin në një karvan tregtar ku kishte pasur fitime të

[7] Po aty, f.48. (shih edhe: Muhamed Shakir, *Tarihul islami*, Bejrut).

[8] Hasan Ejub, *Katër Halifët e drejtë*, Shkup, 2003, f.13. (Titulli orogjinal: *El-HulefauR-R-Rashidin*). Shih edhe:Amër Halid, *Katër Halifët e drejtë*, Prishtinë, 2009, f.9. (Titulli original: *El-Hulefau, R-R-Rashidin*).

[9] Hasan Ejub, *Katër Halifët e drejtë,* f.30.

mëdha dhe të pastra nga të cilat i furnizonte dhe i ndihmonte të afërmit, shokët dhe të varfrit të cilët e respektonin shumë.

Ebu Bekri ishte i ruajtur nga veset e këqija edhe në periudhën e injorancës, siç ishte bixhozi, apo përdorimi i alkoolit etj. Transmetohet nga Ebu Nuajmi se Aishja r.a. ka thënë: "Ebu Bekri r.a. ia ka pas ndaluar vetes përdorimin e alkoolit edhe në periudhën e injorancës".[10] Pra, sipas të gjitha burimeve relevante Ebu Bekri r.a. nuk ka konsumuar alkoolin as në periudhën e xhahilijetit e as në atë të islamit. Ai, nuk kishte adhuruar idhujt edhe në periudhën e para islamit. Në një rast, gjatë një tubimi ku ndodhej Pejgamberi a.s. dhe as'habë të tjerë kishte thënë: "Nuk iu kam përulur idhujve asnjëherë".[11] Sipas shumë burimeve historike, edhe pse Ebu Bekri ishte ndër më të njohurit në fisin e vet në periudhën e xhahilijetit, biografia e tij para islamit nuk është plotësisht e njohur, përveç asaj që ka qenë tregtar i njohur, shok i Muhamedit a.s, dhe ishte ndër të parët që kishte pranuar islamin.

## Kontributi i Ebu Bekrit në Islam

Çdo figurë dhe personalitet që e kishte pranuar islamin, sidomos në fillim të shpalljes e ka peshën dhe autoritetin e vet, mirëpo autoriteti i personalitetit të Ebu Bekrit nuk është i njohur vetëm për faktin se ai e kishte pranuar islamin ndër të parët, por personaliteti i tij është ndër më të njohurit dhe për shkak të sakrificave dhe të kontributit të madh që ka dhënë për islamin që nga fillimi i përhapjes së tij.

Shkaqet dhe rrethanat pse Ebu Bekri pa hezituar dhe që në fillim kishte pranuar islamin janë se ai ishte shoku më i ngushtë dhe më i afërt i të dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s. dhe e njihte atë, gjithherë si njeri të sjellshëm, të edukuar dhe me moral të lartë. Arsyeja tjetër e pranimit të islamit nga Ebu Bekri r.a. ishte edhe njohuria që ai kishte

[10] Po aty.
[11] Po aty: 31.

pasur për fenë e paraardhësit të tij dhe të arabëve tjerë, Ibrahimit a.s. (fenë e drejtë dhe të vërtetë) dhe njohuritë që ai kishte nga librat e mëparshëm, të cilët kishin paralajmëruar për ardhjen e një të dërguari nga mesi i arabëve, madje nga mesi i vet fisit kurejshit nga i cili rrjedh edhe Ebu Bekri r.a.

Në lidhje me këtë që u tha më sipër, përmendim edhe ngjarjen që lidhet me Ebu Bekrin, i cili vetë në një rast ka thënë: "Mora rrugë për në Jemen, para shpalljes. Gjatë rrugës takova një të moshuar nga banorët e Ezdit, i cili kishte lexuar nga librat qiellore dhe posedonte njohuri të shumta. Kur më pa tha: A jeni nga Haremi (vend i Qabesë -Meka)? I thashë: Po jam nga familja e Qabesë! Më tha: Kurejshit? I thashë: Po nga Kurejshët. Më tha: Nga Tejmët (fisi i Ebu Bekrit)? I thashë: Po, jam nga loza e Abdullah bin Uthmani bin Tejm bin Murres. Ai burri më pas e lajmëroi se së shpejti do të jetë shok i një të dërguari (Pejgamberi) që do të jetë i shpallur në Harem (Qabe-Mekë ).[12] Edhe Rebia bin Ka`be i kishte thënë në një rast Ebu Bekrit se do të vijë nga populli yt një i dërguar, kështilltar i të cilit do të jesh ti dhe pas vdekjes së tij, ti do të jesh Kalif (zëvendës - udhëheqës). Këtë çështje Ebu Bekri r.a. e kishte mbajtur të fshehur në veten e tij duke mos e publikuar asnjëherë.[13]

Bazuar në lidhjet e afërta që Ebu Bekri i kishte me Pejgamberin a.s., shumë prej kurejshitëve në fillim të shpalljes shkonin te Ebu Bekri dhe e pyetnin se ç`po ndodh me shokun tënd? Ebu Bekri ua kthente: Ç`po ndodh! Ata i përgjigjeshin: Shoku yt (Muhamedi) po fton në besim në një Zot të vërtetë dhe po e quan veten pejgamber! Ebu Bekri u përgjigjej atyre: Po, ashtu është. Pas qarkullimit të këtyre fjalëve në mesin e mushrikëve kurejshë, Ebu Bekri del dhe shkon te Muhamedi a.s. dhe i tregon për atë që flitej në popull. Pejgamberi a.s. i tha Ebu

[12] Po aty: 34.
[13] Ali El-Tantavi, *Ebu Bekër Es-siddik.*

Bekrit: O Ebu Bekër! Me të vërtetë Zoti im më ka bërë mua përgëzues dhe udhëzues, më ka bërë mua ndjekës të rrugës (thirrjes) së Ibrahimit, më ka dërguar mua për mbarë njerëzit. Ebu Bekri r.a. i tha Pejgamberit a.s.: Ti asnjëherë nuk ke gënjyer dhe je zotërues i kësaj shpallje madhështore dhe unë do të vihem në përkrahjen tënde.[14]

Për sa i përket pranimit të islamit nga Ebu Bekri r.a. disa historianë konsiderojnë se ai është i pari që e kishte pranuar islamin. Sipas Ibni S`adit një grup sahabësh në një rast kishin thënë: "I pari që ka kaluar në islam është Ebu Bekër Es-Siddiku".[15] Ndërsa Ibni Hishami konsideronte se para Ebu Bekrit islamin e ka pranuar Aliu r.a. dhe Zejd bin Harithi. Kur është fjala për orët, ditët apo edhe javët, mendojmë se nuk është edhe fort me rëndësi koha, sepse secili nga myslimanët e parë islamin e ka pranuar nga pozita dhe rrethana të veçanta. Këtej mund të konsiderojmë se Ebu Bekri ka mundur të jetë i pari që e ka pranuar islamin nga të rriturit, ndërsa Aliu r.a. i pari nga të rinjtë, ndërsa Zejdi i pari prej robërve, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë.

Tirmidhiu dhe Ibën Hibani përmendin fjalët e Ebu Se'id el-Hudriut se Ebu Bekri ka thënë: "Vallë, a s'jam më i denji?! Domethënë për kalifatin. " Vallë, a nuk e kam pranuar i pari islamin! "Vallë, a s'kam qenë bashkudhëtar i kësaj e i asaj?! Vallë, a nuk kam qenë shok i filanit e filanit?!"

Lidhur me pranimin e islamit nga Ebu Bekri r.a., Ibën Asakiri nëpërmjet El-Harisit përmend fjalët e Aliut r.a., i cili kishte thënë: " Burri i parë që e ka pranuar islamin ka qenë Ebu Bekri".[16]

Është me rëndësi të themi se Ebu Bekri r.a. shumë shpejt iu përgjigj thirrjes islame. Sipas transmetimit të Ibni Hishamit, Pejgamberi a.s. në lidhje me pranimin e islamit nga Ebu Bekri kishte deklaruar:

[14] Muhamed Shakir, *Tarihul Islami* f.34-35.
[15] *Et-Tabakatul-Kubra*; nga Ibën Sa`di, 3.170-171; El-Isabe, 6/156-157.
[16] Xhelaludin Es-Sujuti, *Historia e kalifëve (në 30 vitet e para të kalifatit),* Shkup, 2008, f.51. (titulli origjinal, Tarih el Hulefa).

"*Askënd nuk e kam ftuar në islam e që tek ai të mos është vërejtur një mëdyshje dhe pavendosmëri pos Ebu Bekrit që nuk kishte shfaqur kurrfarë hamendje".*[17]

## Veçoritë fizike dhe cilësitë e Ebu Bekrit

Veçoritë e konstruktit fizik të Ebu Bekrit më së miri i ka përshkruar vajza e tij Aishja. Ajo e përshkruante me këto fjalë: "Ka qenë burrë me ten të bardhë, thatim, me pamje që shprehte disponim të vazhdueshëm, i kërrusur, me gunë të vjetërsuar e cila varej lirshëm në belin e tij për shkak të fizikut thatak, me eshtra të dalë të fytyrës, sy të thelluar (groposur), ballë të sheshtë dhe duar në të cilat nuk kishte asnjë qime.[18]

Ndërsa Ibën Sa'adi përmend një thënie nga Aishja r.a., të cilën njëherë një person e kishte lutur që t'ia përshkruante Ebu Bekrin, kurse ajo ishte përgjigjur: "Ishte njeri lëkurë bardhë, i dobët, me faqe të thara, i përkulur. S'lejonte që këmisha të mos ia mbulonte kofshët. Kishte fytyrë të dobët, sy të dalë, ballin të sheshtë, pa qime nëpër gishta. Ja kështu ishte ai!"[19]

Sa u përket veçorive të personalitetit dhe karakterit, ato janë të shumta dhe të gjata, ngase ai vërtet ishte dashamirës, i turpshëm, shumë i devotshëm, i fortë në personalitetin e tij. Ishte tregtar besnik, i cili e ruante nderin e vet, kishte pozitë, ishte i begatuar me pasuri dhe me moral, nuk gënjente, por e fliste vetëm të vërtetën.

Ebu Bekri kishte imanin më të lartë dhe më të plotë prej të gjithë njerëzve, siç e ka dëshmuar Pejgamberi a.s., kur kishte theksuar se sikur të matej imani i Ebu Bekrit me imanin e tërë Ummetit, imani i Ebu Bekrit do të peshonte më shumë!

---

[17] *Es-Siretun-nebevijje",* 1/23.
[18] "*Tabekat*" nga Ibni Sa`di, 3/188.
[19] Xhelaludin Es-Sujuti, *Historia e kalifëve (në 30 vitet e para të kalifatit),* Shkup, 2008, f.50. (titulli origjinal, Tarih el Hulefa).

Kishte sahabë që ishin më trima se Ebu Bekri dhe më të ditur se ai, por nuk kishte me iman më të plotë se ai. Kurani dëshmon për shumë rrethana lidhur me të, si p.sh në ajetin: ***"Atij që i jep lëmoshë edhe është i devotshëm dhe atë më të mirën e konsideron të vërtetë, atij do t`ia lehtësoj rrugën".***[20] Ngjashëm sinjalizon edhe ajeti vijues: ***"Me të vërtetë, atyre që thonë: " Zoti ynë është Allahu, pastaj janë të vendosur u zbresin melekët: Mos kini frikë dhe mos u pikëlloni dhe gëzohuni për Xhenetin, i cili është premtuar".***[21] Dhe fjala tjetër e Allahut xh.sh. në Kuran: ***"Kur në të ndodhej vetëm miku i tij, kur ata të dy ishin në shpellë dhe kur ai i tha mikut të vet: "Mos ki frikë, Allahu është me ne!".***[22]

Kur ndodhi nata e Israsë (nata e udhëtimit prej Mekës në Jerusalem), mushrikët kurejshë e shpallën Pejgamberin a.s. gënjeshtar dhe donin ta bindnin Ebu Bekrin r.a. që ta braktiste fenë e tij, andaj nxituan t`i thoshin: "Dëgjo si flet miku yt!" Mirëpo, ai u përgjigj: "Për Allahun, nëse ai e thotë këtë, e ka thënë të vërtetën, ngase ai më ka treguar se lajmi vjen prej qiellit në tokë, në çfarëdo pjese të natës dhe ditës, dhe unë i besoj".

## Ndikimi i Ebu Bekrit në pranimin e islamit nga të tjerët

Ndikimi i Ebu Bekrit r.a. në përqafimin e islamit tek të tjerët është shumë i rëndësishëm, duke marrë parasysh famën dhe popullaritetin që kishte ai në mesin e kurejshitëve. Në saje të këtij autoriteti, ai filloi t`i thërrasë në islam ata që u besonte, që e vizitonin dhe ata që rrinin së bashku me të. Si rezultat i thirrjes së tij, Islamin e përqafuan Zubejr Ibën Avam, Othman Ibën Afan, Talha Ibën Ubejdull-llahu, S`ad Ibën Ebi Vekas, Abdurrahman Ibën Auf, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë këta. Të gjithë emrat e përmendur në shoqërim të Ebu Bekrit shkuan te

[20] El Lejl: 5-7.
[21] Fus-silet: 30.
[22] Et-tevbe: 40.

Pejgamberi a.s. dhe ai ua prezantoi Islamin, u lexoi pjesë nga Kurani dhe i informoi mbi të vërtetat e Islamit, me ç`rast besuan.

Sipas një ngjarjeje, transmetimi i së cilës fillon nga Muhamed Ibën Amr El-Vakidij, Talha Ibën Ubejdull-llahu ka thënë: "Isha në tregun e Basrës, ku takova një murg në manastirin e tij, i cili thoshte: "Shikoni a ka ndonjë njeri nga Meka"? Po, i thashë unë jam nga atje", tha Talha: A ende nuk është paraqitur Ahmedi, tha ai. Unë e pyeta se kush ishte Ahmedi, ai më tha: Ai është i biri i Abdullahut…dhe do të jetë i fundit nga pejgamberët. Ai do të paraqitet këtë muaj në Mekë…". Mua kjo gjë më bëri shumë përshtypje, andaj shkova në Mekë dhe pyeta se a ka diçka të re? Ata më thanë: "Po Muhamedi është bërë i dërguar, ndërsa Ebu Bekri është bashkuar me të". Atëherë shkova te Ebu Bekri dhe e pyeta: "A me të vërtetë e pranove fenë e tij"? Ai tha: "Po". Që të dy shkuan te Pejgamberi a.s., ku Talha e deklaroi Islamin në prani të Muhamedit a.s." Kur e kishte pranuar Islamin Talha, Neufel Ibën Huvejlid Ibën El-A`devie, i cili quhej edhe luani i kurejshëve, i kishte lidhur Talhan dhe Ebu Bekrin me një litar. Për këtë arsye, ata i quajtën "El-Karnejn" (dy shokët).[23]

Ebu Bekri r.a. ishte ndër të parët që kishte përjetuar vuajtje dhe presion nga mushrikët kurejshitë gjatë përhapjes së Islamit. Kur ai kishte kërkuar nga Pejgamberi a.s. që Islamin ta përhapnin haptas dhe pasi që këtë kërkesë e kishte pranuar Muhamedi a.s., Ebu Bekri r.a. doli përpara të gjithëve dhe filloi të fliste, ndërsa i dërguari ishte ulur dhe dëgjonte. Në këto rrethana jobesimtarët iu vërsulën njeriut që publikisht e mbajti fjalimin e parë për Islamin dhe të gjithë myslimanëve që ishin në xhami, të cilët i rrahën pa mëshirë. U`tbe Ibën Rebia iu kishte ofruar Ebu Bekrit dhe filloi t`i mëshonte me sandale të riparuara e t`ia fërkonte ato në fytyrë, derisa erdhën të afërmit e Ebu Bekrit të cilët i larguan jobesimtarët e pamëshirshëm.

[23] Hasan Ejub, *Katër halifët e drejtë*, f.14.

## Përparësia e Ebu Bekrit ndaj sahabëve të tjerë

Se Ebu Bekri r.a kishte shumë besim në Pejgamberin a.s, dhe se ishte i pari që kishte besuar Muhamedin a.s. për profet apo se ishte përkrahës më i afërt i Pejgamberit a.s. këtë e dëshmojnë shumë ngjarje historike, shumë hadithe të Pejgamberit a.s. dhe shumë argumente të tjera, të cilat ne i kemi trajtuar më sipër. Po ashtu kemi edhe shumë ngjarje, argumente dhe thënie të tjera pejgamberike që dëshmojnë për dashurinë, respektin dhe afërsinë që kishte Pejgamberi a.s ndaj Ebu Bekrit r.a, duke u bazuar në kontributin dhe në ndikimin që ai ka dhënë për Islamin në përgjithësi.

Për dashurinë dhe respektin që kishte Pejgamberi a.s. ndaj Ebu Bekrit tregon edhe kjo ngjarje: "*Pejgamberi a.s. një ditë doli para sahabëve në xhami dhe pyeti se ku ishte Ebu Bekri?..Ai u ngrit, ndërsa Pejgamberi a.s. kur e pa i tha eja pranë meje. Pastaj pyeti se ku është Omeri?.. Edhe ai u ngrit ndërsa Pejgamberi a.s. i tha edhe atij të shkonte pran tij. Pastaj i mori të dy për dore, i ngriti lart dhe tha: "Kështu do të ringjallemi në ditën e kiametit".*[24]

Në një rast tjetër kur ishte pyetur Pejgamberi a.s se kush ishte njeriu më i dashur tek ai, Pejgamberi a.s ishte përgjigjur: *"Aishja"*. I thanë*: "E kush prej burrave?" Tha: "Baba i saj". Pejgamberi a.s një ditë tjetër tha: "O Ebu Bekër, ti je shoku im në shpellë dhe në varrezë"*[25].

Pejgamberi a.s. nuk kishte insistuar që ta emëronte prijësin e myslimanëve, pasardhësin e tij, për shkak të urtësisë që del nga vetë natyra e fesë islame e mbështetur në metodën e trasuar nga Kurani: ***"Dhe të cilët bëjnë marrëveshje për punët e tyre".***[26] Sipas këtij ajeti, myslimanët çështjet e veta duhet t'i zgjidhin vetë. Edhe Muhamedi a.s. çështjen e hilafetit (udhëheqjes) e kishte lënë ta zgjidhin vetë myslimanët midis tyre përmes sistemit "shura" (marrëveshje konsensuale).

[24] Po aty f. 31.
[25] Po aty.
[26] Esh-shura: 38.

Kjo nuk do të thotë se Pejgamberi a.s. nuk i kishte këshilluar sahabët e tjerë kur kemi parasysh se ai ishte Pejgamber i tyre që i ftonte gjithherë në rrugë të drejtë. Animin kah Ebu Bekri, e shfaqte përmes ishareteve të tija profetike, të cilat në momente të caktuara i kuptonin vetëm disa as'habë, e më pas edhe të tjerët.

Duke e analizuar jetën dhe veprën e Ebu Bekrit r.a. dhe, duke u mbështetur në burime dhe literaturë të shumtë rreth jetës së tij, mund të arrijmë të njohim arsyet se pse Ebu Bekri kishte përparësi në hilafet para sahabëve të tjerë.

Ndër të tjera Ebu Bekri r.a. kishte përparësi në hilafet, sepse njihej si person i dashur për të gjithë, njihej për cilësi të larta morale e humane, njihej si shoku më i afërt i Pejgamberit a.s. dhe shoqëruesi i tij në çdo hap. Ai shquhej për trimëri, për edukatë të lartë, për qëndrueshmëri si gjatë shoqërimit të Pejgamberit a.s. në çdo rrugëtim të tij të vështirë, ashtu edhe për pjesëmarrjen e tij në luftëra dhe beteja të rëndësishme për myslimanët.

Se Pejgamberi a.s. e kishte preferuar Ebu Bekrin për kalif të myslimanëve pas tij, tregojnë edhe këto transmetime:

- Kur pejgamberi a.s i mbush gjashtëdhjetë e tri vite, tek ai filluan të paraqiten shenjat e lodhjes e të sëmundjes. Erdhi një grua ta pyesë Pejgamberin a.s dhe kërkoi nga ai diçka, kurse ai i sugjeroi të vinte në vitin tjetër. Gruaja i tha Pejgamberit a.s: "Nëse vij vitin tjetër e nuk të gjej?" Ai i tha: *"Nëse nuk më gjen atëherë shko te Ebu Bekri"*. Ky ishte një sinjal i Pejgamberit a.s se Ebu Bekri duhej të ishte kalif i myslimanëve pas vdekjes së tij.

Pas këtij rasti, Pejgamberi a.s. udhëtoi për haxhin e fundit lamtumirës, ku zbriti ajeti i tretë i sures El-Maide. Për zbritjen e këtij ajeti u gëzuan të gjithë as'habët, përveç Ebu Bekrit i cili qau, ngase ky ajet përmbante edhe lajmin për ndarjen e Pejgamberit a.s. nga kjo jetë.

- Pas keqësimit edhe më shumë të gjendjes shëndetësore të Pejgamberit a.s. siç transmetohet nga Tirmidhiu, Pejgamberi a.s. e kishte poro-

situr Aishen me këto fjalë: *"Urdhëroni Ebu Bekrit t`u prijë njerëzve në namaz"*. Atëherë Aishja tha: "Nëse Ebu Bekri të zëvendëson në namaz, ai ka zë të dobët dhe ndikohet nga Kurani dhe njerëzit nuk do të dëgjojnë asgjë nga vaji i tij, andaj urdhëroje Omerin t`i prijë njerëzve". Njësoj mendonte edhe Hafseja. Pejgamberi a.s. tha: *"Me të vërtetë ju jeni njësoj si gratë në rastin e Jusufit a.s. dhe duke thënë prapë: E urdhëroni Ebu Bekrin që t`u prijë njerëzve"…* (Tirmidhiu mendon se hadithi është hasenun sahih).[27]

Pas këtij rasti, Ebu Bekri u priu myslimanëve në namaz, ndërsa Pejgamberi a.s. i shikonte derisa faleshin në rreshta pas Ebu Bekrit dhe buzëqeshte nga kënaqësia. Dijetarët islamë janë të mendimit se me këtë Pejgamberi a.s. synonte diçka.

Transmetohet se Ebu Bekri, në kohën sa ishte në jetë Pejgamberi a.s., tri herë iu kishte prirë njerëzve në namaz.[28] Por, sipas disa mendimeve Ebu Bekri r.a., sa ishte në jetë Pejgamberi a.s.,u kishte prirë myslimanëve në namaz tri ditë, ndërsa sipas disave thuhet se ai kishte falur shtatëmbëdhjetë namaze.[29]

- Përparësia tjetër e Ebu Bekrit te Pejgamberi a.s. vërehet edhe në rastin e mbylljes së derës së xhamisë, nëpër të cilën hyhet nga shtëpitë në xhami. Pejgamberi a.s. urdhëronte që të mbyllen dyert nëpër të cilat hyhet në xhami, pos asaj të shtëpisë së Ebu Bekrit, ngase Pejgamberi a.s. konsideronte se asnjë njeri nuk i kishte ofruar miqësi më të mirë atij se Ebu Bekri r.a. Në një rast tjetër Pejgamberi a.s kishte thënë: "*Nëse do të zgjidhja nga robërit e Allahut ndonjë shok, si mikun më të dashur (i cili do të kishte pozitë të veçantë në fe), do ta pranoja Ebu Bekrin, por ky është i dashur (halil) i Allahut…"*[30]

---

[27] Shakir, Mahmud, *Tarihul Islami* 3, 1991m. 1411h. f. 45.
[28] Ibn S`adi, *Tebekat,* 3/180.
[29] Hajrullah Tilfah, *Ali Bin Ebi Talib* (Pjesa e pesëmbëdhjetë), Bagdad,1982,f.30.
[30] Ibën Hisham, *Sire* 4/219; Buhariu, 7/17; El-Musned, 1/412.

Megjithatë, edhe përkundër këtyre transmetimeve, ne nuk hasim në asnjë argument të fuqishëm se Pejgamberi a.s. kishte ndërhyrë apo kishte urdhëruar, në mënyrë të drejtpërdrejtë, për zgjedhjen e Ebu Bekrit kalif të myslimanëve. Sipas asaj që ne e kemi hasur gjatë leximit të burimeve dhe literaturave të shumta, kemi përfunduar se mosndërhyrja e drejtpërdrejtë e Pejgamberit a.s. në zgjedhjen e Ebu Bekrit për kalif të myslimanëve, ishte nga frika se ndoshta pas vdekjes së tij myslimanët nuk do ta përfillnin urdhrin apo porosinë e Pejgamberit a.s. Ky ndoshta do të ishte edhe shkaku i përçarjes së myslimanëve pas vdekjes së tij.

## Kalimi i Pejgamberit a.s. në botën tjetër

Pejgamberi a.s. kaloi në botën tjetër ditën e hënë, në orët e paradites, më 12 rebiul-evvel të vitit 11 h. Ai vdiq duke i përsëritur fjalët: "*O Zoti im, më fal dhe më mëshiro dhe më bashko me Lajmëtarët e fesë. O Zoti im, më bashko me Lajmëtarët e fesë"*.[31] Fjalët e fundit Pejgamberi a.s. i përsëriti tri herë. Në ditën e vdekjes Pejgamberi a.s. i kishte mbushur gjashtëdhjetetre vjet e katër ditë.

Pas transferimit të Pejgamberi a.s. në Ahiret, bashkëshortja e tij Aishja nuk dinte çfarë të bënte. Më vonë u ngrit dhe hyri në xhaminë e Pejgamberit a.s. dhe bërtiti me sa zë që kishte: "Vdiq pejgamberi i Allahut". Me këtë rast tërë xhamia u shndërrua në vaj. Aliu r.a. nuk mundi të qëndronte në këmbë, Othman bin Afani u bë si fëmijë, e merrnin nga e majta në të djathtë dhe anasjelltas. Fatimja, bija e Pejgamberit a.s. thoshte: "O babai im iu përgjigje Zotit që të thirri! O babai im, në Xhenetin Firdeus e ke vendin…"

Omeri r.a., kur kishte dëgjuar lajmin për vdekjen e Pejgamberit a.s., mori shpatën dhe u bërtiti njerëzve në xhami duke u thënë: "Kush

[31] Safijurrahman El-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i xhennetit*, Urtësia-Shkup, 1997, f. 510. (titulli origjinal: *Er-rahik el Mahtum)*.

thotë se Muhamedi a.s. ka vdekur, do t`ia pres kokën. Ai ka shkuar te Zoti i tij, siç shkoi më parë Musai a.s., i biri i Imranit për t'u takuar me Zotin e tij, kur pas dyzet ditësh u kthye prapë te populli i vet…"[32] Ndërsa njeriu më i qëndrueshëm me rastin e vdekjes së Pejgamberit a.s. ishte ai që e deshi më së shumti - Ebu Bekri. Ai hyri në dhomën e Pejgamberit a.s, e zbuloi dhe e vërtetoi se kishte ndërruar jetë. E mori në gjoksin e tij, e puthi mes dy syve dhe tha: "Sa i bukur ishte i gjallë e sa i bukur je i vdekur, o i dërguari i Allahut!" Dhe thoshte: "O i dërguar, o i zgjedhur, o shok, o i dërguar i Allahut…!

Pastaj Ebu Bekri u largua nga Pejgamberi a.s. dhe hyri në xhami, ku gjeti Omerin e duke folur dhe tha: "Hesht o Omer!" Omeri nuk ndaloi së foluri, ndërsa Ebu Bekri me sa zë që kishte tha: "O ju njerëz, kush prej jush e ka adhuruar Muhamedin a.s. le ta dijë se ai ka vdekur, e kush ka adhuruar Allahun, le ta dijë se Allahu është gjallë e nuk vdes". Pastaj e lexoi ajetin kuranor: ***"Muhamedi nuk është tjetër veç se i dërguar. Edhe para tij pati të dërguar*** *(që vdiqën ose u vranë).* ***E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa*** *(nga feja ose lufta)?* ***E kush do që kthehet prapa nuk i bën dëm Allahut aspak, kurse Allahu do t'i shpërblejë mirëbërësit".***[33]

## Zgjedhja e Ebu Bekrit kalif i myslimanëve

Vdekja e Pejgamberit a.s. shkaktoi dhimbje të madhe jo vetëm te sahabët e ngushtë të Pejgamberit a.s., por edhe te të gjithë myslimanët e tjerë. Megjithatë, pas vdekjes së tij, myslimanët menjëherë filluan të mendonin për zgjedhjen e udhëheqësit të shtetit islam që do ta zëvendësonte Pejgamberin a.s. Ata për këtë filluan të mendojnë ende pa e përgatitur kufomën dhe pa e varrosur trupin tij, me qëllim të moslënies së vakuumit qeverisës në shtetin islam dhe të mbrojtjes së interesave të

[32] Shakir, Mahmud, *Tarihul Islami*, f.46.
[33] Al Imran: 144.

shtetit. Ky veprim është një tregues i qartë për rëndësinë që ka sistemi i qeverisjes dhe i politikës në islam.

Historinë e zgjedhjes së Ebu Bekrit kalif të parë të myslimanëve fillimisht e mbështesim në transmetimin e Umer Ibn Hatabit. Transmetohet nga Ibn Abbasi se Omeri r.a. ka thënë: "Kur vdiq i dërguari i Allahut, ne u ndamë në disa grupe. Aliu dhe Zubejri në shtëpinë e Fatimes, ensarët u mblodhën në shtëpinë e familjes Sai'de, ndërsa ne emigrantët (muhaxhirët) nga Meka u tubuam tek Ebu Bekri. Unë i thashë Ebu Bekrit: "Le të shkojmë te vëllezërit tanë ensarët dhe ta zgjidhim këtë problem". U nisëm dhe rrugës takuam dy burra të mirë, të cilët na pyetën: "Për ku jeni nisur o muhaxhirë?" Unë thashë: "Po shkojmë te vëllezërit tanë ensarë". Ata thanë: "Mos shkoni atje, po kthehuni nga keni ardhur". Unë thashë: "Betohem për Allahun se do të shkojmë". Dhe ashtu bëmë. Kur arritëm atje, i gjetëm të mbledhur nën çatinë e familjes Sa'ide. Në qendër të tyre qëndronte një njeri i mbështjellë me rroba. "Kush është ky dhe çfarë ka!"- pyeta unë. "Ai është Sa'ad bin Ubade! Është i sëmurë". Pasi u ulëm, u ngrit nga ata një njeri orator dhe pasi e falënderoi dhe e lavdëroi Allahun tha: "Ne jemi ndihmësit e Allahut dhe ushtria e islamit, kurse ju muhaxhirët nga ne, përse një grup prej jush kërkon të na largojë nga ajo që na përket!".[34]

Kur ai mbaroi, unë desha ta thosha një fjalë të bukur përpara Ebu Bekrit, të cilën e kisha përgatitur më parë, por Ebu Bekri më ndaloi. Unë nuk dëshiroja ta zemëroja, andaj heshta…Ai filloi të fliste: "Çdo gjë që thatë ju e meritoni, por arabët nuk i kanë parë këto cilësi që i përmendët, vetëm se tek këta pjesëtarë të kurejshëve (dhe bëri me dorë nga muhaxhirët). Këta janë njerëzit më mesatarë si në origjinë ashtu edhe në shtëpi dhe unë po zgjedh për ju dy prej tyre, ndërsa ju merrni kë të dëshironi". Pastaj më ngriti mua dhe Ebu Ubejde ibn Xherrahun. Kjo ishte gjëja e vetme që nuk më pëlqen nga fjalimi i tij. Betohem për

[34] Hasan Ejub, *Katër halifët e drejtë*, f. 29.

Allahun se, në qoftë se mua do të më kërcënoheshin me vdekje, nuk do të pranoja kurrë të udhëhiqja një popull në mesin e të cilëve do të ishte Ebu Bekri... Njëri nga ensarët u ngrit e tha: "Unë jam ai i cili ju nevojitet. Unë e kam zgjidhjen e duhur për problemin tuaj. Unë them se ne duhet të zgjedhim një prijës nga ne dhe një prijës nga ju". Atëherë dhoma filloi të gumëzhinte nga zërat e lartë që shpërthyen pas asaj fjale. Unë u tremba se mos do të përçahemi dhe i thashë Ebu Bekrit të zgjaste dorën, në mënyrë që t'ia jepja besën. Pas meje dhanë besën muhaxhirët dhe pas muhaxhirëve ensarët". (transmeton Ahmedi).[35]

Përzgjedhja e Ebu Bekrit si kalif u bë në ditën e hënë, më 12 të muajit Rebiul Evvel të vitit 11 h.(6 qershor 632). Personat që nuk ishin prezentë në këtë betim ishin: Abasi, Aliu, dhe Zubejr ibn Avvami, të cilët ishin të zënë me përgatitjen e xhenazes së të dërguarit të Allahut. Në ditën tjetër më 13, u bashkuan që të gjithë njerëzit në Xhaminë e Pejgamberit a. s. dhe dhanë betimin për Ebu Bekrin.[36]

Enes ibn Maliku na transmeton detajet e betimit të dytë që u bë një ditë më pas në Xhaminë e Pejgamberit a.s. Ai citon: "Në ditën e martë, Umer bin El Hatabi hipi në minberin e Pejgamberit a.s., ndërsa Ebu Bekri qëndroi anash këtij minberi i heshtur. Pasi u mblodhën të gjithë njerëzit në xhami, Umeri u ngrit para tyre dhe u foli: "Sa kam dëshiruar që të jetonte Pejgamberi a.s., e të ishte i fundit që do të vdiste nga ne… Por, me vdekjen e tij, Allahu nuk e la umetin e tij të shuhet. Ai u la dritën, e cila është syneti i Pejgamberit a.s. Ebu Bekri ishte shoku më i ngushtë i tij, ishte i vetmi që e shoqëroi në rrugëtimin e emigrimin, duke qëndruar me të në shpellën "Thever"… Ju shumë mirë e dini se nuk ka më të mirë se ai ndër të gjithë myslimanët. Pra, ejani dhe jepjani besën Ebu Bekrit si kalif i besimtarëve. Pastaj Omeri i thotë Ebu Bekrit: "Ngrihu në minber!". Ebu Bekri u ngjit dhe që aty filloi betimi

[35] Po aty f. 30.
[36] Eduard Thartori, *Islami në kohë trazirash*, Prishtinë, 2008, f.27.

i masës ndaj Ebu Bekrit, ky betim vinte edhe nga muhaxhirët edhe nga ensarët.[37]

Pas betimit Ebu Bekri mbajti fjalimin e tij historik, ku pos falënderimit të Allahut xh.sh. dhe përshëndetjes së Pejgamberit a.s., ndër të tjera, tha: "O njerëz, unë u përzgjodha nga ju, por nuk jam më i mirë se ju. Nëse unë punoj mirë, atëherë më ndihmoni! Nëse punoj keq atëherë më drejtoni. Sinqeriteti është premtimi im që e bëj para Zotit për ju… Nëse një popull do të neglizhojë në luftën për hir të Zotit, Allahu do t'i poshtërojë ata. Nëse në një popull përhapet degjenerimi, Allahu do t'iu sjellë atyre sëmundje dhe fatkeqësi."[38]

Në betim fillimisht nuk merrte pjesë Ali ibn Ebi Talibi dhe Zubejr ibn Avvami. Ebu Bekri menjëherë dërgoi njerëz t'i thërrisnin ata, të cilët, posa u paraqitën, Ebu Bekri u tha: A dëshironi që të thyeni besën e myslimanëve? Që të dy u përgjigjën: Jo, mos ke merak, o kalif i Pejgamberit a.s. Pastaj u ofruan dhe dhanë betimin e tyre.

Në përfundim duhet të themi se kushdo që trajton këtë temë pak sa më thellë, do të arrijë në konstatim se Ebu Bekri r.a. është zgjedhur kalif i myslimanëve me miratimin e të gjithë sahabëve, duke mos rënë ndesh edhe me paralajmërimin e mëparshëm të Pejgamberit a.s. kur kishte thënë: *"Allahu dhe besimtarët nuk lejojnë (dikë tjetër) përveçse se Ebu Bekrin"*. Në bazë të kësaj thënie profetike nuk fshihet respekti dhe dëshira e Pejgamberit a.s. për Ebu Bekrin r.a., por kjo nuk do të thotë se Pejgamberi a.s. ka ndërhyrë, apo e ka caktuar vet Ebu Bekrin për kalif të myslimanëve, sepse vetë në këtë thënie Pejgamberi a.s. e ka përmendur Allahun xh.sh. dhe besimtarët, të cilët do të gjykojnë dhe do të vendosin për kalifin mysliman pas Muhamedit a.s. Pra, Pejgamberi a.s nuk e kishte caktuar as Ebu Bekrin, siç pretendojnë një pjesë e Ehhli Sunetit, as Aliun siç pretendojnë shiitët. Është shumë e sigurt dhe e argumentuar se i dërguari i Allahut nuk kishte zgjedhur njeri për

[37] *El-bidaje*, 5/248, Transmetuar nga Buhariu.
[38] Po aty (hadithin e transmeton Buhariu).

të qenë zëvendës i tij në udhëheqjen e myslimanëve. Edhe Aliu r.a. në lidhje me zgjedhjen e Ebu Bekrit në një rast para njerëzve kishte thënë: "O njerëz ! I dërguari i Allahut nuk ka thënë asgjë për çështjen e drejtimit të myslimanëve, por ne e pamë të arsyeshme se kjo gjë i përkiste Ebu Bekrit më parë se kujtdo tjetër…"[39]

## Përfundim

Zgjedhja e Ebu Bekrit për kalif të myslimanëve ishte caktimi i Allahut xh.sh., dëshirë e Pejgamberit a.s. dhe vendim i mbështetur nga gjithë sahabët e Muhamedit a.s. dhe nga gjithë myslimanët, qofshin muhaxhirë, qofshin ensarë. Emërimi i tij për kalif, i gëzoi të gjithë, burra e gra, pleq, të rinj e fëmijë. E donin që të gjithë pasi që e njihnin për njeri të butë dhe shumë të sinqertë.

Kur Ebu Bekri r.a. e mori udhëheqjen e shtetit islam pas vdekjes së Pejgamberit a.s., një pjesë e kabileve arabe ishin larguar nga islami, prandaj hapin e parë që ndërmori ai ishte lufta për rikthimin e të gjithëve nën flamurin e islamit dhe dhënia fund e krizës së largimit nga feja. Nën udhëheqjen e Ebu Bekrit r.a. u shënuan edhe suksese të tjera, si: çlirimi i Persisë, Shamit, mposhtja e bizantinëve, si dhe luftërat dhe ekspeditat tjera të udhëhequra nga ai. Me këto fitore të njëpasnjëshme shteti islam u bë një faktor dominues dhe aq i fortë, saqë asnjë shtet nuk ishte në gjendje t'u përballonte sulmeve të ushtrisë myslimane. Suksesi tjetër i Ebu Bekrit ishte edhe iniciativa për tubimin e Kuranit në një libër.

Personaliteti i Ebu Bekrit shquhej me trimëri e bujari, me humanitet e me guxim të madh. Ebu Bekri r.a. ka pasur sjellje shumë të mira, ka qenë i qetë nga temperamenti dhe është dalluar me shkathtësi e urtësi të veçantë. Ai ka luajtur rol të rëndësishëm edhe në pranimin e Islamit nga shumë personalitete të tjera.

[39] Hasan Ejub, *Katër halifët e drejtë*, f.32.

## Burimet dhe literatura:

1. Kurani.

2. Dr. Seid Abdul Aziz Salim, *TarihEl-Deuletu el arabijje*, El-Iskenderije.

3. Eduard Thartori, *Islami në kohë trazirash*,Prishtinë, 2008.

4. Xhelaludin Es-Sujuti, *Historia e kalifëve (në 30 vitet e para të kalifatit*), Shkup, 2008. (titulli origjinal, *Tarih el Hulefa*, Xhelaludin es-Sujuti).

5. Muhamed Shakir, *Tarihul islami*, Bejrut).

6. Hasan Ejub, *Katër Halifët e drejtë*, Shkup, 2003. (Titulli orogjinal: *El-Hulefau-R-R-Rashidin*).

7. Amër Halid, *Katër Halifët e drejtë*, Prishtinë, 2009. (Titulli original: *El-Hulefau, R-R-Rashidin*).

8. Ali El-Tantavi, *Ebu Bekër Es-siddik*.

9. Muhamed Shakir, *Tarihul Islami*.

10. *Et-Tabakatul-Kubra*; nga Ibën Sa`di, 3.170-171; El-Isabe, 6/156-157.

11. *Es-Siretun-nebevijje*", 1/23.

12. Shakir, Mahmud, *Tarihul Islami* 3,1991m. 1411h.

13. Hajrullah Tilfah, *Ali Bin Ebi Talib* (Pjesa e pesëmbëdhjetë), Bagdad,1982.

14. Ibën Hisham, *Sire* 4/219; Buhariu,7/17; El-Musned,1/412.

15. Safijurrahman El-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i xhennetit*, Urtësia- Shkup, 1997. (titulli origjinal: *Er-rahik el Mahtum).*

16. *El-bidaje*, 5/248, Transmetuar nga Buhariu.

## - Summary -

The choice of Abu Bakr to be a khalif of Muslims was a designation of Allah JS, a wish of Prophet AS, and a decision supported by all sahibs of Muhammad AS, and all Muslims, be they muhajir or ensar. His designation for khalif gave joy to all, men and women, elderly, young and child. They all wanted him, since he was known for a soft and sincere man.

When Abu Bakr RA took leadership of the Islamic State upon the death of Prophet AS, a part of Arabic families had moved away from Islam, and therefore, the first step he took was the fight to return all under the Islamic banner, and ending the crisis of moving away from religion. Under the leadership of Abu Bakr RA, many other successes were noted, such as: liberation of Persia, Sham, defeat of Byzantines, and other battles and expeditions led by him. With many consecutive victories, the Islamic state became a dominating factor and so strong, that no other country was capable of fighting against attacks of the Muslim army. Another success of Abu Bakr is the initiative to assemble Qur'an writings into a single book.

The personality of Abu Bakr was known for its bravery and courage, humanity and zeal. Abu Bakr had very good manners, a calm temper, and was distinguished for special abilities and wisdom. He played an important role in the acceptance of Islam by many personalities of the time.

Mr. hfz. Safet HOXHA

# INSTITUCIONI I HIFZIT
## Metodat dhe teknikat e memorizimit të Kuranit

Që nga fillimi i shpalljes, Kurani është regjistruar në mendje me besnikëri dhe është shkruar. Falë kësaj,

myslimanët kanë tekstin e librit të tyre të shenjtë të ruajtur pa asnjë ndryshim, ngase për këtë kishte garantuar Allahu i Madhërishëm kur ia zbriti Muhamedit a.s. ajetet:

لَا تُحَرِّكْ بِهِۦ لِسَانَكَ لِتَعْجَلَ بِهِۦٓ ﴿١٦﴾ إِنَّ عَلَيْنَا جَمْعَهُۥ وَقُرْءَانَهُۥ ﴿١٧﴾ فَإِذَا قَرَأْنَٰهُ فَٱتَّبِعْ قُرْءَانَهُۥ ﴿١٨﴾ ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا بَيَانَهُۥ ﴿١٩﴾

***"Atë** (Kuranin) **mos e shqipto me gjuhë për ta shpejtuar***

***Ne kemi detyrë tubimin dhe leximin e tij,***

***E kur e lexojmë, ti përcille leximin e tij,***

***E pastaj, është detyrë e jona ta shkoqisim''*[1]*.***

Dhe i shpalli:

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا ٱلذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُۥ لَحَٰفِظُونَ ﴿٩﴾

***"Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kuranin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij."***[2]

---

[1] El-kijameh, ajetet, 16,17,18,19.
[2] Hixher, ajeti, 9.

بَلۡ هُوَ ءَايَٰتُۢ بَيِّنَٰتٞ فِي صُدُورِ ٱلَّذِينَ أُوتُواْ ٱلۡعِلۡمَۚ ٤٩

***"Këto janë argumente të qarta në zemrat e atyre të cilëve u është dhënë dituria"***[3]

Çështjet kryesore për të cilat do të hulumtojmë në këtë trajtim të institucionit të hifzit dhe teknikave te memorizimit-hifzit janë; periudha e fillimit të memorizimit -hifzit të Kuranit, metodat e memorizimit - hifzit, mbështetja në metodat klasike të memorizimit - hifzit dhe fillimet e metodave të reja të memorizimit - hifzit. Objektivat kryesorë për t'u arritur në këtë trajtim janë; të përcaktojmë, shpjegojmë dhe të identifikojmë shembuj të fenomenit të memorizimit dhe metodave të hifzit, të shqyrtojmë veçoritë thelbësore të metodave të ndryshme të vlerësuara si të suksesshme për hifzë, të konstatojmë disa parime mësimore të përbashkëta të shumë metodave të hifzit në botën islame, të shtjellojmë mënyrat dhe metodat e hifzit teorike-praktike të cilat plotësojnë dhe përmirësojnë njëra - tjetrën në hifz.

## Kuptimi i memorizimit-hifzit

Në aspektin etimologjik fjala hafiz[4] arabisht: حافظ, Hafidh, arabisht: حفاظ, shumësi huffādh, arabisht: حافظة Hafidhe, fjalë për fjalë do të thotë "kujdestar", është një term i përdorur nga myslimanët e mëvonshëm për dikë që e ka memorizuar plotësisht Kuranin.[5] Në leksikun klasik të gjuhës arabe, fjala 'hafiz' nuk është përdorur tradicionalisht për t'iu referuar atij që e kishte memorizuar Kuranin. Në vend të kësaj fjale është përdorur Hamil (ai që mbart), ndërsa Hafiz është përdorur

[3] Ankebut ajeti, 49.

[4] Hafiz është përdorur në gjuhën osmane dhe boshnjake dhe ashtu është bërë e njohur edhe te populli shqiptar, edhe pse ne kemi shkronjën dh dhe mund ta shqiptojmë si qëndron në arabisht hafidh.

[5] Fjalori arabisht-shqip, fq.165.

për dijetarët e hadithit, dhe për atë i cili kishte mësuar 100.000 hadithe në kujtesë, për shembull, Ibn Haxher el - Askalani.

Muhamedi a.s. ishte Hafizi i parë i Kuranit. Tradita e mësimit përmendësh të Kuranit nis që nga koha e Pejgamberit a.s. Ai dinte Kuranin përmendsh dhe i inkurajonte të tjerët për të mësuar përmendsh sa më shumë të jetë e mundur. Të frymëzuar nga Muhamedi a.s., i cili ishte vetë hafiz, si dhe nga thëniet e tij të cilat përgëzojnë mësimin përmendsh të Kuranit, myslimanët garojnë për të mësuar përmendsh sa më shumë nga Kurani. Një nga aspektet e I'xhazit[6] të Kuranit manifestohet edhe në faktin se ai është libër që mësohet përmendsh tërësisht.

Duke komentuar ajetin 17 të sures El- Kamer: ***"Dhe Ne kemi bërë me të vërtetë Kuranin e lehtë për të kuptuar dhe mbajtur mend, pastaj a ka ndokush i cili do të kujtohet*** *(ose merr mësim)?*[7]***",*** komentuesi i njohur i Kuranit nga Spanja Imam Kurtubiu ka thënë: "Ne kemi bërë Kuranin e lehtë për memorizim, dhe ne do ta ndihmojmë atë i cili dëshiron ta mësojë përmendsh, duke e bërë atë më të lehtë për mësim."[8]

Pasi që shkrimi i Kuranit në fillim ishte pa shenjat zanore ose diakritike të tjera të nevojshme për të dalluar mes fjalëve, në qoftë se ka pasur ndonjë pyetje në lidhje me shqiptimin e një ajeti, atëherë memorizimi ishte një burim më i mirë për të ditur saktësinë e leximit se ato të shkruarat. Mësimi përmendsh është konsideruar edhe më i sigurt, se një dorëshkrim mund të shkatërrohet lehtë, por nëse Kurani ishte që të mësohet përmendsh nga shumë huffazë, ajo kurrë nuk do të jetë e humbur.

Edhe Kalifi Uthman ibn Affan që kishte mbledhur dhe organizuar shumëzimin e Mus'hafeve e ka marrë për bazë recitimin (nga kujtesa) e Kuranit. Ka versione të shumta të recitimit. Shumica e hafëzëve e dinë vetëm një version, por ekspertët e vërtetë mund të lexojnë në disa

[6] I'xhazit paarritshmëria e imitimit të Kuranit në tekst, në strukturë, në kuptim..
[7] Kamer ajeti 17.
[8] El- Kurtubi, Vll.19.321.

versione rivajete. Hafëzët janë shumë të respektuar në kuadër të Bashkësisë Islame. Ata janë të privilegjuar për të përdorur titullin "Hafëz" para emrit të tyre. Ata janë testuar në njohuritë e tyre. Për shembull, në një provim që nga ata kërkohet për të vazhduar recitimin e një ajeti ku do që të fillohet, ata duhet të dinë të gjithë tekstin në mënyrë që të jetë i sigurt kalimi nga provimi. Në një tjetër provë, ai që do ta mbrojë hafëzllëkun mund të kërkohet të recitojë ajete që përmbajnë një fjalë të veçantë të përafërt apo fraza më të veçanta për të dëshmuar fortësinë e të mbajturit mend të hifzit.[9]

Shumica e hafëzëve kanë mësuar si fëmijë, në shkollat speciale islame apo medrese, rregullat e recitimit - texhvidit si dhe mësimin e Kuranit në kujtesë - përmendsh. Mësimi përmendsh i Kuranit ishte i rëndësishëm për myslimanët në të kaluarën dhe është edhe në të tashmen. Çdo vit, mijëra nxënës zotërojnë përmendsh Kuranin të plotë apo pjesërisht. Ky proces zakonisht merr mes 3 deri në 6 vjet me kohë të pjesshme së bashku me shkollimin. Sot, shumë njerëz janë në gjendje ta recitojnë Kuranin rrjedhshëm pavarësisht se nuk janë folës të arabishtes. Kurani është i vetmi libër që është memorizuar tërësisht nga miliona njerëz.

Fakti i mësimit përmendsh i Kuranit e ka bërë aq të shtrenjtë atë, saqë tërë brezat e historisë islame nuk kanë lejuar rënien interesimit për të.

[9] Fadailu elKuran ve mualimuhu ve adabuhu Li ebi ubejd el Kasim bin Selam, fq.79.

## Vlera e hifzit në hadithet e Pejgamberit a.s.

Muhamedi a.s. deklaroi se ka shumë përfitime dhe shpërblime për atë që e mëson dhe studion Kuranin. Disa thënie të Muhamedit a.s. në lidhje me mësimin e Kuranit:

*"Më i miri prej jush është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson atë të tjerëve."*[10]

*"Superioriteti i fjalës së Allahut mbi të gjitha fjalët e tjera është si superioritetit i Allahut mbi gjithë krijimin."*[11]

*"Në ditën e gjykimit, hafëzit të përkushtuar për Kuran do t'i thuhet: "Lexoje Kuranin, dhe vazhdo ngrihu në katet e parajsës dhe recito-këndo në mënyrë të ngadaltë siç ke recituar-kënduar në jetën e asaj bote (dynjaje). Fundi juaj përfundimtar do të jetë ku t'ju arrijë ajeti i fundit."*[12]

*"Kushdo që lexon një shkronjë nga libri i Allahut do të marrë një të mirë prej saj (d.m.th. recitimit të tij) dhe çdo e mirë shumëzohet me dhjetë. Unë nuk them se Elif - Lam - Mim është (konsiderohet si) një harf, në vend Elifi është një shkronjë, Lami është një shkronjë dhe Mimi është një shkronjë."*[13]

*"Lexojeni Kuranin, sepse ai do të dalë në Ditën e Gjykimit si një ndërmjetësues për lexuesit e tij."*[14]

*"Ai që është i aftë për ta mësuar-lexuar Kuranin, do të jetë i nderuar dhe i shpërblyer. Dhe ai që ka vështirësi kur mëson-lexon Kuranin, do të marrë dyfishin e shpërblimeve."*[15]

*"Në Ditën e Kiametit një kurorë e - madhështi - e tillë do të vendoset në kokat e prindërve të atij që e lexon Kuranin dhe i praktikon li-*

[10] Buhariu, fq.4937.
[11] Et-Tirmidhiu, fq. 2906.
[12] Buhariu, fq.4936.
[13] Ahmedi, fq.11778.
[14] Muslimi, fq.817.
[15] Buhariu, fq.4938.

*gjet e tij, që vezullimi i tij do të shkëlqejë më me shumë madhështi se drita e diellit që rrezon shtëpitë tuaja. Atëherë, cila mendoni se do të jetë pozita e atij që vetë ka mësuar Kuranin dhe ka vepruar në përputhje me të?"*[16] *"Kushdo që e mëson përmendsh Kuranin dhe e praktikon atë që është e lejuar dhe përmbahet nga ajo që është e ndaluar, ai do të hyjë në xhenet dhe Allahu do t'ia pranojë ndërmjetësimin e tij për dhjetë vetë nga të afërmit e tij që kanë qenë të destinuar për të hyrë në xhehenem."*[17]

## SI TË BËHEMI HAFËZ
## Metodat dhe teknikat e hifzit

Mësimi i Kuranit përmendsh për myslimanët është farz kifaje. Pra, nëse një grup i tyre e mëson përmendsh, atëherë mbi myslimanët e tjerë përgjegjësia për përmbushjen e këtij obligimi bie. Ata që ngarkohen me këtë detyrë për të përmbushur, Muhamedi a.s. i ka paralajmëruar se do të marrin grada të larta në ahiret. Kjo në fakt, është rruga drejt niveleve më të larta shpirtërore dhe morale. Dashuria ndaj Kuranit fisnik është manifestuar në forma të shumta. Një nga gjërat thelbësore është kontakti i vazhdueshëm me Kuranin përmes recitimit të saktë dhe reflektimit mbi përmbajtjen e tij[18]. Prandaj, ai i cili dëshiron ta mësojë përmendsh Kuranin, ai ka menduar ta lexojë atë shpesh. Kjo do t'i mundësojë atij që të shprehë - të theksojë fjalët me korrektësi dhe rrjedhshmëri dhe që është thelb i rëndësishëm në procesin e mësimit përmendsh. Kurani është libër që përbëhet nga më shumë se 600 faqe, tekst të dendur, ashtu që një person për të mësuar përmendsh kërkohet këmbëngulje me të vërtetë e madhe, si dhe një sakrificë nga çdo gjë që mund të shqetësojë apo largojë nga procesi i përmbushjes të kësaj ënd-

[16] Ahmedi fq. 11870 dhe Ebu Davudi, fq.4843.
[17] Tirmidhiu, fq. 2907.
[18] E neshr fil kirati el asshere Ibni Xhezeri, fq.3.

rre të hifzit. Rrjedhimisht, vetëm një këmbëngulje e shquar, punë e vazhdueshme, dashuri e pashoqe ndaj Kuranit mund të çojë në mbajtjen e tij në mend.

Kurani është fjala e Allahut xh. sh.," leximi" është parim dhe bazë që i duhet kushtuar vëmendje, se të lexuarit, mësuarit, vetë, apo edhe të tjerët, është një detyrë për myslimanët që duhet të krijojnë sa më shumë lehtësi. Sot, për mësimin e Kuranit, është fakt se aplikohen metoda të ndryshme.

Për shkak të metodave të ndryshme të përdorura për leximin dhe mësimin përmendsh, ka pasur rezultate të ndryshme. Të gjitha këto studime dhe metoda të përdorura janë bërë për të arritur rezultate më efikase, dhe kohë më të shkurtër, për të lehtësuar punën e nxënësit pak më shumë, prandaj nuk duhet hamendur për të planifikuar dhe vënë ato në praktikë, siç do ta bëjmë ndarjen e tyre në vijim.

Arsyet që na shtyjnë ta bëjmë një gjë të tillë janë: vetë leximi është adhurim, si në namaz, në lutje etj. Pastaj për shërbimet e tjera fetare, si për nxjerrjen e dispozitave nga Kurani etj. Mësimi i mënyrave të leximi të Kuranit rivajeteve, leximin e tyre, hafëzllëkun sipas tyre dhe leximi i tyre një nga një.

Mësimi i rrjedhshëm i leximit është themeli i parë i kandidatit për hifz. Kjo është një bazë shumë e mirë për të arritur qëllimin e synuar, prandaj me kujdes duhet të merret leximi dhe çka kërkohet në këtë fazë fillestare. Disa nga çështjet që duhet të merren parasysh gjatë periudhës së leximit:

a) Të mësuarit e leximit të rrjedhshëm është i domosdoshëm për të filluar hifzin e Kuranit dhe duhet të përshtatet për nivelin e nxënësve duke shpjeguar çdo rregull.[19]

[19] El vafi fil kiraatil ashere, fq. 32.

b) Duhet përdorur edhe shkrimi për sqarime të nevojshme dhe për të përforcuar leximin ose memorizimin, përdorimi edhe i CD-ve, VCD-së dhe kasetave nga lexues të mirënjohur të Kuranit.

c) Në fillim mësimi i shkronjave në një formë, pastaj formën e secilës prej shkronjave, emrin, cilësitë, karakteristikat, kur qëndron vet dhe së bashku me shkronjat tjera dhe t'i mësojë tingujt e secilës shkronjë, si dhe ngjashmërinë në aspektin e formës dhe të dallimeve të tjera.

d) Për të lexuar siç duhet, në proporcion me aftësinë e nxënësit zgjerohet në rregullat e leximit, ai mëson si të ndalet dhe të fillojë, mëson secilën rregull në vete, çështjet duhet të trajtohen nga më të nevojshmet dhe më shumë hasura gjatë leximit etj.

e) Një nxënës nuk duhet të nënvlerësohet në krahasim me suksesin e dikujt tjetër, duke i dhënë përparësi njërit e duke e nënçmuar tjetrin.[20]

## Kategoritë e mësimi të Kuranit përmendsh

Është e rëndësishme të kuptohet se ky proces ndahet në tri kategori:

1) mësim të ri;

2) memorizim të faqeve të reja /brenda muajit;

3) memorizimi të faqeve të vjetra/ para një muaji.

Për çdo kategori do të bëjmë një hyrje të shkurtër dhe pastaj të tregojmë se si duhet mësuar përmendsh brenda çdo dite dhe jave. Është e rëndësishme të kuptohet se mësimi përmendsh i Kuranit është një proces që nuk përfundon për një muaj. Pasi ta keni mësuar përmendsh një ajet, ai nuk do të jetë i fortë deri sa të përsëritet disa herë dhe deri sa të hyjë në shtresën më të thellë të trurit.

[20] Et-Tibjan fi adab hameletil Kuran, fq. 16.

## Mësimi i ri

Kjo është situata kur ju do të memorizoni nga e para. Nëse fillohet me mësimin përmendsh, do të duhet të ndiqni këto këshilla pikërisht ashtu si janë shënuar më poshtë:

1 ) Duhet lexuar faqen 10 herë, nga lart poshtë;
2 ) Lexon ajetin e parë në faqe 10 herë;
3 ) Pastaj e lexon të njëjtin ajet 10 herë pa e shikuar atë, derisa të mund ta lexoni atë pa gabime.
4 ) E filloni lidhjen e ajeteve. Lexojeni ajetin e parë dhe të dytë së bashku pa shikuar në të dhe pa gabime.
5 ) Lidhini ajetet në faqe. Çdoherë kur lidhni një ajet të ri, shkoni përsëri në krye të faqes dhe lexoni deri te ajeti që e keni mësuar përmendsh.
6 ) Kur të keni arritur ajetin e fundit, ju duhet të lexoni tërë faqen nga lart pa e shikuar dhe pa gabime.
7 ) Lexohet faqja duke u përcjellë nga muhafizi.
8 ) Këta hapa të mësipërm janë të nevojshëm që ta keni memorizuar mirë një faqe.

## Mësimet e reja

Kjo ka të bëjë me atë që ju keni memorizuar në 30 ditët e fundit. Merreni këtë pjesë seriozisht, ajo do të përcaktojë nëse ajetet e memorizuara do të jenë të forta për tërë jetën tuaj apo jo. Për 25 ditë rresht duhet rishikuar ajetet, pas këtyre 25 ditëve, rishikimin njëherë në muaj do të mjaftojë. Kjo do të çojë në mësimin përmendsh të vjetër rreth të cilin do të sqarojmë më poshtë:

1) Ajetet e mësuara gjithherë duhen lexuar para dikujt që i ka të memorizuara, ose është shumë i aftë në leximin e Kuranit.

2) Nëse ju i keni memorizuar pesë faqe në pesë ditët e fundit, ju duhet t'i lexoni ato në vetvete deri sa nuk do të bëni ndonjë gabim. Më pas ia lexoni ato ndonjë mësuesi.
3) Nga kjo pikë e tutje, çdo gjë që ju keni mësuar përmendsh duhet të lexohet çdo ditë. Kur them të lexohet, kjo nënkupton shqyrtimin e vetes për gabime dhe të recituarit te dikush tjetër.
4) Nëse për ndonjë arsye ju nuk e keni shqyrtuar mësimin 'e ri' përmendsh, atëherë nuk duhet mësuar përmendsh ajete të reja. Çdo ditë nëse nuk do të shqyrtoni "mësimin e ri përmendsh, jeni do të ngarkoheni aq shumë sa nuk do të mbani mend asgjë.
5) Mund të tingëllojë disi e tepërt këtu, por është me rëndësi të shqyrtohet mësimin i ri përmendsh, ngase ky fakt do të ketë ndikim të madh në hifzin tuaj.
6) Nëse keni mësuar përmendsh një faqe në ditë, do të përfundoni një xhuz në 20 ditë. Pas këtyre njëzet ditëve, duhen marrë pesë ditë shtesë për të shqyrtuar të gjithë xhuzin me dikë që është i aftë në këtë drejtim.
7 ) Xhuzi, që ju keni memorizuar, tani do të konsiderohet pjesë e" mësimit të vjetër përmendsh". [21]

## Përsëritja përmendsh e faqeve të vjetra

Kjo është diçka që ju e keni memorizuar-lexuar për të paktën njëzetepesë ditë rresht. Pasi ta keni memorizuar një pjesë të caktuar, nuk do të filloni asgjë të re, deri sa të përforcohet mësimi i vjetër. Kjo do të sigurojë për të mbajtur mend tërë jetën nga ato pjesë.

Një sqarim për secilin që di përmendsh nga një xhuz e më shumë:

Ndërmjet 1 deri 3 xhuza duhet përsëritur pesë faqe në ditë.

[21] Dm.th. secili xhuz që përfundohet në një mënyrë konsiderohet i vjetër se tani fillohet me faqe të reja në xhuzin tjetër të ri për mësim..

Ndërmjet 4-7 xhuza duhet përsëritur 10 faqe (që është e barabartë me gjysmën e xhuzit) çdo ditë.

Ndërmjet 7-15 xhuza duhet përsëritur 20 faqe (që është e barabartë me një xhuz) çdo ditë.

Ndërmjet 15-20 xhuza duhet përsëritur 30 faqe (që është e barabartë me 1.5 xhuz) çdo ditë.

Ndërmjet 20-30 xhuza duhet përsëritur 60 faqe (që është e barabartë me 2 xhuza) çdo ditë.

Gjatë këtyre përsëritjeve, kur keni ndonjë gabim, ndaleni aty, e korrigjoni mirë dhe e forconi hifzin derisa nuk mbetet asnjë dyshim. D.m.th., kur gjej që një ajet të jetë i vështirë, e shikoj në Mushaf dhe e shkruaj atë diku, e dëgjoj recitimin për të lehtësuar mësimin përmendsh, por gjithashtu edhe për ta përforcuar më mirë.[22]

## Një mënyrë tjetër nga ajo që u cek më lart për mësimin e faqes së re

Ajetin e parë e lexon njëzet herë,

Ajetin e dytë njëzet herë,

Ajetin e tretë njëzet herë,

Ajetin e katërt njëzet herë.

Këto katër ajete i lidh së bashku duke i lexuar njëzet herë.

Ajetin e pestë po ashtu e lexon njëzet herë,

Ajetin e gjashtë njëzet herë,

Ajetin e shtatë njëzet herë,

Dhe ajetin e tetë njëzet herë.

Pastaj i lexon ato së bashku njëzet herë.

Në fund i lexon nga ajeti të parë, d.m.th të tetë ajetet edhe njëzet herë dhe kështu i mban mirë në mend.

[22] Kjo është shumë domethënëse për shkak se hifzi kërkon precizitet dhe saktësi në lexim.

Me këtë metodë e mësojmë çdo faqe, pasi që të rritet kapaciteti i të mësuarit dhe në vend të një faqeje i mëson dy në ditë, por prapë e përdor këtë metodë.

**Shtrohet pyetja: Nëse nesër do të vazhdoj ta mësoj një faqe të re se, si duhet vepruar?**

Nëse doni ta mësoni një faqe të re me anë të metodave të lartpërmendura, atëherë vendi për mësim përcaktohet dhe ajo që është mësuar përsëritet deri njëzet herë për t'u përforcuar thellë në kujtesë. Pastaj fillon një faqe të re me të njëjtën metodë.[23]

## A nuk e mësojmë Kuranin pa përsëritje!

Përgjigjja është jo, sepse, edhe pse ju keni mësuar një faqe të re, duhet përsëritur faqja e parë, se do të shihni që ju keni harruar nga ajo shumë. Por nuk duhet brengosur shumë, sepse ajo është e mirë për të lehtësuar faqen e re.

Sipas kësaj metode, Kuranin ndahet në tri pjesë, ku çdo pjesë ka dhjetë xhuza. Kur mësohet një faqe e re në ditë, përsëriten katër faqe të vjetra dhe kështu me radhë deri sa të mësohen dhjetë xhuza. Kur të mësohen dhjetë xhuza, atëherë pushojmë nga të mësuarit e faqeve të reja për një muaj, për t'i përsëritur çdo ditë tetë faqe të këtyre dhjetë xhuzave të mësuar.

Pas një muaji do të fillojë mësimi përmendsh i dhjetë xhuzave të tjerë. Mësimi të jetë një ose dy faqe në ditë, në varësi të aftësive për të përsëritur çdo ditë tetë faqe derisa t'i mësoni njëzet xhuza. Kur të mësohen njëzet xhuza, atëherë prapë ndalojmë nga të mësuarit e faqeve të reja dhe bëjmë një pushim prej dy muajsh për të përsëritur çdo ditë se çfarë kemi mësuar deri tani nga 20 xhuzat. Pas dy muajsh fillojmë mësimin e dhjetë xhuzave të fundit të Kuranit, me një ose dy faqe në ditë,

[23] Këtë praktikë e mbajnë një numër i muhafizare në haremin e Mekës dhe Medinës me kandidatët e tyre për hife.

sipas aftësisë dhe mundësisë së kohës në dispozicion që mund ta shfrytëzojë, por prapë bëhet përsëritja çdo ditë nga tetë faqe, derisa të përfundojë gjithë Kurani.[24]

Kur të keni mbaruar të tërë Kuranin, atëherë bëni përsëritje vetëm dhjetë xhuzat e parë për një muaj, çdo ditë nga gjysmë xhuzi (10 faqe). Kur t'i përfundoni këta xhuza, përsëritni deri në xhuzin e njëzetë, por duke i shtuar edhe nga tetë faqe nga xhuzat e parë, vetëm duke i lexuar për një muaj. Pastaj të vazhdoni me dhjetë xhuzat e fundit, por përsëri duke i përsëritur nga tetë faqe në dhjetë xhuzat e parë dhe të mesëm.

## Si duhet përsëritur tërë Kuranin, vërtetimi nëse je bërë hafëz me këtë metodë?

Fillojeni ripërsëritjen e tërë Kuranit: çdo ditë nga dy xhuza, për të përfunduar një hatme çdo dy javë.

Çfarë duhet bërë një vit më vonë kur të përfundojë i gjithë Kurani?

Pas një viti, kur e ke përfunduar hifzin, përsëritjen e Kuranit, e bën duke ndarë leximin e Kuranit në shtatë pjesë, d.m.th çdo të shtatën ditë përfundon hatmen e Kuranit të Shenjtë. Tregohet nga Evs Ibn Hudhejfe të ketë thënë: "I pyeta shokët e Pejgamberit, sallallahu aleljhi ve selem, se si duhet ndarë Kuranin për ta lexuar. Ata më thanë: Tre, pesë, shtatë, nëntë, njëmbëdhjetë, trembëdhjetë …"[25]

[24] Kjo metodë nuk ka shtrirje të gjerë, por e praktikojnë në mënyrë individuale disa kandidat për hifz.

[25] Ahmedi, fq.58, 69.

**Shpjegim si mund ta ndajmë leximin për ta përfunduar hatmen për shtatë ditë:**

Në ditën e parë lexojmë prej sures El-Fatiha deri në fund të sures E-Nnisa.

Në ditën e dytë prej sures El -Maide deri në fund të sures E - Tevbe.

Në ditën e tretë prej sures Junus deri në fund të sures El- Nahl.

Në ditën e katërt prej sures Isra deri në fund të sures El- Furkan.

Në ditën e pestë suren Shuara deri në fund të sures Yasin.

Në ditën e gjashtë nga surja Saffat deri në fund të sures El- Huxhurat.

Dhe në ditën e shtatë nga surja Kaf deri te surja E- Nas (fund i Kuranit).

Ky lexim është mjaft i praktikuar.[26]

## Si veprojmë për t'i dalluar ajetet e ngjashme ('mutashabih)?

Mënyra më e mirë për të dalluar mes dy ajeteve të ngjashme në faqe të ndryshme është analizimi me kujdes deri në gjetjen e një ndryshim mes tyre. Pastaj duhet përcaktuar vetes një rregull: që sa herë që ju vijnë ajete të tilla, ju kushtoni vëmendje të veçantë.

Disa rregulla për hifz të Kuranit nga kjo metodë:

- Të jetë i sigurt që ju keni për të mësuar nga hafëzi i mirë për t'i korrigjuar gabimet.
- Mëson çdo ditë dy faqe, një pas sabahut dhe një pas ikindisë ose akshamit. Me këtë metodë ju plotësisht dhe në mënyrë të sigurt do ta mësoni Kuranin gjatë një viti.[27] Nëse shton për më shumë se dy faqe në ditë, do të harroni faqet që ju keni mësuar më parë shumë shpejt.

[26] Këtë praktikë e kanë përmendur nëpër librat e vlerave të leximit të Kuranit nga Ebu Ubejde dhe disa dijetarë bashkëkohorë në mënyrë gojore si Ejmen Suvejd etj.

[27] Do theksuar këtu se me këtë metodë kam përfunduar edhe unë hifzin në Medine Munevere në vitin 1990.

- Mësimi duhet të fillojë nga surja E-Nas deri te El-Bekare, sepse ajo është më e lehtë, ndërsa përsëritjen e fillon nga surja El-Bekare deri në fund kur e përfundon krejt Kuranin.
- Mësimi përmendsh duhet të bëhet nga e njëjta kopje e Kuranit, e cila do të ndihmojë për fiksimin më të mirë në kujtesë të vendit ku ajetet janë, si dhe fillimet dhe fundet e faqes.
- Kushdo që e mëson Kuranin, dy vitet e para pasi ta ketë mësuar, etapë që studiuesit e quajnë periudha e mbledhjes, nuk duhet merakosur për atë që është harruar dhe për gabimet në të lexuar, sepse kjo është një periudhë e vështirë e trysnisë që vjen edhe nga shejtani i mallkuar për të parandaluar dhe ftohur nga të përforcuarit e Kuranit përmendsh. Duhet qëndruar larg nga këto dyshime dhe duhet vazhduar në mësim dhe përsëritje, sepse Kurani është një thesar i çmuar nëse arrin ta bartë atë në memorie.

**Metodat tjera të mësimit përmendsh të Kuranit janë:**

- **a Metoda sipas renditjes së Mus'hafit;** kur një kandidat i përmbahet në mënyrë tekstuale radhitjes së Kuranit, sipas rendit që është e shkruar në Mus'haf prej fillimit deri në fund. Kjo metodë është e mirë në rastin e një kandidati, i cili e kupton gjuhën arabe dhe është në gjendje për të parë lidhjet ndërmjet kuptimeve të ajeteve. Gjithashtu, nëse një kandidat nuk e arrin qëllimin e tij për t'u bërë një Hafëz, ai ende do të ketë pjesë të plota (kapituj, hizba, xhuza), të cilat ai kishte të mësuar përmendsh dhe kjo sigurisht që është një gjë shumë e dobishme.
- **b Metoda prej fundit të Mus'hafit;** është të mësuarit nga suret e shkurtra prej fundit të mus'hafit e deri te suret e gjata, apo fillimi i Kuranit. Kjo metodë praktikohet në shumë vende në Arabi, sidomos në shkolla fillore dhe të mesme.

- **c Metoda me devra;** është situata kur kandidati nuk i merr faqet e Kuranit sipas rendit në Mus'haf, por ndjek një rend tjetër. Siç e dimë se Kurani është i ndarë në 30 xhuza, ku secili xhuz është i përbërë nga 20 faqe. Kandidati së pari merr faqen e fundit të xhuzit të parë, xhuzit të dytë, xhuzit të tretë e deri në fund të xhuzit të tridhjetë, ky është një dever. Pastaj kthehet në xhuzin e parë, e merr faqen e parafundit dhe kështu vazhdon të gjithë xhuzat deri në fund, ky është devri i dytë. Kështu edhe devrat tjerë i përfundon. Karakteristikë e kësaj metode është se në çdo devër të ri fillimisht përsëriten të kaluarat para muhafizit të tij. Kjo është vendimtare që një Hafëz i ardhshëm përsërit rregullisht faqet e vjetra dhe se muhafizi nuk i jep atij leje për të lëvizur për faqet e reja para se t'i kontrollojë apo verifikojë faqet e vjetra para tij. Duke përfituar nga kjo metodë kandidati freskon tekstin e memorizuar, që është i rëndësishëm në procesin e nxënies së Kuranit përmendsh. Kjo metodë praktikohet në Turqi dhe vendet e Ballkanit, por edhe në disa vende të shteteve të lindjes, kryesisht ish-republikat ruse.

Edhe pse metoda e parë ka të caktuar shumë avantazhe, megjithatë ajo karakterizuar nga disa mangësi, pasi që ajo nuk ofron një mënyrë sistematike për të mbajtur faqet e memorizuara më parë. Pasi fillon mësimin përmendsh të Kuranit, kandidatit i duket sikur i kalon koha, tërhiqet nga faqet e reja që i duken më të mira, por problemi lind kur ai përpiqet për të mbajtur dhe për të ruajtur atë që ai kishte memorizuar më parë. Natyrisht, ai dëshiron që të angazhohet për t'i futur në kujtesë faqet e reja sa më shpejt të jetë e mundur, por ka një problem për t'i mbajtur të vjetrat.

## Si duhet vepruar për t'i ruajtur faqet nga harresa?

Nuk ka asnjë mënyrë tjetër pos përsëritjes. Natyrisht, një kandidat i cili zgjodhi metodën e devrave mund ta përsërisë tekstin tashmë të memorizuar në masë të njëjtë, por me metodat tjera është i detyruar për të freskuar faqet e vjetra në mënyrë tjetër që nuk mund të mbajë baraspeshë të njëjtë mes faqeve. Ky është njëri nga shkaqet që ne e rekomandojmë metodën e devrave për t'u përdorur, në veçanti për ata kandidatë që nuk e dinë gjuhën arabe dhe janë në gjendje për të marrë përfitimet e ofruara nga kjo metodë.

## Disa rregulla të përgjithshme që do të ndihmojnë në mësimin përmendsh të Kuranit

*1. Ihlasi - (Sinqeriteti)*

Pastrimin e qëllimit se për çka po e mëson Kuranin, që ai bëhet vetëm për hir të Allahut të Lartësuar dhe për të fituar shpërblimin dhe kënaqësinë e Tij.

Në të kundërtën, nuk ka asnjë shpërblim për atë i cili reciton Kuranin dhe memorizon atë për të treguar famë dhe për t'u dëgjuar zëri e autoriteti i tij. Nuk ka dyshim se ai, i cili lexon Kuranin duke dashur të mirat në këtë botë dhe duke kërkuar një lloj shpërblimi të kësaj bote, mund të bëhet edhe mëkatar.[28]

*2. Korrigjimi i drejtshqiptimit - drejtleximit*

Hapi i parë në mësimin përmendsh të Kuranit, pas Ihlasit është korrigjimi i drejtshqiptimit dhe leximit të Kuranit. Kjo nuk arrihet vetëm duke dëgjuar prej recituesve-lexuesve të mirë apo memorizuesve të saktë të Kuranit. Kurani nuk mësohet vetëm duke imituar atë (nga një tjetër). Kështu, i Dërguari i cili është më i dalluari nga arabët në shqiptim, e mori atë nga Xhibrili (as) me gojë. Vetë i Dërguari ka përdorur

[28] Ahlak hameletil Kuran lil Axhuri e Sekenderi, fq.35.

për të recituar Kuranin para Xhibrilit një herë në çdo vit, madje në vitin që vdiq ia recitoi-këndoi atij dy herë.[29]

Po kështu, i Dërguari ua mësoi sahabëve ( r.a.) me gojë dhe ata që erdhën pas tyre, e dëgjuan nga sahabët dhe kështu me radhë për çdo brez pas tyre.

Pra, është detyrë për të marrë Kuranin nga një recitues e njohës i mirë i rregullave të leximit dhe ashtu të përcillet te të tjerët.

*3. Specifikimi i një limiti ditor për mësimin përmendsh*

Për atë që dëshiron ta mësojë përmendsh Kuranin është e nevojshme t'i vendosë vetes një limit ditor për memorizim. Një numër i ajeteve për shembull, ndoshta një faqe ose dy faqe apo edhe një e teta e një xhuzi (një e tridhjeta e Kuranit). Kështu, pasi ai e ka korrigjuar recitimin dhe ka vendosur kufirin e tij të përditshëm, nis të mësojë nga përsëritja e shpeshtë. Është gjithashtu e nevojshme që kjo përsëritje të bëhet me melodi, mënyrë kjo që përkon me sunetin në radhë të parë, gjë që e përforcon edhe më shumë hifzin. Recitimi melodioz është i kënaqshëm për t'u dëgjuar dhe ndihmon në mësimin përmendsh. Për më tepër, gjuha gjithmonë do të kthehet në një ton të veçantë të zërit dhe si rezultat i kësaj ai do të bëhet i njohur me ndonjë gabim, sa herë që e përsërit atë përmes tonit të zërit. Kënduesi do të dijë, se gjuha e tij nuk do të pajtohet me të kur ai bën një gabim, dhe se në qoftë se toni është i gabuar ose nga mendja dhe mësimi përmendsh i drejtë do t'i kthehet atij.

E gjithë kjo është për shkak se duke lexuar Kuranin dhe zbukuruar atë me zë melodik është traditë e cila është urdhëruar. Nuk është e lejuar të anashkalohet ky fakt për shkak të thënies së të Dërguarit: "Kushdo që nuk e zbukuron Kuranin (kënduar me melodi) ai nuk është prej nesh."[30]

[29] Po aty,fq.35.
[30] Buhari, fq,5025.

### *4. Mësoni përmendsh duke përdorur të njëjtën kopje (Mus'haf) të Kuranit*

Në mesin e gjërave që ndihmojnë në mësimin përmendsh është se memorizuesi duhet të mbajë për vete një Mus'haf të veçantë (kopje të Kuranit), të cilin ai kurrë nuk duhet ta ndryshojë. Kjo është për shkak se një person i mëson përmendsh duke përdorur shikimin, ashtu si ai e mëson përmendsh duke përdorur mbajtjen mend. Regjistrohet forma e ajeteve dhe vendet e tyre në Mus'haf dhe nguliten më mirë në mendje kur ato lexohen dhe shikohen shpesh. Nëse memorizuesi e ndryshon Mus'hafin, nga i cili ai mëson përmendsh, ose në qoftë se ai ka mësuar përmendsh nga një numër i kopjeve të ndryshme vendet e ajeteve do të ishin në vende të ndryshme dhe gjithashtu shkrimet mund të jenë të ndryshme. Kjo e bën mësimin përmendsh të vështirë për të. Prandaj, është obligim për atë që kërkon të nxë përmendsh Kuranin ta bëjë këtë nga një dorëshkrim i vetëm i Mus'hafit dhe kurrë nuk duhet të zëvendësojë atë me tjetër.[31]

### *5. Kuptimi është rruga që lehtëson memorizimin-hifzin*

Në mesin e gjërave, të cilat në masë të madhe e ndihmojnë procesin e mësimit përmendsh, është të kuptuarit e ajeteve dhe njohuria për lidhshmërinë e tyre. Kjo është arsyeja pse është e domosdoshme për memorizuesin për të lexuar tefsire - shpjegime të atyre ajeteve që ai dëshiron t'i mësojë përmendsh. Por duhet ditur se përsëritja me gjuhë aq sa ajo kalon ajete, është themeli i hifzit edhe nëse kuptimi nuk mund të nxihet. Sa i përket atij që mbështetet vetëm në kuptim, atëherë ai do të harrojë shpesh dhe recitimi i tij do të jetë i shkëputur për shkak të mendjes së tij të ngarkuar me gjëra të tjera. Kjo ndodh shpesh, sidomos kur recitimi është i gjatë.[32]

---

[31] Ihja ulumid-Din, vell. I., fq. 78.
[32] Et-Tibjan fi adab hameletil Kuran, fq.46. Fadailu el Kuran li Ebi Ubejd, fq.37.

*6. Recitimi para muhafizit (leximi tjetrit)*

Është e nevojshme për memorizuesin të mos e mbajë në vete mësimin përmendsh të Kuranit. Përkundrazi, ai duhet të testojë mësimin përmendsh duke recituar ajetet apo suret në fjalë para dikujt tjetër, ose ai duhet t'i lexojë ato më pas në Mus haf. Puna më e shkëlqyer do të ishte, në qoftë se do të testonte mësimin përmendsh të tij para një muhafizi të saktë. Në këtë formë memorizuesi bëhet i vetëdijshëm për mundësinë nëse diçka ka harruar ose ka ngatërruar në recitimin e tij (pa e vënë re). Shumë individë mes nesh, që mësojnë përmendsh një sure, bëjnë gabime dhe nuk mund t'i kuptojnë derisa e konsultojnë Mus'hafin ose ua thotë dikush që i dëgjon. Për këtë arsye recitimi para muhafizit është një mjet për të perceptuar këto gabime dhe për të qenë vazhdimisht në dijeni të tyre.[33]

*7. Kthimit i vazhdueshëm në atë që është memorizuar*

Kurani është i ndryshëm nga çdo material tjetër që është memorizuar, si poezi dhe prozë, ngase ai humbet më shpejt nga mendja. Në fakt i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Pasha Atë në Dorën e të cilit është shpirti im, Kurani ikën më shpejt se një deve që lëshohet nga litari saj."*[34]

Nëse ke memorizuar Kuranin kohët e fundit, mos e lër për një kohë papërsëritur, sepse ai ikën larg dhe nuk mund ta kthesh prapë siç e ke pasur. Kjo është arsyeja pse përsëritja është vazhdimisht domosdoshme, ngase ai shpejt largohet nga mendja.[35]

*8. Duhet përfituar nga vitet e arta për memorizim*

Është i sigurt suksesi dhe përparësia nëse shfrytëzohen vitet më të mira për mësim përmendsh, përafërsisht mosha 5-23-vjeçare. Aftësia e

[33] Ahlak hameletil Kuran lil Axhuri e Sekenderi, fq. 42.
[34] Buhariu, fq. 5065, Muslimi, fq.803.
[35] EL adab hameletil Kuran lil Axhuri e Sekenderi, fq. 43.

një personi për të mësuar përmendsh gjatë këtyre viteve është shumë e mirë. Në fakt këto janë vitet e arta të të mbajturit mend. Prandaj, është e nevojshme për një person për të mbajtur veten të përkushtuar gjatë viteve të jetës së tij, mësimin përmendsh të Librit të Allahut sa më shumë që ai mundet.

Mbajtja e gjërave në kujtesë në këtë moshë mund të bëhet shumë shpejt dhe shumë më lehtë, përkundër asaj që ndodh pas kësaj moshe, ku mësimi përmendsh realizohet me vështirësi dhe harrohet më shpejt. E vërtetë është thënia: Memorizimi në rini është si gdhendje në gur dhe memorizimi kur është i vjetër si gdhendje në ujë.

Kështu, është e nevojshme për të gjithë të përfitojnë nga vitet e arta. Në qoftë se nuk kemi mundur atëherë, ne duhet t'i inkurajojmë bijtë dhe bijat tona për të bërë këtë.[36]

### *9. Largimi nga mëkatet*

Ai që dëshiron të bëhet një Hafëz duhet të mbrojë veten nga mëkatet dhe duhet ta rregullojë jetën e tij në mënyrë që ajo të dakordohet me mësimet e Kuranit. Qëndrueshmëria në adhurim ndriçon zemrën, sjell qetësi dhe çon në pastërtinë e mendjes dhe gatishmërinë për të mësuar. Shoku i njohur i Pejgamberit a.s., Abdullah ibn Mesudi, ka thënë: "Unë besoj se një njeri do ta harrojë atë që ai e dinte vetëm për shkak të mëkateve të kryera nga ai. "Imam Malik Ibn Enesi u pyet nëse kishte diçka që ndihmon në hifz, dhe ai u përgjigj: "Në qoftë se diçka është i dobishëm në këtë drejtim, është e braktisja e mëkateve."[37]

### *10. Përsëritja sistematike forcon atë që është mësuar*

Procesi i përsëritjes është aq i rëndësishëm sa vetë të mësuarit dhe për këtë arsye kërkon vëmendje të madhe. Mund të thuhet se përsëritja është edhe më e rëndësishme se të mësuarit, sepse përsëritja është më e

[36] Ihja ulumid-Din, vell. I.267.
[37] Fadailu el Kuran ve mualimuhu ve adabuhu fq.79.

vështirë dhe kjo kërkon përpjekje të madhe dhe durim. Pa përsëritje, faqet e kaluara janë harruar shpejt. Imam Xhafer el-Sadiku ka thënë: "Zemra është toka, njohuritë janë bimët dhe përsëritja është uji. Kur toka është e privuar nga uji, vegjetacioni do të bëhet i thatë."[38]

*11. Lutja-duatë e vazhdueshme*

Lutja e vazhdueshme ndaj Krijuesit dhe duke kërkuar ndihmë nga Ai është rruga e një besimtari për lehtësimin e të gjitha vështirësive. Ai i cili është në ndjekje të hifzit duhet të lidhet në mënyrë të vendosur me Allahun dhe vazhdimisht përgjërohet për ndihmën e Tij. S'ka dyshim se Allahu kurrë nuk do të refuzojë një lutës të sinqertë, siç thotë në Kuran:[39]

***"E kur robërit e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes së lutësit[40]…"*** Qëndrueshmëria në adhurim ndriçon zemrën, sjell qetësi dhe çon në pastërtinë e mendjes dhe gatishmërisë për të mësuar.

Në përfundim të këtij trajtimi për metodat e teknikat e hifzit do t'ua preferonim kandidatëve për hifz që të motivoheshin sipas këtyre metodave, të zgjedhin atë që u përshtatet e të fillojnë hifzin, ngase çka fillohet shpresohet që përfundohet. Allahut i qofshim falë që e bëri Kuranin të lehtë për hifz!

[38] Po aty, fq.80.
[39] Fadailu el Kuran li Ibni Kethirr në fund të tefsirit vëllim IV Fq.455.
[40] El bekara ajeti 186.

## Literatura:

1. "Et-Tibjan fi adab hameletil Kuran" En-Nevevij.
2. "Menahilul-urfan fi ulumil-kuran"Ez-Zerkani.
3. Ebi Beker Muhamet bin Husejni el axhuri el Bagdadi “Ahlak hamletel Kuran lil axhurij” 2005 El Iskenderije
4. Medhal fi dirasat el Kuran el Kerim Dr.Muhamet Shehbe Darul Liva
5. Fadailu elKuran ve mualimuhu ve adabuhu Li ebi ubejd el Kasim bin Selam.
6. "Fethul Bari sherh sahihul Buharif lbni Haxher.
7. Sahihul Muslim bi sherh En- Nevevij.
8. "Es- Sunen". Ebu Davud.
9. Tirmidhiu, Sunen, daral - hadith, Kairo.
10. El-Darimi: Sunen, Dar al-Rayyan, Kajro, botimi 1,
11. Ibn Hibban, Bejr.
12. Fadailu el Kuran li Ibni Kethirr ne fund te tefsirit ut.
13. Ihja ulumid-Din, vell. I.267.
14. Rregullat e leximit të Kur`ani Kerimit Ibni Xhezeri.
15. E neshr fil kirati el asshere Ibni Xhezeri.
16. Xhamij li ahkamil Kuran, Kurtubi El Garnatij.
17. Fadailu el Kuran ve mualimuhu ve adabuhu.
18. EL adab hameletil Kuran lil Axhuri e Sekenderi.
19. Fjalori Arabisht-Shqip I-II, hartuar nga dr. Isa Memishi.

## - Summary -

The tradition of learning the Qur'an by heart dates from the era of the Prophet (saws). He knew the Qur'an by heart, and encouraged others to learn it, as much as possible. From its revelation, the Qur'an has been recorded in people's minds and written from it. Thanks to such recording, the Qur'an has been preserved with no changes. Inspired by Muhammed (saws), who was Hafiz himself, and his declarations of praise for those learning all Qur'an by heart, Muslims compete in learning the Qur'an. One of the aspects of i'jaz of Qur'an is manifested in the fact that it is a book that is learned entirely and fully.

Muhammed a.s. says in relation to learning of the Qur'an:

"The best among you (Muslims) are those who learn the Qur'an and teach it". (Sahih al-Bukhari)

During the life of Muhammad (saws) many Sahibs learned the Qur'an by heart. The Prophet (saws) paid so much attention to the learning of the Qur'an that whenever someone came from foreign countries to the Islamic State of Medina, he directed those people to the Sahibs, ordering them to teach the Qur'an entirely. Throughout the Islamic history, such interest was kept on the full learning of the Qur'an, thereby using various methods of learning.

All these studies and methods used were invented to reach more efficient results, shorter times and easier ways of the students.

Prof. ass. dr. Xhabir HAMITI

# ORIENTALIZMI DHE ORIENTALISTËT VIS-A-VIS KURANIT

Orientalizmi është emër i mendimit studiues perëndimor, i bazuar mbi ideologjinë e ndarjes mes Lindjes dhe Perëndimit. Ndryshe ky term përfshin studimet e shoqërive të Azisë, gjegjësisht Orientit në përgjithësi. Studimet e kësaj fushe janë aktivizuar në formë institucionale që nga shekulli 18, kur në universitete të rëndësishme të Evropës, si në Oksford, Wien, Tupingen, Paris, etj.

Në Gjermani dhe në vendet e Skandinavisë orientalizmi si term ishte ekuivalent.

Përkufizimi më i zakonshëm i orientalizmit në literaturën shkencore nënkupton " involvimin e studiuesve jolëndorë në gjuhët, civilizimin, filozofinë, literaturën dhe fetë e botës lindore, përmes studimeve dhe analizave krahasuese[1].

Ndërsa, fjala "orientalist", sipas fjalorit të fundit të Oksfordit, nënkupton personin i cili është aftësuar dhe profesionalizuar në hulumtimin dhe studimin e literaturës së Lindjes"[2].

Kurse, sipas Edward Saidit, orientalizmi si formë studiuese daton që nga koha e iluminizmit evropian për t`u riaktivizuar fuqishëm me

[1] **Muhammad Mohar Ali**, *The Quran and Orientalists*, IPSWCH, Oxford,2004, fq.17-19.
[2] 1 *Oxford English Dictionary*, fq.520, London, 1971.

fillimin e kolonizimit të botës arabe dhe islame"[3]. Prandaj, sipas tij, orientalistët janë ata që shkruan apo pikturuan stereotipa me porosinë e të tjerëve, për të krijuar paragjykime ndaj popujve të Lindjes së Mesme në veçanti. Këtë formë të studimeve orientale, para dhe pas kolonizimit të botës arabe dhe islame, Saidi e quan "orientalizëm i fshehur", sepse diskursi i orientalistëve gjatë gjithë historisë së tij, në të shumtën e rasteve, e ka përshkruar botën lindore si një diçka të errët dhe misterioze[4].

Studiuesit myslimanë i përshkruajnë orientalistët si grup i autorësh jomyslimanë nga bota e perëndimore në veçanti, të cilët kanë përdorur ideologjinë dhe metodologjinë perëndimore për të studiuar Islamin dhe mësimet e tij[5].

## Gjuhët e para të studiuara nga orientalistët

Hebraishtja bashkë me gjuhën syrianic (siriane) dhe caldeane (kaldeane) kanë gjuhët e para me të cilat u morën studiuesit e parë të orientalizmit. Ndryshe këto gjuhë të vjetra, përgjithësisht, kanë qenë të njohura në mesin e teologëve të krishterë që në periudhën e hershme të mesjetës.[6]

Ndërsa gjuha e dytë për nga rëndësia dhe vlera studiuese e saj pa dyshim ishte gjuha arabe. Sipas evidencës historike, që nga shekulli i XV, gjuha arabe ka qenë pjesë e planprogrameve mësimore në universitetet kryesore të Evropës. Fillimisht ajo është mësuar për të lehtësuar studimin e autorëve klasikë grekë dhe romakë, përmes përkthimeve që atëherë ishin bërë në gjuhën arabe.[7]

[3] **Edward W. Said,** *Orientalism*, fq. 12, New York, 2003.
[4] Ibid, fq.35.
[5] **Muhammad Mohar Ali**, *The Quran and Orientalists,* fq. 12.
[6] **Beryl Smalley**, *The study of the Bible in the Middle Ages*, fq. 56-58, Oxford, 1983.
[7] **Pierre Martino**, *L'Orient dans la literature française*, fq. 176, Paris, 1906.

Në përgjithësi, orientalistët janë njohës shumë të mirë të gjuhës arabe dhe kanë arritur që përmes saj të hulumtojnë dokumente të shumta antike, historike dhe religjioze.

## I. Periudha e hershme e kontaktit me literaturën e Orientit

Si periudhë e hershme e studiuesve dhe studimeve orientale mund të llogaritet koha, kur të krishterët merrnin mësime të kishës si dhe të filozofisë greke përmes literaturës së përkthyer në gjuhën arabe, e cila në atë kohë gjendej në qendrën e myslimanëve në Bagdad.

Me zgjerimin e Islamit ishte zgjeruar edhe numri i veprave shkencore, duke filluar nga Kurani, suneti, historia, gjuha, astronomia, fizika, kimia, matematika etj. Krahas këtij evoluimi në literaturën fetare, myslimanët janë marrë edhe me përkthime të librave nga gjuha greke, romake dhe latine. Studiuesit e krishterë, të periudhës së mesjetës kishin përfituar nga studimet e myslimanëve. Prandaj, për të arritur kontaktin me literaturën arabe ata kishin bërë udhëtime të gjata deri në Bagdad si dhe në qendrat tjera islame të asaj kohe, duke mësuar gjuhën arabe me qëllim të bartjes së njohurive të reja tek popujt e tyre në Evropë përmes përkthimit të veprave të ndryshme.

## II. Objektivat kryesorë të orientalizmit

Si objektiva kryesorë të orientalistëve dhe institucioneve orientaliste në botën perëndimore janë objektivat religjioze-fetare, por edhe ekonomike dhe politike.

Motivi religjioz, si ndër më parësorët, i ka shtyrë orientalistët që të hulumtojnë kulturën e botës arabe në përgjithësi, e cila Islamin e kishte pranuar për fe të saj shpirtërore. Përmes këtij motivi, ata në hulumtimet e tyre e kanë përfshirë edhe studimin e historisë zakoneve dhe traditës arabe. Mirëpo, të gjithë, me përjashtime të vogla, janë përpjekur dhe përpiqen edhe sot që të thellohen sa më shumë që është e mundur në

burimet e fesë islame, përmes studimi të librit të shenjtë -Kuranit dhe historisë së Muhamedit a.s., e cila përfshin jetën dhe veprimtarinë e tij, si dhe të shokëve të tij.

Përmes motivit religjioz, orientalistët njëkohësisht mëtojnë t`i arrijnë edhe qëllimet dhe interesat e tyre politike dhe ekonomike perëndimore në botën lindore, duke pasur parasysh rëndësinë e pozitës së saj gjeografike dhe gjeopolitike, e cila sigurisht se nuk do të mund të dominohej dhe të dominohet edhe më tutje, pa e njohur historinë, kulturën dhe fenë e saj.

Orientalistët kanë arritur që të themelojnë librari të shumta në qendra studiuese evropiane, përmes së cilave kanë ruajtur dhe ruajnë edhe sot dokumente të vlefshme shkencore, historike, letrare, linguistike, si dhe dorëshkrime të vjetra mjaftë unike.

## III. Përkthimet e para të Kuranit në Oksident[8]

Sipas të dhënave historike, jomyslimanët në Perëndim ishin të interesuar që ta përkthenin Kuranin për arsye polemizuese si dhe imperialiste.

Lloje të shumta të përkthimeve të Kuranit në Perëndim, që në botimet e para janë emërtuar qëllimisht me nofka përgënjeshtruese si: "Muhamed's Quran" (Kurani i Muhamedit ) ose "Quran of the Turks" (Kurani i turqve) etj.

Si përpjekje e parë për përkthimin e Kuranit në gjuhën latine njihet emri i Robertus Ketenensisit 1143, i cili njihet edhe me emrin Robert Ketton. Ky përkthim kishte ngelur në dorëshkrim deri në vitin 1543,

[8] Përkthimi i parë i pjesshëm i Kuranit besohet se ka filluar përmes Xhafer bin Ebi Talibit, kur ai kishte lexuar pjesët e Kuranit nga kaptina Mejrem para mbretit Negusit-Nexhashiut në Etiopi.
Hipoteza tjetër thotë se fillet e para të përkthimit të Kuranit në gjuhët tjera datojnë që nga koha kur persianët kishin kërkuar nga Selman el-Farisiu që të përkthente kaptinën El-fatiha për ta lexuar atë gjatë lutjes - namazit, gjë të cilën ai edhe e kishte bërë.

derisa për botimin e tij kishte rekomanduar Martin Luther (1483-1546).

Ludovic Marache, një prift katolik, po ashtu e ka përkthyer Kuranin në gjuhën latine në vitin 1698. Marache e kishte prezantuar veprën e tij te perandori romak Leopoldi i Parë.

Përmes këtij përkthimi Marache e kishte paraqitur Islamin në formën më të keqe të mundshme.

Anglezi Alexander Rose, po ashtu, njihet si përkthyes i Kuranit në gjuhën angleze në vitin 1648.

Ndërsa, George Sale, një shekull më vonë, gjegjësisht në vitin 1734, kishte bërë përkthimin e dytë të Kuranit në gjuhën angleze.

Përkthimi i Sales ka qenë burimi kryesor për shumë studiues evropianë përgjatë dy shekujve.[9]

Ky përkthim i Sales në gjuhën angleze është përkthyer edhe në gjuhët tjera evropiane si; në gjuhën gjermane, franceze, ruse, suedeze, italiane, bullgare dhe në gjuhën shqipe nga Ilo Mitko Qafzezi.

Përkthimi i George Sale është rishtypur mbi 120 herë.

## IV. Qëllimet e orientalistëve përmes përkthimit të Kuranit

Jo të gjithë orientalistët kishin të njëjtin synim gjatë punimeve dhe studimeve të tyre në raport me kulturën, fenë dhe traditat e botës arabe dhe islame në përgjithësi. Vepra kapitale për shumicën e tyre ishte përkthimi, studimi dhe analiza e Kuranit, i cili nga ana e tyre konsiderohej fondamenti bazë shpirtëror i jetës dhe organizimit shoqëror të myslimanëve.

Qëllimi i shumicës së orientalistëve, përkthyes dhe analizues të Kuranit, me përjashtime të rralla ishte ishin si në vijim:

- Refuzimi i pranimit të Kuranit si libër i shpallur të Zotit xh. sh. Shumica e orientalistëve haptazi thonë se Kurani nuk është

[9] World Bibliography of Translation of the Meaning of the Holy Quran, fq. 38.

shpallje hyjnore. Duke e refuzuar Kuranin si shpallje, ata njëkohësisht refuzojnë edhe pejgamberinë e Muhamedit a.s.[10]

- Përpjekja për të bindur lexuesit se në Kuran nuk ka asgjë të re nga ajo që e kanë evidentuar librat e mëhershëm qiellorë.
- Refuzimi i ajeteve-verseteve kuranore si renditje hyjnore. Sipas pjesës dërrmuese të orientalistëve, në Kuran ka shumë ajete kontradiktore të cilat bien ndesh mes vete.
- Orvatja dhe përpjekja për të sjellë sa më shumë argumente bindëse se Kurani është një libër i shkruar nga Muhamedi (a.s.).
- Përpjekja e orientalistëve që përmes aksentit të ndryshëm recitues të Kuranit të bëjnë ngjashmërinë e tij me versionet e ndryshme të Biblës.[11]

Duke ditur se Kurani është teksti bazik i Islamit, orientalistët u kanë kushtuar kujdes të veçantë studimeve të tij duke vepruar si vijon:

- Kanë bërë përpilimin e librave specifikë lidhur më Kuranin, me theks të veçantë mbi historikun tij.
- Kanë shkruar ese për tematika të ndryshme të Kuranit.
- Kanë bërë mbledhjen tp një numri sa më të madh dorëshkrimesh të Kuranit.
- Kanë publikuar revista të veçanta mbi Kuranin etj.

[10] **Arhtur Geoffrey**: "Muhamedi (a.s.) ka punuar që të lë pas vetes një libër ashtu siç kishin vepruar hebrenjtë dhe të krishterët me testamentin e tyre. Mirëpo ai ( Muhamedi a.s.) kishte ndërruar jetë para se libri të jetë gati. Ajo që është sot në Kuran është material që pasuesit e tij e kanë mbledhur pas vdekjes së tij ( Muhamedit a.s), si korpus të shpalljes së tij.

[11] **Muhamed Mohar Ali**, The Quran and Orientalists, f.3-15.

## V. Kriteret dhe metodologjia e orientalistëve në studimin e teksteve të shenjta vis-a-vis Kuranit

Studiuesit perëndimorë të Islamit, duke përfshirë orientalistët, historianët e religjionit, studiuesit e aspekteve krahasimtare të feve, në përgjithësi, kanë aplikuar metodologjinë biblike të studimeve, e cila në Perëndim është zhvilluar në shekullin e 19 dhe të njëjtën e kanë përdorur dhe aplikuar edhe në raport me Kuranin.

Karakteristikë kryesore e një qasjeje të tillë është aplikimi i metodave të përgjithshme të shkencave humane ndaj tekstit biblik. Janë dy forma kryesore të kritikës, të cilat në Perëndim janë zhvilluar në raport me tekstin e shenjtë: tekstuale dhe letrare-historike[12].

Qëllimi i kritikës letrare ishte kthimi i tekstit në versionin e tij origjinal. Mjetet e kritikës tekstuale përfshinin identifikimin e të dhënave të brendshme dhe të jashtme për të rivendosur tekstin e humbur si dhe për të bërë identifikimin e lëshimeve në brendësi të tekstit.

Ndërsa qëllimi i kritikës letrare-historike ishte ekzaminimi i autorësisë, kohës, përbërjes së dokumentit, si dhe autoritetit të Biblës apo pjesëve të saj.

Premisa themelore e kritikës biblike qëndron në atë se teksti i Biblës duhet të studiohet ashtu siç studiohet edhe çdo pjesë e literaturës dhe dokumenteve historike[13].

Kjo metodë kritike, e zhvilluar në kontekst me Biblën, më vonë është zgjeruar dhe aplikuar në studimin e shkrimeve -*scripture* të shenjta, duke përfshirë edhe Kuranin.

Një shpjegim më i detajuar për një qasje të tillë është dhënë nga studiuesi amerikan, i njohur në shkallë ndërkombëtare, **William A. Graham**:

---

[12] **Lawrence Boadt**, *Reading the Old testament; An introduction*, New York; Paulist Press, 70-73, v. 1984.

[13] **David F. Ford, ed**., *The Modern Theologians: An Introduction to Christian Theology in the Twentieth Century,* f. 10*,* Cambridge, MA and Oxford, UK: Blackwell, 1997.

"Studimi i shkrimeve të shenjta në fushat dërmuese orientale dhe biblike deri sot ka nënkuptuar studimin e dokumenteve si dhe kontekstin historik në të cilin ato janë ngritur. Shqetësimet dhe preokupimet kryesore të tyre kanë qenë vendosja e një teksti origjinal, rindërtimi i procesit të përbërjes së tekstit, analizimi i tekstit në kontekstin historik, hulumtimi dhe nxjerrja e ideve kyçe nga teksti, gjetja e gjurmëve dhe hulumtimin i prejardhjes së burimeve.[14]

Gjysma e dytë e shekullit XX ka dëshmuar përvetësimin e mjeteve të reja të kritikës letrare dhe të kulturës studiuese te studiuesit e Islamit në Perëndim.

Në mesin e tyre mund të veçohen; analizat e diskursit (gjuhët e tekstit - *text linguistics* ) analiza të tregimeve, analiza retorike, analiza të diskursit semantik, analiza strukturore etj. [15]

Orientalistët e gjysmës së parë të shekullit të 19 hulumtonin kryesisht burimet dhe ndikimet e huaja në Kuran.

Metodat e kritikës filologjike dhe historike janë përdorur për të vërtetuar tezën e pretenduar të hebrenjve, krishterëve, manihenëve[16], ose edhe të ndikimeve të tjera.

Studiuesit orientalistë të kësaj kohe i kanë kushtuar rëndësi të veçantë fjalorit të Kuranit, hulumtimit të fjalëve joarabe, studimit të stilit të Kuranit dhe narrativët e tij dhe duke e bërë krahasimin e tyre me shkrimet tjera të shenjta.

Diku kah fundi i shekullit të 19 vëmendja e orientalistëve ishte zhvendosur kah historia e tekstit të Kuranit.

---

[14] **William A. Graham,** "*Quran as Spoken Word; An Islamic Contribution to the Understanding of Scripture* " in Richard martin, ed. Approaches to Islam in Religious Studies Tuscon, f.25-26.
The University of Arizona Press, 1985.

[15] **Stephen D. Moore**, *Literary Criticism and the Gospels*; The Theoretical Challenge (New Haven, CT: Yale University Press, 1989).

[16] Religjion i themeluar nga profeti iranian Mani, gjatë kohës së perandorisë sasaniane.

Korniza teorike për këtë përpjekje ishte gjetur në disiplinën e historisë tekstuale (*textgeschichte),* e filluar dhe e zhvilluar në Gjermani, brenda fushës së studimeve biblike.

Qëllimi kryesor i një qasjeje të tillë ishte përpjekja për të treguar se teksti i Kuranit e ka gjenezën e tij njerëzore, se është rezultat i zhvillimit historik dhe se, si pasojë e kësaj, Kuranin të cilin e kemi sot në dispozicion nuk është versioni origjinal i tij për të cilin pretendojnë myslimanët.

Një metodologji të kësaj forme në veprat e tyre e kishin aplikuar orientalistët, si: Gustav Weil, Theodor Noldelke, Richard Bell, Arthur Jefery si dhe disa orientalistë të tjerë.

Disa nga studiuesit perëndimorë, të cilët kishin ndjekur orientimin e lartpërmendur, si: Gotthelt Bergstrasser, Arthur Jefery, Otto Pretzel, para Luftës së Dytë Botërore kishin planifikuar botimin e formës kritike të Kuranit[17], por projekti i tyre kishte dështuar sepse materiali i tubuar ishte shkatërruar si pasojë e luftës.

Njëra nga orvatjet e vonshme të orientalistëve për të themeluar idenë mbi gjenezën e tekstit të Kuranit është ajo e John Wansbrough[18].

Wnasbrough është përfaqësues i "qasjes revizioniste" në studimet islame të Perëndimit, një qasje e cila radikalisht e vë në pyetje autenticitetin dhe besueshmërinë e burimeve myslimane mbi studimin e Kuranit dhe Sunetit.

**Premisat themelore dhe metodologjike të tij ishin si vijon:**

*"Burimi i shkruar nuk na thotë "se çfarë në të vërtetë ka ndodhur", por vetëm atë se çfarë ka ndodhur me mendimin e autorit. Vetëm syri dëshmitar e di se çfarë ai ka shkruar.*

[17] **Gerd R. Puin**, *Observations on Early Manuscripts in San`a*, in Stefan Wild, ed. The Quran as Text, 107.

[18] **John Wansbrough, Quranic** *Studies; Sources and Methods of Scriptural Interpretation*, Oxford University Press, 1977), f.78.

*Shkrimi autorial imponon devijimin dhe kronologjinë e ngjarjes reale.*

*Transmetimi i historisë për një dokument antik, është i hapur për dyshim të madh.*

*Burimet e shkruara janë letërsi, prandaj studimi i këtyre burimeve nuk është histori, por kritikë letrare. Dëshmitë e jashtme janë të nevojshme për të vërtetuar historikun e burimeve të shkruara. Mungesa e një vërtetimi të tillë është një argument i rëndësishëm kundër historikut të fenomenit të vërtetuar përmes burimeve letrare (**Arguemntum silentio)".***[19]

Kurani është shikuar në të njëjtën mënyrë dhe formë siç është shikuar edhe Bibla nga studiuesit e Perëndimit, si një vepër letrare, e cila duhet të studiohet përmes mjeteve të kritikës letrare. Gjuha e Kurani nuk ka status special sipas premisave të Wansbroughit.

## VI. Qëndrimi i Muhamed Hasan Askerit për orientalizmin dhe produktet e tij

Muhamed Hasan Askerij (1919-1978) [20] mendon se orientalistët si dhe trashëgimtarët e tyre kanë mungesë të theksuar në kuptimin e disa elementeve thelbësore të fesë.

Religjioni **-Dini** sipas Askerit, ka tri elemente të dallueshme:

a. besimin -*akidja*,

b. veprimin adhurues *ibadat,*

c. etikën- *ahlakun.*

Këto tri elemente bazë, shumica e orientalistëve, sipas Askerit, injorohen, sepse " besimin "nuk e konsiderojnë si pjesë integrale të re-

[19] Ibid f.79.

[20] Studiues indian, shkrimtar, kritik dhe gjuhëtar i letërsisë urde. Ka përkthyer një sërë veprash të autorëve evropianë në gjuhën urde, sidomos nga gjuha angleze, frënge dhe ruse. Në fund të jetës së tij kishte filluar të përkthente edhe Kuranin, por vdekja e kishte ndërprerë, pas përfundimit të vetëm një kaptine të tij.

ligjionit, por si një element i cili ndryshon nga një kohë në tjetrën - (*evolutionary perspective - perspektive revolucionare ).*

Në anën tjetër, orientalistët veprimet specifike të adhurimit i konsiderojnë si rituale të thjeshta, të cilat mund të pranohen, ose të refuzohen, apo edhe të modifikohen nga vetë qenia njerëzore.

Askeri mendon se orientalistët në përgjithësi religjionin e limitojnë në etikë apo atij i qasen nga perspektiva etike, duke pretenduar se qëllimi i religjionit është ndërtimi i karakterit të njeriut.

Shkenca orientalistike në përgjithësi, religjionin e mendon si produkt të mendjes së njeriut, të cilin e sheh si proces evolutiv, ndërsa konceptin e Zotit e sheh si diçka që i nënshtrohet evolucionit.

Orientalistët po ashtu nuk bëjnë dallime ndërmjet besimeve hyjnore dhe atyre false (el-batil). Të gjitha i konsiderojnë në të njëjtin nivel me besimet e vërteta (el-hak), nën pretekstin e tolerancës dhe mendimit liberal.

Njashtu aplikojnë relativizmin për principet religjioze dhe insistojnë se të gjitha idetë janë vetëm relativisht të vërteta dhe jo absolute.

Refuzojnë ose i racionalizojnë besimet të cilat janë përtej arsyes - *reason* dhe mundohen që të gjejnë baza racionale për dispozitat fetare duke i mohuar mrekullitë hyjnore, ose duke i interpretuar ato në baza racionale.

Orientalistët, gjithashtu nuk e pranojnë asnjë autoritet, përfshirë edhe atë të dërguarit të Zotit; insistojnë se opinioni i tyre është aq valid sa edhe dispozitat fetare në librin e Zotit.

Me fjalë tjera, e gjithë korniza e tyre e brendshme është e ndërtuar mbi pozitivizmin, pragmatizmin si dhe utilitarianizmin, ndërsa progresin material e kanë masë dhe bazë të çdo gjëje[21].

[21] **Mohamed H. Askeri**, *Jadidiyat* (collection of short stories), fq. 134, Karachi, 1947.

## SUMMARY

Research by European scholars on the culture, history and religion of the Muslim world has dated since the tenth and eleventh centuries. They had intensified, especially in periods of Muslim rules in the Iberian Peninsula, known as the Andalusian period, which had extended from the 7th to the end of 14th century, when peoples of all three monotheist religions had gone through the most collaborative period in terms of scientific research in history.

A first step of European scholars towards the Oriental world, and the Muslim world specifically, was the translation of the Qur'an in their own languages, initially in Latin, and later in English, German, French, etc.

The first departments and institutes for regular Oriental studies in Europe were established in the 18th and 19th centuries, named as "oriental studies".

Apart from the Qur'an the sacred book, the focus of European orientalists was cast also upon languages, history, culture, customs and everything else related to the peoples in the Middle East, specifically the Muslim population.

According to Edward Said, orientalists had generally established stereotypes and prejudice against the Muslim world, for mainly expansionist goals.

However, a number of orientalists have given major contributions in terms of research, classification and storage of many precious manuscripts of the Islamic world.

Prof. ass. dr. Lulzim ESATI

# LLOJET E UDHËZIMIT NË KURANIN FAMËLARTË

## Hyrje

Në këtë punim lexuesi do të njoftohet me dy llojet eminente të "*Hidajetit* - udhëzimit" në Kuran. Edhe pse në shikim të parë duket sikur ka përplasje ndërmjet ajeteve të Kuranit, rreth çështjes së udhëzimit të njeriut në rrugën e besimit të drejtë, për faktin se disa ajete thonë që udhëzimi është kompetencë e rezervuar e Allahut fuqiplotë, e disa të tjera tregojnë që udhëzimin mund ta kryejnë pejgamberët, por edhe njerëzit e tjerë. Pas një përsiatjeje të mjaftueshme rreth ajeteve që flasin për *"Hidajetin-udhëzimin",* dalim në përfundim se ajetet që ia atribuojnë udhëzimin vetëm Allahut kanë për qëllim udhëzimin, që nënkupton ngulitja e besimit në zemër, kurse ajetet që tregojnë se udhëzimi është detyrë e pejgamberëve dhe e dijetarëve kanë për qëllimin udhëzimin që nënkupton orientimin ka rruga e besimit të drejtë. Kësisoj në fund mësojmë që ajo çka duket në fillim si përplasje mes ajetetve të Kuranit famëlartë rreth një çështje të vetme, del se ndërmjet tyre ka një përputhshmëri të plotë. Po ashtu në këtë temë mësojmë se fushëveprimi i thirrësve në Fenë e Allahut xh.sh., dhe të atyre që punojnë në fushën e da'ves-thirrjes kufizohet në llojin e dytë të udhëzimit që nënkupton orientimin e njerëzve kah rruga e drejtë e besimit. Sa i

përket llojit të parë të udhëzimit që nënkupton ngulitjen e besimit në zemrën e njerëzve, këtë nuk mund ta bëjë askush qoftë ai edhe pejgamber, ngase kjo është e drejtë e rezervuar e Krijuesit fuqiplotë, i Cili e di të fshehtën dhe atë që gjendet në zemra. Që këtej, aktivistët dhe përgjegjësit e kësaj fushe duhen ta kenë të qartë se në cilin lloj të hidajetit duhet të përqendrohen.

**Fjalë kyçe:** Hidajetit, Udhëzimi, Besimi i drejtë,orientimi në të vërtetën.

## Udhëzimi në Kuranin famëlartë

Allahu i madhërishëm e zbriti Kuranin famëlartë, që të jetë udhëzues për mbarë njerëzimin, sikurse e thotë edhe vetë:

شَهْرُ رَمَضَانَ ٱلَّذِىٓ أُنزِلَ فِيهِ ٱلْقُرْءَانُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَٰتٍ مِّنَ ٱلْهُدَىٰ وَٱلْفُرْقَانِ

***Muaji i Ramadanit në të cilin** (filloi të) **shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues** (i së vërtetës nga gënjeshtra).*[1]

Në shikim të parë del se udhëzimi është një, siç tregon edhe ajeti i sipërpërmendur. Kësisoj krijohet përshtypja që të gjithë ata që e dëgjojnë Kuranin famëlartë duhen të udhëzohen, ngase ajeti në fjalë dëshmon se Kurani e garanton një gjë të tillë. Nga ana tjetër shohim se jo të gjithë ata që e dëgjuan Kuranin famëlartë u udhëzuan! Kjo lë të kuptohet se duhet të hulumtohet më thellë në librin e Allahut xh.sh. për të mësuar realitetin e *hidajetit*-udhëzimit.

Nëse i referohemi Kuranit famëlartë, mësojmë se çështja e udhëzimit të njeriut në rrugën e besimit të drejtë, është çështje determinizmi, që i përket caktimit të Allahut fuqiplotë, siç bëhet e qartë në këtë ajet:

[1] El Bekare: 185.

ذَٰلِكَ هُدَى ٱللَّهِ يَهۡدِي بِهِۦ مَن يَشَآءُ مِنۡ عِبَادِهِۦ ﴿٨٨﴾

***Ky është udhëzim i Allahut, udhëzon me të kë të dojë nga robërit e Tij.***[2]

وَٱللَّهُ يَهۡدِي مَن يَشَآءُ إِلَىٰ صِرَٰطٖ مُّسۡتَقِيمٖ ﴿٢١٣﴾

***Allahu e vë në rrugë të drejtë atë që dëshiron.***[3]

نُّورٌ عَلَىٰ نُورٖۖ يَهۡدِي ٱللَّهُ لِنُورِهِۦ مَن يَشَآءُ

***Dritë mbi dritë. Allahu udhëzon kah drita e Vet atë që do Ai.***[4]

## Roli i të dërguarve në udhëzimin e njerëzve

Kurani famëlartë na mëson se misioni i tyre ishte udhëzimi i njerëzve në rrugën e Allahut xh.sh.:

وَلِكُلِّ قَوۡمٍ هَادٖ ﴿٧﴾

***Çdo popull pati udhëzues*** *(pejgamberë)*.[5]

Kjo del edhe më e qartë kur bëhet fjalë për misionin e të Dërguarit të fundit, Muhamedit s.a.v.s., kur Allahu xh.sh. vërteton dhe dëshmon në Kuranin famëlartë se ai me të vërtetë i udhëzonte njerëzit në rrugën e drejtë:

وَإِنَّكَ لَتَهۡدِيٓ إِلَىٰ صِرَٰطٖ مُّسۡتَقِيمٖ ﴿٥٢﴾

***Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë.***[6]

Jo vetëm kaq, por në Kuranin famëlartë gjejmë ajete që dëshmojnë se udhëzimi në rrugën e besimit të drejtë është detyrë e dijetarëve të fesë. I Lartmadhërishmi për këtë thotë:

---

[2] El-En'am: 88.
[3] El-Bekare: 213.
[4] En-Nur: 35.
[5] Err-Rra'd: 7.
[6] Esh-Shura: 52.

وَمِمَّنْ خَلَقْنَآ أُمَّةٌ يَهْدُونَ بِٱلْحَقِّ وَبِهِۦ يَعْدِلُونَ ﴿١٨١﴾

***E ndër ata që krijuam Ne, ka njerëz që udhëzojnë në të drejtën dhe veprojnë me të.***[7]

وَجَعَلْنَا مِنْهُمْ أَئِمَّةً يَهْدُونَ بِأَمْرِنَا لَمَّا صَبَرُوا۟ ۖ وَكَانُوا۟ بِـَٔايَـٰتِنَا يُوقِنُونَ ﴿٢٤﴾

***Dhe prej tyre Ne bëmë prijës që me urdhrin Tonë udhëzojnë, pasi që ata*** *(që i bëmë prijës)* ***ishin të durueshëm dhe ndaj argumenteve Tona dhe ishin të bindur.***[8]

وَمِن قَوْمِ مُوسَىٰٓ أُمَّةٌ يَهْدُونَ بِٱلْحَقِّ وَبِهِۦ يَعْدِلُونَ ﴿١٥٩﴾

***Edhe prej popullit të Musait qe një grup që udhëzoi drejt dhe iu përmbajt asaj*** *(drejtësisë).*[9]

Pra, të gjitha këto ajete tregojnë që udhëzimi vjen nga pejgamberët, por edhe nga dijetarët e fesë.

Në fillim pamë ajete që dëshmojnë se udhëzimi është vetëm kompetencë e Allahut fuqiplotë, ndërsa këtu shohim që udhëzimi mund të bëhet edhe nga pejgamberët dhe dijetarët eminentë të kësaj fushe.

## Në kompetencat e kujt është udhëzimi i njerëzve?

Përgjigjja është kjo: udhëzimi i njerëzve në rrugën e drejtë të besimit është kompetencë e vetme e Allahut fuqiplotë. Kjo është bërë e qartë në fjalën e Lartmadhërishmit:

إِنَّكَ لَا تَهْدِى مَنْ أَحْبَبْتَ وَلَـٰكِنَّ ٱللَّهَ يَهْدِى مَن يَشَآءُ ۚ وَهُوَ أَعْلَمُ بِٱلْمُهْتَدِينَ ﴿٥٦﴾

***Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Allahu e udhëzon kë të dojë dhe Ai është që di më së miri për të udhëzuarit.***[10]

[7] El-Earaf, 181.
[8] Se-Sexhde: 24.
[9] El-Earaf: 159.
[10] El-Kasas: 56.

I Lartmadhërishmi iu drejtua me këtë ajet të dërguarit të Tij Muhamedit a.s. pas vdekjes të xhaxhait të tij, Ebu Talibit, i cili vdiq jobesimtar, duke ia bërë të qartë se udhëzimi i Ebu Talibit është jashtë mundësive të të dërguarit, edhe pse ai e donte shumë dhe ishte i brengosur së tepërmi që ai vdiq qafir, me gjithë insistimin e tij, deri në frymën e tij të fundit, që ai së paku të thoshte: *la ilahe ilallah*- nuk ka Zot tjetër përveç Allahut. Ky ajet zbriti lidhur me udhëzimin e të afërmve të tij.

Imam Rraziu thotë: fjala e Lartmadhërishmit "*Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Allahu udhëzon kë të dojë",* Zaxhaxhi thotë: të gjithë myslimanët janë të mendimit se ky ajet ka zbritur për Ebu Talibin. Arsyeja është se kur iu afrua vdekja tha: O bijtë e Abdulmenafit, bindjuni Muhamedit dhe besojini atij se do të jeni të shpëtuar e të udhëzuar. Muhamedi a.s. i tha: O xhaxha, ata po i urdhëron që të përfitojnë për veten e tyre, ndërsa veten tënde po e lë! I tha: Çka po do, o biri i vëllait tim? I tha: Po dua nga ti një fjalë të vetme, ti je në ditën e fundit të kësaj bote, dua që të thuash: *la ilahe ilallah* - nuk ka Zot tjetër pos Allahut, që ta kam si dëshmi për ty tek Allahu i Lartmadhërishëm. I tha: O vëlla, me të vërtetë e di që ti je i vërtetë[11], por e urrej që të thuhet: u frikua para vdekjes dhe sikur të mos të fyenin ty dhe bijtë e babit tënd, e t'jua zinin merrnin për të madhe pas vdekjes sime, do ta kisha thënë atë fjalë dhe do ta kisha freskuar syrin tënd me atë në momentet kur po ndahemi nga insistimi i madh dhe këshilla që po e bën, megjithatë unë do të vdes në fenë e prijësëve të Abdulmutalibit, Hashimit dhe Abdulmenafit.[12]

Kemi edhe ajetin tjetër, i cili tregon që udhëzimi i njerëzve në përgjithësi nuk është në dorën e të Dërguarit s.a.v.s,:

[11] Në atë që po i fton njerëzit.

[12] Err-Rrazi, Muhamed bin Omer, (v.605h), ***Mefatihul Gajb***, botimi i tretë, sh,b: Dar Ihja et-Turath el-Arabij, Bejrut, vëll: 25, f: 3.El-Vahidi, Ali Ibën Ahmet, (v.486 h), ***Esbabu -l- Nuzul,*** sh.b: Mektebet el-Hilal, botimi i I-rë, Beirut, 1983.

۞ لَّيۡسَ عَلَيۡكَ هُدَىٰهُمۡ وَلَٰكِنَّ ٱللَّهَ يَهۡدِي مَن يَشَآءُ

***Nuk është obligim yti** (Muhamed) **udhëzimi i tyre** (në rrugë të drejtë), **Allahu e shpie në rrugë të drejtë atë që do.**[13]*

Ibën Ashuri, në interpretimin e këtij ajeti thotë: E ka kuptimin se kjo nuk është obligim për të Dërguarin, ashtu që mos të pikëllohej se nuk po udhëzoheshin, ngase e kishte kryer detyrimin e komunikimit.[14]

Edhe ky ajet kuranor dëshmon për atë që thamë:

إِن تَحۡرِصۡ عَلَىٰ هُدَىٰهُمۡ فَإِنَّ ٱللَّهَ لَا يَهۡدِي مَن يُضِلُّ ۖ وَمَا لَهُم مِّن نَّٰصِرِينَ ٣٧

***Nëse ti** (Muhamed) **përpiqesh t'i vësh në rrugë të drejtë ata,** (dije se) **Allahu nuk e udhëzon atë që e ka humbur dhe për ata nuk ka ndihmëtar.**[15]*

Pra, udhëzimi i Allahut xh.sh. është vendimtar nëse një person do të udhëzohet në rrugën e Tij, apo nuk do të udhëzohet dhe këtu nuk ka kompromis, ngase e tërë çështja është në vullnetin e Allahut fuqiplotë. Me këtë problem-udhëzimin e familjarëve, u ballafaquan edhe pejgamberët e tjerë. Nuhu a.s. u mundua deri në pikën e fundit për ta udhëzuar djalin e vet që të hipte në anije dhe t'iu bashkohej besimtarëve, por ai nuk hipi dhe kështu u fundos në ujë dhe vdiq si jobesimtar. Ibrahimi a.s. u mundua ta udhëzonte babanë e tij, por pas një konfrontimi të ashpër me të, babai ngeli në idhujtarinë e tij, siç kishte qenë më parë, duke mos ndryshuar as edhe për një fije floku. Disa patën problem me gratë e tyre të cilat vdiqën si jobesimtare, siç kemi shembullin e gruas së Nuhut a.s. dhe gruas së Lutit a.s.!

Të gjithë këta shembuj konkretë, të regjistruar në Kuranin famëlartë, janë tregues të qartë se i tërë udhëzimi i takon vetëm Allahu fu-

[13] El-Bekare: 272.
[14] Ibën Ashur, Muhamed Tahir. ***Et-Tahrir ve-t- Tenvir,*** Tunis: Dar tunisije, 1984, vëll: 3, f: 70.
[15] En-Nahël: 37.

qiplotë. Kjo e dhënë del nga fakti se të dërguarit e Allahut e dhanë maksimumin për t'i udhëzuar njerëzit në besimin e drejtë, sidomos të afërmit e tyre dhe prapëseprapë ata nuk u udhëzuan kurrë!

## Zgjidhja e dilemës në çështjen e udhëzimit

Dijetarët e tefsirit, për ta zgjidhur dilemën mes ajeteve që tregojnë se udhëzimi vjen nga pejgamberët dhe mes ajeteve që tregojnë se udhëzimi vjen vetëm nga Allahu fuqiplotë, e ndajnë udhëzimin në dy lloje:

**Lloji i parë** është: Udhëzimi në kuptimin e orientimit.

Imam el-Kurtubi thotë: "Udhëzimi është dyllojësh: udhëzimi që ka kuptimin e orientimit dhe ky është ai të cilin mund ta kryejnë pejgamberët a.s. e pasuesit e tyre, ndërsa për këtë lloj të udhëzimit i Lartmadhërishmi në Kuranin famëlartë thotë:

وَلِكُلِّ قَوْمٍ هَادٍ ﴿٧﴾

***Çdo popull pati udhëzues** (pejgamber).*[16]

وَإِنَّكَ لَتَهْدِيٓ إِلَىٰ صِرَٰطٍ مُّسْتَقِيمٍ ﴿٥٢﴾

***Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë.***[17]

Këtë lloj të udhëzimit ua ka dëshmuar atyre, e që ka kuptimin e orientimit thirrjes dhe tërheqjes së vërejtjes[18].

Imam Taberiu thotë: Disa herë fjala "el-huda" (udhëzim) ka kuptimin e sqarimit[19], ndriçimit, dëshmimit dhe orientimit në të vërtetën. Në këtë drejtim flasin ajetet vijuese:

---

[16] Err-Rra'd: 7.

[17] Esh-Shura: 52.

[18] Ebu hajjan, Muhammed Ibën Jusuf, (v.745h) ***el-Bahrul Muhit,*** sh.b: Darul Xhil, botimi i I-rë, 1995 Berut. vëll: 4, f: 23.

[19] Et-Taberi, Muhammed Ibën Xheri, (v. 310 h),***Xhamiul Bejan Ante'vil Ajil Kuran,***sh.b: Darul Fikër,1985 Bejrut, vëll: 25, F: 221.

وَإِنَّكَ لَتَهۡدِيٓ إِلَىٰ صِرَٰطٖ مُّسۡتَقِيمٖ ﴿٥٢﴾

***Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë.***[20]

إِنَّمَآ أَنتَ مُنذِرٞۖ وَلِكُلِّ قَوۡمٍ هَادٖ ﴿٧﴾

***Ti je vetëm qortues. Çdo popull pati udhëzues*** *(pejgamber).*[21]

وَأَمَّا ثَمُودُ فَهَدَيۡنَٰهُمۡ فَٱسۡتَحَبُّواْ ٱلۡعَمَىٰ عَلَى ٱلۡهُدَىٰ

***Sa i përket Themudit, Ne atyre u patëm treguar rrugën e drejtë, por ata, megjithatë, më shumë e deshën verbërinë se sa rrugën e drejtë.***[22]***"***[23]

**Lloji i dytë i Udhëzimit**: ka kuptimin; krijimin e besimit në zemër.

Këtë lloj të udhëzimit Allahu xh. sh. e ka rezervuar për veten e Tij të pastër e të lartësuar, siç ka bërë me dije në këto ajete:

إِنَّكَ لَا تَهۡدِي مَنۡ أَحۡبَبۡتَ ﴿٥٦﴾

***Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti.***[24]

أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلۡمُفۡلِحُونَ ﴿٥﴾

***Të tillët janë të udhëzuar nga Zoti i tyre dhe vetëm ata janë të shpëtuarit.***[25]

وَيَهۡدِي مَن يَشَآءُ ﴿٤﴾

***Dhe e udhëzon në rrugë të drejtë atë që do***[26]***".***[27]

---

[20] Esh-Shura: 52.
[21] Err-Raëd: 7.
[22] Fussilet: 17.
[23] Ibën Kethir, ***Kandili ndriçues***, f.r.i 2010 cyrih, vëll: I, f: 96-97.El-Mubar Kefuri, Safijurr-rrahman, ***el-Misbahul Munir fi tehdhibi tefsir Ibën Kethir***, Rijad: Darusselam 2000, f: 876.
[24] El-Kasas: 56.
[25] El-Bekare: 5.
[26] Ibrahim: 4.
[27] El-Kurtubi, Muhamed bin Ahmed, (v. 671, h), ***Elxhamiu Liahkamil Kuran,*** Bejrut: sh.b, Darul kutub el- Ilmije, Bejrut 1991, Vëll: I, f: 160.

Ibën Kthiri thotë: "Ndonjëherë me nocionin "Huda" (udhëzim), qëllimi është të tregohet besimi i ngulitur në zemër. Këtë nuk ka fuqi askush tjetër ta krijojë në zemër e njerëzve pos Allahut të Lartmadhërishëm. Këtë kuptim e hasim në ajetet vijuese:

إِنَّكَ لَا تَهۡدِي مَنۡ أَحۡبَبۡتَ ﴿٥٦﴾

***Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti.***[28]

۞ لَّيۡسَ عَلَيۡكَ هُدَىٰهُمۡ ﴿٢٧٢﴾

***Nuk është obligim yti** (Muhamed) **udhëzimi i tyre** (në rrugë të drejtë).*[29]

مَن يُضۡلِلِ ٱللَّهُ فَلَا هَادِيَ لَهُۥۚ ﴿١٨٦﴾

***Për atë që Allahu e la në humbje, s'do të ketë udhëzues.***[30]

مَن يَهۡدِ ٱللَّهُ فَهُوَ ٱلۡمُهۡتَدِۖ وَمَن يُضۡلِلۡ فَلَن تَجِدَ لَهُۥ وَلِيّٗا مُّرۡشِدٗا ﴿١٧﴾

***Atë që e udhëzon Allahu, ai vërtet është udhëzuar, e atë që e humb, ti nuk do të gjesh për të ndihmës që do ta udhëzonte.***[31]

Imam Rraziu thotë: "I Lartmadhërishmi në këtë ajet thotë: "*Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti"*[32] dhe në një ajet tjetër thotë: *Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë.*[33] Nuk ka kundërthënie mes këtyre dy ajeteve. Atë që ia ka bashkëngjitur Pejgamberit a.s dhe ia ka vërtetuar në këtë çështje është; thirrjen në fe dhe sqarimin e saj, ndërsa atë që ia ka mohuar atij lidhur me këtë çështje është; udhëzimin dhe hapjen e gjoksit, që është një dritë që hidhet në zemër e pastaj gjallërohet zemra me të, siç ka thënë i Lartmadhërishmi:

[28] El-Kasas: 56.
[29] El-Bekare: 272.
[30] El-Earaf: 186.
[31] El-Kehëf: 17.
[32] El-Kasas: 56.
[33] Esh-Shura: 52.

"*Vallë, a është ai që qe i vdekur, kurse Ne e ngjallëm dhe i dhamë dritë"*[34] .[35]

Ebu Suudi dhe el-Alusi, gjatë komentimit të ajetit: "*Nuk është obligim yti (Muhamed) udhëzimi i tyre (në rrugë të drejtë).*[36] Thonë: ti nuk e ke obligim që t'i bësh ata të udhëzuar në veprimin e veprave të mira dhe të ndalohen nga veprat e këqija. Ti e ke për detyrë t'i drejtosh ata në rrugën e të mirave duke i inkurajuar në atë rrugë dhe duke i ndaluar nga e keqja me anë të qortimit, përmes ajeteve që t'u kanë shpallur nga Kurani famëlartë.[37]

Esh-Sharavi thotë: "Allahu i thotë të dërguarit të Tij në dy ajetet tjera në Kuranin kerim: "*Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti",* ia mohon atij mundësinë udhëzimit. Në ajetin tjetër Allahu i Madhërishëm ia vërteton se ai mund të udhëzojë: *Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë".* Si ka mundësi që Allahu t'ia vërtetojë një veprim të vetëm të njëjtit person e pastaj të njëjtin veprim t'ia mohojë atij? U themi atyre: Pejgamberi s.a.v.s. mund t'ua tregojë njerëzve programin e Allahut, por ai nuk e ka për obligim t'i detyrojë ata që t'i përmbahen programit të Allahut, sepse kjo nuk është pjesë e misionit të tij. Kur Allahu thotë: *ti nuk mund ta udhëzosh* do të thotë: nuk mund ta detyrosh me forcë e dhunë atë që e do, por ti "*udhëzon",* që nënkupton; ti vetëm ia tregon rrugën, detyrimi yt është vetëm komunikimi, kurse llogaria e tyre është detyrim i Yni.[38] Kjo është ajo që duhet ta dinë të zotët e da'ves/ da'avetit, kur ata vendosin të thërrasin njerëzit në fe. Përndryshe, do të kemi rezultate të hidhura e të palakmueshme, siç po i shohin edhe sot!

---

[34] El-En'am: 122.

[35] Mefatihul Gajbë; vëll: 25, F: 3.

[36] El-Bekare: 272.

[37] Ebus Suud,Muhammed Ibën Muhammed, (v. 951h) ***Irshadul Aklis Selim Ila Mezajal Kuranil Kerim***,sh.b: Dar Ihja et-Turath el-arabij, Bejrut, vëll: 3, F: 61. el-Alusi, Ruhul Meani,el-Alusi, Shihabedin, es-Sejjid Mahmud, (v.1270 h), ***Ruhul Meani,*** sh.b: Dar Ihja et-Turath el-arabij, Bejrut, vëll: 3, f:45.

[38] Esha'aravi, Muhamed Muteveli, Tefsir el-Havatir, vëll: 20 f: 37.

## Literatura e shfrytëzuar:


- KURANI kerimi, në gjuhën arabe.
- KUR'AN-i, përkthim me komentim në gjuhën shqipe nga ef. H. Sherif Ahmeti. Botimi i sh.b. e mbretit Fehd ibn Abdulaziz.
- Et-Taberi, Muhammed Ibën Xheri, (v. 310 h),***Xhamiul Bejan Ante'vil Ajil Kuran,*** sh.b: Darul Fikër, 1985 Bejrut.
- El-Vahidi, Ali Ibën Ahmet, (v. 486 h), ***Esbabu -l- Nuzul,*** sh.b: Mektebet el-Hilal, botimi i I-rë, Beirut, 1983.
- Err- Rrazi, Muhamed bin Omer, (v. 605h), ***Mefatihul Gajb***, botimi i tretë, sh,b: Dar Ihja et-Turath el-Arabij, Bejrut.
- El-Kurtubi, Muhamed bin Ahmed, (v. 671, h), ***Elxhamiu Liahkamil Kuran,*** Bejrut: sh.b, Darul kutub el- Ilmije, Bejrut 1991.
- Ebu hajjan, Muhammed Ibën Jusuf, (v.745h) ***el-Bahrul Muhit,*** sh.b: Darul Xhil, botimi i I-rë, 1995 Berut.
- Ebus Suud,Muhammed Ibën Muhammed, (v. 951h) ***Irshadul Aklis Selim Ila Mezajal Kuranil Kerim,*** sh.b: Dar Ihja et-Turath el-arabij, Bejrut.
- el-Alusi, Ruhul Meani, el-Alusi, Shihabedin, es-Sejjid Mahmud, (v.1270 h), ***Ruhul Meani,*** sh.b: Dar Ihja et-Turath el-arabij, Bejrut,
- Ibën Kethir, (v. 771h). ***Kandili ndriçues,*** I përkthyer në gj. Shqipe nga Bashkim Aliu, f.r.i 2010 cyrih.
- El-Mubar Kefuri, Safijurr-rrahman, ***el-Misbahul Munir fi tehdhibi tefsir Ibën Kethir***, Rijad: Darusselam 2000.
- Ibën Ashur, Muhamed Tahir. ***Et-Tahrir ve-t- Tenvir,***Tunis: Dar tunisije, 1984.

## SUMMARY

The guidance, or as known amongst Muslims, the Hidayah, which aims to place the man in the right path of Allah J.S., in his devotion and sincerity, and has been and remains the aim of all divine revelations, and the main purpose and mission of the Allah J.S. prophets. After the prophets, the guidance of people to the proper belief remained a responsibility for the disciples. Upon a study of Qur'an ayat which speak of the Hidayah – the guidance, one can conclude that the guidance spoken of in terminological terms, the high Qur'an divides into two types. One type of such guidance is aimed at embedding belief in in the heart, while the other type aims to guide the man towards the righteous path of the almighty Allah. The Qur'an teaches us that embedding belief in the heart is a power only for the almighty Creator. Such guidance can never be given by anyone other than the Great Allah, be that even the Prophet of Allah s.a.v.s., and it is this context in which one must understand all Qur'an ayat which say "*he who is guided by Allah, he shall be fully guided*".

The guidance mentioned in many ayat of the Qur'an, where special emphasis is placed on the contributions of Prophets and educated disciples thereof, must be taken to mean that is is guidance of people to the path of Allah J.S., and its proper elaboration. Ultimately then, one may conclude that the guidance, the Hidayah, belongs only to almighty Allah, the only One who knows the depths of conscience and hearts of people. He shall know who deserves to be guided, and who deserves to be lost. What remains to the propagators, even the Prophets, is to guide the people towards proper belief, with ultimate and wise clarifications, and heartfelt advice. In the end, what remains is to say: a call to the righteous path of the Allah J.S. is a noble mission, though also an obligation, which carries quite the responsibility, and a difficult task! Therefore, great patience is required.

Prof. asoc. Dr. Sulejman OSMANI

# DASHURIA PËR MUHAMEDIN A.S. NË VARGJET E HAFIZ IBRAHIM DALLIUT

Hafiz Ibrahim Dalliu (1878-1952)[1] vlerësohet me të drejtë si njëri nga personalitetet kryesore të kohës kur ai jetoi dhe, pa tepruar, do të thoshim se ai zë vendin e merituar në rreshtin e parë dhe atë jo vetëm në fushën e islamistikës, por në shumë veprimtari që lidhen me letrat shqipe. Rreth tij të gjithë kanë shkruar me admirimin më të madh, duke e vlerësuar në fushën e medies dhe informimit, si publicist, gazetar, editor, analist e shpesh edhe si satirist. Në rrafshin kombëtar është vlerësuar si patriot, atdhetar, liridashës, organizator i iniciativave të shumta në shërbim të çështjes kombëtare, i dënuar, i përndjekur e i përvuajtur.[2]

Për çështjen kombëtare luftoi me të folme e me të shkruar apo siç thuhet: Me mish e me shpirt. Shtypjen e pushtetit e ndjeu deri në frymën e fundit të jetës, asnjëherë nuk iu nda zullumi. Përjetoi përbuzje e dhunim nga të gjitha pushtete, në të gjitha periudhat e jetës së tij. Diktatura komuniste e torturoi shumë, duke i bërë presione nga më të

[1] Dituria Islame ka butuar një seri shkrimesh me titull *"Hafiz Ibrahim Dalliu- jeta dhe vepra"* duke filluar nga nr. 64 -70 të autorit Ibrahim Hasnaj (Hima), ku në mënyrë të detajuar është pasqyruar personaliteti dhe vepra e tij.

[2] Dr. Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i Kulturës Islame te Shqiptarët gjatë Shekullit XX,* Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, Ribotim Tiranë 2002 fq. 309-312.

ndryshmet, e burgun në vitet e shtyra të jetës së tij e kishte dërmuar, me çka kishte rënë në një gjendje të rrënuar fizike e shpirtërore.

Duke analizuar veprimtarinë e tij dhe sfidat nëpër të cilat kaloi Hafiz Ibrahim Dalliu mund të japim disa vlerësime:

1. I ndikuar nga zhvillimet negative dhe trendët në rënie të politikave shqiptare u deklarua haptas se për sa kohë gjendja vazhdon të jetë e tillë ai do të qëndrojë në opozitë duke u bërë besniku i së vërtetës.[3] Transparencën e kishte në shpirt, duke i qëndruar gjithmonë besnik një ideali të tillë. Me masën komunikonte shumë çeltazi, duke u zotuar se me tërë qenien se do të jetë në shërbim të tyre.

2. Hafiz Ibrahim Dalliu shfaqi një personalitet të fortë e të paluhatshëm në të gjitha sfidat që qëndruan para tij, si në përballje me pushtetin, ashtu edhe me situata të caktuara të cilat kërkonin një pozicionim të qartë. Qëndrimi përkrah së drejtës ishte më i dashur tek ai se interesi personal të cilin e sakrifikoi sa e sa herë.

3. Periudha kur jetoi Hafiz Ibrahim Dalliu ishte me plot sfida dhe e karakterizuar me ndryshme të mëdha. Edhe para rënies përfundimtare, kalifati kishte nisur të shembej e të merrte tatëpjetën. Faktorët e jashtëm që e shtynin në zmbrapsje ishin të shumtë, por hiq më të paktë nuk ishin ata të brendshmit.[4] Në një gjendje të tillë, jeta ishte bërë e vështirë dhe rrjedhat e saj po shkonin drejt kahut jo të duhur. Tanimë po merrte frymë shumë vështirë dhe lodhja e kishte dremitur aq shumë sa ishte para dorëzimit. Ligji i Allahut thotë se jeta duhet të ecë përpara e të shkojë drejt progresit në të gjitha fushat, të zmbrapset ai që dështon e të prijë ai që e meriton, kushdo qoftë e çfarëdo qoftë. Dhimbjet për të vdekurin nuk duhet të jenë arsye për dëshpërime a dështim. Rënien e kalifatit e përjetojnë rëndë të gjithë myslimanët pa marrë parasysh kohën kur jetojnë, dje sot apo nesër, e sigurisht se dhimbjet e atyre që e

[3] Arkivi Ministrisë së Brendshme, *Dosja I. Dalliu,* Tiranë 1998.

[4] Dr. Ismail Bardhi, *Hafiz Ibrahim Dalliu dhe ekzegjeza e tij kuranore,* Logos-A- Shkup 1419/1998.

përjetuan rënien dhe e panë me sytë e tyre e pastaj i shijuan pasojat ishin edhe më të rënda. Pa dyshim se Hafiz Ibrahim Dalliu si një alim i madh që ishte e përjetoi në shpirt atë rënie. Mosha e tij e asaj kohe e bën edhe më të ndjeshëm këtë përjetim, ngase atëherë ai ishte në vitet më ideale të jetës kur gjërat peshohen me kandarin e pjekurisë.

Nga vlerësimet që janë dhënë rreth qëndrimeve të hafiz Ibrahim Dalliut në lidhje me ngjarjet e kohës së tij, shihet qartë se ai derdhi gjithë energjinë e tij në urrejtje të komunizmit dhe ideologjisë që po vinte si produkt i marksizëm-leninizmit. Nuk u kursye aspak duke u shprehur e vepruar kundër tyre. Deri në fund të jetës e mbante shpresa se Shqipëria do të lidhej me Amerikën dhe dëshironte që këmba e këtij vendi të shkelë në trojet shqiptare.[5] Ai qartazi mbante qëndrim proamerikan, duke besuar se ata do të ishin shpresa e shqiptarëve. Me kalimin e viteve, një qëndrim të tillë e forcoi edhe më tepër. Aq sa i shtohej zullumi nga pushteti, aq më tepër forconte qëndrimin dhe dilte edhe më i vendosur në bindjet e tij. Ai kishte vërejtur me kohë se përkrahja e Amerikës është e domosdoshme për kombin shqiptar, e kjo paraqiste një argument të fortë për pushtetin e egër komunist, andaj vazhdimisht e goditi me dorën e hekurt të tij. Duke vlerësuar kapacitetin e tij të gjithanshëm, pushteti e dërrmoi për dy elemente të cilat pulsonin fuqishëm në shpirtin e Hafiz Ibrahim Dalliut. Ishte ideali i tij fetar islam prej një alimi të madh me kapacitete të cilat prodhonin energji të pashterur për realizimin e interesave fetare dhe në anën tjetër, po me të njëjtën energji punonte për idealet atdhedashëse si një patriot i dëshmuar.

4. Sinqeriteti dhe karakteri i fortë kishin ndikuar që ai të tubojë rreth vetes njerëz nga më të rëndësishmit të asaj kohe, si të fushës kombëtare po ashtu të asaj fetare. Me ta bashkëvepronte e koordinonte

[5] Dr. Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i Kulturës Islame te Shqiptarët gjatë Shekullit XX,* Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, fq. 309-312.

aktivitete. I kishte shokë të jetës, punës dhe idealit, e të njëjtin fat e patën deri në vdekje.

5. Në fushën e arsimit dhe arsimimit Hafiz Ibrahim Dalliu dha një kontribut shumë të çmuar. Ai udhëhoqi institucione arsimore në periudhat më të ndjeshme nëpër të cilat po kalonte arsimimi në gjuhën shqipe. Ai dha kontribute të veçanta dhe për shkollimin e femrave, ku mbante edhe pozita udhëheqëse e edhe mësimore.

## Kontributi i gjithanshëm

Nuk ka dyshim se kontributi i Hafiz Ibrahim Dalliut, në shërbim të kombit dhe atdheut, ishte aq madhor sa vështirë është të përshkruhet edhe në trajtime voluminoze, andaj në këta pak rreshta synojmë vetëm të tërheqim vëmendjen për të dhënë kontributin tonë drejt njohjes së këtij alimi e patrioti, të cilin e sublimuan idealet e veshura me virtytet më të larta, që vdekjen e bëjnë rrugën e gjatë të një jete që nuk përfundon, ngase mbjelljet e jetës japin frytet të cilët nuk përfundojnë kurrë. Nëse në tokë mbjell një pemë ajo vazhdon të japë fryte për vite të tëra, e nëse njeriu e mbjellë jetën, atëherë produkti i saj vazhdon në pafundësi. Sa e bukur është të bësh një jetë që të jetosh pavdekshëm pas jetës së kësaj bote. Njeriu shkon, por mbetet ajo që ka bërë, atë e kujton e mira e tij. Sidoqoftë dhe çfarëdo qoftë ajo jeta e bënë një ditë përfundon e nga aty nisë një jetë tjetër për të vazhduar pa ty, por me punët e tua. Mund të bësh jetë të mirë apo të vështirë, gjithsesi një ditë ajo do të na thotë lamtumirë këtu përfundoi rruga. Atë ditë kur përfundoi jeta e Hafiz Ibrahim Dalliut, nisi rruga e jetës së veprave të tij, që do të vazhdojnë të jenë gjallë e të japin frytet e punës së tij.

# KONTRIBUTI I HAFIZ IBRAHIM DALLIU NË SHKENCAT FETARE

Veprimtaria, kontributi dhe personaliteti i Hafiz Ibrahim Dalliut ishte aq i gjithanshëm, sa të gjithë mund të marrin prej tij dhe ta ndiejnë të vetin. Ai ishte edhe gazetar e publicist, atdhedashës e patriot, mësimdhënës edukator, dijetar i shquar i fesë dhe pa dyshim një ashik i madh i Muhamedit a.s.

Në bazë të asaj që është shkruar e publikuar rreth tij, natyrisht po them për aq sa unë kam mundur ta përcjell e të lexoj, mund të vlerësoj se Hafiz Ibrahim Dalliut ende nuk i është dhënë haku, së paku deri në një masë të caktuar e lëre më të themi aq sa e meriton. Natyrisht edhe ky shkrim i imi është i një mase të tillë që nuk paraqet më shumë se edhe një përpjekje për ta njohur punën e tij, por në objektiv kemi tërheqjen e vëmendjes rreth veprës së tij "Jeta dhe lemja e t'madhit Muhamed"[6], si një vepër e pa parë në gjuhën shqipe, ku në 6143 vargje ka radhitur jetën dhe veprën e Pejgamberit a.s.

Duke u munduar të vlerësojmë punën dhe personalitetin e tij, lirisht mund të themi se nga të gjithë profilet e cekura më lart, e që Ibrahim Dalliu ka punuar në to, asnjëra palë nuk i ka dhënë hakun e merituar. Ndoshta edhe ky, për shkak të hoxhollakut të tij, ka përjetuar anatemim ashtu siç ka ndodhur me shumë elementë e personalitete të fushës islame. Ndoshta faktori dhe përkatësia fetare edhe te ky kanë bërë dallimin ashtu siç po ndodh te ne vazhdimësi. Përndryshe si është e mundur që një pinjoll i gazetarisë shqiptare, në një periudhë shumë të hershme dhe të ndjeshme të mos tërheqë vëmendjen e duhur dhe të çmohet ashtu siç e meriton.

[6] H. Ibrahim Dalliu, *E lemja dhe Jeta e të Madhit Muhamed Alejhisselam,* Riboton Qendra Islame Shqiptaro-Amerikane New York dhe New Jersey 1992, Është botuar për herë të parë në vitin 1934.

Këtë meritë nuk e mori as nga faktori fetar, i cili veç disa shkrimeve që nuk paraqesin më shumë se një njohje elementare, duke cekur veprat e tij dhe diçka më shumë nga përshkrimi i jetës së tij, mundimeve e zullumeve që e përcollën deri në frymën e fundit, nuk bëri për të diçka më tepër. Nuk mund të them me gojën plot, por ndoshta për faktorin islam në një masë të caktuar ka arsyetim. Diktatura komuniste në Shqipëri vazhdoi për vite të tëra. Këndellja më pas ishte shumë e vështirë, e për faktorin islam po vazhdon të jetë edhe më shumë se kaq. Sigurisht që në situata të tilla këndellja është shumë e vështirë, andaj as individët e as institucionet nuk mund ta bëjnë punën e vet në masën e duhur. Kështu alimëve të mëdhenj, kryesisht të periudhës së Hafiz Ibrahim Dalliut, deri sot përveç përmendjes së emrave të tyre dhe disa veprave, nuk po u jepet haku, e pa zbardhjen e punës dhe idealit të tyre nuk mund të njohim realitetin në të gjitha dimensionet e tij. Publikimi i veprimtarisë së tyre i jep inercionin e duhur elementit islam i cili gjithsesi qëndron para sfidave të njohjes reale.

## Bashkimi në mes idealeve dhe modeli që po na mungon

Personalisht mendoj se Hafiz Ibrahim Dalliu paraqet shembullin më praktik të bashkimit në mes idealeve kombëtare, atdhedashëse dhe atyre fetare, të cilat asnjëherë në personalitetin e tij nuk u ndeshën në mes veti. Ndoshta një model si ky po na mungon në ditët e sotme dhe shumë herë si shoqëri po na qet para kundërthënieve deri në masën e divergjencave agresive, duke mohuar njëri-tjetrin. Shikuar nga botëkuptimet e kohës kur po jetojmë dhe versionin ndaj faktorit fetar islam, kujt i mbushet mendja se një gazetar shqiptar, editor, publicist e mësues punoi për çështjen e kombit, atdheut e atdhedashurisë pareshtur deri në vdekje, ndërsa në anën tjetër ai ishte një hafiz i Kuranit, dijetar islam shumë i shquar, autor i shumë veprave, përkthyes i domethënieve të Kuranit në gjuhën shqipe, poeti që thuri në vargje jetën dhe veprën e

profetit Muhamed a.s. si një kryevepër autentike e pa parë në gjuhën shqipe. I tillë ishte Hafiz Ibrahim Dalliu, modeli që po na mungon. Sigurisht që skenës publike shqiptare në ditët e sotme i është shumë i nevojshëm një mendësi e tillë. Gjersa nuk kemi modele të tilla vështirë se mund të arrihet balanca e peshores së drejtë në shoqërinë tonë.

Në fushën islame Hafiz Ibrahim Dalliu ka dhënë kontribute shumë të çmuara, ose matur me kohën kur i bëri ato mund të vlerësohen edhe si kolosale. Siç bëhet e qartë nga datat e publikimit shihet se vitet më të frytshme të punës së tij në fushën e islamistikës ishin ato në mes viteve 20 - 30 të shekullit të kaluar.

Duke u bazuar në atë që është publikuar nga veprimtaria e tij, mund të themi se ka njohur shumë mirë edhe artin e përkthimit. Punë shumë të madhe e të qëlluar ka bërë me përkthimin e veprës الطريقة المحمدية "Rruga Muhamedane"[7] si një publikim i literaturës së klasit të parë, që konfirmon legjislaturën islame të bazuar në Kuran dhe Sunet e mbi të gjitha, për lëmin që mbulon, llogaritet si një vepër e pazëvendësueshme në gjuhën shqipe e cila edhe sot gati se mbetet e vetme, por për fat të keq e pavërejtur dhe e pavlerësuar sa duhet.[8]

Lëmi i Hadithit, si shkencë që lidhet me Muhamedin a.s. zë një hapësirë shumë të çmuar në veprimtarinë e Hafiz Ibrahim Dalliut. Lirisht mund të themi se mësimet e Pejgamberit a.s. paraqesin kryefjalën e angazhimeve të tij. Ky është autori i parë që veprën e imam Neveviut " Hadithi Erbaini" të njohur në tërë botën islame si libri më i shitur e me shpërndarje më masive, e përktheu dhe botoi në gjuhën shqipe, duke bërë komente të duhura. Sigurisht që ky përkthim, ndonëse i një vepre me vëllim jo të gjatë, meriton një trajtim të duhur. Vlerën e përkthimit

[7] Hafiz Ibrahim Dalliu, *Udha Muhamedane (përkthim i veprës së autori Muhamed El Bergjevi)* Botuar nga: AIITC, Tiranë 2001 Është botuar për herë të parë më 1936.

[8] Më gjithë rëndësinë e saj kjo vepër e përkthyer nga Hafiz Ibrahim Dalliu ka përjetuar vetëm një botim i cili është shpërndarë shumë shpejt. Kjo vepër e përkthyer meriton vëmendje të veçantë.

e ngrit koha kur ai e bëri këtë punë, ngase kishte zhvillime nga më të ndryshmet si në rrjedhat e politikës shqiptare po ashtu edhe të atyre ndërkombëtare.

Në anën tjetër, pas rënies së kalifatit, myslimanët dhe jeta fetare islame po përjetonin ndryshime shumë sfiduese. Para ballafaqimeve të tilla ishte shumë vështirë të marrësh veten me të mirë e të gjesh forcë morale t'u shërbesh besimtarëve me literaturë, duke u përpjekur të plotësojë zbrazëtirën që po krijohej në fushën e mësimit dhe arsimimit islam, kur pushteti në mënyra të ndryshme dalëngadalë po kufizonte rrethin e ndikimit të fesë dhe ulemaja nuk ishin në mundësi të bënin punën e vet për t'iu përgjigjur detyrave. Në rrethana të tilla veprimtaria e Hafiz Ibrahim Dalliut bëhet edhe më specifike dhe sigurisht që meriton një çmim shumë më të lartë. Ecjen drejt idealeve të tij nuk mund ta ndalnin katrahurat e jetës, edhe pse qëndronte para maleve me sfida, marshonte drejt objektivave dhe në këtë aspekt çante rrugën drejt sukseseve. Po ta matnim kohën tonë dhe kohën e rrethanat kur jetoi ai, sigurisht që nuk do të ishte dashur ta shkruaj as një rresht të vetëm, ngase të gjitha faktorët ishin kundër tij. Por produkti i tij në rrethana të tilla e ka bërë të madh sa ne e shohim veten të paaftë për t'i dhënë hakun së paku me rreshtat që po i shkruajmë për të.

Mendoj se Hafiz Ibrahim Dalliu në punën e vet në fushën e publicistikës islame ka të veçanta disa elemente që e bëjnë të dalluar, e nxjerrin si personalitet unik dhe formojnë karakterin e tij në vargun e ulemave të mëdhenj islamë. Në këtë analizë punën e tij e karakterizojnë disa veçori.

1. Kontributi i tij është i shtrirë në shumë fusha islame, duke nisur me komentin e Kuranit si një punë nga më të vështirat, të cilën gjeneratat që erdhën e bënë shumë më vonë. Po të vazhdonte dituria rreth tefsirit të Kuranit me nivelin e Dalliut, Allahu e di se ku do të ishim sot në fushën e shtrirjes së njohurive islame. Është evidente se te shqiptarët u desh të kalonin 50 vjet pas tij për të parë domethëniet e ajeteve të

Kuranit të përkthyera në gjuhën shqipe, ndërsa tefsiri të cilin qysh atëherë e kishte filluar ende nuk po mund ta gjejë rrugën e vazhdimit për të ardhur në dorën e lexuesve si një punë e kompletuar dhe shumë imperative, besoj me prioritet e që nuk mund të matet me asnjë detyrë thetër. Veprimtaria e Hafëz Dalliut na bën të përgjegjshëm të themi se ne nuk bëmë dhe nuk po bëjmë punën e duhur për arsimimin e myslimanëve. Edhe në këto kohë të medies dhe mundësive të ndryshme të publikimit, lexuesve tanë u mungojnë veprat më me rëndësi në fushat më të rëndësishme të islamit, e të cilat Dalliu, qysh në kohën e tij, i kishte dert dhe me mundin e tij nisi t'i nxirrte në gjuhën shqipe. Ai shkroi në fushën e Tefsirit, të Hadithit, Legjislaturës së Kuranit dhe Sunetit, Jetës dhe veprës së Muhamedit a.s. e njohur si Sire, Jurisprudencë Islame, Kulturë dhe Edukatë Islame, po ashtu shkroi rreth bazave të Islamit. Është për t'u dalluar poezia e tij islame, ku paraqiti një mjeshtri të vërtetë.

2. Mendoj se të gjitha kontributet e tij kanë për produkt njohuritë e tij mbi shkencat islame dhe dëshmojnë se ka qenë njohës i mirë i tyre. Këtë mund ta konkludojë çdokush që lexon punën e tij edhe nëse jo me ndonjë vëmendje të theksuar. Gjithçka që ai bëri ishte një brumë i përgatitur mirë që të jep idenë e qartë mbi aftësitë e tij intelektuale.

3. Në fushën e përkthimit posedonte aftësi shumë të mëdha dhe kjo është shumë e qartë në gjithë punën që ka bërë. Në këtë veprimtari, element shumë dallues është standardi i përkthimit i shprehur në fjalët shqipe, një përkthim që e lëmon aq bukur tekstin e bartur në gjuhën tonë sa aspak nuk i lë erë të gjuhës arabe, një defekt që në ditët e sotme po na përcjell pandashëm ndoshta duke u bërë pengesë për punën tonë. Hafiz Ibrahimi në përkthimet e tij e ka përtypur aq bukur tekstin arab sa të bënë të mendosh se Islami e ka burimin në gjuhën shqipe, ngase aspak nuk ka simptoma të shprehjeve tekstuale të cilave në shqip u vjen era arabisht dhe në këtë trajtë duken shumë të pashije.

I ndikuar nga stili i lartë i shprehjeve në gjuhën arabe, e veçanërisht të vjershave që shquhen për kulturën e ligjërimit, me aftësi elokuente të cilat me fjalë shprehin kapacitetet mendore e aftësi linguistike të thurura si produkt i momenteve të inspirimit poetik, kam menduar se gjuhës sonë i mungon një stil i tillë i shprehjes, apo së paku në fushën e islamit gjërat nuk mund të thuhen në gjuhën shqipe fuqishëm ashtu qysh thuhen e shprehen në gjuhën arabe! Megjithatë, mjeshtëria që Hafëz Dalliu dëshmoi në përkthimet e tij nga gjuha arabe na bën të kemi vetëbesim dhe të punojmë pareshtur drejt aftësimit dhe ngritjes së kualiteteve me qëllim të përfitimit të shkathtësive të cilat janë të domosdoshme për punën tonë profesionale. Janë të njohura bukuritë poetike me të cilat ai shpreh energjinë e shpirtit, duke artikuluar atë që do ta thotë. Ai shprehet shumë lirshëm dhe përdor të gjitha format e komunikimit artistik, me çka themelon trajtën e dëshiruar të vargjeve që i radhitë duke përzgjedhur rimën e tyre, e cila për veshin e lexuesit rrjedh shumë e artikuluar. Gjithnjë në vlerësimin e poezisë së tij duhet të themi se përdor shumë pak fjalë të gjuhëve të huaja, arabe, turke apo perse, tipar që, duke marrë parasysh hoxhollakun e tij do të duhej të ishin shumë prezentë. Megjithatë, ka ndodhur e kundërta, ngase ai të gjitha i ka thënë shqip e qartë. Nuk e kemi fjalën për standardet e tij në një vjershë, cilado qoftë ajo, por e themi duke vlerësuar punën e tij në veprën autoriale "E lemja dhe jeta e t'madhit Muhamed", e cila sipas atyre që i kanë numëruar ka 6143 strofa. Kemi shumë raste kur në funksion të domethënies më të fuqishme në strofat e tij radhit pjesë nga ajeti apo hadithi, si tekste që mund të identifikojnë temën e trajtuar.

# DASHURIA PËR MUHAMEDIN A.S. NË VARGJET E HAFIZ IBRAHIM DALLIUT

Dashuria ndaj Pejgamberit a.s. është detyrë fetare, e cila buron nga besimi në të si i zgjedhur i Allahut, të cilin e dërgoi udhëzues dhe thirrës në rrugën e besimit të drejtë, duke shmangur çdo devijim. Dashurinë ndaj tij dhe pasimin e rrugës së tij e do Allahu dhe e shpërblen, ngase janë tregues të besimit të sinqertë në Krijuesin e gjithësisë. Dashurinë dhe pasimin e Muhamedit a.s. Allahu xh.sh. e shpërben me dashuri ndaj robit dhe falje. Ky nivel i dashurisë ndaj tij duhet të ngrihet drejt majave më larta, në atë masë sa ta duam atë më shumë veten, familjen dhe gjithë atë që posedojmë. Kjo është relevante me pozitën e tij si i dërguar i Allahut, interpretues i shpalljes dhe Pejgamber i fundit - vulë e të gjithë vargut të profetëve. Bindja ndaj tij dhe misionit që solli prodhojnë edhe masën e dashurisë të cilën e reflekton çdo mysliman, e është normale të themi se kategoria e dijetarëve di më së miri të kultivojë këtë dashuri dhe të vjelë frutat e saj. Ky fakt i shtyri ulemanë e islamit që në çdo periudhë kohore pareshtur të shkruajnë e recitojnë duke shprehur dashurinë ndaj tij. Ky pellg mallëngjimi që buron nga dashuria e shpirtit krijoi rrjedhat e ujit që nuk u ndalën kurrë, për të shprehur haptazi atë që e ndiejnë në qenien e tyre.

Hafiz Ibrahim Dalliu kishte shumë mall e dashuri për Muhamedin a.s. Këtë e shprehu duke e artikuluar ashtu siç ai dinte. Në formën qysh ai e ka shprehur për ne, paraqet një etje të cilën nuk do të mund ta shuanim kurrë, ngase e ka paraqitur në masën e pakrahasueshme duke derdhur nëpërmes vargjeve mallin dhe dashurinë e zemrës së tij për Pejgamberin a.s. Lavdimin ndaj tij ai e bën duke përmendur elementët kompetentë të Muhamedit a.s. e të cilët i janë dhënë në dispozicion. Autoriteti i tij gëzon pozita meritore të cilat ia ka dhënë Allahu xh.sh. e që besimtarët do të përfitojnë prej tyre në masën e pasimit të rrugës dhe udhëzimit të tij.

Duke çmuar lart kontributin e tij në fushat islame e veçanërisht në lëmin e Hadithit duhet të tërheqim vëmendjen në dashurinë e theksuar për Muhamedin a.s., të cilën e ka shprehur në aspekte të ndryshme, si në shkrime, ashtu në përkthime e gjithsesi e ka veçuar në anën poetike ku Dalliu, me vjershat për të dërguarin e Allahut, hedh në pah shkathtësitë e tij duke derdhur detin e ashkut për Pejgamberin a.s.

Megjithëse në lidhje me dashurinë ndaj Muhamedit a.s. ka shkruar me pasion, në shumë vargje edhe po të mos kishte bërë punë tjetër do të na mjaftonte vjersha me titull "Nji lutje shpirtit të shejtnuëshëm të Pejgamberit tanë (alejhisselam)",[9] ku në njëzet strofa me nga katër vargje, ka përmbledhur shumë tema dhe për secilën prej tyre mund të shkruhet dhe trajtohet si në aspektin e Hadithit po ashtu në atë të Akides Islame. Kjo është praktikë e ulemave, të cilët punën e dijetarëve të mëhershëm dhe vargjet e tyre i kanë shkoqitur në komente të ndryshme duke trajtuar si tekst bazë. Lëmi i Hadithit është modeli më mirë. Gjithsesi, strofat e Hafiz Ibrahimit paraqesin bazë të mirë dhe në këtë aspekt meritojnë trajtim të duhur.

## Lutjet dhe shpresat e Hafiz Ibrahim Dalliut

Në strukturën e saj vjersha përmban të gjithë komponentët e duhur, të cilët identifikohen si në anën emotive po ashtu edhe në qëllimin final. Hafëzi gjatë gjithë strofave ka vënë në funksion dy elementë:

1. Lavdërimet që ia bën Allahut, e që vërehen në fillim dhe lavdërimet ndaj Pejgamberit a.s. në vazhdimësi.
2. Lutjet e shumta që ia bënë të dërguarit të Allahut për ndihmë umetit.

Këta janë dy elementët kryesorë, të cilët i vë në funksion për të arritur te qëllimi final dhe për të adresuar kërkesën, e cila është emëruesi i përbashkët i poezisë.

[9] H. Ibrahim Dalliu, *E Lemja dhe Jeta e të Madhit Muhamed Alejhisselam*, f.231

Ai synon shefatin e Pejgamberit a.s. duke e kërkuar me shumë lutje dhe përkulje megjithëse si term e ka fshehur duke mos e cekur në asnjë rast.

Lutja, të cilën e potencon në titullin e vjershës duke thënë " Nji lutje shpirtit të shejtnueshëm të Pejgamberit tanë" ka për qëllim pikërisht ajo lutje që ia drejton pejgamberit për të ndërmjetësuar te Allahu xh.sh në Ditën e Gjykimit, në një pozitë nderimi të cilën nuk do ta ketë askush tjetër përveç tij. Shefati[10] që e bën Muhamedi a.s. është sinonim i të gjithë myslimanëve, pa marrë parasysh dallimet e tyre në veprime. Këtë të drejtë ia ka dhënë Allahu xh.sh. dhe ai do ta shfrytëzojë në momentet më të vështira për mbarë njerëzinë, atëherë kur të gjithë do të qëndrojnë duke pritur nisjen e gjykimit të tyre. Pozita e shefatit është tematizuar qartazi edhe në thëniet e Muhamedit a.s. e është doktrinë e besimit te mbarë myslimanët si pjesëtarë të ehli sunetit.

Bazuar në hadithet e Pejgamberit a.s. shefatin e tij në Ditën e Gjykimit do ta arrijnë disa kategori besimtarësh:

1. Ai që pas përfundimit të ezanit e lexon duanë e ezanit, duke e bërë këtë rregullisht.[11]
2. Ai që dëshminë islame, shehadetin, e thotë me sinqeritet të plotë.[12]

---

[10] Hadithet në të cilat tregohet çështja e shefatit janë nga hadithet më të gjata si tekst ngase në to trajtohet e tërë ecuria dhe zhvillimi i ngjarjes që nga pamjet e tubimit në vendqëndrim dhe pritjet për të filluar gjykimi, lutjet që u bëhen pejgamberëve për të ndërmjetësuar tek Allahu të fillojë gjykimi e deri te shefati i Muhamedit a.s. me lutjet specifike para madhërinë së Allahut fuqiplotë pas të cilave hapet gjykimi. Hadithet e tilla i ka shënuar Buhariu në Sahihun e tij me nr. 4435 Muslimi nr. 501 Tirmidhiu 3148

[11] Hadithin e shënon Buhariu,nr. 589 me tekst

عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ مَنْ قَالَ حِينَ يَسْمَعُ النِّدَاءَ اللَّهُمَّ رَبَّ هَذِهِ الدَّعْوَةِ التَّامَّةِ وَالصَّلَاةِ الْقَائِمَةِ آتِ مُحَمَّدًا الْوَسِيلَةَ وَالْفَضِيلَةَ وَابْعَثْهُ مَقَامًا مَحْمُودًا الَّذِي وَعَدْتَهُ حَلَّتْ لَهُ شَفَاعَتِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ

Xhabir bin Abdilah tregon se i dërguari i Allahut ka thënë: *"Kush thotë, pasi ta dëgjon ezanin; O Allahu im! Zot i kësaj thirrje të plotë dhe namazit që do të falet, jepi Muhamedit a.s. shkallën më të lartë në Xhenet dhe nderimin e veçantë (nga të gjithë njerëzit) dhe ngrite atë në gradën e shefatbërësit, pozitë të cilën Ti ja ke premtuar ati, i tilli do të gëzon shefatin tim."*

[12] Hadithin e shënon Buhariu nr.99 me tekst

3. Ai që në çdo mëngjes dhe mbrëmje bie salavat nga 10 herë për Pejgamberin a.s.[13]
4. Ata që bëjnë mëkate të mëdha nga pjesëtarët e umetit të Pejgamberit a.s.[14]

Në një ndarjen gjenerale Muhamedi a.s. do t'i bëjë tri ndërmjetësime:

1. Ndërmjetësimi madhështor të cilin do ta bëjë për mbarë njerëzinë, ku do t'i lutet Allahut të fillojë gjykimin, e më pas secili do të shkojë në rrugën e vet për t'u gjykuar sipas punëve të tij.
2. Ndërmjetësimin për kategoritë e ndryshme të besimtarëve, ashtu siç i cekëm më parë dhe hapjen e dyerve të xhenetit të cilat nuk do t'i hapen askujt para tij.
3. Ndërmjetësimi për një kategori jomyslimanësh, për lehtësimin e dënimit ndaj tyre, për shkak të mirësjelljes së tyre dhe kontribu-

---

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ أَنَّهُ قَالَ قِيلَ يَا رَسُولَ اللَّهِ مَنْ أَسْعَدُ النَّاسِ بِشَفَاعَتِكَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ لَقَدْ ظَنَنْتُ يَا أَبَا هُرَيْرَةَ أَنْ لَا يَسْأَلُنِي عَنْ هَذَا الْحَدِيثِ أَحَدٌ أَوَّلُ مِنْكَ لِمَا رَأَيْتُ مِنْ حِرْصِكَ عَلَى الْحَدِيثِ أَسْعَدُ النَّاسِ بِشَفَاعَتِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ مَنْ قَالَ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ خَالِصًا مِنْ قَلْبِهِ أَوْ نَفْسِهِ

Ebu Hurejra tregon se Pejgamberit a.s. i është thënë: *"O i dërguar i Allahut! Cili nga njerëzit do t'i gëzohet më së shumti shefatit tënd ditën e kiametit! Pejgamberi a.s. tha se për shkak të interesimit tuaj që kam parë, për mësimin e hadithit, o Ebu Hurejre, kam menduar se askush para teje nuk do të më pyesë mua për këtë hadith! Më i gëzuari me shefatin tim ditën e kiametit do të jetë ai i cili me sinqeritetin e plotë nga zemra dhe shpirti e thotë fjalën La ilahe illallah".*

[13] Hadithin e transmeton Taberaniu nr. 2164, Albani e vlerëson si hadith hasen. Shih. Sahih El Xhamië nr. 6357 teksti i hadithit

وَعَنْ أَبِي الدَّرْدَاءِ رضي الله عنه، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صلى الله عليه وسلم: مَنْ صَلَّى عَلَيَّ حِينَ يُصْبِحُ عَشْرًا، وَحِينَ يُمْسِي عَشْرًا، أَدْرَكَتْهُ شَفَاعَتِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ

Ebu Ed Derda tregon se Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Ai që bie salavat ndaj meje dhjetë herë kur ngrihet në mëngjes dhe dhjetë herë në mbrëmje, do ta meritoj shefatin tim."*

[14] Transmeton Tirmidhiu nr. 2435 Albani e vlerëson si hadith Sahih (i saktë), shih: Sahih Et Tergijb ve Et Terhijb nr. 3649 Teksti i hadithit:

شَفَاعَتِي لأَهْلِ الكَبَائِرِ مِن أُمَّتِي

*"Shefati im do të jetë (edhe) për ata që kanë bërë mëkate të mëdha nga pjesëtarët e umetit tim".*

tin e dhënë në ndihmesën e Muhamedit a.s., si në rastin e xhaxhait të tij Ebu Talibit, i cili edhe pse do të mbetet në xhehenem, do t'i lehtësohet dënimi duke qenë shumë më i butë e megjithatë i dhimbshëm dhe përvëlues.[15]

E gjithë domethënia e poezisë sillet rreth ndërmjetësimit të Muhamedit a.s., për të cilin lidhet Hafëz Dalliu dhe e do aq fort. Në fakt ai këtë e bënë edhe elementin kryesor të lutjes së tij, duke e lavdëruar me cilësitë që Allahu ia përshkruan në Kuran, të atilla që nuk i ka gëzuar kush para e as pas tij.

Në vazhdim do të sjellim të njëzet strofat e vjershës, ndërsa do të mundohemi të zbërthejmë domethënien e disa prej tyre, sa për model të dertit të Hafiz Ibrahim Dalliut.

*La Ilahe il-lall-ah*
*Muhammedyrr-rresullull-llah*
*S'kemi tjetër t'mir ejvah*
*N'doresh ja Resulall-llah!*

*Por n'detë t'fajevet jem kah mbytmi*
*Me faqe n'pluhnit po zhytmi*
*Ditn e vajit kur do t'pytmi*
*M'doresh*

*Punët kur do të na shikohen*
*T'mira e t'liga kur t'peshohen*
*Të mçeftat kur t'na zbulohen*
*N'doresh...*

[15] Hadithin e transmeton Muslimi, nr. 317 teksti

عَنِ ابْنِ عَبَّاسٍ ، أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ ، قَالَ : " أَهْوَنُ أَهْلِ النَّارِ عَذَابًا أَبُو طَالِبٍ ، وَهُوَ مُنْتَعِلٌ بِنَعْلَيْنِ يَغْلِي مِنْهُمَا دِمَاغُهُ."

*"Transmetohet nga Ibën Abasi se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Nga banorët e Xhehenemit ai që do të ketë dënimin më të lehtë është Ebu Talibi; Do të mbathë dy nalle (të zjarrta) nga të cilat do ti vlojnë trutë e tij."*

*Kur t'vië mbi njerëzit skutera*
*Kur t'i mbulojë të gjithë mënera*
*Prej frike t'ju bjerë punëhera*
*N'doresh...*

*Kur t'na epen n'dorë defterët*
*Kur t'thanë nefsij nefsij tjerët*
*Kur t'tremben dhe pejgamberët*
*N'doresh...*

*Gra e burra t'ri e t'vjetër*
*Kur t'terohen porsi letër*
*Përveq teje s'kemi tjetër*
*N'doresh...*

*Vetëm ke ti asht uzdaja*
*Se veç ty t'shkoj rixhaja*
*Kurban tu baftë gjith dynjaja*
*N'doresh...*

*Ti je shembull'i gjith mirësive*
*Ti je ma i ndershmi i nebivet*
*Si elmasi n'varg t'inxhivet*
*N'doresh...*

*Ti je Diell'i ditunis*
*Ja ke ndriçuë sytë njerzis*
*Je i dashm'i Perëndis*
*N'doresh...*

*Njaj Zot qi kreu qiell e dhe*
*N'jetët t'ate k aba be*
*Në këtë gradë kurrkush ma s'le*
*N'doresh...*
*N'rruzllit t'dheut anë e m'anë*
*Në ç'do çast thirret ezanë*
*Ty t'ka lavduë vetë Perëndija*
*N'doresh...*

*Ty t'a ka huva gjith bota*
*Se i ke mund besat e kota*
*Me shumë dokumenta t'plota*
*N'doresh...*

*Ti na e ke kënduë Kuranin*
*Ti na e ke mësuë Imanin*
*Ti na e ke diftuë dermanin*
*N'doresh*

*Por se na at udhë nuk po e ndjekim*
*Përnej po vujm e po hjekim*
*Prap ke Ti kryt e përpjekim*
*N'doresh...*

*Gjeti nuk kimi ku t'futmi*
*N'derët t'Ate vimë nuk tutmi*
*Se ke shumë mëshirë pra lutmi*
*N'doresh...*

*Dhe pse na u ka prish morali*
*Lutju Zotit kot t'na fali*
*Ndëshkimin mbi ne t'a ndali*
*N'doresh...*

*Lutju pra fort Perëndisë*
*Si fëmije s'amës për sisë*
*Për mbretin e gjithë Shqipnisë*
*N'doresh...*

*Qi t'a rujë prej ç'do rreziku*
*T'i vië galip çdo armiku*
*T'shkëlqejë si dritë elektriku*
*N'doresh...*

*Hafiz Ibrahim Dalliu*
*S'i shpërpirtet far njeriu*
*M'ty veç tretet si qeriu*
*N'doresh...*

Shefati është shpresa e çdo myslimani dhe do të jetë një nga momentet më të rëndësishme në ngjarjet e botës tjetër. Ky është motivi i masivizimit të mrekullisë së tij në të gjitha nivelet besimtare, si te masa e gjerë, ashtu edhe te shtresat intelektuale. Dijetarët kanë shkruar vëllime të shumta, duke shkoqitur argumentet që kanë të bëjnë me ndërmjetësimin e Pejgamberit a.s. me shpresë dhe dashuri se do ta gëzojnë atë.

Ne ecim duke pasuar rrugën e Muhamedit a.s. dhe zbatojmë programin e Sunetit të tij, andaj ky është një faktor i cili na mban afër mundësisë së përfitimit nga ndërmjetësimi që bën ai për umetin e tij.

Hafiz Ibrahim Dalliu strofën e parë e fillon me konfirmimin e njësisë së besimit në Allahun dhe të dërguarin e tij Muhamedin a.s., me çka vazhdon praktikën e ulemave të Islamit, që është obligim për të gjithë myslimanët. Çdo punë e hairit duhet të fillojë me emrin e Allahut dhe duke falënderuar atë. Menjëherë pas këtij elementi përbërës në temë duhet të vijë salavati mbi Pejgamberin a.s., apo vazhdimi me prezencën e tij e cila mund të përfaqësohet në forma të ndryshme.

Autori thotë:
*La Ilahe il-lall-ah*
*Muhammedyrr-rresullull-llah*
*S'kemi tjetër t'mir ejvah*
*N'doresh ja Resulall-llah!*

Është interesant në vargun e tretë kur thotë:" S'kemi tjetër t'mir ejvah" me modesti dhe përulje shprehet se pos shehadetit që paraqet minimumin e domosdoshëm për çdo mysliman, pa të cilin nuk vlen asnjë punë tjetër por si minimum e tillë nuk mjafton për ngritje në pozita më të larta, deklarohet se ne nuk kemi bërë e nuk posedojmë vepra tjera të mira, andaj me besim të fortë në shehadetin, ne do të mbështetemi në ndihmën tënde dhe shpresojmë në shefatin që ti e bën.

Pas një ndjenje të tillë mendoj se mund të qëndrojnë dy arsye:

E para: Mund të jetë modestia e autorit në raport me krijuesin e tij. Duke vlerësuar atë që duhet bërë, ajo që po bëjmë gjithmonë është e paktë dhe e mangët.

E dyta, ndoshta ka të bëjë me gjendjen reale që lidhet me kohën kur autori po jetonte. Duke parë se çështja e fesë nuk po ecte mbarë dhe se dukuritë negative që po e përcillnin jetën po shkonin në rritje e sipër, në të kundërtën ndikimi i islamit po binte, ai ishte i shtyrë të thoshte se nuk na ka mbetur tjetër e mirë në punët dhe jetën tonë pos fjalës La ilahe il-la llah Muhamedyrre-rresulullah, në të cilën besojmë e shpresojmë fort.

Përndryshe Hafiz Ibrahim Dalliu, në anën personale, kishte shumë gjëra të mira me të cilat dallohej atëherë, me të cilat vazhdojmë ta përmendim ne sot e do ta kujtojnë edhe gjeneratat në vazhdim. Dhuntia më e mirë e njeriut është modestia. Ajo e ngre njeriun dhe e bën të madh, më të madh se vetë puna e tij.

Në të gjitha strofat vargu i katërt është identik, i përsëritur si refren. Vetëm në strofën e parë e ka thënë të plotë:

*"N'doresh ja Resulall-llah"* ndërsa në strofat tjera e thotë: *"N'doresh..."* që nënkupton refrenin.

Pasi në vargjet më parë kishte shprehur gjendjen e robërve dhe se ata nuk posedojnë diç më tepër se shehedetin, tani ishte e natyrshme që në një situatë të tillë t'i drejtohet Pejgamberit a.s. për të kërkuar ndihmën e tij, duke i thënë se ne jemi në dorën tënde, o i dërguar i Allahut dhe shpresojmë në shefatin tënd.

Në gjashtë strofat e para ka qarë hallin duke treguar gjendjen tonë, ndërsa në ato pasuese ka lavdëruar të dërguarin e Allahut duke cekur meritat dhe veçoritë e tij dalluese nga e gjithë njerëzia.

Në vazhdim tregon arsyet pse e kërkon ndihmën e Muhamedit a.s. duke përshkruar mëkatet si një deti që po mbytemi në të me brengën se ditën e gjykimit do të pyetemi për to. Ajo do të jetë ditë vaji e pikëllimi, pasi punët tona do të vendosen në peshore dhe do të dënohemi për to, andaj për të tejkaluar këtë gjendje na është i nevojshëm ndërmjetësimi yt, o i dërguar i Allahut.

*Në këtë kuptim Hafiz Ibrahim Dalliu thotë:*
*Por n'detë t'fajevet jem kah mbytmi*
*Me faqe n'pluhnit po zhytmi*
*Ditn e vajit kur do t'pytmi*
*M'doresh...*

Në strofat e lavdërimit të Muhamedit a.s. Hafëz Dalliu ka spikatur disa veçori të cilat janë specifike për të dërguarin e Allahut dhe që nuk e shoqëron askush në to. Janë dhunti nga ana e Allahut për të dëshmuar mrekullitë dhe konfirmuar pozitën e Muhamedit a.s. tek Allahu xh.sh. dhe vlerësimin mbi gjithë njerëzinë, e për më tepër edhe vlefshmërinë mbi të gjithë pejgamberët dhe se në momentet më të vështira kur njerëzia i lutin pejgamberët sipas radhës duke filluar nga Ademi, që t'i luten Allahut të fillojë gjykimi. Të gjithë, të ndikuar nga ato momente

vuajtje e trishtimi, do të thonë: "Nefsi, nefsi"[16], ndërsa Muhamedi a.s. do të ketë dertin e umetit të tij dhe në ato situata kur të gjithë tërhiqen ai do t'i lutet Allahut duke thënë:" Umeti im, umeti im:" Këtë gjendje e ka rimuar dhe shprehur shumë bukur duke thënë:

*Kur t'na epen n'dorë tefterët*
*Kur t'thanë "nefsij nefsij" tjerët*
*Kur t'tremben dhe pejgamberët*
*N'doresh...*

Nga "Nji lutje shpirtit të shejtnuëshëm të Pejgamberit t'anë" që ia bëri Hafiz Ibrahim Dalliu në vjershën e tij, ne zgjodhëm disa strofa për t'i sjellë si model të asaj që bëri ai në shprehje të mallit dhe dashurisë për Muhamedin a.s. përndryshe ato strofa të mbetura kanë domethënie shumë madhore dhe zbulojnë edhe karaktere tjera të Hafëz Dalliut si modele të alimit, që e njohu shumë mirë të dërguarin e Allahut dhe aq shumë e luti dhe lavdëroi duke shpresuar shefatin e tij. Është madhështore se lutjet e tij i la të shkruara dhe si të tilla ne i lexojmë dhe u bashkohemi duave të tij duke e lutur Allahun për Hafiz Ibrahim Dalliun, ta gëzojë shefatin e Pejgamberit a.s. dhe ta rehatojë në xhenetul Firdevs.

## Në vend të përfundimit, një ngjarje!

Haxhaxh bin Jusuf Eth Thekafi ishte një pushtetar shumë i egër dhe zullumqar i llojit të vet. Kishte vrarë shumë njerëz duke i dënuar pa mëshirë dhe pa ndonjë arsye të qëndrueshme. Dorës së tij nuk i kishin shpëtuar as dijetarë të njohur nga më të mëdhenjtë e këtij umeti. Në mesin e tyre ishte edhe Seid bin Xhubejr, nxënës i Ibën Abasit dhe njohës shembullor i shkencave të tefsirit. Haxhaxhi e kishte dënuar me

[16] Në përkthim: "Vetja ime, vetja ime" e që se kam dertin tim dhe më mjaftojnë brengat e mia, më mjafton të merrem me çështjen time e të ngjashme në situatat kur nuk të intereson diçka tjetër, ngase çështja personale të angazhon dhe të mjafton të merresh me të.

prerje koke vetëm se ai nuk i ishte bindur veprimeve të tij. Dënimi ishte zbatuar në prezencën e vet Haxhaxhit. Pas heqjes së kokës nga trupi i Seidit kishte rrjedhë shumë gjak dhe kjo e kishte frikësuar pa masë Haxhaxhin. Me këtë rast kishte thirrur një mjek për ta konsultuar! Pse rrodhi aq shumë gjak? Mjeku i kishte thënë: Zotëria im! Kjo dëshmon se Seidi nuk ka vdekur më herët dhe se nuk është mposhtur krenaria e tij para vdekjes. Tek tani, me rrjedhjen e gjakut po i del krenaria e tij, të cilën nuk ke arritur t'ia vrasësh sa ishte i gjallë.[17]

Hafiz Ibrahim Dalliu vuajti shumë dhe u persekutua nga regjimi komunist, por edhe më herët. Megjithatë, kurrë nuk arritën të vrasin krenarinë e tij. Sigurisht se ajo vdiq bashkë me të, pasi ai e mori me vete e nuk ua la të tjerëve që t'ia marrin.

[17] Ibën Kethir Ed Dimeshki, El Bidaje ve En Nihaje, v.12 f.464, Dar Alemul Kutub 2003.

## SUMMARY

Hafiz Ibrahim Dalliu (1878-1952) is rightly considered to be amongst the major figures of the time of his life, and without much praise, one would say that he would be in the first row of people in the Islamic studies, but also in many activities related to Albanian literature. Many have written in admiration of this figure, thereby appraising Mr. Dalliu for his work in media and information, publications, journalism, editing, analysis and even as a satirist. In a more nationalist regard, he has been praised as a patriot, liberty fighter, organizer of many initiatives to defend the national matter, and he was convicted, persecuted and tormented.

Mr. Dalliu did much for the national issue, in his speeches and writings, or otherwise, wholeheartedly. He felt the oppression by the regime to his last breath. He suffered contempt and violations from all governments and throughout his life. The communist dictatorship tortured him a lot, pressuring from all sides, and imprisonment in his elderly years had tired him.

He had the fortune of being part of most dramatic epochs of time, characterized by developments that changed the course of humanity. He was witness of the last period of the Ottoman Caliphate, or its demise. He lived through the First and Second World Wars, and then he suffered the hardships of the Communist era. Despite all challenges he faced, he gave precious inputs to many scientific areas, and was known for his Islamic studies. He wrote and translated many works, which even today stand at the highest pedestals of scientific achievement. There is no doubt that his contribution deserves the attention and commitment by us all.

Prof. ass. dr. Musa VILA

# KUPTIMI I HADITHIT PËR NDARJEN E UMETIT NË 73 GRUPE

**عَنْ أَبِى هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللهُ عَنْهُ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللهِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَ سَلَّمَ: افْتَرَقَتِ الْيَهُودُ عَلَى إِحْدَى وَ سَبْعِينَ فِرْقَةً ، وَ افْتَرَقَتِ النَّصَارَى عَلَى اثْنَتَيْنِ وَ سَبْعِينَ فِرْقَةً ، وَ سَتُفَرِّقُ هَذِهِ الْأُمَّةُ عَلَى ثَلاَثٍ وَ سَبْعِينَ فِرْقَةً كُلُّهَا فِى النَّارِ إِلَّا وَاحِدَةٌ. قِيلَ: مَنْ هِيَ يَا رَسُولُ اللهِ؟ قَالَ: مَنْ كَانَ عَلَى مِثْلِ مَا أَنَا عَلَيْهِ وَ أَصْحَابِى. وَ فِى بَعْضِ الرِّوَايَاتِ: هِيَ الْجَمَاعَةُ.**

*Ebu Hurejra r.a. tregon se Resulullahu s.a.v.s. ka thënë: "Çifutët u ndanë në shtatëdhjetenjë grupe, të krishterët u ndanë në shtatëdhjetedy grupe dhe ky umet do të ndahet në shtatëdhjetetri grupe, të gjitha për në zjarr përveç njërit." I është thënë: "Cila është ajo, o i Dërguar i Allahut?" Ai tha: "Ajo (rrugë) në të cilën sot jam unë dhe shokët - sahabët e mi." Në disa versione: "Ata janë shumica (xhemati)."*[1]

**Fjalët e panjohura**

Fjala فِرْقَةٌ - *firka* ka kuptimin e grupit, sektit, partisë, divizionit, ndërsa folja افْتَرَقَتْ - *ifterekat* ka kuptimin e ndarjes, përçarjes, shkëputjes. Për shembull, themi: janë ndarë, janë përçarë, janë shkëputur nga

[1] "Sunen Ebi Davud", vëll. II, fq. 608, nr. 4596, 4597; "Sunen Et-Tirmidhij", vëll. V, fq. 25, nr. 2640, 2641.

trungu i origjinalitetit. Shumësi i fjalës فِرْقَةٌ - *firkatun* është فِرَقٌ - *firek* - *grupet*.

Fjala الْأُمَّةُ - *el-umme* ka kuptimin e pasuesve të Muhamedit a.s., kombi apo populli që vjen pas kohës së Muhamedit a.s. Themi الْأُمَّةُ الْإِسْلاَمِيَّةُ - *el-ummetul islamijetu* - populli mysliman, kombi apo komuniteti islam.

Kemi dy lloje kombesh: الْأُمَّةُ الْمُسْتَجَابَةٍ - *el-ummetul-lmustexhabetin* - kombi që i është përgjigjur ftesës së Muhamedit a.s. dhe që jetuan pas ardhjes së tij. Këta janë myslimanët. Dhe së dyti الْأُمَّةُ غَيْرُ مُسْتَجَابَةٍ - *el-ummetu* gajru mustexhabetin - kombi që nuk i është përgjigjur ftesës së Muhamedit a.s., që janë çifutët, të krishterët, budistët, apo të gjitha kombet dhe nacionalitetet që nuk iu përgjigjën ftesës islame. Shumësi i kësaj fjalë është الْأُمَمُ - *el-umem* - kombet, nacionalitetet.

Fjala إِلاَّ وَاحِدَةٌ - *il-la vahide* ka kuptimin *"përveç njërës"*. Nga kjo kuptojmë se e vërteta është një dhe nuk ndahet në shumë pjesë dhe grupe.

Dijetari Esh-Shatibiu thotë: أَنَّ الْحَقُّ وَاحِدٌ لاَ يَخْتَلِفُ - *"E vërteta nga kjo fjalë e hadithit është një dhe nuk ndryshon.* Sikur e vërteta të ishte e shumtë, nuk do të thoshte: إِلاَّ وَاحِدَةٌ - *"përveçse njërës"*. Po ashtu, në mënyrë absolute, e vërteta në sheriat nuk has në kundërthënie, sepse sheriati gjykon ndërmjet palëve që kanë kundërshtime. Allahu xh.sh. thotë:

**... فَإِنْ تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ ... .**

***"Dhe nëse keni mosmarrëveshje për ndonjë gjë mes jush drejtohuni Allahut dhe të Dërguarit."*** *(En Nisa, 59)*

Pra, kthimi në sheriat për mosmarrëveshje është treguesi më i mirë, se sikur sheriati të përmbante kundërthënie, atëherë çfarë dobie do të kishte kthimi (për gjykim) te sheriati[2].

[2] Esh-Shatibiu, "El-I'atsam", vëll. II, fq. 249. "Darul Marife", Bejrut, 1402h.

**Shpjegimi i hadithit**

El-Mubarekfurij në komentimin e këtij hadithi thekson:

"Të gjithë ata që kanë dhënë mendime për këtë hadith e dinë se Resulullahu s.a.v.s., me përçarje të umetit, nuk ka pasur për qëllim grupet që kanë kundërthënie dhe mospajtime në çështjet e fikhut, në kapitullin e lejimit (hallallit) dhe ndalimit (haramit), por vërtet ka pasur si qëllim nënçmues ata që kundërshtojnë të vërtetën në bazat e akides, në përcaktimin (kaderin) e të mirës dhe të keqes, në kushtet e pejgamberllëkut dhe mesazhit, në miqësinë dhe respektin e sahabëve dhe në nivele të ngjashme të këtyre kapitujve. Kundërshtuesit e tillë e kanë vënë njëri-tjetrin në kufër (mosbesim), për dallim nga grupi i parë (ata që kanë kundërthënie në çështje të fikhut - hallallit dhe haramit), të cilët në kundërthëniet e tyre nuk e kanë vënë njëri-tjetrin në kufër, e as në fisk (mëkate të rënda). Kështu që komentimi i hadithit se *umeti do të përçahet dhe ndahet* - افْتَرَقُ الْأُمَّة nuk ka të bëjë me mospajtimet në çështje fikhu (dytësore). Në fund të shekullit të sahabëve janë paraqitur kaderitë (ata që mohojnë kaderin) nga Ma'bed El-Xhuhenij dhe ndjekësit e tij. Kështu, pak nga pak kundërthëniet janë paraqitur derisa u plotësuan shtatëdhjetedy grupe të humbura dhe e shtatëdhjetetreta është Ehlu s-sune vel xheme'a, që është grupi i shpëtuar".[3]

Në komentimin e këtij hadithi Ibn Ebi El-Aizë në librin "Sherh Et-Tahavije" thotë:

"Në përgjithësi grupet kundërshtuese janë të humbura, përveç Ehlu s-sune vel xhemë'a[4], apo në fjalorin e sotshëm Sunizmi.

Të këtij mendimi janë edhe shumica dërrmuese e dijetarëve, se qëllimi me *grupin e shpëtuar* الْفِرْقَةُ النَّاجِيَةُ është për Ehlu s-sune vel xheme'a - pasues të Sunetit dhe Xhematit (besimtarëve).

[3] El-Mubarekfurij, "Tuhfetul ahvedhij bi sherh xhami Et-Tirmidhij", vëll. VII, fq. 398. El-Medine Munevere. Botimi II, 1385h.

[4] Ibn Ebi El-Azizë El-Hanefij, "Sherh El-Akide Et-Tahavije", fq. 383.

Sa u përket grupeve që kundërshtojnë Ehli s-sune vel xheme'a, vendimi ndaj tyre jepet varësisht prej çështjes së mosbesimit në bërjen e bidateve. Për këtë çështje dijetarët e Ehli s-sune kanë dhënë shumë sqarime[5], por me fjalë përmbledhëse mund të themi:

1. Bidati nuk është i shkallës së njëjtë. Kemi bidate që të hedhin në mosbesim e që vepruesin e tyre e nxjerrin nga hallka e Islamit dhe kemi bidate që janë të shkallës më të ulët, që vepruesin e tyre nuk e nxjerrin nga hallka e Islamit.
2. Disa dijetarë nuk i fusin në mesin e shtatëdhjetë e dy grupeve fanatikët e rëndë të bidateve, të cilët me bidatin e tyre hidhen në kufër (mosbesim). Kështu që të gjykuarit e shtatëdhjetë e dy grupeve ka të bëjë me ata që janë të gjykuar me kërcënime nga mëkatet e rënda حُكْمُ أَهْلِ الْوَعِيدِ مِنَ الْكَبَائِرِ وَ الْمَعَاصِى të këtij umeti, të cilët i ka gjykuar Islami në këtë botë, e në botën tjetër ndodhen në dëshirën e Allahut xh.sh. Nëse do Allahu xh.sh. i fal, e nëse do i ndëshkon, e pastaj do të futen në xhenet. Ky është mendimi më i mirë në këtë çështje.

## Mospajtimi si shkak i mohimit të alternativës së mendimit

Abdullah bin Mesudi r.a. tregon se ka dëgjuar një person duke lexuar një varg të Kuranit në kundërshtim me atë që e lexonte Pejgamberi s.a.v.s. "Atëherë e mora dhe shkuam me të te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i tregova për atë. Atëherë në fytyrën e tij pashë një mospëlqim dhe tha:

كِلاَكُمَا مُحْسِنٌ وَ لاَ تَخْتَلِفُوا فَإِنَّ مَنْ كَانَ قَبْلَكُمْ اخْتَلَفُوا فَهَلَكُوا .

*"Që të dy mirë ia keni qëlluar, mos u kundërshtoni, se vërtet ata që ishin para jush kundërshtuan njëri-tjetrin dhe u shkatërruan."*[6]

[5] Ibn Tejmije, "Mexhmu el-fetave", vëll. III, fq. 354.
[6] Ibn Haxher, "Fet'hul Bari", vëll. V, fq. 70, nr. 2410.

Në komentimin e këtij hadithi Ibn Tejmije thotë:

"Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar kundërshtimin, i cili të shpie në mbulimin e të vërtetës ndaj njëri- tjetrit, ngase që të dy lexuesit mirë e kishin lexuar (por e kishin kundërshtuar njëri-tjetrin). Veprimin e tyre e komentoi me fjalët "vërtet ata që ishin para jush e kundërshtuan njëri-tjetrin dhe u shkatërruan". Ibn Tejmije pastaj tha: "Dijeni se shumica e mospajtimeve dhe kundërthënieve në umet e që mbjellin hamendje janë të këtij lloji, d.m.th. kur çdonjëri prej tyre konsideron se ia ka qëlluar, kurse mendimin e tjetrit e konsideron gabim dhe e mohon."[7]

Ibn Abasi r.a. tregon se Resulullahu s.a.v.s. ka thënë:

*"Kush vepron me xhemat (kolektiv) për hir të Allahut, nëse ia qëllon, Allahu e pranon prej tij, por nëse gabon, Allahu e fal. E kush vepron në grupacione, nëse ia qëllon, Allahu nuk e pranon prej tij, e nëse gabon, atëherë le ta përgatitë një ulëse prej zjarrit të xhehenemit."*[8]

## Kuptimi i fjalës Es-Sunne - السُّنَّةُ

Ky nocion, *Es-Sunne - Sunizmi,* i ka rrënjët në praktikimin e Traditës Profetike. Të gjithë ata që pasojnë praktikën e Profetit s.a.v.s., fjalët, veprat dhe pëlqimet e tij quhen sunitë. Pejgamberi s.a.v.s. tha:

فَمَنْ رَغِبَ عَنْ سُنَّتِي فَلَيْسَ مِنِّي

*"Kush e kundërshton Sunetin tim nuk është prej meje."*[9]

Këtu fjala Sunne ka kuptimin e rrugës, drejtimit, kahut. *"Kush nuk i përmbahet rrugës sime dhe merr rrugë tjetër, nuk është prej meje."*[10]

[7] Ibn Tejmije, "Iktiadu s-siratal mustekimë", vëll. I, fq. 124.
[8] Ibn Buta El-Akberij, "El-Ibane an sheriat el-firkatu n-naxhije", nr. 130.
[9] "Sahihul Buhari", vëll. XV, fq. 493, nr. 4675; "Sahihu Muslim", vëll. VII, fq. 175, nr. 2487.
[10] "Fet'hul Bari", vëll. IX, fq. 104.

Ata që nuk e marrin në konsideratë rrugën e Resulullahut nuk mund të thonë se e pasojnë atë, kurse ata që e pasojnë rrugën e tij quhet sunitë.

Abdullah Ibn Mes'udi r.a. thotë:

اتَّبِعُوا وَ لاَ تَبْتَدِعُوا فَقَدْ كَفَيْتُمْ

*"Pasoni (rrugën e Profetit) e mos shpikni, se ajo ju mjafton."*[11]

Këtu kuptohet se rrugë e mjaftueshme është tradita, rruga dhe drejtimi i Pejgamberit s.a.v.s.. Ky ether thërret në pasimin e sunizmit si rrugë e drejtë dhe e vetme për umetin islam.

Shpeshherë nocioni Es-Sune vjen në kuptimin e kundërt të logjikës dhe mendjes. Buhari në "Sahihun" e tij thotë se Ebu Zenad ka thënë:

إِنَّ السُّنَنَ وَ وُجُوهَ الْحَقِّ لَتَأْتِي كَثِيرًا عَلَى خِلاَفِ الرَّأْيِ فَمَا يَجِدُ الْمُسْلِمُونَ بُدًّا مِنَ اتِّبَاعها

*"Vërtet sunetet dhe rruga e drejtë, në shumicën e rasteve, vijnë në kuptimin e të kundërtës së logjikës, kështu që myslimanët patjetër duhet ta pasojnë Sunetin."*

Ibn Haxheri thotë: "Thënia e Ebu Zenadit se sunetet në shumicën e rasteve vijnë në të kundërtën e logjikës sikur sinjalizon për thënien e Aliut r.a.:

لَوْ كَانَ الدِّينُ بِالرَّأْيِ لَكَانَ بَاطِنُ الْخُفِّ أَحَقُّ بِالْمَسْحِ مِنْ أَعْلاَهِ

*"Sikur feja të ishte me logjikë, atëherë më e drejtë do të ishte dhënia e mes'hit nga poshtë sesa nga lart."*[12]

Pra, myslimanët duhet të zgjedhin rrugën e Traditës së Profetit a.s., që quhet sunizëm, e jo rrugët e drejtimeve, jetësore, filozofike, partiake që janë pjell e mendjes njerëzore. Thënia e Aliut r.a. mposht çdo tentim të njerëzve që largohen nga Sunizmi dhe mbështeten në logjikë dhe filozofi njerëzore.

[11] "Sunen Ed-Darimij", vëll. I, fq. 61, 211.
[12] Ibn Haxher, "Fet'hul Bari", vëll. IV, fq. 192.

Ebu Uthman En-Nisaburij thotë:

مَنْ أَمَّرَ السُّنَّةَ عَلَى نَفْسِهِ قَوْلاً وَ فِعْلاً نَطَقَ بِالْحِكْمَةِ وَ مَنْ أَمَّرَ الْهَوَى عَلَى نَفْسِهِ قَوْلاً وَ فِعْلاً نَطَقَ بِالْبِدْعَةِ

*"Kush ia urdhëron vetes Sunetin në thënie dhe praktikë, ai ka deklaruar urtësinë, e kush i ka urdhëruar vetes pasionin në thënie dhe praktikë, ai ka deklaruar bidatin - risinë."*[13]

Nga kjo thënie e Nisaburit kuptojmë se çdo shmangie nga sunizmi është shmangie nga urtësia dhe përqafim i bidatit apo risisë. Me fjalën bidat nënkuptojmë rrugën që ndeshet me Traditën e Profetit s.a.v.s., apo rrugën që ndeshet me sunizmin.

Allahu xh.sh. thotë:

**فَلْيَحْذَرِ الَّذِينَ يُخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ**

***"Le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e Tij*** *(Sunetin e Profetit)* ***se ata do t'i godasë ndonjë fitne, ose do t'i godasë dënim i hidhët."*** *(En Nurë, 63)*

Në komentimin e fjalës: *"Le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e Tij (Sunetin e Profetit)",* Ibn Kethiri thotë: "Le të ruhen ata që kundërshtojnë urdhrin, rrugën, programin, drejtimin, sheriatin e Resulullahut. Fjalët dhe veprat tona do të përballen me fjalët dhe veprat e Tij: ajo që përputhet me të pranohet e ajo që bie në kundërshtim refuzohet, pavarësisht se kush është ai."[14] Imam Maliku thotë:

مَنْ ابْتَدَعَ فِي الْإِسْلاَمِ بِدْعَةً يَرَاهَا حَسَنَةً فَقَدْ زَعَمَ أَنَّ مُحَمَّدًا خَانَ الرِّسَالَةَ لِأَنَّ اللهَ يَقُولُ: (الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ) فَمَا لَمْ يَكُنْ يَوْمَئِذٍ دِينًا فَلاَ يَكُونُ الْيَوْمَ دِينًا .

*"Kush shpik në Islam një bidat-risi që e sheh si vepër të mirë, ai ka supozuar se Muhamedi a.s. e ka tradhtuar mesazhin, nga-*

[13] El-Asbehanij, "Hiljetul Evlijai", vëll. X, fq. 244.
[14] Ibn Kethir, "Tefsirul Kur'anil Adhim", vëll. III, fq. 307.

*se vërtet Allahu xh.sh. thotë: "Sot jua përsosa fenë tuaj...". Ajo që në atë kohë nuk ka qenë fe, as sot nuk është fe."*[15]

Kjo thënie e Imam Malikut ka për qëllim ruajtjen e Islamit dhe të sunizmit nga çdo devijim dhe risi e kohës që mund t'i ndodhë.

Me sunizmin si drejtim nënkuptojmë Islamin real. Kushdo që e ndjek sunizmin, ka ndjekur Islamin real në besim, moral, ibadete, dispozita, vendime, konkluzione etj. Ky realitet është dëshmuar në kohën e Profetit a.s., në kohën e sahabëve, tabiinëve, tabitabiinëve dhe po dëshmohet edhe në kohën tonë. Ruajtja e sunizmit është ruajtja e fesë. Nuk mund të paramendosh të kesh Islam pa Traditë të Profetit a.s. apo pa sunizëm në fjalorin tonë të sotshëm. Myslimanët e Ballkanit ndër begatitë kryesore kanë fenë islame që është përcjellë me sunizëm. Traditën fetare e bazuan në drejtimin sunit, që për mbështetje legjislative ka Kuranin dhe Sunetin e Resulullahut s.a.v.s. Po ashtu myslimanët e Ballkanit në çështjet e fikhut janë të drejtimit hanefi, i cili për bazë të argumentimit ka Kuranin, Sunetin, ixhmain, kijasin etj.

Pra, myslimanët e Ballkanit jetën e tyre fetare e ndërtuan në dy komponentë kryesorë: në besimin sunit dhe në jurisprudencën hanefi. Kështu sunizmi dhe hanefizmi mbetën amanet nga të parët tanë që t'i ruajmë, zhvillojmë dhe kultivojmë.

## Kuptimi i fjalës الْجَمَاعَةُ - El-Xhematu (Shumica)

Në hadithin bazë, sipas disa versioneve, tregohet se grupi i shpëtuar është El-xhematu (shumica).

Imam Taberiu këtë çështje e kishte përcaktuar në katër variante. Ai tha: "Kjo çështje, përkushtimi i xhematit, ka mendime të ndryshme, po ashtu edhe fjala El-xhematu ka disa variante:

[15] Esh-Shatibij, "Kitabul I'atisam", vëll. I, fq. 28.

1. Disa thanë se përkushtimi i xhematit është çështje e domosdoshme - الْأَمْرُ لِلْوُجُوبِ . Ndërsa fjala el-xhematu nënkupton shumicën e njerëzve të umetit - es-sevadul e'adham.
2. Disa thanë se el-xhema'a janë sahabët e jo të tjerët.
3. Disa thanë se el-xhema'a janë dijetarët, ngase Allahu xh.sh. ata i ka bërë argument për mbështetje të njerëzve në çështje të fesë.
4. E vërteta e këtij hadithi për përkushtim ndaj xhematit është tubimi i njerëzve nën urdhrin e udhëheqësit. E kush tërhiqet nga zotimi i tij, ai ka dalë prej xhematit[16].

Imam Shatibiu fjalën El-xhematu e kishte komentuar në pesë variante apo mendime dhe secilin mendim e kishte mbështetur në burime të sigurta:

**E para,** me fjalën El-xhematu qëllimi është *shumica e njerëzve të umetit islam* - الْجَمَاعَةُ السَّوَادُ الْأَعْظَمُ مِنْ أَهْلِ الْإِسْلَامِ . Këtë mendim e mbështet te transmetimet e Ebi Mesud el-Ensariut dhe Abdullah bin Mesudit, që inkurajojnë përmbajtjen ndaj xhematit - shumicës së besimtarëve.

Në këtë rang të xhematit bëjnë pjesë studiuesit aktivë dhe dijetarët e umetit - مُجْتَهِدُوا الْأُمَّةِ وَ عُلَمَاءُهَا , juristët e sheriatit që veprojnë me të - أَهْلُ الشَّرِيعَةِ الْعَامِلِينَ **بِهَا** . Edhe ata që janë jashtë këtyre grupeve i përfshin ky mendim, ata të cilët janë pasues dhe të udhëzuar përmes tyre - dijetarëve.

**E dyta,** me fjalën El-xhematu fjala është për imamët e dijetarëve aktivë - الْجَمَاعَةُ: أَئِمَّةُ الْعُلَمَاءِ الْمُجْتَهِدِينَ . Këtu fjala dijetar përfshin dijetarët e shquar - الْعُلَمَاءُ الْأَعْلَامُ që pasojnë librin, Sunetin dhe gjurmët e sahabëve r.a.. Këtu përfshihen edhe ata që i pasojnë këta dijetarë të

[16] Ibn Haxher, "Fet'hul bari", vëll. XIII, fq. 37.

shquar, fjalët e tyre i marrin, rrugën e tyre e ndjekin, duke i pasuar dhe duke braktisur risitë apo duke mos shpikur rrugë të tjera në pasim.

Të këtij mendimi janë Abdullah bin Mubarek, Is'hak bin Rahuvejh, një grup prej selefëve, por ky është mendim edhe i usulijinjve[17].

Në këtë mendim bëjnë pjesë edhe Imam Buhariu, i cili fjalën El-xhematu e kishte komentuar si fjalë që përfshin هُمْ أَهْلُ الْعِلْمِ - dijetarët aktivë dhe praktikë. Po ashtu, Tirmidhiu fjalën El-xhematu e kishte komentuar si fjalë që përfshin: هُمْ أَهْلُ الْفِقْهِ وَ الْعِلْمِ وَ الْحَدِيثِ - dijetarët e fikhut - fakihët, dijetarët në përgjithësi dhe hadithologët (muhadithinët)[18].

I këtij mendimi përafërsisht është edhe El-Adhim Abadij, i cili thotë: "Fjala El-xhematu përfshin: أَهْلُ الْقُرْآنِ وَ الْحَدِيثِ وَ الْفِقْهِ وَ الْعِلْمِ - Dijetarët (lexuesit) e Kur'anit, të hadithit, të fikhut dhe dijetarët e tjerë."[19]

Imam Ahmedi, duke komentuar grupin e shpëtuar, thotë:

إِنْ لَمْ يَكُونُوا أَهْلُ الْحَدِيثِ فَلاَ أَدْرِى مَنْ هُمْ

*"Nëse nuk janë hadithologët, nuk e di se kush mund të jetë".*

Mendimin e Imam Ahmedit në mënyrë të shkathët e analizon El-Kadij Aijad dhe thotë:

أَرَادَ أَحْمَدُ أَهْلَ السُّنَّةِ وَ مَنْ يَعْتَقِدُ مَذْهَبَ الْحَدِيثِ

*"Imam Ahmedi kishte për qëllim Ehlu s-sune dhe ata që kanë mendime dhe bindjeve të hadithologëve."*

Pra, të gjithë këta dijetarë fjalën الْجَمَاعَةُ - El-xhematu e shohin se ka për qëllim dijetarët e umetit në përgjithësi. Mendimet e tyre janë të përafërta.

**E treta,** me fjalën El-xhematu ka për qëllim sahabët në veçanti. Ky mendim përputhet me versionin: مَا أَنَاْ عَلَيْهِ وَ أَصْحَابِى - *"Aty (rrugën) ku sot jam unë dhe sahabët e mi."*

[17] Po aty, vëll. II, fq. 261.
[18] "Sunen Et-Tirmidhij", Kitabul fiten.
[19] Avnul Ma'bud fi "Sherh Ebi Davud", vëll. XII, fq. 342.

I këtij mendimi është Omer bin Abdul Aziz r.a.[20].

Sahabët janë njerëzit më me merita për këtë çështje, ngase ata ishin pasuesit më të denjë të Kuranit dhe Sunetit. Ata ndoqën rrugën e Resulullahut s.a.v.s., kështu që fjala El-xhematu përfshin grupin e sahabëve, që janë grupi i shpëtuar dhe që përmes tyre ne u udhëzuam dhe pasuam rrugën e Resulullahut s.a.v.s.

**E katërta,** me fjalën El-xhematu ka për qëllim:
جَمَاعَةُ أَهْلِ الْإِسْلَامِ إِذَا أَجْمَعُوا عَلَى أَمْرٍ - grupin e umetit islam, të cilët janë unikë në një çështje dhe është obligim t'i pasojmë ata përkundër të tjerëve". Ky mendim i Imam Shatibijut nuk është shumë i qëndrueshëm para mendimeve të tjera.

**E pesta,** me fjalën El-xhematu e ka për shumicën e myslimanëve të tubuar rreth një udhëheqësi. Për këtë ka urdhëruar Pejgamberi s.a.v.s. dhe na e ka ndaluar ndarjen e umetit pasi jemi tubuar nën udhëheqjen e tij.

Këtë mendim e kishte përkrahur dhe zgjedhur edhe Et-Taberiu.

Esh-Shatibiu në përfundim thotë: "El-xhematu nënkupton tubimin rreth udhëheqësit që vepron me Kuran dhe Sunet. Tubimi jashtë Sunetit nuk përfshin kuptimin e fjalës El-xhematu të theksuar në hadithe, sikurse havarixhët dhe ata që pasuan rrugën e tyre."[21]

Kështu që grupi i shpëtuar mbetet grupi أَهْلُ السُّنَّةِ وَ الْجَمَاعَةِ - ***Ehlu s-suneti vel xhematu*** - *ata të cilët i përmbahen rrugës së Resulullahut s.a.v.s., sahabëve* në çështje të bindjes dhe bazave të fesë, që nënkupton shumicën e myslimanëve në globin tokësor dhe që në fjalorin bashkëkohor quhen *sunitë apo sunizmi*.

[20] Esh-Shatibij, "El-I'atisam", vëll. II, fq. 263.
[21] Po aty, vëll. II, fq. 265.

## Interpretimi i hadithit bazë sipas dijetarit El-Butij

Disa të tjerë këtij hadithi i japin kuptim të ndryshëm. Shpesh ndodh kur dikush e pyet një të ri se nga vjen, ndërsa ai përgjigjet se vjen prej vendit të grupit të shpëtuar. Sipas mendimit të këtij njeriu, ai që nuk është në rrugën e tij, atëherë nuk është prej grupit të shpëtuar. Një gjë e tillë është e rrezikshme. Nganjëherë kur e pyet të riun nga cili vend dhe shtet është, ai e injoron pyetjen tënde dhe thotë se është prej grupit të shpëtuar. Pyetje: Çka e ka bërë që të flasë kështu, kush është ai që ia ka mbjellë këtë në zemër?! Ai është edukuar të mendojë se i vetmi drejtim (medhheb) islam që do ta shpëtojë njeriun është drejtimi i tij! Dhe vetëm mendimi i tij dhe paragjykimi e bëjnë të shpëtuar, kurse të tjerët kanë dalë prej fesë (el-mile). Nga këtu ka lindur "tekfiri" (akuza për kufër - mosbesim). Kur e hasim këtë përgjigje, atëherë, për t'i mbrojtur të rinjtë që të mos bien në këtë kurth, patjetër duhet të ngjallim te ta ndjenjat shpirtërore që thërrasin për bashkimin e rinisë, ashtu që të mendojnë mirë për tjetrin. Në këtë rast disa njerëz me siguri do të pyesin: Mirë, si shpjegohet hadithi i Pejgamberit s.a.v.s. *"Çifutët janë ndarë në 71 sekte, të krishterët në 72, e umeti im do të ndahet në 73 sekte",* ndërsa tek imam Tirmidhiu ceket shtesa *"Të gjitha janë në zjarr, përveç njërës".* Ashtu që kanë të drejtë të thonë "unë jam nga grupi i shpëtuar", ngase i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka kufizuar shpëtimin në vetëm një grup. D.m.th. të gjithë të tjerët do të jenë në zjarr. Problem! Kujdes tani! Shumica kanë rrëshqitur në të kuptuarit e këtij hadithi, ngase e kanë kuptuar në mënyrë jo të drejtë. Mirë! Unë në përgjithësi në aktivitetet e mia të davetit në çdo rast them: "O ju njerëz, nuk është ky kuptimi i këtij hadithi. Pejgamberi s.a.v.s. ka theksuar katër-pesë herë, në transmetime (versione) të ndryshme, thënie që arrijnë shkallën kolektive kuptimore (mutevatir ma'nevij) ku mund të thuhet:

## A mund të ketë kontradiktë mes këtyre haditheve?

مَا مِنْ أَحَدٍ يَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ صِدْقًا مِنْ قَلْبِهِ إِلَّا حَرَّمَهُ اللَّهُ عَلَى النَّارِ

*"Nuk ka asnjë nga ata që dëshmon sinqerisht nga zemra e tij se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut dhe se vërtet Muhamedi është i Dërguari i Allahut, përveçse Allahu do ta mbrojë nga zjarri."*[22]

*"Kush e takon Allahun duke mos i përshkruar shok Atij, do t'i ndalohet zjarrit që ta djegë atë."* (Buhariu dhe Muslimi)

Pastaj, hadithi tjetër te Nesaiu, ku Pejgamberi s.a.v.s. thotë:

*"Kush thotë nuk ka zot përveç Allahut dhe unë jam i Dërguari i Tij, nuk do ta takojë njeriu Allahun me këto dy dëshmi në Ditën e Gjykimit përveçse është i mbrojtur nga zjarri."*

*"Ai që fjalën e fundit do ta ketë "La ilahe il-lAll-llah", do të hyjë në xhenet."*

E përmenda se shumë hadithe janë të shkallës kolektive kuptimore (mutevetir ma'nevij). Këto janë fjalët e Pejgamberit s.a.v.s., a është e mundur që ai të bjerë në kundërshtim me veten?! Ai, s.a.v.s., thotë:

وَ سَتُفَرِّقُ هَذِهِ الْأُمَّةُ عَلَى ثَلاَثٍ وَ سَبْعِينَ فِرْقَةً كُلُّهَا فِي النَّارِ إِلَّا وَاحِدَةٌ

*"Dhe ky umet do të ndahet në 73 grupe, të gjitha për në zjarr, përveç njërit."*

Po mirë! Edhe grupet e tjera thonë "La ilahe il-lAll-llah". Xhehmijtë thonë "La ilahe il-lAll-llah", mu'tezilët thonë "La ilahe il-lAll-llah", hashvijët njësoj, shiat thonë "La ilahe il-lAll-llah". A mund të flasë Pejgamberi s.a.v.s. në mënyrë kontradiktore? Jo. Pra, cili është kuptimi i këtij hadithi. Kjo është pjesë e metodologjisë së davetit, ju lutem që të gjithë vëllezërit të bien në ujdi rreth kësaj.

Pse myslimanët në hadith nuk ceken me emrin e tyre?

[22] "Sahihul Buhari", vëll. I, fq. 218, nr. 125.

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: *"Çifutët janë ndarë në 71 grupe, të krishterët janë ndarë në 72 grupe ..."*. Përderisa ka cekur hebrenjtë dhe të krishterët me emër, atëherë duhet të kishte theksuar se "myslimanët do të ndahen..." Duke pasur parasysh se hebrenjtë janë quajtur me emrin e tyre *hebrenj*, të krishterët janë quajtur me emrin e tyre, po ashtu duhet të ishin përmendur edhe myslimanët me emrin e tyre dhe të thoshte se edhe ata do të ndahen... Por nuk ka thënë *myslimanët*, por ka thënë *se umeti i tij do të ndahet.* Dhe ti e di se fjala *umet* ka dy kuptime: *umet të cilit i drejtohet ftesa - thirrja* dhe *umet i cili e pranon ftesën - thirrjen*. Umeti të cilit i drejtohet ftesa - thirrja përfshinë të gjithë (kombet dhe fetë) që vijnë pas të Dërguarit s.a.v.s., qoftë ateistë, të lajthitur (munafikë), të prishur, qofshin ata evropianë apo amerikanë. Të gjithë ata që jetojnë pas të Dërguarit janë umet që u drejtohet thirrja! Fjala umet i ka dy kuptime: E para: *Umetu Da've*, atyre që u drejtohet thirrja, të gjithë atyre që u është dërguar Resulullahu s.a.v.s. ftohen të besojnë Resulullahun s.a.v.s.. Disa prej tyre e kanë pranuar e disa jo. Ata që e kanë pranuar po ashtu hyjnë edhe në kuptimin *e dytë*, e që janë umeti, i cili i është përgjigjur ftesës - thirrjes. Mendoj se është e qartë. Umet që i drejtohet thirrja islame dhe umet që kanë pranuar thirrjen islame. I Dërguari s.a.v.s. ka thënë se do të ndahet *umeti i tij*. Umeti me cilin kuptim? Me kuptimin e parë. D.m.th. umetit të cilit i jam dërguar, pra, (njerëzimit në përgjithësi pas meje dhe pas sahabëve) ky umeti im do të ndahet në shumë grupacione. Natyrisht aty ka myslimanë, përfaqësues të feve të tjera, të cilët janë mbi 63 grupe. Dhe argumenti për këtë që them është argument i prerë (për nga rruga transmetuese dhe teksti) sepse Resulullahu s.a.v.s. ka thënë se *të gjitha janë në zjarr përveç* ... Dhe nuk ka thënë përveç një grupi (فِرْقَة - firka), por ka thënë *përveç një mileti (umeti)* - إِلَّا وَاحِدَة . E kush është ai? Mileti (umeti) islam. Të kishte thënë *përveç një grupi*, ai do të ishte një grup në mesin e rrethit të Islamit, por nuk ka thënë ashtu. Ka thënë: *"Umeti im do të ndahet në 73 grupe ..."* , *"... të gjithë janë në zjarr"*.

Kjo është shtesë te Tirmidhiu, *"të gjithë janë në zjarr, përveç ...",* nuk ka thënë *një grupi,* por ka thënë *përveç një mileti (umet - popull).*

Kurse fjala "mil-let" është sinonim i fjalës "fe". P.sh. themi: *"Unë jam në miletin islam",* apo *"ai i takon miletit hebre".* Kjo domethënë se të gjitha religjionet e gabuara nuk do të jenë të shpëtuara në botën tjetër, përveç pjesëtarëve të miletit islam me gjithë grupet e veta, kushdo që thotë "*La ilahe il-lAllah ve enne Muhameden resulullah" - Nuk ka të adhuruar tjetër pos Allahut dhe Muhamedi është i Dërguar i Tij*.[23]

## Disa tekste kuranore që ftojnë në unitet dhe nënvleftësojnë përçarjen

Në këtë kontekst kemi shumë vargje kuranore që u drejtohen besimtarëve për ruajtjen e unitetit, ruajtjen e xhematit dhe përkushtimin ndaj tyre. Në Kuran, në mënyrë të qartë, në shumë vende tregohet se *umeti islam është një* - وَ أَنَّ الْأُمَّةَ الْإِسْلَامِيَّةِ أُمَّةٌ وَاحِدَةٌ . Po ashtu Kurani thërret për ngritjen e fesë në njëshmërinë e Allahut xh.sh., largimin nga politeizmi dhe llojet e tij. Gjithashtu na inkurajon që vëllazërimi të jetë mbi bazën e imanit, na inkurajon që besimtarët të bashkëpunojnë njëri me tjetrin në bamirësi dhe devocion. Ndër këto ajete janë:

وَاعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلا تَفَرَّقُوا

***"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin*** *(fenë dhe Kuranin)* ***e Allahut, e mos u përçani!"*** *(Ali Imran, 103).* Sipas Ibn Xheririt, ky ajet ka për qëllim ruajtjen e *xhematit* - الْجَمَاعَةُ . Po ashtu ka sjellë sened (lidhje të transmetuesve) nga të parët se kuptimi i fjalës حَبْلُ اللهِ - *litari i Allahut* është Kurani, sinqeriteti vetëm për hir të Allahut dhe Islami.[24]

[23] www.mexhlisi-asr.com
[24] Ibn Xherir Et-Taberij, "Xhamiul Bejan an te'vilil Kur'an", vëll. IV, fq. 31.

Ky ajet ka një synim, një rezultat. Vërtet kapja pas Kuranit, sinqeriteti për Allahun, lidhja me Islamin, e gjithë kjo gjenerohet nga uniteti dhe bashkimi i myslimanëve. Pjesa e dytë e ajetit tregon se Allahu xh.sh. na e ka ndaluar ndarjen dhe për këtë na e ka tërhequr vërejtjen që të mos u prijmë shkaqeve që na çojnë në ndarje, urrejtje dhe përçarje.

Argument tjetër është ajeti:

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ

***"S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër."*** *(El Huxhuratë, 10)*

Ky ajet tregon për një parim prej parimeve të mëdha të Islamit, që është vëllazëria dhe dashuria ndaj njëri-tjetrit për hir të Allahut xh.sh.. Islami këtij principi i ka dhënë një rol të madh dhe e ka konsideruar prej shtyllave kryesore ku mund të mbështeten uniteti, bashkimi dhe solidariteti i myslimanëve. Prej veprave të para që kishte bërë Pejgamberi s.a.v.s., pas emigrimit në Medinë, ishte *vëllazërimi ndërmjet emigrantëve (muhaxhirë) dhe vendasve (ensarë)* - الْمُؤَاخَاةُ بَيْنَ الْمُهَاجِرِينَ وَ الْأَنْصَارِ .

Argument tjetër i unitetit dhe bashkëpunimit është:

وَالْمُؤْمِنُونَ وَالْمُؤْمِنَاتُ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ ...

***"Besimtarët dhe besimtaret janë të dashur për njëri-tjetrin."*** *(Et Tevbe, 71)*

Ky ajet e konfirmon qartë principin e *dashurisë dhe miqësisë* - الْوَلَاءُ ndërmjet besimtarëve dhe ky princip është më i gjerë se principi i lartcekur i *vëllazërisë* - التَّنَاخِي . Vëllazërimi konsiderohet një pjesë e miqësisë. Dijetari El-Kahtanij thotë: "Me miqësi nënkuptojmë ndihmë, dashuri, respekt me të dashurit (miqtë) haptazi dhe fshehurazi.[25]

Argument tjetër:

[25] Muhamed bin Seid El-Kahtanij, "El-Velau vel berau fil Islam", fq. 90.

فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَصْلِحُوا ذَاتَ بَيْنِكُمْ

***"... prandaj, kijeni frikë Allahun dhe përmirësoni gjendjen e unitetit tuaj."*** *(El Enfal, 1)*

Ky ajet inkurajon për përmirësimin e gjendjes dhe rrethanave të besimtarëve nëse ndodh që ndërmjet tyre të ketë plasaritje apo ndarje, në mënyrë që shoqëria të mbetet e lidhur dhe unike.

Argument tjetër është:

وَلا تَكُونُوا كَالَّذِينَ تَفَرَّقُوا وَاخْتَلَفُوا مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَهُمُ الْبَيِّنَاتُ وَأُولَئِكَ لَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ .

يَوْمَ تَبْيَضُّ وُجُوهٌ وَتَسْوَدُّ وُجُوهٌ فَأَمَّا الَّذِينَ اسْوَدَّتْ وُجُوهُهُمْ أَكَفَرْتُمْ بَعْدَ إِيمَانِكُمْ فَذُوقُوا الْعَذَابَ بِمَا كُنْتُمْ تَكْفُرُونَ . وَأَمَّا الَّذِينَ ابْيَضَّتْ وُجُوهُهُمْ فَفِي رَحْمَةِ اللَّهِ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ .

Argument tjetër është:

وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا فَاتَّبِعُوهُ وَلا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَنْ سَبِيلِهِ ذَلِكُمْ وَصَّاكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ .

***"Dhe se kjo është rruga*** *(feja)* ***Ime e drejtë*** *(që e caktova për ju),* ***pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni."*** *(El En'amë, 153)*

## Disa hadithe që ftojnë në unitet dhe përçmojnë përçarjen

Dijetarët janë të mendimit se hadithi është sqarues dhe analizues i Kuranit, detajues i ajeteve të përgjithshme dhe specifikues i tyre. Kemi shumë hadithe që inkurajojnë për përkushtim ndaj xhematit, ruajtje të unitetit dhe nënvleftësim të urrejtjes dhe përçarjes.

Një prej argumenteve është:

مَنْ لَمْ يَشْكُرْ الْقَلِيلَ لَمْ يَشْكُرْ الْكَثِيرَ وَمَنْ لَمْ يَشْكُرْ النَّاسَ لَمْ يَشْكُرْ اللَّهَ عَزَّ وَجَلَّ وَالتَّحَدُّثُ بِنِعْمَةِ اللَّهِ شُكْرٌ وَتَرْكُهَا كُفْرٌ وَالْجَمَاعَةُ رَحْمَةٌ وَالْفُرْقَةُ عَذَابٌ

*"Ai që të paktën nuk e falënderon, as të shumtën nuk e falënderon. Ai që nuk falënderon njerëzit nuk e falënderon as Allahun. Biseda për mirësitë e Allahut konsiderohet falënderim, e lënia e saj është mosbesim (bukëshkelës). Xhemati është mëshirë, ndërsa përçarja është dënim."*[26]

Allahu xh.sh. e krijoi njeriun në këtë botë për të qenë rob i Tij dhe trashëgimtar në Tokë për ta ndërtuar dhe zhvilluar atë. Këtë veprimtari njeriu nuk mund ta kryejë i vetmuar, por në shoqërim me të tjerët. E në jurisprudencën islame proklamohet me nocionin el-xhematu (shumicë, bashkësi, masë, union). Omeri r.a. thotë:

لاَ إِسْلاَمَ إِلاَّ بِجَمَاعَةٍ وَ لاَ جَمَاعَةَ إِلاَّ بِإِمَارَةٍ وَ لاَ إِمَارَةَ إِلاَّ بِبَيْعَةٍ وَ لاَ بَيْعَةَ إِلاَّ بِطَاعَةٍ

*"Nuk ka Islam pa bashkësi e nuk bashkësi pa udhëheqje. Nuk ka udhëheqje pa zotim e nuk ka zotim pa nënshtrim."*[27]

Kjo është një ftesë për ruajtjen e bashkësisë, për të jetuar në solidaritet dhe dhembshuri ndaj njëri-tjetrit.

Argument tjetër është:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَجْمَعُ أُمَّتِي أَوْ قَالَ أُمَّةَ مُحَمَّدٍ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَلَى ضَلَالَةٍ وَيَدُ اللَّهِ مَعَ الْجَمَاعَةِ وَمَنْ شَذَّ شَذَّ إِلَى النَّارِ.

*"Vërtet Allahu nuk i mundëson umetit të ketë unitet në devijim (humbje). Dora e Allahut është me shumicën, e kush largohet, largohet për në zjarr."*[28]

Argument tjetër është:

[26] Musned Esh-Shihab, vëll.I, fq.43, nr.15; El-Albanij, "Silsiletu s-sahiha, vëll.II, fq.277. nr.667.
[27] "Sunen Ed-Darimij", vëll. I, fq. 97.
[28] "Sunen Et-Tirmidhij", vëll. IV, fq. 466.

فَإِذَا رَأَيْتُمْ اخْتِلَافًا فَعَلَيْكُمْ بِالسَّوَادِ الْأَعْظَمِ

*"Kur të hasni në përçarje (thyerje), ju përmbajuni shumicës."*[29]

Argument tjetër është:

عَلَيْكُمْ بِالْجَمَاعَةِ، فَإِنَّ الشَّيْطَانَ مَعَ الْوَاحِدِ وَ هُوَ مِنَ الْإِثْنَيْنِ أَبْعَدُ، مَنْ أَرَادَ بِحَبُوحَةِ الْجَنَّةِ فَلْيَلْزَمْ الْجَمَاعَةَ.

*"Përmbajuni shumicës (bashkësisë) se vërtet shejtani është aty ku është një person, e te dy persona ai është më larg tyre. Kush dëshiron kënaqësinë e xhenetit, le t'i përkushtohet shumicës."*[30]

Ky është një përgëzim për xhenet për ata që e ruajnë dhe i përmbahen xhematit dhe bashkësisë.

Këto hadithe janë një argument i qartë se baza dhe forca e umetit është bashkësia dhe uniteti. Bashkimi bën fuqinë, ndërsa për ata që braktisin xhematin dhe bëjnë përçarje për shkatërrimin e unitetit pasi është arritur me mund të madh ka kërcënime me ndëshkim.

Argument tjetër është:

إِخْوَانُكُمْ خَوَلُكُمْ جَعَلَهُمْ اللَّهُ تَحْتَ أَيْدِيكُمْ فَمَنْ كَانَ أَخُوهُ تَحْتَ يَدِهِ فَلْيُطْعِمْهُ مِمَّا يَأْكُلُ وَلْيُلْبِسْهُ مِمَّا يَلْبَسُ وَلَا تُكَلِّفُوهُمْ مَا يَغْلِبُهُمْ فَإِنْ كَلَّفْتُمُوهُمْ فَأَعِينُوهُمْ.

*"Punëtorët (shërbëtorët) janë vëllezërit tuaj, Allahu jua ka mundësuar të jenë nën urdhrat tuaja. Kush ka vëllanë e vet nën urdhrin e tij, le ta ushqejë me atë që ushqehet vetë, le ta veshë me atë që vishet vetë. Mos i ngarkoni me atë që nuk munden e nëse i ngarkoni, ndihmojini!"*[31]

Argument tjetër është:

[29] "Sunen Ibn Maxh", vëll. XI, fq. 442, nr. 3940.
[30] "Sunen Et-Tirmidhij", vëll. VIII, fq. 69, nr. 2091.
[31] "Sahihul Buhari", vëll. I, fq. 481.

الْمُؤْمِنُ مِرْآةُ الْمُؤْمِنِ وَالْمُؤْمِنُ أَخُو الْمُؤْمِنِ يَكُفُّ عَلَيْهِ ضَيْعَتَهُ وَيَحُوطُهُ مِنْ وَرَائِهِ.

*"Besimtari është pasqyrë e besimtarit, besimtari është vëlla i besimtarit, ai ia pengon të keqen atij dhe ia ruan shpinën. Nëse sheh ndonjë dobësi, ia drejton atë."*[32]

Argument tjetër është:

إِنَّ الْمُؤْمِنَ لِلْمُؤْمِنِ كَالْبُنْيَانِ يَشُدُّ بَعْضُهُ بَعْضًا

*"Me të vërtetë besimtari për besimtarin janë sikur ndërtesa, janë të lidhur me njëri-tjetrin (duke e mbajtur)."*[33]

Argument tjetër është:

مَنْ فَارَقَ الْجَمَاعَةَ شِبْرًا فَقَدْ خَلَعَ رِبْقَةَ الْإِسْلَامِ مِنْ عُنُقِهِ.

*"Kush ndahet prej xhematit një pëllëmbë, ai ka zhveshur litarin (zotimin) e Islamit nga qafa e tij."*[34]

Xhemati apo bashkësia është i vetmi aspekt të cilit myslimani ia vë në dispozicion tërë fuqinë dhe energjinë e tij. Krejt energjia e tij funksionon në mënyrë të barabartë dhe të plotë në të njëjtën kohë. Kjo në vetvete është mëshirë, ndërsa individualizmi apo ndarja e shkatërron energjinë që ka njeriu dhe mundëson që ai të shfrytëzohet nga djalli i xhinëve dhe njerëzve në manipulime dhe humnerë, kurse kjo në vetvete është dënim.[35]

Pra, xhemati apo bashkësia e furnizon njeriun me shumë mirësi dhe begati, ashtu siç e furnizon me eksperiencë që e ndihmon në përballjen e sfidave të shumta që gjenden para tij.

[32] "Sunen Ebu Davud", vëll. XIII, fq. 76, nr. 4272.
[33] "Sahihul Buhari", vëll. II, fq. 289, nr. 459.
[34] "Sunen Ebu Davud", vëll. XII, fq. 375, nr.4131; "Sunen Et-Tirimidhij", nr. 2864.
[35] Muhamed Kutubi, "Menhexh Et-terbije islamije", vëll. I, fq. 18.

## SUMMARY

In this hadith, we have addressed a short history of the division of people before us, such as the Jews who divided into 71 groups, and then the Christians who divided into 72 groups, and then, the division of our Ummah into 73 groups.

In this hadith, we also address some unknown words, such as the “firqa – a group, a sect or party”, and then the meaning of the word Ummah – nation, community or nationality".

The meaning of this hadith, and its words of division and Ummah, is not related to confronting or contesting groups in terms of Fikh, but is really aimed at deprecating those groups who dispute the truth on the basis of belief – Aqidah, Qadar, Prophets, the Message, and the issues of Sahibs.

In this hadith, we have mentioned who is the saved group Ahlus Sunnah wal Jamaah.

What was the position of the Ahlus Sunnah wal Jamaah on the Bid-ah, and what are its types?

The Hadith addresses the disputes springing as a result of denying the option of another belief, and the topic also contains the meaning of the word "es-suneh" –Sunnism, and the "el-Jamma'atu" – the majority, or vast majority.

The interpretation of this hadith according to El-Buti.

Several Qur’an verses that invite unity and undermine division, and several other hadiths which call for unity amongst believers.

Dr. Ajni SINANI

# PËRHAPJA E MEDHHEBIT HANEFI NË BALLKAN

## HYRJE

### Shkolla e Irakut

Abdullah b. Mes'udi ishte imam i ixhtihadit racional; ai ishte një nga konsulentët më të afërt të Omerit r.a. Në veprën "Kitabul Haraxh", të Ebu Jusufit, emri i Omerit është përmendur 124 herë dhe mendimi i tij, nëpërmjet Ibn Mes'udit, ka ndikuar dukshëm në formulimin e mendimeve të shkollës hanefite.

Aliu r.a. me fetfatë dhe gjykimet e tij është bërë udhërrëfyes për irakianët. Shabiu e ka ushqyer me hadithe rajonin e Irakut. Alkameja, Esvedi dhe Ibrahimi janë nga Nehaja, ndërsa Mesruku dhe Shabiu nga Hemedani. Neha dhe Hemdan janë dy fise të Jemenit. Shurajhi dhe Hamadi kanë lidhje me Jemenin. Përfaqësuesi kryesor dhe më i famshëm i ixhtihadit racional, Muadh b. Xhebeli, është dërguar në Jemen nga Pejgamberi i Allahut për ta mësuar popullatën dhe për të gjykuar drejt në mes të asaj popullate.[1]

[1] Hayreddin Karaman, Historia e të drejtës Islame, nga fillimi deri në kohën tonë, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2014, Logos-A, f.178.

## Metoda e Ebu Hanifes r.a.

Ebu Hanife thotë: "E pranoj pa diskutim atë që është në librin e Allahut. Nëse nuk e gjej në të, atëherë veproj sipas synetit të Pejgamberit a.s., që është transmetuar nga transmetuesit autentikë. Nëse nuk e gjej edhe aty, atëherë marr mendimin e atij që dua prej as'habëve, nuk anashkaloj mendimin e tyre; por kur është fjala për Ibrahimin, Sha'biun, Atain, atëherë edhe unë mund të bëj ixhtihad si edhe ata.[2]

## Ebu Hanifja dhe Hadithi

Ka prej atyre që janë të mendimit se Ebu Hanife bazohej tek arsyeja dhe i refuzonte hadithet autentike. Ndërkaq, Imam Ebu Hanife i jepte përparësi hadithit ndaj kijasit, edhe në qoftë se hadithi është mursel. Ai, gjithashtu, i jepte përparësi edhe hadithit të dobët/daif ndaj kijasit. Analizat kanë provuar se ai, në ixhtihadet e veta, ka përdorur përafërsisht 4 mijë hadithe.[3]

Ebu Hanife thotë: Shpifin kur thonë se ne i japim përparësi kijasit tonë kundrejt Sheriatit. A ka nevojë të përsiatet kur ekziston teksti i shenjtë."[4]

Për sa i përket refuzimit të hadithеve, ai i ka refuzuar ato hadithe për autencitetin e të cilave ka pasur dyshime, me fjalë të tjera, për shkak se ato nuk janë përputhur me rregullat e autenticitetit të hadithеve që i ka venë Ebu Hanife.[5]

---

[2] Taha Xhabir El Ulvani, Kultura e dialogut në Islam, Shkup, 2000/1421, Logos-A, f. 38.
[3] Vehbi Sulejman Gavoçi, Imam Ebu Hanife, kryejuristi mysliman, libër në dorëshkrim, f. 63.
[4] Seid Ramadan, E drejta islame, Burimi dhe zhvillimi, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2007, Logos - A, f. 92.
[5] Hayreddin Karaman, op. cit., f. 187.

## Kijasi (analogjia)

Kijasi është gjykim në bazë të analogjisë, respektivisht përfundim në bazë të parimit të dhënë në Kuran, Sunet ose Ixhma`, të mishëruar në shembullin paraprak që një rast i ri të përfshihet nën parimin e njëjtë, ose është i ngjashëm me atë shembull për shkak të karakteristikës së përgjithshme thelbësore të quajtur "shkak" (*il-le*)."[6]

Ixhtihadi nuk mund të shkojë kundër kuptimit evident të mësimeve të Kuranit dhe Sunetit. Ai është përpjekje për gjykim vetjak në mungesë të çfarëdo teksti aplikues, kurse mund të bëhet vetëm deri sa mendimi i tillë i lirë nuk i kundërvihet Kuranit dhe Sunetit.[7]

Muhamedi a.s. e kishte emëruar Muadh bin Xhebelin gjyqtar në Jemen. Para se të shkonte ta pranonte detyrën, Pejgamberi a. s. e pyeti Muadhin: "Me çka do të gjykosh?" Ai u përgjigj: "Sipas Librit të Zotit." "E nëse aty nuk gjen asgjë?" "Sipas Sunetit të Pejgamberit të Zotit"."E nëse aty nuk gjen asgjë?" "Atëherë do të përpiqem të formoj gjykimin tim vetjak." Pejgamberi, pas kësaj, ka thënë: "I lartësuar qoftë Zoti që e drejtoi emisarin e Pejgamberit të Tij drejt asaj me çka është i kënaqur Pejgamberi i Tij."[8]

Ixhtihadi, si një përpjekje për të depërtuar në domethënien dhe thelbin e ligjit të Zotit, është privilegji i shkencëtarëve më të ditur, doktorëve të ligjit islam, të cilët, përveç njohurive të hollësishme të shkencave tradicionale islame, kanë shikim "të mprehtë" dhe i njohin rrethanat e vendit e të kohës në të cilën jetojnë.

Ibn Abdil Berri thotë se Ebu Hanife është akuzuar për shkak të kijasit. Ndërkaq, kijasi/analogjia është zbatuar që nga periudha e as'habëve dhe secili prej imamëve, pak a shumë, e ka përdorur këtë metodë. Por, Ebu Hanifja:

[6] Vehbi Sulejman Gavoçi, op. it., f. 63.
[7] Seid Ramadan, f. 79.
[8] Po aty, f. 76.

A) E ka sistemuar dhe i ka vënë rregullat e kijasit,

B) E ka përdorur në masë të madhe;

C) E ka zbatuar edhe në ngjarjet hipotetike.[9]

Prof. Muhamded Ebu Zehre përmend një citat prej Sehl b. Muzahimit, në të cilin thuhet: "Procedura e Ebu Hanifes gjatë nxjerrjes së dispozitave ka qenë: 1. Miratimi i pakundërshtueshëm i teksteve autentike; 2. Refuzimi i rreptë i sjelljes së pahijshme; dhe 3. Shqyrtimi i sjelljeve njerëzore me qëllim që të gjendet ajo që është më e mirë për interesin njerëzor dhe stabilitetin e tyre."[10]

## Sistematizimi i mësimeve të shkollës hanefite

Shkolla e Ebu Hanifes është më e hershmja, më tolerantja dhe më e madhja. Ajo u zhvillua më tej dhe u sistematizua prej dy nxënësve të tij, **Ebu Jusufit** (vdiq më 181/797) dhe **Muhamed esh Shejbanit** (vdiq më 189/805). Kjo shkollë u favorizua nga abasitët. Ishte me seli në Bagdad. Karakterizohej me shprehjen e mendimit të lirë, prandaj u bë objekt i përshtatshëm për akuzat e Ehl El Hadithit në shekullin II dhe III, duke qenë se këta e refuzonin në mënyrë energjike mendimin e lirë.[11]

Çdo shkollë u quajt medheb në arabisht, dhe kishte pikëpamje paksa të ndryshme. Një shkollë priret të sundojë një hapësirë. Shkolla hanefite dominoi në atë çka do të ishin perandoritë otomane dhe mogule, kurse shkolla Malikite në Afrikën e Veriut, shkolla shafite në Egjiptin e poshtëm, në Afrikën Lindore, në Arabinë Jugore dhe në Azinë Juglindore dhe shkolla hambelite në Arabinë Saudite (ku vehabistët e Nexhdit ndoqën parimet e Ibn Temies, 1263-1328, një ndjekës i Ibn Hambelit). Në qytetet e mëdha, si Kajro, bashkëjetojnë dy e më shumë

[9] Hayreddin Karaman, op. cit., f.187.
[10] Muhammed Ebu Zehhreh, Ebu Hanife, f. 309, sipas: Seid Ramadan, op. cit., f. 105.
[11] Fazlur Rrahman, Islami, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2010, Logos - A, f. 182.

shkolla. Sot idetë e imamëve mbizotërojnë mendimin ritual dhe intelektual midis miliona njerëzve, ndërsa sfilitësit e tyre janë figura të harruara në librat e historisë.[12]

## Jetëshkrimi i Ebu Hanifes (80/699 - 150/767)

En Numan b. Thabit b. Zuta. Gjyshi i tij Zuta ishte sjellë si sllav nga Irani në Irak dhe më pas ishte liruar nga pronari i tij. Babai i tij, Thabiti, kishte lindur si i lirë dhe mysliman. Në moshë të re ishte takuar me Aliun r.a. dhe ai ishte lutur për mirësinë e tij dhe të pasardhësve të tij. Nga një familje e tillë doli Ebu Hanife.

Ishte imam i devotshëm, dijetar që punoi me dijen që i dhuroi Allahu. Ebu Hanifja është takuar me dijetarët e lartë të tabinëve dhe ka mësuar dituri e etikë prej tyre. Ai në fëmijëri është takuar me disa nga as'habët. I takon gjeneratës së dytë të tabinëve. Në mesin e mësuesve të tij tabinë më së shumti ka mësuar prej Hamad b. Ebi Sulejmanit.[13]

**Hamad b. Ebi Sulejmani** ishte mësuesi më me ndikim tek Ebu Hanifja. Hamadi kishte marrë fikhun nga Ibrahim en Nehai, i cili kishte marrë fikhun nga Alkamete en Nuhai, ky e kishte marrë fikhun nga Abdullah ibn Mes'udi.[14]

## Shërbimet në shkencën e fikhut

"E ka mbjellë" Abdullah ibn Mes'udi, "e ka ujitur" Alkameja, "e ka korrur Ibrahim en Nehaiu, "e ka shirë" Hamadi, "e ka bluar" Ebu Hanifja, "e ka bërë brumë" Ebu Jusufi dhe "e ka bërë bukë" Muhamedi, "kurse njerëzit e tjerë hanë prej kësaj buke".[15]

---

[12] Akbar S.Ahmed, Zbulimi i Islamit, duke kuptuar shoqërinë dhe historinë Islame, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2012, f. 116-118.
[13] Muhamed Ashik Ilahi el Bureni, çështje të fikhut sipas Kuduriut II, Prishtinë, 2010, f. 233.
[14] Një grup autorësh, Tarihut teshri, Xhide, 2005/1425, f. 225.
[15] Muhamed Ashik Ilahi el Bureni, op. cit., f. 231.

## Të tjerët për Ebu Hanifen

Ai kishte inteligjencë dhe aftësi të lartë rezonuese. Imam Maliku thotë: "Ebu Hanifja është një person, i cili po të tha se nën këtë dru ka ar, ka fuqi edhe ta argumentojë atë."

Imam Shafiu: "Në krahasim me Ebu Hanifen njerëzit konsiderohen fëmijë në lëndën e fikhut."[16]

Ibnul Mubarek: "Nuk kam parë të ngjashëm me Ebu Hanifen në fikh, por, gjithashtu, nuk kam parë edhe më fetar se ai."[17]

## Mësuesit e Ebu Hanifes

Numri i mësuesve të Imam Ebu Hanifes - Allahu i Madhërishëm e mëshiroftë - arrin në katër mijë mësues, prej tyre 7 janë nga sahabët e të Dërguarit s.a.v.s., 93 nga tabi'inët, kurse të tjerët janë nga tabi'i-tabi'inët. Nuk është çudi që mësuesit e tij të jenë në këtë numër; Ebu Hanife ka jetuar 70 vjet, plot 55 herë ka qenë në haxh, në këtë vend janë takuar dijetarët e vendeve të ndryshme të botës islame, gjashtë vjet ka banuar në Mekë. Në kohën kur iu kërkua ta pranonte postin e kadiut në Kufë, ai e refuzoi dhe iku në Mekë në vitin 130 hixhri dhe qëndroi rreth 6 vjet.[18] Kufa në atë kohë ka qenë qendra e hadithit dhe e diturisë, e mbushur përplot me dijetarë të shquar. Nuk është çudi që brenda 55 vjetëve të takohej me katër mijë dijetarë dhe të marrë dituri prej tyre, shumë apo pak, qoftë edhe një hadhit apo një mesele. Imam Ebu Hafs El-Kebir, pasi përmend numrin e mësuesve të Imam Ebu Hanifes, thotë: "Emrat e mësuesve të tij janë të radhitur sipas shkronjave të alfabetit dhe të përmbledhur në një vëllim."[19]

[16] Taha Xhabir El Ulvani, op. cit., f. 131.
[17] Hayreddin Karaman, op. cit., f. 180.
[18] Një grup autorësh, Tarihut teshri, op. cit., f. 225.
[19] Vehbi Sulejman Gavoçi, op. cit., f. 22.

Njëri prej mësuesve të tij ka qenë edhe dijetari i famshëm i gjeneratës së tabinjve - Amir b. Sherahil el Kufi esh Shabiu. Ky konsiderohet mësuesi më i njohur i Ebu Hanifes, sepse kishte arritur t'i takonte mbi 500 as'habë të Pejgamberit a.s. Ebu Hanifja mori mësime edhe prej Ata b. Ebi Rebahut, i cili kishte takuar mbi 200 as'habë.[20] Kalifët e fundit emevit dhe kalifi abasit, Mensuri, i propozuan Ebu Hanifes të bëhej kryegjykatës (*kadil kudat*), por ai nuk pranoi dhe, për pasojë, Mensuri e burgosi në vitin 150/767 në Bagdad, ku edhe vdiq.

## Nxënësit e Ebu Hanifes

Nxënësit e Ebu Hanifes kanë qenë të panumërt. Salihiu në veprën "Ukudul Xheman," f. 183, thotë: "Ebu Hanifen e shoqëruan dhe mësimet e tij pëlqyen shumë nxënës, një gjë që nuk mund të thuhet për asnjërin prej imamëve të mëdhenj, pas tij. Salihiu, në kapitullin e pestë, përmend disa emra njerëzish nga Meka, Medina, Damasku, Basra etj., të cilët kanë marrë mësime prej Ebu Hanifes. Sipas tij, dijetarët që kanë marrë mësime drejtpërsëdrejti nga Ebu Hanife arrin në 800.[21] Nxënësit më të njohur të Ebu Hanifes janë Ebu Jusufi dhe Muhammedel- Shejbani.

**Ebu Jusufi** (vdiq më 798) është nofka për Jakub ibn Ibrahim el-Ensariun. Nxënës i Ebu Hanifes. Përhapi influencën e shkollës hanefite nëpërmjet shkrimeve të tij dhe pozitave qeveritare që ai mbajti. U emërua gjykatës në Bagdad, më vonë kryegjykatës (*kadi el-kudat*) nën kalifin abasit Harun err-Rashid, me autoritetin për të emëruar gjykatësit në shtetin abasit. Vepra e tij më e famshme është *Kitab el-haraxh*, një traktat mbi tatimet dhe problemet fiskale të shtetit, të përgatitura për kalifin. Ai ka përpiluar veprën më të hershme të njohur të parimeve të

[20] Muhamed Ashik Ilahi el Bureni, op. cit., f. 234.
[21] Muhamed Ashik Ilahi el Bureni, op. cit., f. 234.

jurisprudencës islame (*usul el-fikh*). Një pjesë e veprës i kushtohet të drejtës ndërkombëtare.[22]

**Ebu Abdullah Muhammed ibn el-Hasan ibn Farkad Esh Shejbani** (vdiq më 804), jurist dhe nxënës i Ebu Hanifes dhe Malik ibn Enesit. U arsimua për jurisprudencë në shkollat e Irakut dhe ato të Medinës. Insistonte për rolin vendimtar të hadithit në ligjin islam. Ka mbajtur një post të lartë në oborrin abasit, gjë që ia mundësoi të përhapte shkrimet dhe idetë e shkollës hanefite. Juristi i parë që e shkroi mendimin ligjor hanefit. Shkroi një vepër të detajuar mbi ligjin e trashëgimisë dhe traktatin e parë gjithëpërfshirës mbi ligjin e xhihadit. Formuloi doktrinën e së drejtës ndërkombëtare (sijar).[23]

## Zhdukja e medhhebeve

Historianët shënojnë formimin e një numri të shkollave juridike gjatë shekujve II-III, prej të cilave një pjesë e konsiderueshme u zhdukën nga skena historike. Kjo ngase ato nuk mundën ta përballonin verifikimin praktik.[24]

Disa nga medhhebet sunite kanë mbijetuar deri sot dhe kanë ithtarët e tyre. Ndërkaq, disa të tjera, për shkak se nuk u kanë mbetur ithtarë, janë shkrirë dhe kanë ngelur në të kaluarën. Disa nga këto medhhebe janë shuar për shkak se nuk kanë pasur reprezentues me famë që t'i promovojnë opinionet e tyre, ndërsa disa të tjera, si dhahiritë, janë shuar për shkak të sistemeve të brendshme, për shkak të përqendrimit të verbër në kuptimin e jashtëm të teksteve, mohimit të analogjisë dhe mos pasjes përgjigje për nevojat e kohës. Ato janë të përmendura në librat e fikhut.[25]

[22] The Oxford Dictionary of Islam, John L. Esposito, United States of America, 2003, f. 5-6.
[23] Po aty, f. 290.
[24] Fikret Karciq, Historia e së drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 61.
[25] Hayreddin Karaman, op. cit., f. 167.

## Përhapja e medhhebit hanefi në aspektin gjeografik

Medhhebi hanefi është më i përhapur në Turqi, Azinë Qendrore, Pakistan, Bangladesh, Indi, Afganistan, Irak dhe në Ballkan. Medhheb hanefi në fillim u përhap në Irak, pastaj në Horasan, Sixhistan dhe Transjordani, pjesërisht në Taberistan, ndërsa plotësisht në Azerbajxhan, Kaukaz, Tebriz, Rej, Hudistan dhe Iran. Edhe në Sind (Pakistan) ka hanefi. Popullsia e Sixhistanit dhe udhëheqësit e Bengalit janë hanefi. Ky medheb nëpërmjet selxhukëve dhe osmanëve ka ardhur në Ballkan. Medhhebi hanefi ka qenë dominues në Afrikën Veriore deri në shekullin e katërt. Kurse më pas ia ka lëshuar vendin medhhebit maliki.[26]

## Si ka arritur medhhebi hanefi në Ballkan

Prania e sotme myslimane në Ballkan është rezultat i kalimit masiv të popullatës lokale në Islam gjatë sundimit osman (*futuhat*) në shekujt XIV, XV, por dhe shekujt vijues. Duke e pranuar Islamin, myslimanët e Ballkanit kanë pranuar gjithashtu dhe medhhebin hanefi në fikh dhe shkollën maturidite në akaid, të cilët ishin medhhebi zyrtar në shtetin osman. Përkatësia e këtyre dy shkollave të mendimit, ndër të tjera, është karakterizuar nga manifestimi i Islamit në zonën kulturore turke të botës myslimane.[27]

Do të mundohemi t'i përgjigjemi pyetjes se përse osmanët përkrahën medhhebin hanefi dhe cilat ishin rrugët e arritjes së këtij medhhebi në Ballkan e në hapësirat tona, duke u mbështetur në interpretimin historiko-gjeografik që i bën Fikret Karçiq veprës *Nidhamu'l ulema ila hatemi'l-enbija* (një numër i dijetarëve deri te Pejgamberi i fundit), që

[26] Po aty, f. 238.

[27] Fikret Karčić, Kako je hanefijski mezheb dosao u Bosni, Interpretacija silsile Hasan Pruščaka, shih: https://bosnamuslimmedia.files.wordpress.com/2011/08/islamske-teme-i-perspektive-dr-fikret-karc48dic487.pdf

është shkruar në gjuhën arabe nga Hasan Kafi Pruscak (1544-1615)[28]. Vepra është përkthyer në gjuhën boshnjake nga Mehmed ef. Hanxhiq.[29] Vepra është përkthyer edhe nga Amir Ljuboviq dhe Fehim Nametak.[30]

Kësaj pyetje do të përpiqemi t'i përgjigjemi duke u mbështetur edhe në studimet mbi historinë e medhhebit hanefi. Vepra e Hasan Kafit bie në kategorinë e veprave silsile - me të cilat dijetarët myslimanë të së kaluarës kanë provuar vërtetësinë e njohurive që ata kanë fituar.

Vepra silsile përmend zinxhirin e mësuesve të një dijetari nga të cilët janë përcjellë njohuritë, nga mësuesi te nxënësi duke u kthyer pas deri te Pejgamberi a.s.. Kjo metodë është karakteristike në shkencën e hadithit që njihet si zinxhir/sened i hadithit.

Kjo vepër e Hasan Kafitnuk është vetëm silsile e tij. Ajo është, siç thekson Mehmed ef. Hanxhiq, vepër përmes së cilës ne marrim një pasqyrë të qartë të përhapjes së të drejtës islame (fikh), dhe veçanërisht medhhebit hanefi që nga Arabia deri në vendet tona.[31]

Përmes kësaj vepre mund të shohim se si u shtri medhhebi hanefi, ku i kishte qendrat e tij kryesore dhe së fundi si ka arritur në Ballkan.

Rëndësia e kësaj vepre qëndron në faktin se ajo tregon gjithashtu se si ka arritur kjo njohje deri tek ekspertë të tjerë të fikhut hanefi, bashkëkohës të Hasan Kafit. Duke pasur parasysh këtë fakt mund të kuptojmë shtigjet gjeografike dhe rrethanat historike të përhapjes së medhhebit hanefi nga sahabët deri te shteti osman dhe edhe në hapësirat tona.

---

[28] Nizamul-ulama' ila Hatemil-enbija ((Niz učenjaka do posljednjeg Božijeg Poslanika), në gjuhën arabe e ka shkruar Hasan-ef. Kafi Pruščak, kurse e ka përkthyer: Mehmed Handžić (Sarajevo: Islamska dionička štamparija, 1935.).

[29] Fikret Karčić, Kako je hanefijski mezheb dosao u Bosni, op. cit.,

[30] Shih: Hasan Kafija Pruščak, Izabrani spisi, hyrja, përkthimi dhe shënimet Amir Ljubovic dhe Fehim Nametak, Sarajevo, Veselin Maslesa, 1983.

[31] Nizamul-ulama' ila Hatemil-enbija, 54, shih: https://bosnamuslimmedia.files.wordpress.com/2011/08/islamske-teme-i-perspektive-dr-fikret-karc48dic487.pdf

## Biografitë në silsilen e Hasan Kafit

Hasan Kafi në veprën e tij citon 30 biografi**.** Kjo silsile shkon prapa deri te Pejgamberi a.s.:

1. Pejgamberi Muhammed a.s. Pastaj përmendet kalifi i parë, Ebu Beker es-Siddiku (v. 13/634 në Medinë).
2. As'habët Umer b. el-Hattabi (v. 23/644 në Medinë), Uthman b. Affan (v. 35/656 në Medinë), Ali b. Ebi Talibi (v. 40/661 në Kufe), Abdullah b. Mesud (v. 32/652-3 në Medinë).[32]
3. Alkame b. Kajs en-Nehai (v. 62/681-2 në Kufe)[33], Mesruk b. el-Exhda el-Hamedani (v. 63/682-3 në Kufe), El-Esved b. Jezid en-Nehai (v. 74/693-4 në Kufe), Shurejh b. Harith el-Kindi (v. 79/698-9 në Kufe), që i përkasin grupit tabi'n të përqendruar në Irak.
4. Ibrahim b. Jezid en-Nehai (v. 96/714-5 në Kufe).[34]
5. Hammad b. Ebi Sulejman (v. 120/757-8 në Kufe).
6. Ebu Hanife Numan b. Thabit (v.150/767 në Bagdad), themeluesi i medhhebit.[35]
7. Muhammed b. el-Hasan esh-Shejbani (v. 189/804-5 në Rejj, afër Teheranit të sotëm), kodifikues i medhhebit hanefi.[36]

---

[32] Këtu është lëshuar emri i Ebu Bekrit, kurse në përkthimin e bërë nga Amir Ljubovic dhe Fehim Nametak dhe emri i Uthmanit r.a. Shih: Hasan Kafija Pruščak, Izabrani spisi, hyrja, përkthimi dhe shënimet Amir Ljubovic dhe Fehim Nametak, Sarajevo, Veselin Masleša, 1983, f. 127.

[33] Alkame b. Kajs en-Nehai, fekihu i famshëm, xhaxhai i Esved bin Jezidit dhe daja i Ibrahim en Nehaiut. U lind sa ishte gjallë Pejgamberi a.s. Kuranin dhe diturinë e mori prej Ibni Mes'udit, Aliut, Umerit, Ebu Derdasë dhe Aishes, Allahu qoftë i kënaqur me ta. Shih: Muhamed Ashik Ilahi el Bureni, op. cit., f. 231.

[34] Ibrahim b. Jezid en-Nehai, imam i njohur dhe i devotshëm. Shih: Muhamed Ashik Ilahi el Bureni, op. cit., f. 232.

[35] Ebu Hanife, themeluesi i medhhebit hanefi. Imami i imamëve, pishtari i këtij umeti. Ai qe i pari që e klasifikoi Fikhun, e sistemoi dhe e radhiti atë në kapituj e libra ashtu siç është sot. Shih: Muhamed Ashik Ilahi el Bureni, op. cit., f. 232.

[36] Muhammed b. el-Hasan esh-Shejbani i ka precizuar dhe detajuar edhe më rregullat dhe bazat e vëna nga Imam Ebu Hanifja, duke u përpjekur për shtimin dhe deduktimin-nxjerrjen e dispozitave të reja dytësore, "Kadil kudat-Gjykatës i gjykatësve". Shih: Muhamed Ashik Ilahi el Bureni, op. cit., f. 232.

8. Ebu Hafs el-Kebir Ahmed b. Hafs el-Buhari (216/831).
9. Ebu Hafs es-Sagir Abdullah b. Ahmed (v. 264/877-8 në Buharë).
10. Abdullah b. Muhammed b. Jakub es Sebzemuni (v. 340/952 në Buharë), me origjinë nga Sebzemuna, një fshat në Buharë.
11. Muhamed b. el-Fadl el-Buhari el-Kumazi (v. 381/991-2 në Buharë), me origjinë nga Kumaza, një fshat në Buharë.
12. El-Hussejn b. el-Hidr ibn Muhammed en-Nesefi (v. 424/1032-3), nga Nesefa afër Semerkandit.
13. Abdulaziz b. Ahmed el-Halvani (v. 448/1056-7), nga Kesha në Buharë.
14. Ebu Bekr Muhammed b. Ahmed ibn Ebi Sehl es-Serahsi (v. 490/1096-7 në Fergani), me origjinë nga Serahsa në Horasan.
15. Abdulaziz b. Umer b. Maze, "es Sadru'l-madi" (v.?), i lidhur me Buharanë dhe Ferganin.
16. Husamuddin Umer b. Abdulaziz b. Umer ibn Maze, "es Sadru'sh-Shahid" (v. 536/1141-2) në Semerkand, u varros në Buharë.
17. Ali b. Ebi Bekr b. Abdulxhelil el-Fergani el-Marginani, autor i librit El-Hidaje (v. 642/1244 në Buharë).
18. Muhammed b. Abdusettar b. Muhammed el-Kenderi el-Beraniki (v. 642/1244 në Buharë), me origjinë nga Kerdera në Iranin e sotëm.
19. Ebulfadl Muhammed b. Muhammed b. Nasir el-Buhari (v. 693/1294 në Buharë).
20. El-Husejn b. Ali el-Haxhxhaxh es Signaki (v. 710/1310-11 në Halep), me origjinë nga Signaka, Turkestani, ligjëronte në Bagdad, Damask dhe Halep.
21. Muhammed b. Muhammed b. Ahmed el-Buhari "Kavamuddin el Kaki" (v. 749/1348-9 në Kajro).
22. Ekmeluddin Muhammed b. Muhammed b. Mahmud al-Baberti (v. 786/1384 në Kajro), me origjinë nga Baberti në afërsi të Bagdadit, i lidhur me Halepin dhe Kajron.

23. Shemsuddin el-Fenari (v. 834/1431), nga Fenara në Iran, i lidhur me Kajron dhe Anadollin, mufti-enam i shtetit osman në kohën e Sulltan Muratit I (763/1362-791/1389).
24. Muhjiddin Muhammed b. Ermegan (v. gjatë sundimit të Muratit II, 824/1421 -. 855/1451) në Iznik të Anadollit.
25. Hidr-bej b. Xhelaluddin (v. 863/1458 në Stamboll). Kadiu i parë i Stambollit, i lidhur me Sivrin -dhe Hisarin dhe Bursën.
26. Muhjiddin Muhammed b. Taxhudin Hatib-zade (v. 901/1495-6), në Stamboll dhe Muhjiddin Mustafa el-Kastalani (v. 901/1495-6) i lidhur me Bursën, Edirnen dhe Stambollin. (myftiu i njerëzve dhe xhinëve) (v. 940/1533-4 në Stamboll), një dijetar i madh dhe Shejhu'l-Islam.
28. Kara Jilan Jahja efendiu (v. 983/1575-6 në Stamboll), mësuesi i Hasan Kafi Pruscakut.

Biografia e njëzet e nëntë është e Kafit, kurse biografia e tridhjetë është e nxënësit të tij.

## Analizë

Silsilet e dijetarëve islamë, njashtu sikurse edhe isnadi tek shkenca e hadithit, janë të lidhura në fund të tyre me Pejgamberin a.s. si transmetues dhe interpretues i shpalljes së fundit hyjnore. Muhamedi a.s. është shpjeguesi më autoritar, prandaj çdo dije, për të qenë e besueshme, është dashur të transmetohet më pas në mënyrë të besueshme nga brezi në brez. Kjo metodë e përcjelljes së njohurive quhet menhexhun-nakl (metoda tradicionale).[37]

[37] Shih: Aiša 'Abdurrahman, Mukaddime fi'l-menhedž (el-Kahire: Ma'hedu'l-buhusi ve'd-dirasati'l-arebijje, 1971.), 116 e tutje, sipas: Fikret Karčić, Kako je hanefijski mezheb dosao u Bosni, op. cit.

Pas Pejgamberit a.s. kjo silsile e Kafit përfshin zinxhirin e dijetarëve që tregon vërtetësinë dhe autenticitetin e medhhebit hanefi.[38]

*Në biografinë 2*

Përmenden Hulefa-i rashidinët (kalifët në rrugën e drejtë) dhe as'habi Abdullah b. Mes'ud. Ai, gjatë kalifatit të Umer b. Hatabit, ishte gjykatës në Kufe dhe, gjatë qëndrimit të tij, ai ia përcolli dijen popullatës së atjeshme dhe kontribuoi në formimin shkollës së hershme irakiane në fikh.

*Në biografitë numër 3, 4, dhe 5*

Duke filluar nga kadi Shurejh deri te mësuesi i Ebu Hanifes, Hammad b. Ebi Sulejman, i përkasin rrethit të dijetarëve të cilët në Irak janë formuar rreth Ibn Mes'udit dhe përfaqësojnë një lidhje në zinxhirin e transmetimit të njohurive mes Ebu Hanifes dhe Kalifëve të Drejtë.

*Me biografinë 6*

Të Ebu Hanifes fillon historia e shkollës juridike hanefite. Duke u mbështetur në traditën e shkollës së hershme irakiane, Ebu Hanife zhvillon dhe rafinon metodologjinë e interpretimit të burimeve të Sheriatit dhe nxjerrjen e rregullave juridike. Bazuar në këtë metodologji, e zhvilluar kryesisht në diskutime që Ebu Hanife kishte me nxënësit e tij, formohet e tërë shkolla e mendimit juridik.

Të mësuarit e kësaj shkolle e vazhdojnë nxënësit e Ebu Hanifes, kurse atë sistematikisht e shkruan Muhamed b. Hasan esh-Shejbani (biografia 7) në gjashtë librat bazë (el-asl). Ky dijetar shërben si gjykatës në krahinat lindore të Hilafetit (në Iranin e sotëm), dhe tek ai janë arsimuar nxënësit e shumtë të cilët do të vazhdojnë të zgjerojnë njohu-

[38] Krahaso: Umer Sulejman el-Eshkar, Tarihu'l-fikhi'l-islamijji (Bejrut: Mektebetu'l-felah, 1402/1982), 86-87.

ritë islame, dhe me këtë edhe medhhebin hanefi në pjesë të Azisë Qendrore.

*Biografitë 8 -19*

Biografitë nga nr. 8 (Ebu Hafs el-Kebir Ahmed b. Hafs el-Buhari) deri në biografinë nr. 19 (Ebulfadl Muhammed ibn Muhammed b. Nasir el-Buhariu) i referohen Ulemave në Transoksani, të njohura në epokën klasike myslimane si *Ma wara'-en nehr* (pjesët në anën tjetër të lumit).[39] "Lumi" i përmendur këtu është Oksusi, gjegjësisht Xhejhuni, gjegjësisht Amu Darja. Gjeografët myslimanë e quanin vendin në anën tjetër të Amu Darjas *Ma wara'-ennehr*, kundrejt Horasanit, i cili qëndron para Amu Darjas dhe u quajt *Ma dune en-nehr* (Toka deri te lumi).

Kufijtë e Transoksanisë kanë ndryshuar gjatë historisë, por ky rajon në bazë përfshin pellgjet e lumit Zarafshan - i njohur si Sogdia - pjesët deri te pellgjet e lumit Sir Darja (Sajhun), në veriperëndim deri te Horezmi, në lindje deri te Fergana dhe përmes maleve Tien Shan, në Turkistanin Lindor apo kinez (Sinkjang). Sot këto zona i përkasin republikave të Azisë Qendrore: Uzbekistanit, Kazakistanit, Taxhikistanit dhe Kirgistanit, si dhe Kinës.[40]

Kutejbe b. Muslim el-Bahili, guvernatori i Haxhaxhit i provincës lindore të Hilafetit, e ka çliruar Transoksaninë dhe e hapi qytetin Buhara ndaj fesë islame dhe ka ndërtuar xhaminë e parë në vitin 94/712-13.[41]

Në fillim të periudhës abasite, Transoksiania është integruar plotësisht në kuadër të shtetit mysliman si një krahinë e vetme. Qytetet transoksianike si Semerkandi (qyteti kryesor), Buhara, Belh, Tirmidh, Amul, Farab, Kish, Nesef, Fergana, Uzgend, Hoxhend, Shas etj. do të

[39] Shih: The Encyclopaedia of Islam, new edition (Leiden: E.J. Brill, 1986.), 5:852-859 s.v. "Ma wara'al-nahr", sipas:Fikret Karčić, Kako je hanefijski mezheb dosao u Bosni, op. cit.

[40] Shih: The Encyclopaedia of Islam, 852, sipas: Fikret Karčić, Kako je hanefijski mezheb dosao u Bosni, op. cit.

[41] Prof. dr. Mehmet Maksudoglu, Historia osmane dhe institucionet, Tiranë, Alsar, 2013, f. 62.

bëhen qendra të kulturës islame me emrat e dijetarëve të njohur myslimanë. Rëndësia e Transoksanisë si një qendër e kulturës islame tregohet nga fakti se shumica e autorëve të koleksioneve/ përmbledhjeve më autoritare të hadithit është nga ky rajon apo në afërsi të tij, si dhe themeluesi i shkollës maturidite.[42]

Imam el-Buhari (v. 256/870) është nga një prej qendrave më të famshme të Transoksianisë,

Imam Muslimi (v. 261/874) është nga Nisaburi në Horasan, në kufi me Transoksaninë,

Davud es Sixhistani (v. 275/888) është gjithashtu nga Horasani,

Imam El-Tirmidhi (v. 279/892) është nga Transoksania,

Imam En-Nesai (v. 303/915) është nga Horasani,

Imam Ibn Maxhe (v. 273/886) është nga Kazvini në pjesën qendrore të Iranit.

Imam Ebu Mensur el-Maturidiu (v. 333/944.), themeluesi i shkollës maturidite në akaid, është nga rrethina e Semerkandit, ashtu si dhe një numër i konsiderueshëm i juristëve hanefi që janë përmendur në silsilen e Kafit që janë nga po kjo rrethinë.[43]

Rajonet e Horasanit dhe Transaksonisë në shekullin IX-X ishin prej më të qëndrueshmeve politikisht. Ato ishin nën sundimin e dinastisë samanide, rreth sundimtarëve të së cilës Ibn Hal-likani ka thënë: "Sa i përket sundimtarëve samanidë, ata ishin sundimtarë të Transaksonisë dhe të Horasanit. Ata ishin më të mirët e sulltanëve… ata (sundimtarët samanidë) zakonisht kishin qëndruar besnikë ndaj drejtësisë, fesë dhe dijes." Prandaj në një atmosferë të tillë të stabilitetit politik, të drejtësi-

[42] Shih: Muhammad Zubayr Siddiqi, Hadith Literature: Its Origin, Development and Special Features (London: The Islamic Text Society, 1993.), 53-69, sipas: Fikret Karčić, Kako je hanefijski mezheb dosao u Bosni, op. cit.

[43] Fikret Karčić, Kako je hanefijski mezheb dosao u Bosni, op. cit.

së sociale, prirjeve fetare dhe përpjekjeve shkencore, kushtet e nevojshme për punë të lirë dhe të ndershme intelektuale ishin të arritshme.[44]

Rajoni i Horasanit dhe Transoksanisë ishte një vijë kufitare e botës myslimane në Azinë qendrore, intelektualët e së cilës, duke qenë në një hapësirë të tillë gjeografike, shqetësoheshin për mbrojtjen e doktrinës islame prej sulmeve të jashtme. Ulematë e Transoksanisë, që jetonin në kufi të Hilafetit, e kishin shumë të zhvilluar ndjenjën e misionit (davetit). Në sajë të këtyre misionarëve fiset turke, që jetonin përtej kufijve të shtetit mysliman, pranuan Islamin.[45] Ky rajon ishte prej rajoneve më të avancuara në shkencë.

Pas pranimit të Islamit, fiset turke u bënë shpejt një faktor i rëndësishëm politik. Dinastia turke e Selxhukëve (430/1038 - 552/1157) vendosi pushtetin mbi Transoksaninë, Horasanin dhe shumicën e Iranit dhe Irakut dhe u bë mbrojtës i kalifëve abasidë në Bagdad. Duke i respektuar mësuesit e tyre të parë në fe, selxhukët i dhanë mbështetje të plotë Ehli Sunetit dhe medhhebit hanefi. Edhe ulematë e Transoksanisë i vendosën në pozitën e myftinjve dhe kadilerëve në territoret e tyre. Gjatë shekujve V (XI), VI (XII) dhe VII (XIII), autorët më të njohur të medhhebit hanefi ishin nga Transoksiania.[46]

Rrethanat e reja historike shpjegojnë praninë e një numri të madh të ulemave nga ana tjetër e lumit Amu Darje në silsilen e Hasan Kafiut.

Të tre dijetarët e përmendur në silsilen me nr. 20, 21, 22 janë të lidhur gjeografikisht me Halepin dhe Kajron. Dy prej tyre - Es-Signaki dhe Kavamuddin el-Kaki - janë me origjinë nga Transoksania, por emigruan në Sham dhe Egjipt. Ata ishin pjesë e një vale të migrimit të dijetarëve myslimanë nga Lindja në pjesët perëndimore të Hilafetit, të

[44] Mustafa Cerić, Rrënjët e teologjisë sintetike në Islam, Ebu Mensur el Maturidiu, Shkup, Prishtinë, Tiranë, Logos-A, 2015, f. 45.

[45] Po aty, f. 47.

[46] Shih: Wilfred Madelung, op.cit. 140-141, sipas: Fikret Karčić, Kako je hanefijski mezheb dosao u Bosni, op. cit.

shkaktuar nga pushtimi i mongolëve. Në vitet 615/121 dhe 616/122, përballë vërshimeve mongole, ranë disa nga qytetet e Transoksanisë, si: Balasagun, Buhara, Farabi, Semerkandi dhe të tjerë. Një pjesë e ulemave e lëshoi Transoksaninë dhe lëvizi drejt pjesëve qendrore të Kalifatit dhe më tej, në veriperëndim, ku autoritetin e kishin ejubitët dhe më vonë dinastia e memlukëve.

Migrimi i ulemave në perëndim të Hilafetit u ndal vetëm në shek. VII (XIV), prandaj, dy dijetarë nga silsila e Kafiut janë të lidhur me territoret e memlukëve.

Dijetarët e përmendur nga numri 23 (Shemshudin el-Fenari) deri te mësuesi i Kafiut, Kara Jilan Jahja-efendiu (nr. 28.), i përkasin zonës gjeografike Bilad-i Rum (vendeve bizantine).[47]

Turqit selxhukë e quajtën Anadollin "Bilad-i Rum" ose "Rum" për arsye se, në atë kohë, ishte nën zotërimin e romakëve (Rum) të Lindjes. Në fakt perandoria kishte origjinë latine (romake), por ishte helenizuar nga ana kulturore.[48]

Turqit selxhukë, nën sundimin e sulltan Muhammed Alp Arslan b. Davudit (455/1063 - 465/1072), zhvilluan betejën që do të vendoste të ardhmen e Anadollit, më 1071, në Malazgirt (Manzikert). Gjatë zotërimit të Anadollit nga Devleti i Selxhukëve, si sundimtar i pjesës qendrore u caktua komandanti Sulejman. Në vitin 473/1080, ai e zgjeroi territorin e tij deri në brigjet e detit Marmara dhe Egje, duke e detyruar kështu perandorin romak, Aleks Kommenin, të paguante një taksë vjetore. Territori që ishte nën degën e tij, të Dinastisë së selxhukëve, njihej si "Sulltanat i Rumit" dhe sulltanët quheshin në gjuhën arabe "Cezarët e Romës", si shenjë treguese e zotërimit të tyre në pjesën lindore të Perandorisë "Romake."[49]

---

[47] Shih: The Encyclopaedia of Islam, 8:601-612, s.v. "Rum", "Rumeli", sipas: Fikret Karčić, Kako je hanefijski mezheb dosao u Bosni, op. cit.
[48] Prof. dr. Mehmet Maksudoglu, op. cit., shih fusnotën 11, f. 69.
[49] Po aty, f. 71.

Në perëndim të shtetit të selxhukëve të Anadollit, në vitin 1299, u vendos principata e osmanëve.

Në zonat kufitare (bejlik) të shtetit selxhuk në Anadoll, në vitin 1289, u formua Emirati i Osman Gazit. Sundimtarët e parë dhe korniza administrative e Emirateve (Bejlikeve) Osmane ishin më të përkushtuarit ndaj Islamit. Ata ishin simbol për shpëtimin dhe lumturinë e gjithë njerëzimit dhe qenë përcaktuar për të realizuar bashkimin e Anadollit mysliman.[50]

Kjo principatë, me kohë, është rritur dhe është shndërruar në një shtet që ka sunduar nga Irani në Ballkan, nga Krimeja në Afrikën Veriore, në Egjipt, Siri, Irak dhe Jemen.[51]

Osmanlinjtë ndoqën shembullin e selxhukëve, vazhduan vlerësimin e ulemave hanefi, sidomos ata me origjinë nga Transoksania. Shumë prej këtyre dijetarëve erdhën në territorin osman dhe morën funksione gjyqësore, jurisprudenciale dhe arsimore.

Mes tyre ishte Shemshudin el-Fenari, me origjinë nga një fshat në Iran, i cili e braktisi Egjiptin e memlukëve dhe erdhi në Anadoll që të bëhet i pari myft-ienam, respektivisht më vonë *shejhu'l islam* i shtetit osman.

Meqenëse drejtimi i zgjerimit të shtetit osman ishte drejt Perëndimit, edhe medhhebi hanefi është përhapur në atë drejtim. Prandaj, në silsilen e Kafit ne gjejmë dijetarët që lidhen me qytete si Bursa, Izniku, Edirneja dhe Stambolli. Nga këto qytete, tri prej tyre ishin kryeqytet i shtetit osman. Sigurisht më i rëndësishëm në mesin e tyre ishte Stambolli, i cili që nga çlirimi i tij më 29 maj 1453 deri më 3 mars 1924, do të ishte *Daru'l-hilafe* (selia e Hilafetit) dhe qendër e dijes islame.

Grupi osman i dijetarëve të Kafiut konsiderohet të jetë elita e ulemave të shtetit osman.

[50] Po aty, f. 76.
[51] Hayreddin Karaman, op. cit., f. 267.

Aty është i pari muft-i enam, gjegjësisht shejhu'l islami (Shemsuddin el-Fenari), kadiu i parë i Stambollit (Hidr-beu), ripërtëritësi i dijeve islame në shek. 9/15 (Kemalpasha- zade) dhe ndihmësi i tij, që ishte edhe mësuesi i Kafit, Kara Jilan-efendi.

Me zgjerimet osmane dhe përhapjen e Islamit në Ballkan, referenca gjeografike e termit Rumeli zhvendoset më tej në perëndim, duke u ndalur në Gadishullin Ballkanik. Për myslimanët e Ballkanit, Stambolli me medresetë e tij të famshme, u bë qendër e re kulturore. Në gjysmën e dytë të shekullit 10/16 Stambolli ishte qendra tashmë e njohur e dijeve islame dhe "dijetarët e Rumit i kishin tejkaluar të tjerët në të gjitha shkencat dhe disiplinat."[52]

Myslimanët e rinj filluan të shkonin për të studiuar në qendrën e re shkencore të Islamit. Njëri nga të rinjtë - i takon brezit të tretë të myslimanëve në Bosnjë - HasanKafi nga Prusca, do të bëhej një hallkë në zinxhirin e transmetimit të njohurive islame (biografia nr. 29).

Studentët e Hasan Kafit, Alaudin Ali b. Mustafa b. Husamuddin Shejh-zade (Shehoviç), Muhamed b. Ahmed b. Sejfuddin Aga-zade (Agiç) dhe mulla Muhamed b. Hasan (biografia nr. 30) përfaqësojnë fundin e hapur të kësaj silsileje dhe fillimin e disa silsileve të reja të shkruara dhe të regjistruara në ixhazetnamet dhe në kopertinat e dorëshkrimeve, të cilat janë shkatërruar gjatë luftërave që do të tronditnin Evropën Qendrore dhe Ballkanin në shekujt e ardhshëm.

## PËRFUNDIM

Analiza historike dhe gjeografike e silsiles së Hasan Kafi Prushçakut tregon rrjedhën e mëposhtme të transmetimit të njohurive islame në interpretimin e shkollës juridike hanefite nga Arabia (shekulli 1/6) deri në Ballkan (shekulli 10/16), gjegjësisht: **Hixhaz - Irak - Transoksiani - Kajro - Halep - Anadoll - Stamboll - Ballkan**. Kjo tregon se

[52] Fikret Karčić, Kako je hanefijski mezheb dosao u Bosni, op. cit.

në zinxhirin e bartjes së dijes nuk ka hallka të humbura. Dija është bartur nga mësuesi te nxënësi, gjeneratë pas gjenerate, deri në ditët tona.

Ky përfundim mund të testohet më tej me studimin e biografisë së ulemave të Ballkanit të periudhës së hershme osmane dhe ixhazetnameve të tyre.[53]

Sidoqoftë, dallimet mund të paraqiten në lidhje me transmetimin e dijes nga Anadolli drejt Bosnjës, gjegjësisht Ballkanit, por jo në lidhje me transmetimin e medhhebit hanefi nga qendra dhe djepi i tij deri te turqit osmanë.

## Çështja e pasimit të medhhebit

Shumica dërrmuese e myslimanëve të sotëm ndjekin medhhebin e tyre të veçantë. Dijetarët e një medhhebi janë bazuar mbi metodologjinë e themeluesit të medhhebit të tyre, gjatë interpretimit të burimeve parësore dhe dytësore dhe synimeve të Sheriatit. Cilësitë e themeluesve të medhhebeve ishin në nivelin më të lartë. Asnjë nga katër imamët nuk e ka kundërshtuar Kuranin dhe Sunetin.

## Thirrja për veprim sipas librave të hadithit

Nga mesi i shekullit të gjashtë, në Afrikën Veriore dhe në veçanti në Marok, kishte filluar një lëvizje e re e ixhtihadit, e cila nuk zgjati shumë. Udhëheqësit Muvehidë kishin konstatuar se dijetarët dhe popullsia, sipas tyre, ishin larguar nga burimet e vërteta të fesë dhe kishin imituar librat e medhhebit maliki. Më pas ata e kishin ndaluar popullsinë që t'i lexonte këta libra dhe i kishin djegur të gjithë librat e dispozitave juridike fetare. Në vend të tyre ata futën në përdorim dhjetë librat e hadithit (Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu etj). Ata i analizuan hadithet e këtyre librave, i shkruan sipas temave dhe kërkuan që

[53] Fikret Karčić, Kako je hanefijski mezheb dosao u Bosni, op. cit.

dijetarët dhe popullsia t'i mësonte ato dhe të vepronte sipas tyre. Personave që i mësonin dhe praktikonin ato mësime u jepnin shpërblime të ndryshme. Autorët kanë polemizuar rreth kësaj lëvizjeje, nëse ajo ishte një lëvizje e ixhtihadit të lirë, apo ishte një lëvizje e dhunshme, për të siguruar sundimin e medhhebit dhahiri.

Kjo lëvizje është mbështetur në dhunë. Brenda lëvizjes ka pasur një ngrirje dhahirite nën petkun e ixhtihadit të lirë. Mbështetësit e lëvizjes muvehidë janë shkatërruar, ndërsa pushtetet e reja të këtij rajoni nuk e kanë mbështetur lëvizjen dhe e kanë çrrënjosur atë.[54]

## Rishikimi i medhhebeve

Disa individë, grupe dhe lëvizje në mesin e myslimanëve kanë kërkuar "kthimin në Kuran dhe Sunet" pa ndonjë ndërmjetësim dhe duke mos pasur parasysh mendimin e dijetarëve islamë.

Përpjekja për të rishikuar interpretimet medhhebore, pa kurrfarë kriteresh në dritën e kushteve moderne, lidhet me shkatërrimin e gjurmës së fundit të vazhdimësisë dhe qëndrueshmërisë, që një mysliman në mënyrë instiktive e shoqëron - dhe në mënyrë të drejtë - e bashkëshoqëron me të kuptuarit e *nususeve*. Prandaj, çdo vend duhet t'i përdorë mësimet e fikhut që i përkrah shumica e popullsisë së tij. Kështu në një vend të banuar kryesisht nga hanefitë, fikhu hanefi duhet të respektohet dhe zbatohet.

Nëse një rishikim është i domosdoshëm tani, ai do të bëhet përsëri i domosdoshëm për dekada më vonë, kur "kushtet moderne" do të kenë ndryshuar përsëri: dhe kështu me radhë e me radhë, derisa Ligji i Islamit do të revizionohet plotësisht. Nëse vazhdimisht do t'i ndryshonim të gjitha interpretimet deduktive fikhore, të bëra nga ulematë dhe kolosët e këtij umeti duke u thirrur në interpretimet origjinale, do të kishim rezultat të kundërt.

[54] Hayreddin Karaman, op. cit., f. 269.

## - Summary -

When talking about medh'heb, we talk about knowledge and systematized science, wholesome and consistent interpretation of law by great lawyers who have left indelible traces in the Islam law, and that have gone beyond practical verification.

Their service was amazing. Medh'heb does not mean fatwa or opinions of a single person, who may have received no hadeeth. We talk about a science which is structured and shaped by thousands of wise people, sahabs, tabi'i and tabi-tabi'i.

In this paper, we explore the reasons why the Ottomans pursued the Hanafi Medh'heb, and what were the ways of arrival of such way in Balkan and our lands, based on the historical and geographical interpretation made by Fikret Karciq to the writing "Nidhamu'l ulema ila hatemi'l-enbija" ("Several wise people up to the last Prophet), written in Arabic by Hasan Kafi Pruscak (1544-1615).

Prof. dr. Hysen MATOSHI

# RRËFIMET KURANORE NË LETRAT SHQIPE

**Abstrakt**

Edhe pse Kurani i Madhërishëm ka qenë një burim i rëndësishëm i formimit kulturor ndër shqiptarët, ky fakt nuk është pohuar në masën e duhur në shkrimet tona studimore. Kjo gjendje konstatohet edhe në studimet tona letrare të derisotme. Ky studim mëton të kthejë vëmendjen te roli që pati Kurani Famëlartë, si vepër frymëzuese, në letërsinë shqipe. Duke qenë e pamundur të përfshihet e gjithë gama e autorëve, të cilët e kanë bërë Kuranin burim të veprës së tyre letrare, ne jemi fokusuar vetëm te dy vepra narrative me subjekt kuranor. Fjala është për poemat e Muhamet Kyqykut - Çamit dhe Hafiz Ali Korçës, që marrin për bazë ngjarjet e sures Jusuf. Këto dy poema, pothuajse të anashkaluara nga mendimi ynë historiko-letrar, janë ndër veprat më të mira të letërsisë shqipe me frymë fetare. Mjetet e tyre shprehëse janë të përzgjedhura me kujdes, ndërsa autorët e tyre kanë ofruar vepra letrare të realizuara me një nivel të lartë artistik, duke i mbetur prore besnikë versionit burimor. Përveç vlerave artistike, këto poema kanë një rëndësi të veçantë historiko-letrare kundruar në proceset e zhvillimit të përgjithshëm të letërsisë shqipe. Fundja këto vepra dhe shumë të tjera dëshmojnë se në letërsinë shqipe ekziston edhe krahu i letërsisë kuranore.

**Fjalët çelës:** Kurani, letërsia shqipe, alamiado, poema, Jusufi a.s., Muhamet Kyqyku - Çami, Hafiz Ali Korça.

Paragjykimet për pjesën e letërsisë shqipe, të shkruar në frymën islame dhe të bazuar në modelet letrare orientale, për një kohë të gjatë, kanë prodhuar një pamje ta paplotë lidhur me vlerat tona letrare. Ato ose janë anashkaluar plotësisht, ose janë zënë ngoje kalimthi pa një thellim të mirëfilltë dhe pa identifikuar në to vlera me peshë kombëtare për kulturën shqiptare. Paragjykimi fillestar nis me emërtimin e kësaj rryme të fuqishme të letërsisë shqipe, e cila gjithandej është identifikuar si letërsi e bejtexhinjve[1]. Marrë parasysh domethënien përçmuese, në planin e vlerës letrare, të nocioneve bejte[2] dhe bejtexhi[3], del i qartë qëndrimi zhvlerësues lidhur me këta autorë të letërsisë shqipe që në nismë. Terminologjia e këtillë, përveçse përçmuese në rrafshin vlerësimit letrar, është gjithashtu shpërfillje e terminologjisë shkencore të fushës së shkencës së letërsisë. Përdorimi i termave bejte dhe bejtexhi, me domethënien e standardizuar në Fjalorin e gjuhës shqipe, përjashton mundësinë që të identifikohen vlera të artit letrar te ky qark i rëndësishëm kulturor e dituror përgjithësisht i letërsisë shqipe veçanërisht, duke e paragjykuar rëndë atë. Rrjedhimisht kjo rrymë e rëndësishme e letërsisë shqipe është konceptualizuar, në masë të madhe edhe nga vetë emërtimi i saj nëpërmjet termave, përkatësisht togfjalëshave

[1] Shih Çabej, Shuteriqi, Qosja, Hamiti, Elsi etj.

[2] Fjalori i gjuhës së sotme shqipe e shpjegon kështu fjalën bejte: Vjershë, zakonisht e dy strofa prej dy vargjesh, karakteristike për poezinë e vendeve të Lindjes, që u përhap në Shqipëri në shekujt XVII-XVIII; vjershë lirike a satirike, që thuret nga një poet popullor zakonisht aty për aty; shak. (në kuptimin e fjalës a shprehjes që përdoret me shaka, vër. H. Matoshi) vjershë humoristike, që dy veta ia ngrenë njëri-tjetrit aty për aty. *Bejte me shkop* bejte që dy vetë krijojnë aty për aty për njëri-tjetrin, bejte hidh e prit. *Bën (nxjerr) bejte. I ngjiti bejte*. Në kuptimin e dytë është përfshirë dimensioni keqësues i kësaj fjale që shpjegohet kështu: Vargje pa vlerë, vjershë e keqe. *Shkruan bejte.* FGJSSH, botoi Akademia e Shkencave e RSP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980, f. 122.

[3] Shpjegim të ngjashëm gjejmë edhe për emrin bejtexhi-u, i cili në kuptimin e parë shpjegohet këtë mënyrë: Ai që bën bejte, bejtar; vjershëtar popullor, që thur vargje lirike ose satirike, zakonisht aty për aty. *Bejtexhiu i fshatit. Letërsia e bejtexhinjve*. Në kuptimin e dytë, përkatësisht keqësues, kjo fjalë shpjegohet kështu: Ai që shkruan vargje pa vlerë artistike, vjershëtar i keq. FGJSSH, po aty.

terminologjikë, si: bejte, bejtexhi, letërsia e bejtexhinjve, qarku letrar i bejtexhinjve etj., si një letërsi pa vlera të njëmendta letrare. Në këtë rast nuk kërkohet më shumë se sa të zbatohet terminologjia shkencore për këto lloje shkrimesh, përkatësisht termi gjithandej i pranueshëm edhe në kulturat e tjera botërore alamiado, që në spanjisht ka domethënien "joarab". Pra tekst i shkruar në gjuhë të tjera, por me alfabetin arab.[4]

Në fakt, sikundër dihet, alamiadistët shqiptarë e begatuan me prurje të reja letërsinë shqipe dhe përgjithësisht kontribuuan që gjuha shqipe të bëhej gjuhë e shkruar në një varg disiplinash diturore, të cilat qartazi deri atëherë i mungonin traditës sonë shkrimore. Vetëdija për vlerat evidente të veprave të alamiadistëve shqiptarë tashmë ka filluar të lëshojë rrënjë, ndonëse ende nuk mund të flitet për një qëndrim të drejtë e parimor në raport me to. Mirëpo alamiadoja është vetëm një shtresë, e identifikueshme në aspektin grafik si fakt historiko-kulturor, e një tërësie më të madhe të asaj që mund të quhet si kulturë shqiptare me përbërës islamë. Pranimi masiv i Islamit nga shqiptarët e bëri librin e shenjtë Kuranin, fjalën e Allahut Fuqiplotë, një burim të fuqishëm motivues në fushën e shkrimeve letrare. Marrë parasysh këtë fakt, mund të thuhet se më parë sesa për ndikimin e Kuranit në letërsinë shqipe, bëhet fjalë për rolin e tij frymëzues e motivues në raport me autorët shqiptarë të proveniencës islame. Nëse ndikimin do ta konceptonim si diçka që vepron nga jashtë, është krejtësisht e qartë se Libri i Shenjtë i myslimanëve në jetën e besimtarëve islamë nuk mund ta kishte një funksion të këtillë. Përkundrazi, Kurani është pjesë e pandashme e perceptimit të jetës shoqërore e kulturore islame dhe, si i tillë, shfaqet në funksion të motivuesit të autorëve të fushave të ndryshme. Në kulturën shqiptare dhe veçmas në letërsinë shqipe, si pjesë e rëndësishme e saj,

[4] Shih: Rečnik književnih termina, Institut za Književnost i Umetnost u Beogradu, "Nolit", Beograd, 1986, f. 16.

Kurani i madhërishëm zë një vend të rëndësishëm, ndonëse ky fakt ende nuk pohohet sa duhet, ose pohohet me gjysmë zëri. Kjo shpërfillje e një pjese të traditës sonë letrare nuk mund të arsyetohet me ekskomunikimin total që iu bë letërsisë shqipe me përmbajtje fetare për gati gjysmë shekulli, ngase ajo në raport me Kuranin dhe përgjithësisht me shtresimin islam vijon, në një masë të konsiderueshme, edhe sot. Ndonëse historianët e letërsisë flasin gjithandej për letërsinë shqipe filobiblike, për letërsinë biblike, ne ende nuk e kemi të trajtuar rëndësinë kulturore të Kuranit në të njëjtin nivel, paçka se përbërësit kuranorë janë aq shumë të pranishëm në kulturën tonë, duke filluar që nga letërsia popullore, frazeologjia shqipe, letërsia autoriale etj.

Duke marrë parasysh dimensionin shumështresor të çështjes dhe formatin e kufizuar të këtij punimi studimor në aspektin vëllimor, do të përqendrohem vetëm në një aspekt trajtimi të raportit që ndërtojnë dy autorë të letërsisë shqipe me përmbajtjen e Kuranit, përkatësisht me suren Jusuf, që është njohur ndryshe edhe si ngjarja më e bukur e Kuranit. Këta dy autorë e kanë marrë lëndën për veprën e tyre në një burim të pashtershëm, në një burim që nuk pakësohet asnjëherë, ndonëse i kanë shtuar vlera letërsisë e kulturës sonë përgjithësisht.

Autori i parë i një vepre narrative në letërsinë shqipe, Muhamet Kyqyku - Çami, është njëkohshëm edhe autori i parë, me sa dimë deri sot, që u frymëzuar nga kjo sure e Kuranit për të shkruar veprën "Jusufi e Zulejhaja" që ka 2432 vargje.[5] Ndonëse albanologu kanadez, Robert Elsi, ka merita të veçanta ngaqë e ka përfshirë në historinë e tij të letërsisë shqiptare këtë autor, duke i kushtuar vëmendje edhe veprës në fjalë dhe duke e vlerësuar si veprën më të mirë të Çamit, duhet thënë se përpjekja e tij për ta nxjerrë si bazë motivuese të saj Biblën, paralelisht

[5] Shih Muhamet Çami, Jusufi dhe Zulejhaja, recensues i botimit Ibrahim D. Hoxha, botoi "Vatra", Shkup, 2002. Në këtë botim dhe në botimin paraprak të vitit 1996 del se poema ka 2432, përkatësisht dy vargje më shumë se sa thuhet në "Historinë e letërsisë shqiptare" të Robert Elsit.

me suren e 12 të Kuranit, nuk qëndron, sikundër nuk qëndron as formulimi i tij "Jusufi biblik, në disa pikëpamje, është kolegu mashkullor i Ervehesë".[6] Josifi dhe Jozefi janë biblikë, por Jusufi, pavarësisht se në cilin variant artistik shfaqet, është gjithsesi protagonist kuranor.

Gjithë poema ka një strukturë unike të pandarë në njësi më të vogla rrëfimtare, pikërisht ashtu sikundër e gjejmë si model tek "Erveheja". Vërehet një shpërputhje në pikëpamje të paraqitjes së dy protagonistëve të saj, kuptohet me një mbizotërim të qartë të Jusufit, ndërsa Zulejhaja është më shumë në funksion të nxjerrjes në pah të vlerave morale islame të Pejgamberit, të cilin e vë në sprova të vazhdueshme. Edhe vetë mbrojtja e Jusufit para akuzës së mbretit Aziz bëhet mbi këtë bazë detyruese morale:

*"Jusufi nisi e qan:*
*"Eja e kujto Perëndinë,*
*mos më vurë këtë buhtan,*
*se ne s'bënemi hainë!*

*Këjo vetë më kërkoi,*
*pra u nuk i dhaçë riza,*
*çish thotë "Më turpëroi",*
*ga inati flet iftira!*

*U kam borç me sheriat,*
*ti dhe gruasë sate*
*t'u bi hizmet me hakikat,*
*këjo mb'atë fjalë vate.*[7]

Përgjithësisht, kjo poemë vijon të mbetet një vepër ende e patrajtuar sa duhet dhe rrjedhimisht edhe e pavlerësuar si pjesë e rëndësish-

[6] Robert Elsie, Histori e letërsisë shqiptare, përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu, "Dukagjini", Tiranë-Pejë, 1997, f. 80.

[7] Muhamet Çami, Jusufi dhe Zulejhaja, recensues i botimit Ibrahim D. Hoxha, botoi "Vatra", Shkup, 2002, f. 41.

me e procesit letrar shqiptar, si një vepër që vjen në fillet e letërsisë sonë rrëfimtare. Janë premtuese disa qasje të një numri të studiuesve tanë, të cilët vitet e fundit kanë bërë përpjekje që ta kthejnë vëmendjen tek autorët e alamiados shqiptare dhe këtu kam parasysh kontributet e Qazim Qazimit, Nehat Krasniqit, Mahmud Hysës, Abdullah Hamitit etj.

Autori tjetër që frymëzohet nga Kurani për ta trajtuar në vepër letrare besnikërinë shembullore të Pejgamberit Jusufi a.s. është islamologu, poeti, publicisti, gjuhëtari, përkthyesi, me një fjalë dijetari i rrallë i kohës, Hafiz Ali Korça, i cili ka shkruar një poemë me titullin *Jusufi me Zelihanë a më e bukura e ngjarjeve Ahsen-ul-Kasas*. Kjo kumtesë nuk mëton të ofrojë një shqyrtim krahasues lidhur me atë se sa teksti letrar i autorit tonë i qëndron besnik tekstit kuranor, qoftë edhe për faktin se tashmë kjo materie në mënyrë shumë shteruese është trajtuar profesor Ismail Ahmedi[8], qoftë për faktin se intenca jonë është që të trajtojmë përbërësit e saj letrarë.

Ideja orientuese e veprës është përcaktuar nga ideja orientuese e veprës burimore, në këtë rast e sures Jusuf nga Kurani famëlartë, dhe ajo konsiston në devotshmërinë e protagonistit si besimtar ndaj Krijuesit dhe në besnikërinë e tij ndaj bashkëkohësve. Janë këto dy vlera të rrënjosura në besimin e patundur të Pejgamberit Jusuf në Allahun e Madhërueshëm, i cili e kishte dërguar në mesin e beni israilëve si një model të udhëzimit të besimtarëve.

Në parathënie Hafiz Ali Korça pohon se librin e kishte shkruar që në rini, ndërsa do ta botonte gati tri dekada më vonë, më 1923. Vepra në planin zhanror është një poemë e shkruar në tetërrokësh me një strukturë tipike për vepra narrative të ndara në njësi më të vogla tregimtare. Titulli i këtyre njësive është një argument, ku përshkruhet përmbajtja e secilës, ndonjëherë deri në tepri informacioni. Për të qar-

[8] Ismail Ahmedi, Hafiz Ali Korça - jeta dhe vepra, botoi Logos A, 2006, f. 376.

tësuar po sjell dy-tre shembuj. Pjesa që flet për shërimin dhe kthimin e Zelihasë në gjendjen e hershme është titulluar kështu: "Arthj' e Zelihasë në shtëpi të veçantë të Jusufit dhe me lutjen e tij që j'u hapnë sytë edhe u shrua u zbukurua më tepër se ish"[9]; ose qëndrimi i Jusufit në burg dhe marrëdhënia e tij me të tjerët aty është titulluar kështu: "Të mirat e Jusufit që u bënte të mbyllurëvet në burk, e tregim i ti ëndrat t'atyre q'ishin pranë mbret edhe porosija që ta kujtojnë ne mbreti kur të dalin ngaj burgu"[10] etj.

Ndonëse kanë të njëjtën bazë motivuese, vepra e Hafiz Ali Korçës, për dallim nga ajo e Çamit, del më lirike, duke pasur një fokus më të theksuar tek raportet ndërmjet dy kryeheronjve të poemës. Lënda kuranore në këtë vepër është letrarizuar më ndjeshëm nëpërmjet përshkrimeve të detajuara të veprimeve dhe përqendrimit të autorit në gjendjen shpirtërore të protagonistëve. Ndonëse është tipizuar si njeriu më i bukur në planin estetik dhe më i ndershëm në planin etik, figura e Jusufit spikat më shumë nëpërmjet përshkrimit të përjetimeve shpirtërore të Zelihasë, pra nëpërmjet dashurisë, shpresave, ëndrrave, hidhërimit, mashtrimit e pendimit të saj. Ajo është sprovë për Jusufin që shpërfaqet në trajta të ndryshme nëpërmjet lajkave, lutjeve e kërcënimeve, mbi të cilat karakteri i fuqishëm i Pejgamberit Jusuf triumfon, gjithnjë duke u mbështetur në Krijuesin e vetëm. Me mjeshtërinë e rrallë ligjërimit letrar, Hafiz Ali Korça e përshkruan shpresën dhe mbështetjen e vetme të Jusufit, edhe atëherë kur askush nuk i dilte krah, kur mbreti Aziz vendosi ta burgoste, bazuar në grackën hakmarrëse të Zelihasë:

*"O ti që di ç'do të pshehur*
*E grackën kush e ka ngrehur!*
*Perveç teje s'ka të tjerë*
*Të drejtën sheshit ta nxjerë.*

[9] Hafiz Ali Korça, Vepra 3, Jusufi me Zelihanë, a më e bukura ngjarje e Ahsen-ul-Kasas, botoi Logos A, 2006, f. 95.
[10] Hafiz Ali Korça, Vepra 3, f. 83.

*Gjithë këto mi kokë m'ardhë*
*As më qit zot faqe-bardhë!"*[11]

E gjithë vepra karakterizohet nga një ligjërim poetik nëpërmjet të cilit përçohen ndjenja të larta të besimit, të besnikërisë e të krenarisë së Jusufit, që i bën ballë sprovës së tundimit për të lakmuar të drejtën e tjetrit. Është veçmas interesant dialogu ndërmjet plakës shoqëruese të Zelihasë dhe Jusufit, e cila porosinë e zonjës së saj për një lidhje dashurie, ia shfaq nëpërmjet këtyre fjalëve:

*"Tek t'i japç një pikës ujë*
*O bir! Nuk bënet rëmujë."* [12]

Nuk është veçanta e këtij distiku vetëm ligjërimi alegorik, që e thotë të vërtetën nëpërmjet nënkuptimit dhe pa e banalizuar atë, por është aftësia e rrallë e autorit që, në kaq pak tekst, përmbledh edhe domethënie të tjera, sikundër është ajo që përjashton pasojat nëse heroi i kësaj poeme do të pranonte dashurinë e Zelihasë. Shumë ngushtë për fjalët dhe shumë gjerë për mendimet, do të thoshim. Është tejet interesante përgjigjja që autori Hafiz Ali Korça e koncepton si kundërshtim të rreptë të Pejgamberit Jusuf. Në fakt përgjigjja mohuese nuk është element risimtarie i autorit, ngase ai buron nga teksti i Kuranit Famëlartë, por veçantia e tij ndërlidhet me mjetet shprehëse, me gjetjet mjaft origjinale:

*"Është liksht shumë për mua*
*T'ime zonjë t'a mar grua.*
*Aziz' e kam si tim-etë*
*Se më njeh si birn e vetë.*
*Këtë gjë të pa pëlqyer*

[11] Hafiz Ali Korça, Vepra 3, f. 67.
[12] Hafiz Ali Korça, Vepra 3, f. 43

*Kur si zok më ka ushqyer.*
*Qysh t'ja bëj t'im-zoti unë!*
*Kopili bën kësi punë.*
*Njeriu qen nukë pjell kurë,*
*S'jep gruri elp, elbi grurë.*
*Gjyshi, stërgjyshi, e im-atë*
*Nuk' e bënë kësi datë."*[13]

Vërtet do të duhej të kërkohej nëpër shumë për modele të ligjërimit poetik që të mund të gjendej diçka e këtillë, vargje që ngërthejnë dimensione interesante bashkëdyzuese të figurave të mendimit me ato gjuhësore. Po sjell këtu edhe një antitezë që, për mendimin tim, është ndër më të mirat e më origjinalet e letërsisë sonë përgjithësisht. Zelihaja, e penduar dhe e dëshpëruar me veprimet e saj, e shpërfaq absurditetin e gjendjes në të cilën ka rënë krahasuar me atë që e gëzonte dikur:

*"Rrop e kisha unë mbrenë*
*Mbeç e varfër po fshij dhenë."*[14]

Zotësinë e tij letrare Hafiz Ali Korça nuk e ka dëshmuar vetëm në këtë vepër, ngase ai ka shkruar dhe botuar mija faqe shkrimesh, madje të fushave të ndryshme, por në të cilat gjithashtu spikatin talenti dhe formimi i jashtëzakonshëm si autor i letërsisë. Mjafton të kujtojmë këtu historinë e shenjtë të katër kalifëve, me rreth 700 faqe të shkruara në vargje, me të cilën ia del që historinë ta fusë brenda kornizave të ligjërimit poetik dhe që nga Kryesia e Komunitetit të atëhershëm Mysliman të Shqipërisë ishte vlerësuar si Chef d'Oeurvres - vepër kapitale dhe kryevepër e tij; ai është autor i tri varianteve të mevludit në gjuhën shqipe, një trashëgimi kjo e jona fetare, letrare e kulturore përgjithësisht; ai është autor veprave letrare me përmbajtje të qartë atdhetare,

[13] Hafiz Ali Korça, po aty.
[14] Hafiz Ali Korça, Vepra 3, f. 94.

sikundër janë poemat antologjike “Shtatë ëndrrat e Shqipërisë” dhe “Vajtimet e Atdheut”; është përkthyes i veprave të përbotshme letrare dhe një nga mjeshtrit e publicistikës shqiptare të kohës, gjuhëtar, dijetar, intelektual i rrallë. Kultura jonë nuk ka pasur për gjysmë shekulli islamolog më të shquar, ishte edhe përkthyes e komentues i Kuranit, dijetar, i cili, bashkë me Hafiz Ibrahim Dalliun, e parashikoi plot njëzet vjet më herët gjëmën më të tmerrshme që po i afrohej botës shqiptare, shkatërrimin e madh material e shpirtëror që solli komunizmi.

Megjithatë, poemën me motive kuranore, të cilën e trajtuam në këtë kumtim, autori e çmonte si një punë, si një vlerë personale, me të cilën do të mund të dilte para të tjerëve. Njëqindenjëzet vjet pas shkrimit të saj dhe në 30-vjetorin e përkthimit të plotë të Kuranit në shqip është koha që ta kthejmë vëmendjen te margaritarë të këtillë letrarë e kulturorë, ndonjëherë pothuajse të harruar, shkëlqimi i të cilëve, në rend të parë, i dedikohet burimit, shtysës fillestare motivuese, librit tonë të shenjtë, fjalës së Allahut Fuqiplotë, Kuranit Kerim.

## SUMMARY

Despite that the Magnificent Quran was an significant source of cultural development among Albanians, this fact has not been emphasized sufficiently in our studies. This is revealed by our literary studies to date. This study endeavours to focus the attention on the role the Noble Quran had as an inspiring work in the Albanian literature. Being unable to include the whole gamut of authors who made the Quran the source of their literary work, in fact we have focused only on two narrative works with Quranic topic. Reference is made to the poems of Muhamet Kyqyk – Çami and Hafiz Ali Korça, that are based on the events from Yusuf Surah. Those two poems, almost overlooked by our historical and literary criticism – are among the best works of Albanian literature in a religious spirit. Their expressive means have been selected painstakingly, while their authors have provided accomplished literary works and of supreme artistic level, remaining faithful to the original version. In addition to artistic values, these poems have a special historical-literary relevance – viewed from the overall development processes of Albanian literature. Overall, these and many other works prove that in Albanian literature there is a Quranic section of literature.

Mr. Qemajl MORINA

# ARABISHTJA NË DRITËN E GJUHËVE SEMITE

Tekstet e poezisë arabe të kohës së injorancës, për disa shekuj, mbeten tekstet më të vjetra arabe. Mirëpo, hulumtimet bashkëkohore të shekullit nëntëmbëdhjetë sqaruan, pas zbulimit të gjuhës akadishte si dhe hulumtimeve që u bënë ndaj gjuhëve semite me metoda komparative, siç është karakteristika e strukturës gjuhësore të arabishtes dhe dialekteve të saj të vjetra, mund të merren si datë në dritën e shkencës së filologjike semite komparative[1]. Kështu, pra, u bë e mundur që nëpërmes studimeve komparative të njihet historia e shumicës së fenomeneve arabe që nga koha para periudhës së poezisë së injorancës, për më shumë se dy mijë vite. Kështu shohim se fenomenet e përbashkëta në arabishte dhe në akadishte nuk mund të jenë përveçse të trashëguara nga gjuha semite e parë, prej së cilës kanë rrjedhë të gjitha gjuhët semite. Për këtë fillon hulumtimi në historinë e gjuhës arabe, duke i shpjeguar marrëdhëniet e arabishtes me gjuhët tjera semite, si dhe me gjuhën e parë semite. Në përpjekje për të zbuluar historikun e aspekteve fonetike, morfologjike, sintaksore dhe semantike të gjuhës arabe para shkrimit të saj.

---

[1] حول المنهج المقارن و نتائجه في اللغات السامية و مكانة العربية بين اللغات السامية:
Brockelmann, Grundriss.
Moscati, Introduction to the comparative Grammar of semitic Languages.
وبرجشتراسر: التطور النحوي للغة العربية. القاهرة ١٩٢٩

## 1. Shkrimet semite dhe realiteti fonetik

Hulumtimi krahasues në gjuhët semite shpjegon një numër të të vërtetave të rëndësishme lidhur me historikun e arabishtes në aspekte të fonetikës, morfologjisë, sintaksës dhe semantikës. Nëse gjuha arabe është gjuha më e re semite, të cilën e shkruan bijtë e saj, atëherë mund të thuhet se gjuhët e tjera semite janë shkruar para gjuhës arabe për shekuj të tërë. Për shembull, akadishtja është shkruar në vitin 2500, para epokës së re, kurse egjretishtja, e cila është shkruar përafërsisht në vitin 1400 (p.e.r.). Krahasimet në mes gjuhëve të ndryshme semite[2], shpjegojnë përse arabishtja ruajti një mori karakteristikash të thella në lashtësi, të cilat i kthen tek gjuha semite e parë. Andaj, karakteristikat e përbashkëta në të gjitha gjuhët semite, apo tek shumica e tyre, janë ato për të cilat supozojnë hulumtuesit se janë të trashëguara nga gjuha e parë semite, nga e cila edhe dolën të gjitha gjuhët semite.

Gjuhët semite shkruhen me disa lloje shkrimesh, ku secili shkrim ka karakteristikat e tij morfologjike si dhe potencialet e tij shprehëse. Kështu shohim shkrimin Mismarit, me të cilin është shkruar gjuha akadishte, pa fjalë, e ndarë në rrokje dhe me këtë e ruajti shkrimin akadik, me gjithë vështirësitë e mëdha në shkrimin e zanoreve së bashku me bashkëtingëlloret. Në këtë aspekt, shkrimi akadik zbulon për natyrën e zanoreve, qofshin ato në mes të fjalës apo në fund të saj.

Po ashtu ekzistojnë gjuhë të vjetra semite, shkrimi i të cilave nuk na e ka dhënë mundësinë e njohjes me zanoret, të cilat i kanë takuar asaj. Për shembull, gjuha arabishte e vjetër e jugut, gjuha egjritishte, gjuha fenikase, të gjitha këto ishin shkruar me një shkrim të veçantë në aspektin formal. Aty vërejmë se shkrimi i arabishtes së jugut nuk i përngjan shkrimit të egjritishtes si dhe shkrimit fenikas, por këto shkrime marrin pjesë në një tipar të përbashkët themelor e ai është: se ato i

[2] انظر القائمة التي أعدها برجشتراسر بالألفاظ المشتركة في اللغات السامية:
G. Bergstrüsser, Einfügrung s. 182-192.

kodifikojnë bashkëtingëlloret, por ato nuk i kodifikojnë zanoret. Në këtë mënyrë, pra, nuk mund ta njohim natyrën e zanoreve në këto gjuhë, përveç nëse i krahasojmë ato me gjuhët tjera që janë afër secilës prej tyre.

Gjuhë të gjalla semite janë: arabishtja, aramishtja, hebraishtja dhe gjuhët semite në Abisini. Ne jemi të barabartë për t'u njohur me mënyrën e shqiptimit të trashëguar te bijtë e saj për mënyrën e shqiptimit të vjetër të këtyre gjuhëve.

Përshkrimi i Halilit dhe i Sibevejhit rreth shqiptimit të zërave të arabishtes në shekullin e dytë të hixhretit tregon se shqiptimi i tashëm i trashëguar i arabishtes letrare nuk dallon, përveç në disa aspekte të kufizuara nga shqiptimit i atëhershëm. Kurse sa i përket shqiptimit të trashëguar të gjuhës hebraike te çifutët e lindjes dhe aramishtja, tek ata të cilët e njohin sirianishten e vjetër nga të krishterët e Irakut dhe të Shamit, si dhe te folësit e gjuhës El Xheaz, tek njohësit e saj nga bijtë e Abisinisë të gjitha këto duhet të merren me rezerva të mëdha.. Ndryshime në shqiptimin e këtyre gjuhëve kanë ndodhur për shumë faktorë. Sa për ilustrim po përmendim gjuhën hebraike, që përdoret tek ata në një përdorim të kufizuar në ceremonitë fetare, ndërkohë që përdorimi i saj në kuadër të sionizmit është evident, ndikimi i të cilit është vendimtar në shqiptimin e evropianëve të gjuhës hebraike. Pakicat aramite flasin me dialekte, ku secili prej tyre ka dallime shumë të mëdha nga dialektet e vjetra. Nuk ka kurrfarë përdorimi për gjuhën el-xhaz në Abisini për shekuj të tërë. Ajo është gjuhë e liturgjive fetare, të cilën e lexojnë te bijtë e emherishtes duke qenë të ndikuar nga ajo dhe bijtë e gjuhës tixhri të ndikuar me të, po ashtu edhe bijtë e gjuhës tixhrina. Mirëpo ne me të gjitha këto njohuri në formë të përafërt, mund t'i shqiptojmë zërat e vjetër të gjuhës hebraike, aramishtes dhe të gjuhës el-xheaz, sepse në shkrimet me të cilat janë shkruar ato gjuhë marrin pjesë zanoret dhe bashkëtingëlloret.

Me krahasimin e fjalëve elementare të përbashkëta në të gjitha gjuhët semite[3] hulumtuesi mund të dëshmojë për një grup karakteristikash të përbashkëta të lashta.

Të gjitha gjuhët semite nuk dallojnë në aspektin e zërave, siç janë zërat (RRA-un), (LA-mun), (NU-nun), (TA-un) dhe (DA-lun). (RRA-ja e arabishtes i paraprin (RA-ja) në akadishte, kurse (RA-ja) në hebraishte, (RA-ja) në aramishte dhe (RA-ja) në abisinishte, pa më të voglin ndryshim që vlen të përmendet.. Sa i përket dallimit të shqiptimit të imazheve të ndryshme të zërave ndryshe, siç është (RRA-ja) e trashë nganjëherë paraqitet e kundërta e saj, por kjo çështje del nga kuadri i hulumtimit tonë. E ngjashme me këtë është çështja e (LA-mit), të cilin e gjejmë tek të gjitha gjuhët semite (LA-men). Kjo vlen edhe për (NU-NU-n), (DA-LU-n), (EL-BA-u) dhe (EL-MI-mu).

Mirëpo, një grup i zërave të përbashkët dhe stabilë në gjuhët semite u është ekspozuar ndryshimeve të kufizuara në sistemin fonetik të gjuhës hebraike dhe të aramishtes. (El-BA-ja) shqiptohet sikurse (EL-BA-ja) e arabishtes, nëse ajo gjendet në fillim të fjalës, por ajo mund të shqiptohet si shkronja "V" e huaj, në gjuhën anglishte, nëse ajo është me teshdid (e dyfishuar) apo dhe nëse paraprin ndonjë zanore. Shqiptohet (EL-KA-fi) ashtu siç shqiptohet (EL-KA-fi) i arabishtes, nëse ajo është në fillim të fjalës. Po ashtu shqiptohet (KHA-en), nëse nuk është e dyfishuar dhe paraprihet me zanore dhe shqiptohet (TA-ja) (TA-en), po ashtu siç shqiptohet pas çdo zanoreje (THA-en) etj.

Vërehet se të gjitha këto ndryshime, që shprehin imixhet e zërave në kuadër të një njësie të njëjtë. Nëse i shikojmë të gjitha këto ndryshime, në të cilat marrin pjesë gjuha hebraike dhe aramishtja, do të shohim se ajo shpreh një përparim të brendshëm në të dyja gjuhët dhe se kjo dukuri, e cila nuk është e njohur në gjuhët e tjera semite, është prej

[3] انظر:
Brockelmann, Grundriss I, 125-136.

dukurive që u përhap në të dyja gjuhët. Kjo do të thotë se nuk është e trashëguar nga gjuha semite nënë, kurse sa i përket shqiptimit arab të këtyre zërave, ai shpreh shqiptimin e trashëguar nga gjuha semite nënë dhe në këtë aspekt konsiderohet shqiptimi arab i këtyre zërave më i vjetër sesa vetë shpërnguljet semite.

Po ashtu atje gjejmë një grup të zërave të qartë të dalluar nga të gjitha degët semite, përveç degës akadishte dhe ajo është grupi zërave të grykoreve, siç janë, për shembull: (EL-AJ-nu), dhe (EL-HA-u). Me këtë rast mund ta imponojmë njërën prej dy çështjeve: 1) Mund të jenë se këto degë të gjuhës i kanë njohur zërat e grykoreve gjatë periudhës së ndryshimit që ndodhi në këto gjuhë; ky supozim është i largët. 2) Apo mundësinë që akadishtja ta ketë humbur dallimin ndërmjet zërave grykorë nën ndikimin e gjuhës sumerite dhe ky është mendimi i preferuar. Kjo do të thotë se zërat e grykoreve kanë qenë të njohura në gjuhën semite nënë, të cilën e njohën shumica e gjuhëve semite. Duke e llogaritur prej dukurive të trashëguara nga gjuha nënë, mund të supozojmë vjetërsinë e zërave të grykoreve në arabishte, se ato kanë ekzistuar në gjuhën semite nënë para shpërnguljeve më të vjetra, që i bie përafërsisht para vitit 2500, p.e.r. Kjo do të thotë se jeta e grykoreve në gjuhën arabe është më jetëgjatë se 45 shekuj dhe se të gjitha karakteristikat në arabishte i përkasin gjuhës semite nënë...

Është i mundur zbatimi i këtij programi mbi dukuritë e tjera gjuhësore në aspektet fonetike, morfologjike, sintaksore dhe semantike. Dukuritë në të cilat marrin pjesë të gjitha gjuhët semite, apo të cilat vërtetojnë krahasimet se ato kanë ekzistuar në gjuhët e vjetra semite, këto dukuri kthehen tek gjuha semite nënë. Në të kundërtën e kësaj, janë dukuritë që e dallojnë nga një gjuhë semite me tjetrën, siç është dukuria e "Nyjës Shquese" (EL) që i paraprin emrit. Në gjuhën hebraike është (HA-un) nyja që i paraprin emrit, në gjuhën aramite, ajo vjen (FET'HA E GJATË) pas emrit. Ndryshimi i kësaj dukurie prej një gjuhe semite në tjetrën do të thotë se ajo nuk është e trashëguar nga gjuha

semite nënë, por secila gjuhë e ka zhvilluar nyjë shquese të veçantë dhe me të ndryshuan nyjat shquese në gjuhët semite të ndryshme..

## 2. Ligjet e fonetikës

Hulumtuesit i fokusuan aspektet e dallimeve të qëndrueshme ndërmjet tingujve të gjuhëve semite të ndryshme në formë të ligjeve, të cilat regjistrojnë aspekte të fonetikës kontrasteve.[4] Mund të nxirren ligjet e Fonetikës Kontrastive në gjuhët semite me krahasimin e fjalëve themelore të përbashkëta në këto gjuhë, për t'iu shmangur fillimit me fjalë jo të përbashkëta dhe të huaja.

(TA-ja) e arabishtes dhe kundërvlerat e saj në gjuhët semite

Tregon krahasimin e një grupi të fjalëve elementare në gjuhët semite, të cilat kanë ardhur nga formatet e tyre arabe të zërit (THA-un)[5], kur dihet që akadishtja e njeh në vendin e këtij zëri (SHI-nun). Gjuha hebraike po ashtu e përdor të njëjtin zë. Mirëpo, aramishtja e njeh (TA-un), ndërkohë që gjuha hebraike apo abisinishtja për të njëjtat pozita e përdor (SI-nun). Kjo më së miri shihet nga shembujt vijues:

| **Arabishtja** | **Arabishtja e jugut dhe Habeshitja** | **Aramishtja** | **Hebraishtja** | **Akadishtja** |
|---|---|---|---|---|
| thowmun | sõmat | tûmā | šûm | Šûmu |
| thowrun | sõr | taurā | šõr | Šûru |

Këtu e shohim qëndrueshmërinë e disa ndryshimeve: (THA-ja) e arabishtes ballafaqohet me (SHI-nun) në akadishte dhe në gjuhën hebraike, shkruhet (SHI-nun) me shkrimin fonetike me shenjën e (SI-nit) dhe mbi të ekziston shenja dalluese, e cila mund të jetë alternativë e dukshme prej pikave të (SHI-nit) të arabishtes në formë të mbrapshtë. Nuk është e mundur të imagjinohet se (SHI-n) këtu është fonogram

[4] Bergstrasser, Einfuhrung s. 183.
[5] Bergstrasser, Einfuhrung s. 185.

origjinal në gjuhën semite nënë, por mund të komentohen të gjitha zërat gjenden aty, duke llogaritur se "THA-ja" paraqet formulën më të vjetër dhe se (SHI-ni), (TA-ja) dhe (SI-nun) përfaqësojnë zhvillimet të veçanta për çdo gjuhë prej këtyre gjuhëve veç e veç. Mjafton me këtë rast të shpjegojmë ndryshimin e (THA-së), që e supozuam në gjuhën semite nënë, që gjendet në arabishte e që kthehet në (TA-un) në aramishte. Ky ndryshim është një lloj shqiptimi ndryshim në mes zërave të dhëmbëve, si për shembull: (THA-un) dhe (DHA-lun) deri tek kundërvlerat dhëmbore (TA-un) dhe (DA-lun), ashtu siç ndodhi në ndryshimin e arabishtes letrare në dialektet e Egjiptit e të Shamit. (THA-ja) e arabishtes ballafaqohet në këto dialekte, ashtu siç ballafaqohet në aramishte zëri (TA-un), këtë gjejmë të qartë në fjalët:(ithnejni / itnejni), (tha'lebun/ta'lebun), në arabishte po ashtu edhe në përemrin dëftor: (dha/de), (dhi/di), ndryshimi që ka ndodhur për (THA-un) semite të parë dhe kthimit kësaj në (TA-un) në aramishte është paralel me ndryshimin që ndodhi pas kësaj kur ndodhi kthimi i (THA-ut) në arabishten letrare në (TA-un) në dialektet e Egjiptit dhe të Shamit. Dhe ky është argument për vjetërsinë e (TA-es) arabishte dhe me ndryshimet e ballafaqimit të saj në gjuhët e tjera, konsiderohet zgjatje e drejtpërdrejtë e (THA-es) në gjuhën semite të parë, do të thotë para shpërnguljeve semite.

### *"DADI" i arabishtes dhe ballafaqimet e tij në gjuhët semite*

Arabishtja përshkruhet si "Gjuha e DAD-it", sikur "DA-di" ka të bëjë vetëm me arabishten. Në realitet "DA-di" është prej zërave ku merr pjesë arabishtja e veriut me arabishten e vjetër të jugut. Ballafaqon atë në gjuhët semite veriore "SA-din" në gjuhën hebraike dhe në akadishte, "AJN-un" në aramishte. Kjo shihet më së miri prej shembujve vijues:[6]

[6] انظر: Brockelmann, Grundriss I 136
برجشتراسر: التطور النحوي للغة العربية ص. ١٤

| Arabishtja | Arabishtja e Jugut | Aramishtja | Hebraishtja | Akadishtja |
|---|---|---|---|---|
| Erd | r d | >a>rã | Éres | Erşetu |

"DA-dun" konsiderohet këtu tipar prej tipareve të arabishtes së veriut dhe të arabishte së jugut. Shumica e hulumtuesve mendojnë se "DA -di" paraqet zërin më të vjetër në këtë grup. Mirëpo, ekziston mospajtim në mënyrën shqiptimit të këtij "DA-di" në gjuhën semite të parë, si shqiptimin e vjetër të saj arab, i cili ende edhe sot e kësaj dite është objekt polemike në mesin hulumtuesve. Konsiderohet ballafaqimi ndërmjet "DA-dit" të arabishtes dhe"AJ-nit" të aramishtes prej fenomeneve të dëshmueshme, për të cilën është vështirë të gjendet komenti fonetik.

Dhe në të gjithë shembujt e mëparshëm kemi vërejtur "dam-men" e emërores në formulën e akadishtes. Konsiderohet "El-I'rabu"në rasën emërore, kallëzore dhe gjinore prej tipareve të përbashkëta të arabishtes dhe të akadishtes, gjë që jep shenjë se është i trashëguar nga gjuha e parë semite. Po ashtu është vërejtur nga shembujt paraprakë përfundimi i formulës së aramishtes me "fat-ha" të gjatë, gjë që tregonte për emrin e njohur apo të definuar. Dhe pavarësisht nga numri i zërave, të cilët janë ndryshuar në gjuhën arabe e nga gjuha e parë semite. Zërat e arabishtes konsiderohen në përgjithësi vazhdimësi e drejtpërdrejtë për zërat për ekzistimin e të cilëve në gjuhën e parë semite (të para shpërnguljes semite) kishin supozuar dijetarët.

Bergsträsser, Einführung 184.

## 3. Zëra të arabishtes dallojnë nga gjuha semite e parë

Konsiderohen zërat e arabishte në përgjithësi janë vazhdimësi e drejtpërdrejtë të zërave të semites së parë. Ka shumë të ngjarë që disa zëra të arabishtes të kenë ndryshuar nga zërat e tyre në gjuhën e parë semite. Prej këtyre zërave të arabishtes (FA-ja) dhe grupi zërave (SI-nun)dhe (SHI-nun).

*(FA-ja) e arabishtes dhe (BA-ja) pështpëritëse semite*

Ballafaqohet (FA-ja) e arabishtes me një zë tjetër në gjuhët e tjera semite dhe ky zë tjetër është (BA-ja) pështpëritëse (P), sqarohet ky ballafaqim nga tabela vijueset fjalës (FEMUN-gojë) arabe dhe me ato që ballafaqohet prej derivateve në gjuhë të tjera semite.

| **Arabishtja** | **Habeshitja** | **Aramishtja** | **Hebraishtja** | **Akadishte** |
|---|---|---|---|---|
| nafsun | nafs | napšā | Népeš | Napištu |

Këtu shohim pëlqimin e gjuhëve semite - përveç arabishtes - për ekzistimin e zërit (EL-BA-a) pështpëritës në këtë fjalë. Kjo gjë të jep të kuptosh se ky zë ka ekzistuar si i tillë në gjuhën e parë semite. Kjo do të thotë se (EL-FA-u) e arabishtes nuk është vazhdimësi e drejtpërdrejtë e gjuhës semite, por është rezultat i ndryshimit të zërit, është kthyer (EL-BA-u) pështpëritëse, i cili është zë buzor që shqiptohet me takimin e dy buzëve me takimin e plotë kthehet në (EL-FA-u). Ai është zë buzor-dhëmbor, shqiptohet me takimin buzës së poshtme e dhëmbëve të lartë. Kjo do të thotë që (EL-BA-u) pështpëritëse dhe (EL-FA-u) nuk dallojnë vetëm në vendin e shqiptimit, ngase në një masë të caktuar, buza e poshtme merr pjesë në shqiptimin e të dyjave, ndaj nuk ishe vështirë të ndodhte i tërë ky ndryshim. Andaj (EL-FA-u) i arabishtes është rezultat i rit (EL-BA-u) i pështpëritshëm në gjuhën e parë semite.

*(ES-SIIN-u) dhe (ESH-SHIIN-u) të arabishtes dhe etimologjia e tyre semite*

Pa ashtu ekziston dallim ndërmjet zërave të arabishtes dhe të zërave, ekzistencën e të cilëve e supozuan hulumtuesit në gjuhën e parë semite. Ky dallim ka të bëjë me grupin e zërave (ES-SI-nu) dhe (ESH-SHI-nu). Ky grup përfshin në arabishte vetëm dy zëra e ata janë (ES-SI-nu) dhe (ESH-SHI-nu), por ajo në gjuhë të tjera semite, siç është emherishtja, përfshin tre zëra. Ata janë (ES-SI-nu) lateral apo anësor si dhe (ES-Si-nu) dhe (ESH-SHI-nu). Ai përfshin shkrimet në arabisht, një simbol të (ES-SI-nit) dhe një simbol të (ESHI-SHI-nit), si dhe simbolin e tretë të shkronjës (SAMEKH), duke sugjeruar ekzistimin e tre zërave në këtë grup të arabishtes. Hulumtimi krahasues ka vërtetuar se gjuha e parë semite përfshinte në vete tre zëra, të cilët u shndërruan në arabishte në dy zëra të vetëm[7], u themelua (ES-SI-nu) e arabishtes prej dy zërave njëri prej tyre (ES-SI-nu) i semites së parë dhe i dyti (ESH-SHI-nu) i semites së parë. Kurse sa i përket zërit të tretë, ekzistimi i të cilit u supozua në gjuhën e parë semite, ai vazhdoi të ekzistojë në gjuhën emherite dhe u shndërrua në arabishte, në habeshite dhe në akadishte në (SHI-NU-n). Është e qartë shpërndarja e zërave nga tabelat vijuese:

| **Semitja e parë** | **Arabishtja jugore dhe mehrite** | **Arabishtja veriore** | **Habeshite** | **Aramite** | **Hebraishte** | **Akadishte** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ES-SI-nu | ES-SI-nu | ES-SI-nu | ES-SI-nu | | ES-SI-nu | ES-SI-nu |
| ESH-SHI-nu | ESH-SHI-nu | | | | ESH-SHI-nu | ESH-SHI-nu |
| ES-SI-nu anësore | ES-SI-nu anësore | ESH-SHI-nu | ES-SI-nu | ES-SI-nu | | |
| | | | | | (ES-SAMEKH) | |

Nga kjo tabelë bëhet e qartë shtrirja e kompleksitetit të marrëdhënieve midis këtyre zërave. Mjaftojmë këtu që të theksojmë se (ES-SI-

[7] انظر: Brockelmann, Grundriss I 128
برجشتراسر: التطور النحوي للغة العربية ص. ١٤-١٥

nu) në arabisht përfaqëson (ES-SI-nu) semiten e parë nga njëra anë, ashtu siç përfaqëson (ESH-SHI-nu) semiten e parë nga ana tjetër. Ndërsa, (ESH-SHI-nu) arabe përfaqëson (ES-SI-nu) anësore të supozuar në gjuhën e parë semite.

Në këtë mënyrë, studimi krahasues i zërave të gjuhëve semite ka sqaruar disa ligje që përmbledhin harmoninë akustike. Këto ligje akustike kanë konfirmuar se gjuha arabe paraqet në përgjithësi zërat e gjuhës së parë semite, por disa zëra arabë janë produkt i ndryshimit gjuhësor në arabisht, që e kanë bërë të ndryshojë nga gjuha e parë semite.

## 4. Përemrat

Analiza krahasuese e strukturës së fjalës trajton të gjithë fjalorët e gjuhës. Me këtë program krahasues trajton llojet e fjalëve që kanë qenë jashtë pjesës së analizës morfologjike tek arabët. Llojet më të rëndësishme janë përemrat, emri tregues, emri lidhës dhe emrat pyetës. Shkenca e gjuhës bashkëkohore i rendit të gjitha këto lloje nën emrin:

"Përemrat". Përemrat, sipas kuptimit bashkëkohor, përfshijnë përemrat personalë, përemrat tregues dhe përemrat lidhës dhe përemrat pyetës[8]. Edhe pse analiza morfologjike tek arabët nuk ka trajtuar këto fjalë, ajo është një nga temat e hulumtimit në shkencën e gjuhës krahasuese, si dhe pjesës së hulumtimit për emrat (e tjerë), foljet dhe nyjat.

Analiza e përemrave arabë, në dritën e gjuhës semite, bëhet duke u bazuar në analizimin e formulimit të çdo përemri sipas përmbajtjes së tij.

[8] انظر القسم الخاص ببحث Pronomina في كتاب: Brockelmann, Grundris I 297 ff.
و كذالك: برجشتراسر: التطور النحوى للغة العربية ص ٤٧ و ما بعدها

| Përemri në arabisht | Përemri themelor | Fundi | Komentimi |
|---|---|---|---|
| Unë (Ena) (=Ene) | an | (ã) | Ky fund është marrë nga shkronja e ngjashme an+'a →anã |
| Ti (Ente) | an | ta | Ky fund është marrë nga shkronja e ngjashme: Shkruaj (Uktub) an+ta= anta |
| Ti (f. - Enti) | An | Ti | Shkronja et-Tau është marrë nga ta e ngjashme + Kesre e fundit e ngjashme an+t+i →anti |
| Ai (m. - Huve) | Hu | (w)a | El-hau është element tregues, pastaj është lehtësuar el-hemze hu+'a → huwa |
| Ajo (Hije) | Hi | (y)a | hi+'a → hiya |

Nga tabela e mësipërme vërehet se përemrat personalë, të ndarë nga njëjësi, lidhin elementet e tyre të përbëra nga shkronjat e ngjashme. Gjithashtu, nga analiza e formulimeve të përemrave personalë të ndarë në gjuhën semite, vërehet se përbëhen nga elemente të marra nga precedentët me të cilët formohen formulimet e kohës së tashme (shkronjat e ngjashme), apo nga prapashtesat me të cilat përbëhen formulimet e kohës së shkuar (përemrat e lidhur).

| Gjuha arabe | Gjuha | Përemri themelor | Fundi | Komenti |
|---|---|---|---|---|
| | Unë (Ena) | An | 'a | Ky përfundim është paralel me precedentin e kohës së tashme të folësit: Shkruaj (Uktub) |
| Akadishte | Anãku | An | ku | Ky përfundim është përemri i lidhur me kohën e shkuar të folësit, dhe është al-Kafi i përqafuar në gjuhën akadike |

Kuptimi i kësaj është se formulimet e përemrave personalë, të ndarë në gjuhët semite, përfshijnë elemente themelore në të cilat marrin pjesë gjuhët semite. Dhe këta elementë janë të trashëguar që nga e kaluara. Gjuhët e ndryshme kanë krijuar formulime të ndryshme të përemrave personalë të ndarë nga elemente të marra nga precedentët e kohës së tashme, siç është rasti me formulimet e lartpërmendura të gjuhës arabe, apo nga elemente të marra nga përemrat personalë të lidhur, siç është përemri akadik i lartpërmendur.

Formulimet e përemrit personal të lidhur dallojnë nga e kaluara e folësit njëjës nga gjuha semite te tjetra. Në disa gjuhë ai përbëhet nga (el-Kafi) dhe në gjuhët tjera përbëhet nga (el-Tau).

| **Gjuha arabe** | **Gj. Hebraike** | **Gj. Akadishte** | **Gj. Habeshite** | **Gj. Mehrite** |
|---|---|---|---|---|
| Tu | -ti | -ku | -ku | -k |

Studiuesit janë të mendimit këtu se gjuha semite e parë ka përdorur (el-Kaf) në këtë rast, dhe se gj. arabe e hebraike kanë dalluar me këtë nga ky aspekt nga gjuha amtare semite. Ky mendim bazohet se (el-Kafi) ka qenë përemër i folësit, dhe se (el-Tau) ka qenë përemër i atij që i adresohet në gjuhën amtare semite. Më pas, gjuha arabe ka përdorur (el-Tau) për folësin dhe të adresuarin së bashku. Dhe pas (el-Tau) është dalluar me al-damme, el-fetha dhe el-kesre nga formulimet e ndryshme.

Në këtë mënyrë, programi krahasues sqaron elementet e përbëra të formulimeve të përemrave të ndryshëm nga njëra anë, ashtu siç shpjegon elementet e saj të vjetër të trashëguar nga gjuha e parë semite dhe elementet e saj të përbëra në kuadër të gjuhës arabe.

## 5. Emrat dypalësh

Ideja e peshores morfologjike tek arabët bazohet në atë se shumica e shprehjeve arabe janë me rrënjë të trefishtë. Hulumtimi krahasues në gjuhët semite ka konfirmuar se rrënja e trefishtë është e fshehur pas shumë fjalëve të gjuhëve semite. Dhe në të njëjtën kohë, është shfaqur përmes krahasimit se një grup i fjalëve mund të vijnë në rrënjë të dyfishtë. Dhe rrënjë këtu është formulimi më i vjetër nga i cili kanë dalë formulimet e tjera të reja. Ka dallim midis metodës së gramatikanëve arabë dhe metodës së shkencëtarëve të gjuhëve semite lidhur me përcaktimin e rrënjës. Dijetarët arabë janë përpjekur që të arrijnë te rrënja e fjalës me rrotullimin e fjalëve të nxjerra nga e njëjta materiale në arabisht, por shkenca e gjuhës krahasuese përpiqet që të njohë rrënjën historike me krahasimin e të gjitha fjalëve semite që i takojnë një rrënje të vetme në përpjekje për përcaktimin e origjinës, nga e cila rrjedhin këto fjalë. Nuk ka dyshim se përemrat dhe shumica e nyjave dalin nga kuadri i rrënjës së trefishtë. Hulumtimi në çështjen e trefishtë dhe të dyfishtë trajton emrat dhe foljet, të cilat mund të vijnë në rrënjën e dyfishtë[9].

Kategorizimi i shprehjeve, që shkencëtarët i kthejnë në rrënjën e dyfishtë, në disa grupe. Më e rëndësishmja është grupi i emrave që tregojnë afërsinë dhe grupi i emrave që tregojnë pjesët e trupit të njeriut.

Fjalët baba, nënë, vëlla, vjehërr, djalë, janë me rrënjë të dyfishtë. Këto fjalë janë zhvilluar në drejtim të trefishtë, për të shkaktuar prishje të ekuilibrit dhe që të bëhen të ngjashme me shumicën e fjalëve arabe që janë fjalë të trefishta. Ky zhvillim ka ndodhur në disa drejtime. Njëri nga ta e bën lëvizjen e zgjedhimit të gjatë, duke e bërë emërore me ed-dame të gjatë (Babi yt - Ebuke), dhanore me el-fetha të gjatë (Babi

[9] أهم الدراسات حول قضية الأسماء ذات الأصل الثنائي ما كتبه نولدكه:
Nöldeke, Zweiradikalige Substantive, in: Neue Beiträge zur semitischen Sprachwissenschaft, s. 109-178

yt - Ebake) dhe kallëzore me el-kesre të gjatë (Babi yt - Ebike). Por, këto fjalë ruajnë të dyfishtën e tyre kur iu shtohen përemrit të folësit (Babi im - Ebi, Vëllai im - Ekhi). Dhe drejtimi i dytë për t'i bërë këto fjalë të ekuilibruara me të trefishtë ka qenë me theksimin e të heshturit të dytë në fjalë baba - Eb, nënë - Um, vëlla - Ekh, Vjehërr - ham. Këtë e gjejmë në shumë dialekte arabe. Por, fjala "bin" është zgjeruar formulimi i saj me mijëra lidhje. Kjo fjalë shfaqen me (el-bau) dhe (el-nunu) në gjuhën asiriane, hebraike dhe arabe, por në gjuhën aramite dhe mehrite me (el-ba) dhe (el-rra). Formulimet e shumësit në gjuhën aramite dhe mehrite, si dhe formulimet e njëjësit e shumësit në gjuhët e tjera semite tregojnë që rrënja e këtyre fjalëve është (el-bau) dhe (el-nunu), ashtu si në gjuhën arabe. Ndërsa, formulimi i njëjësit në gjuhën aramite dhe mehrite është zhvillim i veçantë në të dy gjuhët, dhe nuk pasqyron formulimin e trashëguar nga gjuha amtare semite.

Ka një grup të shprehjeve me rrënjë të dyfishtë në gjuhët semite që tregojnë pjesët e trupit. Prej tyre janë fjala "dorë - jed" dhe fjala "gjak i veshkës - dem rie" dhe fjala "dhëmbë - lethe".

Fjala dorë - jed në të gjitha gjuhët semite vjen e përbërë nga (el-jau) dhe (ed-dal) që tregon dualizmin e rrënjës së kësaj fjale. Por, disa dialekte arabe kanë bërë përpjekje që këtë fjalë ta bëjnë në formën e trefishtë, duke theksuar (el-dal), ndërsa dialektet e tjera arabe janë përpjekur ta bëjnë të trefishtë, duke shtuar hemze në fillim të fjalës.

Ndërsa, fjala "gjak - dem", ajo është me rrënjë të dyfishtë gjithashtu, ashtu siç e dëshmojnë formulimet në gjuhën arabe letrare dhe gjuhët e tjera semite. Por, formulimi që e njohin disa dialekte arabe me theksimin e (el-mim), kthehen në drejtimin e përgjithshëm, duke i bërë këto fjalë me rrënjë të dyfishtë në formë të trefishtë, ashtu si shumica e fjalëve arabe.

Ndërsa, fjalët "veshkë", "dhëmë - lethe" dhe "buzë - shefet), konsiderohen me rrënjë të dyfishtë të zhvilluar, duke shtuar (ta-un) e gjinisë femërore në rrënjën e dyfishtë.

Ka fjalë që vijnë në rrënjë të vetme, siç është fjala gojë - el-fem (goja jote -fuke, fiike, fake). Rrënja e përbashkët është el-fau, që vjen në gjuhët semite si rrënjë të kësaj fjale. Formulimi arab është zhvilluar nga kjo el-fa me lëvizjen e gjatë në emërore, gjinore dhe kallëzore. Ndërsa, (el-mim) që shfaqet në fjalën fem, mund të jetë pjesë e pjesëve të fenomenit të el-temjimit, që është fenomen i ngjashëm me (et-tenvin) në disa gjuhë semite.

Hulumtimi ka sqaruar se dualizmi i fjalëve të tjera ka qenë pikë mospajtimi midis gramatikanëve arabë. Në të kaluarën nuk janë pajtuar për fjalëm "emër - ism", nëse është me prejardhje nga tipari - (el-seme) apo nga lartësia - (el-sumuv)[10]. Hulumtimi krahasues ka konfirmuar se rrënja e dyfishtë, është (esh-shin) dhe (el-mim) në gjuhën amtare semite me argumentin e formulimeve të gjuhëve të ndryshme semite. Duke marrë parasysh se (esh-shin) i gjuhës semite amtare ka ndryshuar në (es-sin) arabe, bëhet e qartë se është formulim me rrënjë të dyfishtë, ndërsa elifi lidhës që ka hyrë në formulimin arab, është bërë që fjalën ta bëjë të ngjashme me shprehjet e trefishte dhe për të bëjë një lloj balance me shumicën e fjalëve arabe.

## 6. Foljet

Ka një grup të foljeve që i njohim në formë të trefishtë dhe mund të kthehen me krahasim në rrënjë të dyfishtë. Këto folje rregullohen në dy grupe:

Foljet që fillojnë me (el-siin), si: SEKEVE duke e krahasuar me KEBE. Në këtë shembull është i qartë afrimi i dy kuptimeve dhe afrimi i formulimit, që tregon se rrënja është (el-kaf) dhe (el-ba) dhe se formulimi është zgjeruar në drejtim të trefishtë, duke shtuar (el-siin) në fillim të saj apo me theksimin e shkronjës së dytë (krahaso hafe, sehafe).

[10] انظر: ابن الانباري : الانصاف في مسائل الخلاف بين النحويين, (المسألة الأولى) في تحقيق فايل ص. ١-٦. و نو لدكه (البحث المذكور في ٩) ص ١٤٠-١٤٣.

Foljet që fillojnë me (el-nun), si: "nekase" duke e krahasuar me "kase". Kuptimi i të dy fjalëve është i afërt dhe se të dyja formulimet kthehen në një rrënjë të dyfishtë që është zgjeruar duke shtuar (el-nun) para rrënjës së dyfishtë, apo me theksimin e shkronjës së dytë të rrënjës. (Krahaso "habese" dhe "nahbisu", dhe gjithashtu "dhel-le" dhe "nedhil-lu".

Mund të përmenden edhe shumë shembuj të tjerë, duke ndjekur të dy fenomenet në fjalorin arab.

## 7. Përcaktimi i rrënjëve në dritën e krahasimeve

Studimet krahasimtare shpjegojnë disa të vërteta lidhur me përcaktimin e rrënjëve në disa fjalë. Folja "hereka" ka ardhur në gjuhën arabe, sikur të jetë nga rrënja "hereka"[11]. Por, e vërteta është se (el-hau) këtu nuk është rrënjësore, por është (haun) ekuilibruese hefal. Dhe kjo peshë analogjike në gjuhën hebraike dhe në gjuhën arabe të jugut është përballë peshës "efale" në gjuhën arabe të veriut. Ndoshta, krahasimi i fjalës "Erak" dhe fjalës "Herak" me kuptimin e njëjtë na bënë të qartë se e para është me peshën Ef'al, ndërsa e dyta me peshën "Hefal". Të dyja peshat këtu janë me qëllim të bartjes në gjuhët semite. Duke u bazuar në këtë, fjala "herak" është me peshën "hef'al" dhe mund të ketë hyrë nga gjuha arabe e jugut. Por, mund të jetë tepricë nga gjuha e parë semite, nëse supozojmë se ajo ka njohur gjithashtu peshën hef'al për bartje. Lidhur me atë që kemi përmendur lidhur me fjalën "herak" e konfirmojnë fjalët e tjera në gjuhë arabe si: hexhrea', heblea' etj. Studimi i fjalëve që fillojnë me "el-ha" në gjuhën arabe ka zbuluar për shumë shembuj të tjerë të këtij lloji, ku el-hau është shtesë dhe jorrënjësore.

[11] في باب : "فعلت بغير ألف". انظر: فصيح ثعلب. مادة: هرق

Nëse ka ndonjë mospajtim në përcaktimin e shkronjave rrënjësore në fjalën "medine"[12], hulumtimi i saj në dritën e gjuhës semite e bën të qartë se (el-mimi) është shtesë. Në gjuhën arabe dhe hebraike e gjejmë fjalën "di-in" me kuptim të ligjit, dhe në gjuhën aramite "di'ina". Ashtu siç e gjejmë në gjuhën hebraike "bejt di-in" me kuptimin e gjykatës, dhe në gjuhën arabe e hebraike "dej-jan" me kuptimin e gjykatësit. Fjala "medine" në gjuhën aramite është paraqitur me rajonin e Shamit para Islamit me kuptimin e rajonit administrativ apo rrethit gjyqësor të lidhur me këtë kuptim gjyqësor që vazhdojmë ta gjejmë në fjalët arabe si: da'in, medi-in, Edane, idanet etj. Kur, Profeti a.s. e ka quajtur Jethribin me emrin El-Medine, ky përdorim ka qenë i lidhur me shfaqjen e Shtetit të vogël Islam afër Profetit a.s. dhe ai gjykon në "el-Medine". Dhe kështu, studimi krahasues shpjegon anët e ndryshme në përcaktimin e rrënjëve të fjalëve të ndryshme arabe.

## 8. Shprehjet e përbashkëta

Lidhja midis shprehjeve arabe dhe prejardhjeve të tyre në gjuhët e tjera semite trajton dy çështje: ka shprehje që marrin pjesë në përgjithësi në gjuhën semite dhe i kthehen gjuhës amtare semite. Përveç kësaj, ka shprehje që kanë hyrë nga ndonjëra prej gjuhëve semite në një gjuhë tjetër semite. Si të hyjë një fjalë arabe në gjuhën habeshite apo fjalë hebraike në atë aramite etj. Kuptimi i kësaj është se studimi trajton shprehje të përbashkëta semite nga njëra anë, dhe nga ana tjetër shprehje të huaja nga ndonjë gjuhë tjetër semite.

Ka një grup të shprehjeve të përbashkëta në gjuhët semite. Me këtë nënkuptohet se rrënjët e tyre të prejardhura janë të përbashkëta. Kjo nuk do të thotë se kuptimi i tyre është plotësisht i njëjtë në të gjitha gjuhët semite. Ndryshimi tregues është fenomen i njohur në kuadër të një gjuhe, si dhe në kuadër të një familje gjuhësore. Fjala "mish - lah-

[12] انظر: مادة (مدن), و مادة (دين) في المعاجم العربية.

mun" në gjuhën arabe nënkupton diçka të kundërt nga ajo që ka kuptim fjala "Lēhem" në gjuhën hebraike. Kjo e fundit ka kuptimin e bukës. Është e qartë se të dy fjalët arabe dhe hebraike kanë rrënjë të njëjtë të prejardhur që është (l - h - m). kuptimi i kësaj rrënje ka pajtim të largët, pasi që qëllimi është ngrënia e gjësë jo të lëngët. Por, ndryshimi i kuptimit të dy fjalëve i ka bërë që të dyja të specializohen në kuptim të caktuar. Që të dyja janë bërë me kuptim të ndryshëm nga njëra-tjetra. Ka edhe një shembull tjetër që shpjegon idenë e njësisë së origjinë së prejardhur dhe ndryshimin e kuptimit të fjalëve të prejardhura në gjuhët e ndryshme semite. Fjala "familje - Ehl" në gjuhën arabe ka përballë fjalën "Ōhēl" në gjuhën hebraike. Që të dyja kanë rrënjë të njëjtë të prejardhur, që është (hemze, haun dhe lamun). Por, fjala hebraike ka kuptimin e "tendës" dhe nuk ka asnjë kuptim tjetër, ndërsa fjala arabe ka kuptimin e familjes në përgjithësi apo të bashkëshortes me theks të veçantë. Ka lidhje midis dy kuptimeve, që mund të paramendohet që shoqëria beduine apo gjysmë beduine ka përshkruar tendën apo bashkëshorten apo bashkëshorten dhe fëmijët që i ka me të, me të njëjtën fjalë. Kuptimi ka ndryshuar dhe është përcaktuar, dhe për këtë ka ndryshuar kuptimi i fjalës hebraike nga fjala arabe nga e cila ka prejardhjen. Nuk ka dyshim se bashkëshortja ndryshon nga tenda. Fjalori i prejardhjeve të gjuhëve semite dhe çfarëdo studimi i fjalëve të ngjashme i shqyrton fjalët që kanë rrjedhur nga një rrënjë e prejardhur, pastaj shqyrtojnë nivelin e pajtimit apo dallimit tregues pas kësaj.

## 9. I huaji në dritën e ligjeve të zërit

Përcaktimi nëse një fjalë e përbashkët e dy gjuhëve semite është autentike e trashëguar nga gjuha amtare semite, apo e huaj nga ndonjëra prej dy gjuhëve në gjuhën tjetër, përcaktohet në radhë të parë me kriter gjuhësor. Ky kriter, që është pranuar nga studimi i ri, hyn në kuadër të aplikimeve direkte të idesë së "ligjeve të zërit". Ky kriter nuk

është i ri. Gjuhëtarët arabë kanë njohur ekzistimin e fjalëve të qëndrueshme midis gjuhës arabe dhe asaj aramite. Janë dy shembuj që i ka përmendur al-Hawaliki (540 h.) në librin e tij "el-Muarreb",[13] që e bëjnë të qartë se sipas idesë së ligjeve të zërit nëse fjala është e huaj në gjuhën arabishte. al-Hawaliki ka përmendur se fjala "al-Natur" është e arabizuar dhe ka kuptimin e "ruajtjes së hurmës dhe pemës". Ai ka argumentuar se ajo nuk është me origjinë arabe me atë që ka përmendur Al-Asmei se e kundërta arabe e kësaj fjale është "el-Nadhuur" me (el-dhau). Dhe e vërteta është se përballë (el-dhaut) në gjuhën arabe është (el-tau) në gjuhën aramite. Ky është një nga ligjet e qëndrueshme të zërit. Al-Hawaliki ka vërejtur se qëndrueshmërinë e takimit midis (el-dhau) arabe dhe (el-tau) aramite.

Substanca "nedhar" në gjuhën arabe domosdo duhet të takohet me "netar" në gjuhën aramite. Al-Hawaliki thotë: "Rrjedhja e bën (el-dhau) (Ta-en) dhe ajo që del se Nebetet kanë qenë përdoruesit më të afërt të gjuhës aramite tek arabët. Al-Hawaliki ka argumentuar për qëndrueshmërinë e këtij ligji gjuhësor me fjalën" bertale" që ka kuptimin e "djalit të hijes". E vërteta është se fjala "berr" në gjuhën aramite ka kuptimin e "djalit" në gjuhën arabe, ndërsa fjala e dytë përfundon me fetha të gjatë. Pjesa tjetër e fjalës është në pajtim me fjalën arabe "dhil", përveç në takimin midis (el-dhau) arabe dhe (el-tau) aramite. Me këtë, al-Hawaliki qëllimisht ka bërë të ditura komentet e gjuhëtarëve në shekullin e dytë hixhri, si al-Asmei, për idenë e ligjeve të zërit midis gjuhës arabe dhe aramite, si dhe zbatimin e tyre të kufizuar për të njohur joautencitetin e fjalët në gjuhën arabe dhe përcaktimin e origjinës së saj.

Hulumtimi bashkëkohor ka pranuar zbatimin e idesë së ligjeve të zërit, duke i konsideruar si kriteri i parë për përcaktimin e autenticitetit

[13] انظر: المعرب للجواليقي, ص. ٣٣٤, ص. ٦٨

të fjalës apo joautenticitetin e tyre nga ana e prejardhjes[14]. Këtë ide do ta shpjegojmë me një grumbull shembujsh, që i takojnë lëndës së arabishtes "thegare" dhe asaj që i takon sipas ligjeve të zërit në gjuhët e ndryshme semite. (El-Thau) në gjuhën arabe shpreh (el-thau) në gjuhën amtare semite. Dhe takohet me (el-shiinu) në gjuhën hebraike dhe (el-tau) në atë aramite. Ndërsa, (el-gajnu) në gjuhën arabe ka përballë (el-ajnu) në gjuhën aramite dhe atë hebraike. Kjo nënkupton që përballja e prejardhjes direkte të lëndës arabe (thau-gajn-raun) është (shin-ajn-raun) në gjuhën hebraike, (taun-ajn-raun) në atë aramite. Kjo është ajo që gjejmë në fjalët "thegare" në gjuhën arabe, ša'ar në gjuhën hebraike, tar'ā në aramite. Është e qartë se këto fjalë kanë rrënjë të përbashkët të prejardhur dhe se fjalët aramite kanë pësuar ndryshim të vendit dhe kanë marrë el-fetha të gjatë që ka qenë nyje e shquar në gjuhën aramite. Ndërsa, kuptimi i këtyre fjalëve është i afërt, por nuk janë në pajtim ashtu sikurse shumica e fjalëve me origjinë të përbashkët të prejardhur. Kuptimi kryesor i të gjitha këtyre fjalëve është kuptimi i el-fet'has. Fjala "thegar" në gjuhën arabe ka kuptimit e kufijve të jashtëm të shtetit apo pikat kufitare. Për këtë, rajoni kufitar arabo-bizatin është përshkruar si el-thugur" dhe kur është zhvilluar kuptimi i kësaj fjale sipas kuptimti bashkëkohor në gjuhën arabe, ka marrë kuptimin e kufijve detarë të shtetit. Më parë, ka treguar për kufijtë detarë apo tokësor pa përcaktim. Kësaj i shtohet edhe përdorimi i fjalës "thegar" me kuptimin e fet'has së gojës. Ndërsa, në gjuhën hebraike fjala "shear" ka kuptimin e derës apo hyrjes. Ndërsa, fjala aramite "ter'a" ka kuptimin e derës apo hyrjes apo gjësë të lidhur me gjënë tjetër. Kur është kthyer formulimi aramit i lartpërmendur në gjuhën arabe, ka ruajtur dy tipare kryesore që kanë treguar se nuk është autentike në gjuhën arabe dhe e huaj në gjuhën aramite. Ato janë ekzistenca e (el-tau) - jo (el-thau) -

[14] أنظر مثلا:
برجشتر اسر: التطور النحوي للغة العربية ص. ١٤٠-١٥٤

dhe ekzistenca e el-fet'hasë së gjatë në fund të formulimit. Të dy tiparet janë të veçanta për formulimin aramit. Kur ky formulim aramit është kthyer në gjuhën arabe ka ndodhur përcaktim i të kuptuarit. Në gjuhën arabe ka marrë kuptimin e rrjedhjes së lumit që lidh një zonë me zonën tjetër.

## 10. Krahasimet gjuhësore dhe historia e shprehjeve

Krahasimet gjuhësore shpjegojnë historinë e shumë shprehjeve arabe. Shprehjet që kanë ardhur në poezinë e injorancës apo në fjalorët arabë apo në Kuran nuk kthehen nga aspekti i prejardhjes historike te një periudhë e njëjtë. Ka shprehje që janë shumë të vjetra dhe shprehje të një periudhe më të re. Në përgjithësi, shprehjet e përbashkëta në gjuhën semite në përgjithësi, apo të përbashkëta midis gjuhës arabe e asaj akadike në veçanti, mund të konsiderohen nga kjo trashëgimi gjuhësore, që e ka njohur gjuha amtare semite para se të fillojnë emigrimet në Irak dhe Sham, që nënkupton se këto shprehje kthehen para vitit 2500 para Krishtit. Ndërsa, shprehjet që i gjejmë në pozitën e injorancës apo Kuran apo fjalorët arabë dhe nuk i gjejmë fjalët e prejardhura në gjuhët e vjetra semite, atëherë këto shprehje kanë hyrë në gjuhën arabe apo i ka krijuar arabishtja në periudhën midis emigrimeve dhe krijimeve të poezisë së injorancës apo zbritjes së Kuranit. Këtë çështje e sqarojmë me hulumtimin e një grupi të shprehjeve që në nivelet gjuhësore të mëpastajme kanë treguar për burrin e gruan dhe marrëdhëniet midis tyre. Të gjitha gjuhët semite ndajnë fjalët "dheker" dhe "untha". Në formulimet e këtyre dy fjalëve në gjuhën akadike, hebraike dhe aramite zbatohen ligjet e veçanta të zërit me zërat e krijuar pa asnjë anomali. Kjo tregon se fjalët "dheker" dhe "untha" janë nga fjalori semit i vjetër, që e ka njohur gjuha amtare semite para se të nisin emigrimet semite rreth vitit 2500 p.e.s. Por, ne gjejmë në arabishte dy fjalë të tjera "beal" dhe "zevxh". Fjala "beal" ka kuptimin e burrit të lidhur me lidh-

je bashkëshortore, ndërsa "el-zevxh" me gruan. Për secilën fjalë nga këto dy fjalë ka prejardhje të ndryshme, por kuptimi i të dyjave kuptohet - si njësi kundrejt kuptimit. Fjala "beal" i takon fjalorit të vjetër semit, dhe është e njohur në shumicën e gjuhëve semite. Ajo ka kuptimin e Zotit apo zotërisë. Por, përdorimi i saj me kuptimin e burrit të martuar është lidhur me fjalën "zevxh" dhe fjala "zevxh" ka rrënjë josemite. Ajo rrjedh nga fjala greke Zeugos që së pari ka hyrë në gjuhën aramite, dhe ka pasur formulimin grek që nuk përfundon "os", por edhe me përfundim aramit që është el-fet'ha e hapur. Për këtë, formulimi aramit "zevxha" është formuluar së bashku me formulimin gati të papërfunduar me nyjë shquese "zevxh". Më pas, kjo fjalë është kthyer në arabishte dhe ka marrë kuptimin e kundërt të fjalës "beal".

"El-Bealu" është njeriu i martuar dhe gruaja e tij që është "el-zevxh". Ky përdorim ka dominuar derisa al-Asmei ka vënë re se disa bashkëkohës të tij po e përdorin fjalë "zevxhe". Ai e ka mohuar këtë formulim dhe e ka konsideruar melodi[15]. Ky formulim mund të ketë dy shpjegime: njëri është se është formulim i zhargonit që ka vazhduar gjuha aramite. Dhe e dyta se është përpjekje për shtimin e shenjës së gjinisë femërore te formulimi që tregon gjininë femërore. Në shekujt e ardhshëm, kur al-Asmei ka vënë re se takimi i kuptimit midis fjalës "zevxh" që tregon burrin e martuar dhe fjalës "zevxhe" që nënkupton gruan e martuar, që do të thotë ekzistimin e dy fjalëve "zevxh" dhe "zevxhe" së bashku, ka bërë që ta specifikojë fjalën e parë me burrin dhe të dytën me gruan. Me këtë kuptim, ka vazhduar përdorimi i të dy fjalëve në tekstet arabe deri më sot.

Ndryshimi është pasqyruar në përcaktimin (burrë/grua) në (beal/zevxh). Njeriu nga përshkrimi biologjik i thjeshtë që e ka përcaktuar "natyra" është shndërruar në marrëdhënien shoqërore që e ka bërë njeriu

[15] حول رأي الأصمعي في هذه الكلمة, انظر/ الموشح للموزباني ص. ٢٨٣-٢٨٤.

që kontribuon në krijimin e "civilizimit". Ndërsa, ndryshimi nga "beal/zevxh" në "zevxh/zevxhe" ka çuar në zhdukjen e fjalës "beal". Ajo nuk është përdorë më në gjuhën arabe, përveç në disa emra vendesh në Liban, si "Balebek" (Zoti i Ekzistencës apo zoti Bahus), dhe "Beal Shemije" (Zoti i Qiellit). Fjala është zhdukur [16] kur është shfaqur përdorimi i ri "zevxh/zevxhe".

Por, gjuha arabe ka mundësi të mëdha për të përfituar nga rrënjët autentike dhe të huaja. Për këtë, janë formuluar fjalë të shumta nga rrënja (z-v-xh), ashtu siç ka qenë rrënjë arabe semite. Për këtë, janë shfaqur fjalët në vijim: (zevxh-tezvixh-zevaxh-muzavexhe-muzdevexh-izdivaxh) etj.

Me këtë, përmes ligjeve të zërit dhe ndjekjes së grupeve tregues dhe lëvizjes së shprehjeve nga gjuhët semite dhe josemite në gjuhën arabe, mund të dimë historinë e anëve të ndryshme të jetës së shprehjeve arabe.

[16] لم أدخل في الاعتبار وجود كلمة "بعل" في لهجات العراق, و في اللغة المهرية – دون عين, و في صيغة النسبة: "بعل" الموجودة في لهجات منطقة الشام و صفا للأراضي التي تروى بمياء الأمطار. و في هذه الأمثلة نجد كلمة "بعل" بمعنى السيد الزوج, أو الاله, "بعل" بمعنى ما يأتي به الاله.

## SUMMARY

There were poetic texts of the time of Arabic ignorance for several centuries, the oldest Arab texts known by scholars. However, contemporary research in the nineteenth century clarified, after having discovered the Akkadian language and some studies on Semitic languages using comparative methods, including the features of linguistic structure of Arabic and its ancient dialects, can be taken as an important date in the science of comparative Semitic linguistics. Therefore, it became possible that through comparative studies, Arabic developments would be known from the times of ignorance poetry, for more than two thousand years. This way, we could recognize common phenomena in Arabic and Akkadian, which cannot be other than inherited from the ancient original Semitic language, from which derive all Semitic languages. This was the reason to begin research of the History of Arabic Language, thereby explicating relations of Arabic with other Semitic languages, and the original Semitic, in efforts of discovering the history of phonetics, morphology, syntax and semantics of Arabic language even before its script.

If Arabic is the youngest Semitic language, as written by its people, it can be stated that other Semitic languages were written before Arabic language for centuries. For example, Akkadian language was written already in 2500 BC, while Ugaritic, which was written approximately in 1400 BC. Comparisons between different Semitic languages clarify that Arabic language preserved a number of ancient features, which can be traced to the original first Semitic. Therefore, common features of all Semitic, or at least majority of Semitic languages, are features for which the scholars assume to be inherited from the first Semitic, from which other Semitic languages derived.

Dr. Sadik MEHMETI

# MBISHKRIMI I XHAMISË SË KATIB SINANIT NË PRIZREN DHE AUTORI I TIJ

**Abstrakt**

Në mesin e xhamive të qytetit të Prizrenit gjendet edhe ajo që e ka ndërtuar Katib Sinani, e cila e mban edhe emrin e ndërtuesit. Nuk është e përcaktuar se kur është ndërtuar Xhamia e Katib Sinanit në Prizren, pasi që mbishkrimi i ndërtimit të saj nuk është ruajtur.

Megjithatë, është shumë e sigurt se kjo xhami në vitin 1311 Hixhri (1893/4) është restauruar. Këtë e dëshmon Kronogrami/Târîh-i në gjuhën osmane, që ruhet mbi derën e kësaj xhamie, mbishkrim i shkruar poeti "Hifzî"-u. Po kush është autori i këtij mbishkrimi, pra kush është "Hifzî"-u?

Punimi ynë synon të hedhë dritë pikërisht mbi jetën dhe veprën e këtij autori.

**Fjalët çelës:** Kronogram/Târîh, xhamia e Katib Sinanit, Prizren, Abdylaziz "Hifzî" efendi

## Hyrje

Në mesin e 37 xhamive, sa ka sot qyteti i Prizrenit[1], gjendet edhe xhamia monumentale të cilën e ka ndërtuar Katip Sinani, që mban edhe emrin e tij. Si për shumë xhami tjera, edhe për xhaminë e Katip Sinanit nuk dihet viti i ndërtimit dhe as ka të dhëna të mjaftueshme për ndërtuesin e saj. Kjo për arsye se mbishkrimi i ndërtimit të xhamisë nuk është ruajtur, kurse vakëfnâmeja e saj nuk na është e njohur, me se do të vërtetohej saktë viti i ndërtimit dhe do të kishim më shumë të dhëna për vakëflënësin e saj.

Mungesa e këtyre burimeve, i ka shtyrë që disa autorë[2], kur kanë bërë fjalë për këtë xhami, të na japin vit të pasaktë të ndërtimit të saj. Kështu, fakti se në *"Defterin e hollësishëm të Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1590-91"*, përmendet edhe mëhalla e Katip Sinanit, - si një ndër tetë mëhallët e mëdha myslimane të këtij qyteti dhe e cila kishte 71 shtëpi myslimane dhe disa zeje[3], - u ka mjaftuar këtyre autorëve për të konstatuar se kjo xhami është ndërtuar pikërisht në vitin 1590-91, meqë përmendet mëhalla me këtë emër. Mirëpo, ky konstatim nuk mund të merret si i mirëqenë dhe pa rezerva, sepse me botimin, së voni, të *"Defterit të hollësishëm të Sanxhakut të Prizrenit të vitit 1571",* vërejmë se mëhalla e *yazici-katip Sinanit*[4] përmendet që në atë kohë.

[1] Këtu janë përfshirë edhe xhamia, më saktë minarja e Xhamisë së Arastës dhe xhamia e Namazgjahut.

[2] Mehmet Z. Ibrahimgil-Neval Konuk, *Kosova'da osmanli mimari eserleri*, vëll. II, Ankara 2006, f. 685-686; Abib Ahmedi, *Theranda-Prizreni ndër shekuj*, Prizren 1996, f. 239. Salajdin Krasniqi, *Prizreni-udhëtim nëpër kohë*, Prizren 2002, f. 34.

[3] Selami Pulaha, *Qytetet e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVI, në dritën e të dhënave të reja të regjistrimeve kadastrale osmane*, në "Gjurmime albanologjike, SSHH, Prishtinë 1980, f. 12; Muhamet Tërnava, *Popullsia e Kosovës, gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë 1995;Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë 1982, f. 251.

[4] Tatjana Katić, *Opširni popis Prizrenskog sandžaka iz 1571.* godine, Beograd 2010, f. 53-54.

Së këndejmi, nëse ndjekim parimin e njëjtë me autorët në fjalë, atëherë mund të themi se kjo xhami do të jetë ndërtuar të paktën dy dekada para vitit 1591 dhe kjo duke u mbështetur në "*Defterin...*" e vitit 1571.

Është e vërtetë se një mëhallë rëndom është bërë e njohur në saje të xhamisë që është ndërtuar aty dhe sipas saj ka marrë edhe emrin, por kjo nuk domethënë domosdoshmërish të saktësojë edhe vitin e ndërtimit të akëcilës xhami. Përkundrazi, logjika thotë se njëherë do të ketë ekzistuar mëhalla, pastaj të jetë ndërtuar xhamia, e më pastaj mëhalla të jetë identifikuar me emrin e xhamisë ose me emrin e ndërtuesit të xhamisë. Nuk ka dyshim se xhamia me objektet përreth saj ka përbërë bërthamën e mëhallës ekzistuese, përkatësisht të vendbanimit të caktuar, porse është dashur që të kalojnë disa vite, që një xhami të bëhet e njohur sa për t'i dhënë pastaj emrin e saj edhe mëhallës apo vendbanimit, nëse përjashtojmë ndonjë rast të veçantë, i cili nuk mund të merret si rregull.

Për këtë arsye, ne mendojmë se viti 1571 është më i përafërt me vitin e saktë të ndërtimit të xhamisë së Katip Sinanit, por kjo e dhënë mund të na shërbejë vetëm për aq sa nuk gjendet vakëfnâmeja e kësaj xhamie dhe për aq sa nuk i njohim defterët osmanë të para vitit 1571.

*Xhamia e Sinan Katipit sot*

Kur jemi te mëhalla, duhet theksuar edhe faktin se vendi ku është ndërtuar xhamia, përveç si *"Mëhalla e Katip Sinanit"*, njihet edhe si *"Tumba"*, ngase atypari ka ekzistuar një tumul (varrezë) ilire, por edhe si *"Mëhalla e Levishës"*[5].

Kurse xhamia njihet me disa emra, si *"Xhamia e Katip Sinanit"*, *"Xhamia e Sinan Qatipit"*, *"Xhamia e Shkurtër-Vogël"*, për shkak se deri në vitin e renovimit të saj më 1893-94, - meqë ishte djegur disa herë, - kishte një minare të shkurtër.[6]

[5] Abib Ahmedi, *Theranda-Prizreni...,* po aty, f. 239. Salajdin Krasniqi, *Prizreni...*, po aty, f. 34.
[6] Raif Virmiça, *Kosova'da osmanli mimari eserleri*, Ankara 2007, f. 68.

## Mbishkrimi i renovimit të xhamisë

Tashmë u theksua se përveçse për vitin e ndërtimit të xhamisë së Katip Sinanit nuk kemi të dhëna as për ndërtuesin e saj. Titulli "*katip-qatip-jazici",* me të cilin njihej Sinani, tregon se ai do të ketë qenë shkrues a sekretar i qytetit, ose i ndonjë personaliteti të shquar të kohës. Sidoqoftë, deri sot, përveçse në*"Kronikën/Menâkibin"* e famshëm të Tahir ef. Prizrenit, - në të cilën ofrohen informacione të rëndësishme mbi jetën dhe veprat e shumë personaliteteve të shquara të Prizrenit dhe jo vetëm, e që janë dalluar në jetën fetare, arsimore, kulturore dhe politike gjatë një periudhe disa shekullore (shek. XV- deri në gjysmën e parë të shek. XIX)[7], - për Katip Sinanin dhe vitin e ndërtimit të xhamisë së tij, në dokumentet e hershme të botuara, nuk ka ndonjë të dhënë më tepër. Në *"Kronikën"* në fjalë, në katër vargje në gjuhën arabe, thuhet:

**مناقب جامع كاتب سنان**

كاتب سنان شخص يقولونه ايضا

بنا جامعا ايضا بشرق بلادنا

و حرب هذا عمرغير مرة

وقد خلق العامر عون الهنا

*Po ashtu edhe një person që i thoshin Sinan qatipi,*
*ka ngritur një xhami në lindje të qytetit tonë.*
*Kjo (xhami) është shkatërruar e rinovuar më se një herë,*
*rinovuesin e ka krijuar vërtet ndihma e Zotit tonë"*[8].

[7]Më gjerësisht për *"Menâkib"-in e Tahir Efendiut,* shih studimin e Dr. Nehat Krasniqit, i cili është i pari që e përktheu dhe i bëri një vështrim kësaj *"Kronike"*, në: Dr. Nehat Krasniqit *Kontribute Albanologjike (studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane*, Prishtinë 2001, f. 75-132.

[8] Dr. Nehat Krasniqit *Kontribute...*, po aty, f. 95 dhe 118.

Mirëpo, pavarësisht mungesës së informacioneve që kanë të bëjnë me vitin e ndërtimit dhe ndërtuesin e kësaj xhamie, një gjë është më se e sigurt: Xhamia e Sinan Katipit në vitin 1893/4 (1311 Hixhri) ka njohur një renovim dhe meremetim të theksuar. Këtë e dëshmon edhe mbishkrimi në gjuhën osmane që ruhet mbi derën e kësaj xhamie, e të cilin e ka shkruar poeti *"Hifzî"*-u.

Ky mbishkrim/kronogram është në gjuhën osmane me alfabet arab, i shkruar në vargje dhe poezi, i gdhendur në një pllakë mermeri, me llojin e shkrimit *t'alîk*, me përmasa 50x40 cm.

Dhe aty shkruan:

بانئ اول كاتب سنانه

اوله بشارت روح همامه

بانئ ثاني اهل حميت

اولدى موفق حد ختامه

دى حفظيا بر تاريخ زيبا

معبد فيض بو عالى مقامه

١٣١١

Transkriptimi:

*1. a) Bânî-i evvel Kâtib Sinân'a*
*b) Ola beşâret rûh-ı hümâma*
*2. a) Bânî-i sânî ehl-i hamiyyet*
*b) Oldi muvaffak hadd-i hitâma*
*3. a) De Hıfziyâ bir târîh-i zîbâ*
*b) Ma'bed-i feyz bu 'âlî makâma*
*1311*

Përkthimi:

*1. a) Ndërtuesit të parë, Katip Sinanit,*
*b. i qoftë myzhde shpirtit të tij të ndershëm.*
*2. a) Për të dytën herë banorët atdhedashës,*
*b) me sukses e rinovuan deri sa e përfunduan.*
*3. a) O Hifzi, thuaje një kronogram/târîh të bukur, për vitin e renovimit,*
*b) të kësaj faltore të begatë në këtë mekam të lartësuar*
*1893-94*



*Kronogrami/Târîh-i i renovimit të xhamisë së Sinan Katipit*

Të parët që e kanë lexuar, transkriptuar dhe botuar mbishkrimin e renovimit të xhamisë së Sinan Katipit janë autorët K. Özergin, H. Kaleshi dhe I. Eren, kur kanë bërë fjalë në një punim të gjatë për mbishkrimet islame në Prizren[9].

Me gjithë autoritetin shkencor të autorëve të sipërpërmendur dhe respektin për ta, i japim të drejtë vetes të themi se gjatë leximit të këtij

[9]Kemal Özergin-Hasan Kaleşi-Ismail Eren, *Prizren kitâbeleri*, në: "Vakıflar dergisi", sayı VII, Istanbul 1968, f. 93.

mbishkrimi, u janë përvjedhur disa lëshime, sado të vogla qofshin, të cilat konsistojnë në mos zgjatimin e zanoreve gjatë transkriptimit dhe në leximin jo të drejtë të fjalës *"ciddi hitâma"* në vend të*"haddi hitâma"*.

Versionin e lexuar nga këta autorë, më vonë e kanë transmetuar pa ndonjë vështrim kritik, me lëshimet e njëjta, edhe autorët e tjerë që kanë shkruar për këtë xhami, si R. Virmiça[10], M. Ibrahimgil-N. Konuk[11] etj. Mirëpo, në monografinë *"Kosova kitâbeleri/ Mbishkrimet në Kosovë",* të botuar në Stamboll më 2014[12], këto lëshime, pothuajse pas pesë dekadash, janë përmirësuar, por edhe këtu në tekstin me shkronja arabe, janë përvjedhur dy gabime dhe në vend të "حفظيا - Hifziyâ" ka dalë "خفظيا"- Ĥifziyâ", që ia humb kuptimin plotësisht, dhe në vend të "hümâma - همامه" ka dalë "hümâmâ - هماما", kurse përkthimi në gjuhën shqipe i mbishkrimit lë shumë për të d̄ëshiruar[13].

## Autori i kronogramit

Mirëpo, ajo që i bashkon të gjithë këta autorë është fakti se asnjëri prej tyre, çuditërisht, nuk ka marrë mundimin për t'iu përgjigjur pyetjes se kush është autori i këtij mbishkrimi, kush është ky poet që ka shkruar një kronogram kaq konciz e përshpirtërues, me një fjalë, kush është "*Hifzî"*-u? Dhe përsëri kush është ky autor, të cilit do t'i ketë rënë hise për të përjetësuar vitin e renovimit të xhamisë së Sinan Katipit dhe me se do ta ketë merituar këtë privilegj? Sikundër që nuk na kanë treguar edhe për poetët e tjerë autorët të mbishkrimeve të xha-

[10] Raif Virmiça, *Kosova'da...,* po aty, f. 70.

[11] Mehmet Z. Ibrahimgil-Neval Konuk, *Kosova'da osmanli mimari eserleri*, vëll. II, Ankara 2006, f. 685-686.

[12] Grup autorësh, *Kosova kitâbeleri*, editor: Yard. Doç. Dr. Mehmet Samsakçı, Istanbul 2014, f. 107.

[13] Autorët e kësaj monografie gjatë leximit të mbishkrimeve islame në Kosovë, nuk kanë qenë sa duhet të vëmendshëm, prandaj dhe shumë mbishkrime i kanë lexuar me gabime. Por meqë kjo çështje del përtej qëllimeve të këtij shkrimi, ato do t'i vështrojmë veçan në një rast tjetër.

mive të Prizrenit, si f.v. kush është *"Shejh Alî"*-u i mbishkrimit të xhamisë së Gazi Mehmet Pashës në Prizren, kush është *"Ragîb"*-i i mbishkrimit të xhamisë së Çohaxhi Mahmud efendiut, ose kush është *"Nurî"*-u i mbishkrimit të xhamisë së Mahmut Pashës në kalanë e Prizrenit (xhamia sot nuk ekziston) dhe i çezmës së Emin Pashës në Mamush etj. Këta poetë dhe autorë të këtyre mbishkrimeve është dashur që të përmenden, të identifikohen, të jepen të dhëna themelore për ta dhe të drejtohen në literaturë ose në lokalitet.

Sido që të jetë, këto dhe pyetje të ngjashme na kanë shtyrë që të hulumtojmë për të identifikuar dhe për të ndriçuar se kush është *"Hifzî"*-u i mbishkrimit të xhamisë së Sinan Katipit.

Duhet thënë se që në fillim të interesimeve tona kemi qenë të bindur se prapa pseudonimit *"Hifzî"*, sipas traditës së kohës, fshihet emri i ndonjë dijetari, poeti, myftiu a myderrizi të shquar. Kjo, sepse nderi për të shkruar një konogram/târîhpër ndonjë objekt të rëndësisë së veçantë, siç janë xhamitë, medresetë, teqetë, bibliotekat etj., në radhë të parë u ka takuar pikërisht personave që vinin nga këto profesione ose që ishin të shquar në këto profesione.

Kështu, mbi bazën e dhjetëra dokumenteve të ndryshme, të cilave do t'u referohemi më poshtë dhe të tjera, jemi të sigurt kur konstatojmë se autori i këtij mbishkrimi, nuk është askush tjetër, pos hafiz Abdylaziz ef. Ahmet Kurtishi, i biri i Zejnelabidinit, i njohur ndër dokumente dhe i popullarizuar ndër studentë, kolegë dhe ndër njerëz me emrin Hafiz Aziz efendi Prizreni.

*Hfz. (Abdyl) Azîz "Hifzî" efendi Prizreni*

Ja edhe arsyet përse konstatojmë se *"Hifzî"*-u është Aziz efendiu:

Koha kur është bërë renovimi dhe meremetimi i xhamisë së Sinan Katibit, është dekada e parë pas Lidhjes së Prizrenit dhe koha kur kryetari i saj, haxhi Ymer Prizreni, për shkak të veprimtarisë së tij politike në favor të çështjes kombëtare, u detyrua të shpërngulej nga Prizreni dhe të linte kështu detyrën e myderrizit të medresesë "Mehmet Pasha" dhe të myftiut të Prizrenit njëkohësisht. Haxhi Ymer efendiun do ta pasojnë në dy intervale të shkurtra i vëllai Ali efendiu dhe kolegu haxhi Memish efendiu, derisa në vitin 1889 kthehet nga studimet e mbaruara në Stamboll, Hfz. Aziz efendiu dhe emërohet myderriz në medresenë "Mehmet Pasha" me pagën ditore 25 akçe[14].

Që nga viti 1889 e deri kur vdiq më 1917, i vetmi intelektual i Prizrenit i pranishëm në të gjitha zhvillimet shoqërore, politike dhe arsimore, që nënshkruhej dhe e kishte të gdhendur në vulën/myhyrin e tij pseudonimin "Hifzî", është Hfz. Aziz efendiu.

[14] Başbakanlik Osmanli Arşivi (BOA), Mehmed Paşa Cami ve Medrese Vafkı EV.MKT.CHT. 00294.00260; VGM. 01838. 000159; VGM 00171.00011. Hulumtimet e këtyre dokumenteve janë kryer në: Vakıflar Genel Müdürlüğü (VGM) Ankara, në vitin 2013, prandaj dhe referimi i këtyre dokumenteve bëhet sipas shënimeve të këtij institucioni.

Dhe jo vetëm kaq, por kur i krahasojmë dorëshkrimet e shumta që ka lënë ky myderriz i shquar e që janë të mbushura me shënime të tij dhe ixhâzetnâmetë e lëshuara nga ai, ngjashmëria mes tyre dhe shkrimit të koronogramit të xhamisë së Sinan Katipit është lehtë e dallueshme[15].

Për të qenë edhe më të sigurt në konstatimin tonë, theksojmë edhe faktin se gjithkund që Aziz efendiu ka vënë firmën dhe vulën e tij, nuk ka harruar të theksojë edhe mahlasin/pseudonimin e tij poetik e shkencor *"Hifzî"*[16]. Po ashtu, duhet ritheksuar se për të shkruar një mbishkrim në një objekt kaq të rëndësishëm siç është xhamia, qoftë edhe me rastin e renovimit a meremetimit të saj, nderi në radhë të parë, sigurisht që do t'i ketë takuar myderrizit kryesor të medresesë dhe myftiut të qytetit, që me këtë rast ka qëlluar të ishte edhe *poet*, edhe *dijetar*, edhe *kaligrafist* edhe *epigrafist* dhe për më tepër i shquar dhe me dije të thella në këto fusha.



*Faksimile e një faqeje të një dorëshkrimi ku shihen firma, pseudonimi dhe vula e Aziz efendiut*

[15] Shih *Koleksionin e Dorëshkrimeve Islame të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës,* dorëshkrimet që kanë qenë pronë e Aziz efendiut, dhe sidomos dorëshkrimin me signaturën nr. 0144 DAM, Sig. nr. 0051 DAM dhe Sig. nr. 0199 DAM etj.

[16] Po aty.

*Faksimile e faqes së parë dhe të fundit të veprës "Sherh Risâle-i 'Adûdiyye", e kopjuar nga Abdylaziz " Hifzî" Prizreni në vitin 1302/1885 në Stamboll*[17]

## Jetëshkrimi i Hfz. Aziz "Hifzî" efendiut

Hafiz Aziz "Hifzî" efendiu u lind në Krushë të kazasë së Gorës më 1853[18]. Pasi mbaroi shkollën fillore në Prizren, studimet i ka vazhduar në Stamboll, dhe ka marrë mësim te dijetarët e shquar të kohës *Abdylmumin efendiu* nga Ohri dhe *hfz. Ibrahim Vehbiu nga Prishtina*, i cili për shkak të autoritetit njihej me titullin *"mevlânâ"*[19]*,* kurse diplomën/ixhâzetnâmenë e ka marrë më 1885 te dijetari i shquar *Ismail*

[17] *Koleksioni i Dorëshkrimeve Islame të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës,* dorëshkrimi me signanturën nr. 0199 DAM.

[18] *Hâfiz Abdül'azîz "Hıfzî" efendi ibn Ahmet Kûrtîş bin Zeynel'âbidîn el-Krûşeviy.* Shih ixhâzetnâmetë e lëshuara nga myderriz Aziz efendiu për studentët e tij: Haxhi Rexhep ef. Ismailin, lëshuar më 1322/1904, Haxhi Iljas ef. Shahsivarin e lëshuar më 1328/1910 dhe Hfz. Nysret ef. Galibin e lëshuar më 1335/1916-7, kopjet e të cilave gjenden në bibliotekën tonë; si dhe shih: Faik Miftari, *Hafizët e Prizrenit me rrethinë (1912-2012),* Prizren 2012, f. 19-20.

[19] Për këto të dhëna autobiografike, shih *Ixhâzetnâmetë...* e lëshuara nga myderriz Aziz efendiu për studentët e tij të përmendur në fusnotën nr. 18.

*Hakki Manastiri*[20]. Në vitin 1889 është emëruar myderriz dhe drejtor i medresesë "Mehmet Pasha" e myfti i Prizrenit.[21] Detyrën e myderrizit e ushtroi për afro tri dekada[22]. Ishte hafiz i shquar i Kuranit. Aziz efendiu ka poseduar një bibliotekë shumë të pasur me libra të botuar dhe dorëshkrime[23], të cilën pas vdekjes së Aziz efendiut, në mënyrë të ligjshme e ka trashëguar myderriz Abdullah ef. Telaku, e më pastaj ka kaluar në pronësi të Bibliotekës "Mehmet Pasha" në Prizren, kurse sot një pesë e saj ruhet në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës në Prishtinë. Nga ajo që ka mbetur dhe ka ardhur deri në ditët tona nga biblioteka e Aziz efendiut, lirisht mund të themi se ai ka qenë një bibliofil i madh dhe kopjues i shumë veprave në dorëshkrim, kurse disa të tjera janë të mbushura me shënime, shpjegime e komente në margjina të shkruara nga dora vetë e Aziz efendiut dhe mbajnë vulën e tij[24].

Hafiz Aziz efendiu ka vdekur në vitin 1917 në Prizren. Haxhi Ymer Lutfi Paçarizi, i cili e ka njohur shumë mirë dhe nga afër Aziz efendiun, me fjalë prekëse ka shkruar dy *kronograme* për vdekjen e tij, një në gjuhën arabe dhe një në gjuhën osmane, ku, përveç tjerash, Aziz efendiun e cilëson me epitete të zgjedhura, si*"Hoxha ynë, nderi i ulemave të vendit tonë, dijetar i thellë i shkencave islame, unik në kohën e tij* etj.*"*[25] dhe tregon se Aziz efendiu ka qenë *"edhe myfti edhe myde-*

[20] *Ismail Hakki ef. Manastiri (1846-1912).* Dijetar i shquar, profesor universitar, publicist, autor i shumë veprave. U lind në vitin 1846, në Manastir, prandaj edhe u bë i njohur sipas vendlindjes. Botoi shumë shkrime në gazetën "*Sirât-i müstakîm*" të cilën e drejtonte, si dhe gazetën "*Sebîl'ur-reşâd*" me kryeredaktor Mehmet Akif Pejanin. Ishte autor i dhjetëra veprave nga fusha e shkencave islame. Vdiq më 22 nëntor 1912 dhe u varros në oborrin e xhamisë së Fatihut në Stamboll. Süleyman Baki, *Manastırlı Ismāil Hakkı ve Telhīsu'l-Kelām Eseri*, Logos-A, Shkup, 2006.

[21] Başbakanlik Osmanli Arşivi (BOA),*Mehmed Paşa Cami ve Medrese Vafkı EV.MKT.CHT. 00294.00260; VGM. 01838. 000159; VGM 00171.00011.*

[22] 'Ömer Lütfî Pâçârîzî, *Tevârîh*, (dorëshkrim), Arkivi i Kosovës-Prishtinë, f. 110.

[23] Këtë bibliotekë të myderrizit të tij, në mënyrë të ligjshme e ka trashëguar myderriz Abdullah ef. Telaku, e më pastaj po në mënyrë të ligjshme ka kaluar në pronësi të Bibliotekës "Mehmet Pasha" në Prizren, kurse sot një pesë e saj ruhet në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës në Prishtinë.

[24] Shih:*Koleksionin e Dorëshkrimeve Islame të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës,* dorëshkrimet që kanë qenë pronë e Aziz efendiut.

[25] Ömer Lütfî Pâçârîzî, *Tevârîh*, (dorëshkrim), Arkivi i Kosovës-Prishtinë, f. 109-112.

*rriz në medresenë "Mehmet Pasha" në Prizren për 27 vjet dhe tek ai kanë marrë ixhâzet tri gjenerata studentësh"*[26], nga të gjitha trojet e Shqipërisë Verilindore.[27] Shumica e studentëve të tij më pastaj kanë ushtruar detyrën e myderrizit në medrese të ndryshme dhe janë dalluar në veprimtari të tjera arsimore dhe kombëtare, si p.sh. *hfz. Rrystem ef. Shporta*[28]*, hfz. Nysret ef. Galipi*[29]*, haxhi Iljas ef. Shahsivari*[30]*, haxhi Rexhep ef. Ismaili*[31]*, hfz. Abdullah ef. Telaku*[32]*,* etj..

[26] 'Ömer Lütfî Pâçârîzî, *Tevârîh...*, po aty, f. 109-112.

[27] Disa prej studentëve që kanë marrë ixhâzetin tek Hfz. Aziz efendiu i përmend studiuesi turk Sadik Albajrak kur flet për ta. (Shih: Sadik Albayrak, *Son Devir Osmanlı Uleması*, vëll. 1-5, Istanbul 1996.) Mirëpo duhet thënë se ky studiues, kur trajton ulematë osmanë të periudhës së fundit, nuk ofron asnjë të dhënë për myderriz Hfz. Aziz efendiun, as edhe për shumë ulema të tjerë shqiptarë shumë të shquar që kanë vepruar në këtë periudhë. Nuk duam të besojmë se në një vepër kaq vëllimore ky autor serioz të ketë anashkaluar qëllimshëm ulemanë shqiptare që nuk ishin në të njëjtën vijë me politikën zyrtare osmane, për faktin se ata ishin prijës ose përkrahës dhe aktivistë të kauzës së tyre kombëtare.

[28] *Hfz. Rrystem ef. Shporta (1864-1937).* Myderriz, shkencëtar, myfti, veprimtar dhe i burgosur politik. Ka lindur në Prizren, ku edhe e zhvilloi veprimtarinë e tij. Në vitin 1924 u burgos dhe u dënua nga pushteti serb me 20 vjet heqje lirie. Dënimin e ka vuajtur në burgun e Prizrenit, Shkupit, Nishit dhe Zenicës. Ka qenë mik, përkrahës dhe jatak i Hasan Prishtinës. Ka shkruar tetë vepra autoriale në dorëshkrim. (Shih: Resul Rexhepi-Sadik Mehmeti, *Haxhi Rrystem ef. Shporta-Jeta dhe vepra (1864-1937)*, Monografi, Prishtinë 2010.

[29] *Hfz.Nysret ef. Galipi (Doda)* (1878-1941). Myderriz në medresenë "Mehmet Pasha" dhe myfti i Prizrenit. (Më gjerësisht: Dr. Feti Mehdiu, *Hafizët tanë gjatë historisë - shek. XVIII-2010*, Prishtinë 2010, f. 95).

[30] *Haxhi Iljas ef. Shahsivari* (1886-1959), ishte myderrizi kryesor i medresesë së "Sulltan Selimit" në Prishtinë deri sa kjo medrese u mbyll më 1948. (Shih: *Ixhâzetnâmenë e Haxhi Iljas ef. Shasivarit*, një kopje e së cilës gjendet në bibliotekën tonë personale). Haxhi Iljas efendiu ka qenë veprimtar i shquar i çështjes kombëtare dhe kundër shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga trojet e veta. Ka qenë përkrahës dhe ithtar i ideve dhe pikëpamjeve të Ferat bej Dragës.

[31] *Haxhi Rexhep ef. Ismaili (1871-1956),* lindi në Bresanë të Opojës, ku edhe shërbeu si myderriz në medresenë e Opojës për afro katër dekada. (Më gjerësisht: Sadik Mehmeti, *Kontribute për historinë e Opojës*, Prishtinë, 2015).

[32] *Hafiz Abdullah ef. Hizri* (1896-1943). Myderriz në medresenë "Mehmet Pasha", myfti i Prizrenit dhe veprimtarë politik. Ka qenë bashkëpunëtor dhe mendimtar i Ferat bej Dragës. Abdullah ef. ka lënë një bibliotekë shumë të pasur me libra dhe dorëshkrime në gjuhët islame-orientale, të cilat ia ka dhuruar bibliotekës "Gazi Mehmet Pasha" në Prizren. Ka qenë një kopjues i shkathët i dorëshkrimeve islame dhe një artist i vërtetë i kaligrafisë arabe. (Shih: Resul Rexhepi-Sadik Mehmeti, *Myderrizi i medresesë "Mehmet Pasha" të Prizrenit-Hfz. Abdullah ef. Telaku-Hizri*, në: "Takvimi/Kalendari", Prishtinë 2011, f. 189-220.)



لذی عظم امرتك الخير لكن ما امرت به وما استقمت
فما قولى لك استقم جعلنى الله وايّاك من العلماء
العاملين وحشرنا فى زمرة عباده الصالحين
ربّنا لا تزغ قلوبنا بعد اذ هديتنا وهب لنا من لدنك
رحمة انّك انت الوهّاب ربّنا اغفر لنا ولوالدينا
ولاساتذنا وشركائنا ولمن وصّينا بالدعاء الخير
والمؤمنين والمؤمنات يوم يقوم الحساب لا اله
الا الله محمد رسول الله آخر كلماتنا ان شاء الله
لا حول ولا قوة الا بالله والحمد لله تعالى دائما
وعلى انبيائه تحية وسلاما
تمت
وانا العبد الى الله عثمان بن احمد بن اسماعيل
الشهير بسراج الدين الاوشي
عفى الله عنه ووالديه ولمشايخه
ولجميع المسلمين آمين
١٢٧٨



بسم الله الرحمن الرحيم
الحمد لله الذى علّمنا ما لم نعلم واسعدنا بتعليم العلوم والحكم
والصلوة والسلام على محمد المرشد للانام وعلى آله واصحابه
العالمين بشريعة النبى المحترم فاعلم وفقك الله وايّانا
لطاعته ان السبب لنيل الكرامات العلية والمقامات
السنية والمراتب البهية والسعادات الابدية هو العلم
الشريف حيث قال عليه السلام من سلك
طريقا يلتمس فيه علما سهّل الله له طريقا الى الجنة
وان الملائكة لتضع اجنحتها لطالب العلم رضاء بما يصنع
وان العالم يستغفر له من فى السموات ومن فى الارض
حتى الحيتان فى الماء وان فضل العالم على العابد
كفضل القمر ليلة البدر على سائر الكواكب وان
الزاهد العابد بلا علم كقوس بلا وتر وان العلماء
ورثة الانبياء وقال عليه الصلوة والسلام
من تفقّه فى دين الله تعالى كفاه الله تعالى فى
دينه ودنياه وقال الله تعالى وانزل الله عليك الكتاب
والحكمة وعلّمك ما لم تكن تعلم وكان فضل الله
عليك
عليك عظيما وقال الله تعالى ولقد آتينا داود وسليمان
علما وقالا الحمد لله الذى فضّلنا على كثير من عباده
المؤمنين وقال الله تعالى يرفع الله الذين آمنوا منكم
والذين اوتوا العلم درجات وقال الله تعالى هل يستوى
الذين يعلمون والذين لا يعلمون وان شرف هذه
الامة خصوصيتها باسناد الدراية والرواية جيلا
بعد جيل كليات دينها وجزئيات مرويّاتها ولولا
الاسناد لقال من شاء فى دين الله ما شاء قال
الامام احمد بن حنبل رحمه الله سبحانه وتعالى الاسناد
بشيوخهم فاذا ذهبت الشيوخ فمع من العيشر
نقله عند البخارى وقال الامام سفيان الثورى
رحمه الله تعالى الاسناد سلاح المؤمن واذا
لم يكن له سلاح فبأى شئ يقاتل وافاويل التسلف
فى شرف الاسناد والاخذ عن المشايخ كثير وحرصهم
على تحصيله عزيز وبعد فيقول الفقير الى الله سبحانه
عبد العزيز الحنفى بن احمد دوريش بن زين
العابدين فذ ساقنى اللطف الالهى والجود

*Faksimile e fillimit dhe fundit të ixhâzetnâmesë sëhaxhi Iljas ef. Shahsivarit*

Hfz. Aziz efendiu është shquar edhe për aktivitetin e tij kombëtar në krahë të elitës intelektuale dhe atdhetarëve të njohur si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini etj. Ka qenë njëri ndër hartuesit dhe nënshkruesit e *Deklaratës* që i parapriu kryengritjeve të shqiptarëve (1911-1912) kundër politikave dhe reformave diskriminuese osmane në dëm të shqiptarëve dhe trojeve të tyre. Në këtë *Deklaratë,* të nënshkruar nga paria e Kosovës, siç ishin Musa Prizreni, Ebu Bekir Prishtina, Zejnullah Vuçitërna, Ahmet Hamdi Myrteza Gjakova, Jahja Prizreni, Bajram Curri, Hasan Prishtina, Riza Gjakova, Sami Prishtina, Muharrem Vuçitërna, Ramazan dhe Rifat Vuçitërna, Ahmet Adem Prishtina, Isa Boletini, Shani Prizreni, Aziz Prizreni etj., ishin renditur kërkesat dhe ankesat e shqiptarëve drejtuar Portës së Lartë[33].

Hfz. Aziz efendiu ka qenë i martuar me Emine hanëmin dhe ka lënë vajzat, Salihan dhe Fadilen, dhe djemtë Maxhidin e Azizin. Këta të fundit, së bashku me nënën e tyre Eminen, në vitin 1957, për shkak të represionit dhe dhunës sistematike të ushtruar mbi ta nga sistemi i kohës, u shpërngulën për në Turqi[34].

## Si përfundim

Nga sa u tha më sipër, mund të përfundojmë se në periudhën osmane, - sipas shembullit arab, - ka qenë traditë që me rastin e ndërtimit a të renovimit të një objekti sakral dhe profan, të gdhendej edhe pllaka me mbishkrimin dhe të vendosej në një vend të dukshëm, rëndom në hyrje të objektit.

Këto dokumente epigrafike, të cilat kanë mbetur fare pak nga ai numër i madh që ka ekzistuar dikur në Kosovë, akoma nuk janë sistemuar

[33] Syrja Bej Vlora, *Shqipëria pasosmane (1912-1920),* përktheu nga turqishtja: Rubin Hoxha, "Logos-A", Shkup 2015, f. 107-108 dhe 391-393.
[34] Faik Miftari, *Hafizët e Prizrenit...,* po aty, f. 20.

si duhet. Puna e bërë në këtë drejtim ka qenë e pjesshme, ashtu siç ka mundur dhe ka dëshiruar secili që është marrë me to.

Një studim sistematik dhe i përgjithshëm i tyre, qoftë individual a institucional, kujtojmë, do të ishte një kontribut shumë i vlefshëm për kulturën dhe historinë tonë. Sepse, këto mbishkrime shpeshherë shërbejnë si burim i vetëm për njohjen e institucioneve dhe ndërtuesve të tyre si dhe të autorëve të mbishkrimeve të tyre. Mbishkrimet, pra, na japin të dhëna plotësuese që konfirmojnë të dhënat e burimeve të tjera dhe kështu na mundësojnë që shumë data, emra njerëzish a objektesh etj., t'i lidhim me persona ose ngjarje të ndryshme të historisë sonë dhe të nxjerrim përfundime me interes historik, siç është rasti me mbishkrimit e xhamisë së Sinan Katipit në Prizren dhe autorin e tij, hafiz Aziz "Hifzî" efendiun.

## SUMMARY

Among numerous mosques of Prizren, there is Katib Sinan mosque, named after its constructor. Exact date of its construction is not determined as the plaque of its construction is not preserved.

But what is known and determined is that restoration of this mosque took place in 1311 Hijri (1893/4). This is also confirmed by Chronogram/Târîh available in ottoman language that is preserved on the gate of the mosque. The chronogram was written by poet “Hifzî”.

My paper aims to shed light on the life and works of the autor.


**Key words:** Chronogram/Târîh, Katib Sinan Mosque, Prizren, author Abdylaziz “Hifzî” effendi

Mr. Rexhep SUMA

# KONTRIBUTI I ULEMAVE PËR PENGIMIN E MIGRIMIT TË SHQIPTARËVE

**Abstrakt:**

Ky punim shkencor ka për synim që të ndriçojë dhe të nxjerrë në pah rolin dhe kontributin e ulemave e të institucioneve islame për pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve nga trojet stërgjyshore dhe për ruajtjen e ekzistencës kombëtare e ngritjes së vetëdijes politike dhe fetare.

Shqiptarët gjatë historisë janë ballafaquar me situata tejet të rënda, e sidomos kur kemi të bëjmë me projektet sllave për dëbimin e tyre me dhunë nga trojet tona etnike drejt vendeve të tjera. Të shtyrë nga ndjenja dhe mësimet fetare, që çmojnë dhe vlerësojnë vatanin, shumë ulema shqiptarë vazhdimisht në ligjërata, predikimet e tyre, vaze, takime dhe komunikimet me xhemat e popull, kanë shprehur qëndrimin që të jetohet në këto toka dhe assesi mos të braktiset vendi. Qëndrimi i tyre ishte që të ruhen atdheu dhe feja.

Ulematë, në mënyrë të hapur, iu kundërvunë zbatimit të planit famëkeq "Naçertanie" të Ilija Garashaninit, të vitit 1844, i cili parashihte spastrimin e trojeve shqiptare. Në atë kohë një frymë revolucionare nisi nga Ferat Draga, në krahun e të cilit ishin paria e atëhershme kombëtare e fetare shqiptare, si: Mulla Idriz Gjilani, Shaban Efendiu, Rexhep ef. Abdullau, Bedri ef. Hamidi, Kadri Saliu, Azem Hoxha, Idriz Cërcëri, Akshi Sulejmani, Mulla Lutfi Ahmeti, Zenel Ibrahim

Strazimiri etj. Sa për ilustrim, parulla kryesore e Mulla Hamidit të Dobërçanit kundër shpërnguljes ishte*:*

***"Kush shkon në Turqi dhe e len vendin e tij, është pa iman"***

***"Ai që e lëshon vatanin është shkja*** *(i pa fe)".*

Më 1931 Mbretëria Jugosllave shpall ligjin mbi kolonizimin e krahinave jugore, kurse më 1937 "Klubi Kulturor Serb i Beogradit vendos një projekt për shpërnguljen e detyruar të shqiptarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë drejt Turqisë dhe Shqipërisë." Konform këtij projekti, qeveria jugosllave, më 29-30 shtator të vitit 1938, nënshkruan një marrëveshje me qeverinë turke, që njihet si "Marrëveshja turko-jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi.". Duhet theksuar se këto politika antishqiptare ishin projekte të Vasa Çubrilloviçit më 1936, ndërsa po të njëjtin diskurs tre vjet më vonë e ndoqi Ivo Andriçi. Përderisa autoritetet e Beogradit bënin plane të fshehta për depërtimin e dhunshëm të shqiptarëve, ndodhi e kundërta, ngase roli i hoxhallarëve ishte tepër efektiv në bindjen e familjeve që të mos lënë vatanin dhe që në vitet 1938-1941 shpërnguljet ranë në minimum.

Fjalë kyçe: *shpërngulje, ulema, komjet, racë e pathyeshme, depërtim.*

## Ulematë shqiptarë, kala e parë e pamposhtur në Kosovë Planet mafioze të Patrikanës së Stambollit

Shtimi i dhunës në masë të madhe dhe represioni nga pushteti serbo-sllav ndaj popullatës së pafajshme shqiptare myslimane në përgjithësi, prodhuan dhe nxitën shpërnguljen e detyrueshme të popullsisë së Kosovës dhe më gjerë drejt Turqisë. Për pasojë kjo shpërngulje e detyruar ndikoi në dizajnimin e strukturës së popullsisë në baza nacionale e fetare, ku u zvogëlua dukshëm numri i shqiptarëve myslimanë dhe u rrit dukshëm numri i popullatës së krishtere (serbe), e cila u vendos në vendbanimet dhe pronën e uzurpuar nga ana e kolonëve serbë dhe malazez.

Pushteti përdori çfarëdo lloj mjeti për t'i diskreditуar, nënçmuar ulematë dhe joshur me para, poste, privilegje të ndryshme, ose edhe kërcënimeve që të përkrahnin procesin e shpërnguljes me dhunë.

Ulema Mexhlisi i Shkupit në Mbretërinë e Serbo-kroato-sllovene, që përfshinte tërë viset shqiptare nën Jugosllavi, pati një rol të rëndësishëm kundër shpërnguljes si dhe në organizimin e popullsisë myslimane. Nisur nga ky fakt, pushteti i atëhershëm jugosllav, te kjo organizatë, shihte një mjet të fuqishëm për realizimin e planeve të veta të errëta, siç ishin: asimilimi i popullsisë myslimane veçanërisht të asaj shqiptare e turke; dëbimi i dhunshëm i kësaj popullsie për në Turqi dhe kolonizimi i këtyre viseve me kolona sllave.[1]

Në shtator të vitit 1924 Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, me udhëzimet e Hoxhë Kadriut, dërgoi në Gjenevë një delegacion që të protestonte pranë Lidhjes së Kombeve kundër barbarizmave të qarqeve shoviniste serbe në Kosovë. Delegacionin e përbënin Hasan Prishtina, Bajram Curri dhe Bedri Pejani, të cilët e paraqitën protestën.

Në të, përveç tjerash, thuhej:"*... ky regjim hekuri, zjarri e grabitjeje përbën shkakun kryesor të një emigrimi në masë të popullsisë shqiptare drejt Turqisë, emigrim ky që bëhet në kushte të tmerrshme e që kushton jetën qindra familjeve dhe pjesa tjetër, që mbeten, dënohen me një mjerim të pashërueshëm... mjafton me dijtë se për mijëra krime të bëra në mes të ditës asnjë nuk është ndjek nga gjyqet... është vendi i vetëm në botë, ku mund të vriten njerëzit në prani të gjyqtarëve që heshtin*.[2]

Gjatë vitit 1950 të shekullit të kaluar në Kosovë vepruan disa misionarë politikë të kamufluar që synonin pastrimin etnik të popullit shqi-

[1] Dr. Shinazi Memedi, Kontributi i ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare,- Kontributi i Ulema-Mexhlisit të Shkupit në shpërnguljen e popullatës muslimane në Turqi (1930-1941), simpozium shkencor organizuar nga BFI e Maqedonisë, 17 nëntor 2012, Shkup.f.80.

[2] Mr. Qemajl Morina, "Kontributi i prijësve mysliman në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtarë-Kontributi i hoxhë Kadri Prishtinës në mbrojtje të tërësisë së tokave shqiptare", KMSH, BIK dhe BFIM, Tiranë, 28-29, shtator 2012 f.198.

ptar të besimit islam, sidomos në Kosovë, duke përgatitur opinionin e gjerë që të gjithë të shpërnguleshin për në Anadoll (Turqi). Për këtë qëllim, nga fillimi i vitit 1950, me nismën e Patrikanës së Stambollit dhe Patrikanës Serbe, do të merrej një aksion i përqendruar në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Jugosllavisë. Ky aksion udhëhiqej nga krimineli i njohur Aleksandar Rankoviç dhe parashihte dërgimin në Kosovë të një misioni të cilin e përbënin Moma Markoviçi, Mita Milkoviçi dhe Dushan Mugosha, me synim për krijimin e një "dege" të kombit shqiptar, vetëm në baza fetare, "degë" që gjatë regjistrimit do të prononcohej për popullsi turke. Plani jugosllav ishte përgatitur nga MPB, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ushtria, për t'ua bërë shqiptarëve jetën sa më të vështirë dhe pa rrugëdalje. Vështirësitë nisnin që nga kushtet e shkollimit serbisht deri te detyrimi i kazanit të përbashkët në ushtri. Në këtë mënyrë shumica e të rinjve shqiptarë do të gjendej në pozitë shumë delikate shoqërore dhe kulturore-civilizuese.[3]

Që të realizohej plani sekret i spastrimit të Kosovës, fronti jugosllav ndërmori aksionin e ekstradimit të disa intelektualëve shqiptarë, duke burgosur shumë mësues e myderrizë (si Mulla Nuredin Xhinovci, dhëndër i Ramë Bllacës që vdiq në burgun e Nishit më 1953). Rrezikun më të madh për pushtetit e përbënin ulematë shqiptarë që atëherë vazhdimisht i bënin thirrje popullit të mos shpërngulej. Për këtë arsye ishte bërë plani që "ulematë" të kompretoheshin në fillim, jo të gjithë, por vetëm ata që ishin në shërbim.

Bazuar në dokumentin sekret nr.03/51 rrjetit të agjentëve të UDBsë i qe dhënë udhëzimi që imamët të quheshin "dërzhavni imami" (imam shtetërorë) që populli të krijonte version ndaj tyre ngase gjoja "ata po i emëron dërzhava"-shteti, prandaj po punojnë për të. Në këtë

[3] Prof dr. Hakif Bajrami, Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956, Kryesia e BIK në Prishtinë, revista Dituria Islame, nr.85, viti 12, tetor-nëntor, 1996. Prishtinë, f.24.

grackë kishin rënë edhe shumë intelektualë të mirëfilltë, sepse me ndonjë "dërzhavni imam" identifikonin të gjithë ulematë.

Prej të gjithë ulemave, si ideologu më i rrezikshëm, që me mësimet e tij nuk lejonte që shqiptarët të shpërnguleshin në Anadoll, ishte cilësuar Hasan Nahi (Hoxhë Xhehnemi), që për likuidimin e tij ishte angazhuar krimineli Voja Vojvodiç, që punonte në Pejë, por që agjentët e vet i kishte kudo. Po mençuria e Hasan Nahit do të triumfojë.[4]

## Për fe e atdhe meriton të sakrifikohet çdo gjë

Përveç kësaj, shumë imamë u kërcënuan me burg e likuidim me familje nëse nuk do të pranonin të shpërnguleshin, sikur është rasti i Mulla Tahir Thaçit, i cili, përveç ndjenjave të pastra fetare, kishte ndjenja të zjarrta atdhetare. Në dokumentet sekrete të Beogradit, të publikuara nga historiani dr. Hakif Bajrami, rreth shpërnguljes së shqiptarëve, emri i Mulla Tahirit është shënuar dy herë. Aty shkruante: "Dy herë i janë kërcënuar që të shpërngulej për në Turqi. Nëse nuk shpërngulej, do ta burgosnin me familje në Nish..."!

Gjatë viteve 1950-1960, Mulla Tahirin e burgosën dy herë dhe në burg kishte vuajtur shumë, por ai nuk fliste kurrë, më shumë fliste trupi i tij i dërrmuar, i shkretë, se ai vetë! Edhe mbas vuajtjes së burgut, Mulla Tahiri jetoi në Gjakovë në skamje, po nuk e lëshoi Kosovën, derisa i mbylli sytë, më 1984, në moshën 86-vjeçare.[5]

*Për fe e atdhe ishte thënë në një mevlud në Llap më 1953-meriton të sakrifikohet çdo gjë. Ai që ua kthen shpinën varreve të stërgjyshave, ai ka tradhtuar kombin, ai e fyen Zotin e madhërishëm.*

[4] Prof dr. HakifBajrami, Planet secrete përlikuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956, Ibid. f.26.

[5] Mexhid Yvejsi "Mulla Tahir ef. Thaçi", revista "Dituria Islame", nr.291, viti 28, BIRK, 2014, Prishtinë. f.53.

Prijësit fetarë fatin e tyre e kishin të lidhur shumë ngushtë me fatin e popullit dhe për këtë gëzonin mbështetje dhe respekt të madh në mesin e popullatës. Këtë respekt nga popullata e kishin fituar me vepra e me këshilla. Janë të njohura fjalët e Mulla Hajriz Bllacës së Dyzit, në xhaminë e Dumnicës, ku ishin më se 10 mijë veta, publikisht pati deklaruar: "*Ai që lëshon vendin e vet, ai është short që mbetet pa iman. Zoti ka thënë: respektoni Allahun dhe Pejgamberin, mos u përçani mes vete e të dobësoheni e të humbni fuqinë (El enfalë,46). Vllazëni kjo tokë është tokë e mirë, atje ku po na detyrojnë me shkue, ajo tokë nuk është e jona, ajo tokë pasha kit Kuran, neve nuk na sjell bereqet, neve atje mizat kanë me na u farue e lene ma uria dhe skamja. Këtu në Kosovë, qite farën si t'duesh dhe kur t'duesh, marë del, se kjo tokë e din gjuhën tonë*"

Ulematë edhe në rajonin e Drenicës gjithnjë e më tepër po e dëshmonin veten si atdhetarë të denjë, sepse nuk ishin pajtuar të mbanin derse nëpër xhami për "jetën pa brenga në Turqi" si i kishin porositur misionarët e panjohur, që shtireshin si "njerëz që jetojnë dhe flenë me Kuran në dorë".

## Jemi përgjegjës për varret e prindërve tanë para Zotit dhe para kombit

Shëmbëlltyrë e historisë sonë kombëtare e fetare - Mulla Idriz Gjilani (1901-1949) ishte atdhetar konsekuent, orator, mjeshtër i penës, besnik i fjalës, mësues fetar dhe mualim, ideolog dhe luftëtar i lirisë. Ai pandërprerë propagandonte kundër shpërnguljes së shqiptarëve dhe thoshte ***"pa nji atdhe të lirë feja nuk mbahet, nuk mund t'ushtrohet".***

Ai ishte krah i djathtë i Ferat Dragës për Anamoravën. Kontributi i tij për pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare të cilat i zbatonte qeveria jugosllave ishte i madh dhe me efekt kombëtar. Shkonte prej njërit katund në tjetrin, prej një me-

xhlisi në tjetrin, prej një xhamie në tjetrën, edhe në raste të vdekjes popullit ia vinte në spikamë rrezikun e thërriste: *"Jemi përgjegjës për varret e prindërve tanë para Zotit dhe para kombit. Nuk guxojmë të heqim dorë prej tyre, t'i lëmë të shkreta për t'i lëvruar derrat e naçalnikëve sllavë!. Jo vetëm në Turqi, por as në Shqipëri nuk bën të shkojmë. Zoti në Kur'an na ka bërë përgjegjës për vatanin dhe kombin"*[6].

Më 1949 Mulla Idrizin e djegin në zjarr për të mbetur shembull te pasardhësit si luftëtar dhe për të vdekur si fetar atdhetar dhe patriot.[7]

Roli i Ataullah efendi Kurtishit, në pengimin e shpërnguljes së popullsisë shqiptare ishte shumë i madh, sidomos në viset e Shkupit, Kumanovës e të Preshevës. Ai, gjatë fushatës së tij kundër shpërnguljes, e demaskoi projektin sllav për pastrimin e myslimanëve nga trojet tona etnike, i sqaroi dëmet dhe pasojat e emigrimit, qëllimin e vërtetë të kësaj çmendurie serbe, me qëllim që t'i largojë myslimanët e posaçërisht shqiptarët nga këto troje dhe t'i instalojë diku larg në Anadoll, ku do të shërbejnë si tampon zonë ndërmjet turqve në njërën anë dhe armenëve dhe kurdëve në anën tjetër.[8]

Mulla Adem Emërllahu (1850-1921) nga Prapashtica ishte njëri ndër veprimtarët e theksuar në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, sidomos në kryengritjen e vitit 1910 ishte krahu i djathtë i Idriz Seferit me Mulla Sinan Maxheren e Karadakut (Preshevë), i cili dënohet me varje nga xhonturqit në Kaçanik më 1910 (Ahmeti, 2011).

Ai veprimtarinë e vet do ta vazhdonte edhe pas pushtimit të Kosovës nga Serbia më 1912. Ndonëse familja e tij ishte gjithnjë nën trysninë e pushtuesve, kjo nuk e lëkundi në bindjet e tij. Ai, edhe pse u lut nga të afërmit e tij që ta lëshonte vendin dhe të shkonte diku në brigjet

[6] Dr. Muhamet Pirraku, Shëmbëlltyrë e historisë sonë kombëtare-mulla Idriz Gjilani (1901-1949), Dituria Islame, nr.47, Prishtinë, viti 8, mars 1993, f.29-30.
[7] Dr. Fahrush Rexhepi, Periodiku shqiptar islam, gjysma e parë e shekullit XX, Dituria Islame, Prishtinë 2013, f.114.
[8] Mr. Taxhudin Bislimi, Medreseja e Ataullah Efendiut dhe nxënësit e saj, Shkup, 2011, f. 80.

e Anadollit ku do të tretej përgjithmonë, sikurse bëri djali i tij Halimi, pati vendosmëri të patundur për të mos e lëshuar vendlindjen. Ky fakt është tregues i qartë që flet për personalitetin e këtij njeriu, sepse sikur të merrte një hap të tillë dhe të shpërngulej prej vendit, sigurisht se me të do të shkonte edhe një pjesë e madhe e popullatës së asaj ane, e që natyrisht një gjë e tillë do t'iu konvenonte pushtuesve të asaj kohe.

Aktivitetin nuk e ndërpreu deri në fund jetës, kur më 10 janar 1921, ushtarët dhe xhandarët serbë e vranë në prag të shtëpisë, bashkë me nëntë anëtarë të familjes.[9]

Me detyrimin e këtyre ulemave ishte planifikuar që të tundej tërë popullata shqiptare e rajonit të Ferizajt dhe Kaçanikut për Anadoll, për t'u realizuar marrëveshja famëkeqe xhentëlmene Tito- Kyprili, e vitit 1953, e përpiluar në Split si atentat kundër të gjithë myslimanëve të Jugosllavisë dhe sidomos kundër shqiptarëve.[10]

Të gjithë këta ulema që ishin në listën e pushtetit serb për likuidim, ishin njerëz me autoritet të lartë dhe ishte paraparë që gjatë vitit 1954 të detyroheshin me familjen e tyre të shpërnguleshin në Anadoll, në Vilajetin Mysh për të çelë rrugë masive të popullit shqiptar tek i cili kishin ndikim. Ndaj këtyre ulemave ishte paraparë të bëheshin provokime të ndryshme, duke filluar me diskreditimin moral e deri te kërcënimi dhe rrahjet para anëtarëve të familjeve, ose para xhematit në xhami, siç shprehet prof. Hakif Bajrami.

[9] Ahmeti, N.(2011), Krerët fetarë në lëvizjen kombëtare shqiptare në vilajetin e Kosovës (1878-1912), Instituti Albanologjikë, Prishtinë, p.137

[10] Prof dr. Hakif Bajrami, Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956 (2), Dituria Islame nr. 87,1997.

## Muhamedi a.s. nuk preferon arratisjen prej vendlindjes

Xhelatëve të UDB-së, myderriz Mulla Rashit Prugovci (Prishtinë) iu kishte thënë: *Mua nuk ka para që më blen dhe nuk ka çmim që më shet. Nderi i fesë sime, i të Madhit Zot që më ka falë asht ma i madh se çdo pasuni. Unë Turkinë e kam në respekt, por komjeti jem është shqiptarë. Islamizmi nuk ka atdhe. Ku është Zoti, aty është edhe emni i madhit Muhamed i cili nuk preferon arratisjen prej vendlindjes.*[11]

Ligjëratat dhe vaizet e hoxhallarëve nëpër xhami këshillonin xhematin që të mos e lëshonin trojet e veta. Porositë e tyre e forconin dinjitetin e popullit në çdo lëmë.

Ulematë nuk donin ta flisnin "gjuhën e okupatorit", siç kishte thënë Mulla Shaban Arifi,- nuk e kam në zemër kurrë. *Unë e di se çka i kanë ba këta hoxhë Brezhnicës, por Zoti asht i madh, atij i kofshim falë dhe këtu me dy lug nuk ka.*

Por edhe ata ulema që me dhunë detyroheshin të shpërngulen prej Kosove në Turqi, vazhdonin të mbanin qëndrimin e palëkundur se pjesa tjetër e kombit me asnjë kusht nuk duhet t'i lëshojë vatrat e stërgjyshërve. Kërkesën e tyre, ulematë e shpërngulur e përsëritën me këdo që e takonin", thuhet në një analizë të Tanjugut të marrë nga Konsullata Jugosllave në Stamboll.

Shumica e ulemave ishte keqtrajtuar në çdo mënyrë, por asnjëri nuk kishte thënë për askënd që "duhet të ndiqet ". Është fenomen, thuhet në një raport të PKJ-së, se si këta njerëz të shkolluar në një sistem të vjetër në asnjë moment nuk janë labilë. Në karakterin e tyre, thuhet aty, më tepër ka ndikuar rrethi kombëtar dhe që të mbesin të pathyeshëm ka ndikuar shkollimi e mësimi kuranor dhe bindja absolute e tyre në fatin e njeriut. Është në interes të shtetit, thuhet aty, që sa më parë këtë racë të pathyeshme ta përzëmë jashtë kufijve, sepse në të ardhmen

[11] Prof dr. Hakif Bajrami, Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956 (2), Ibid f.30.

këta do të ndikojnë në rininë e re, e cila kur të armatoset me dituri evropiane, (plus) fanatizmi oriental, do të bëhej një NYJË shumë e ngurtë që do të sjellë probleme.[12]

## Kontribut determinues

Kontributi i ulemasë shqiptare ishte determinues, si në marrjen pjesë aktive nëpër kryengritje të shumta, duke i udhëhequr ato, por edhe duke u dhënë kurajë luftëtarëve të lirisë me këshilla e vepra dhe me autoritetin të cilin e gëzonin në masë. Ulemaja shqiptare ishte e motivuar nga mësimet kuranore dhe porositë e Muhamedit a.s. që të japin në vazhdimësi kontributin e tyre për liri e pavarësi.

I madhi Zot në Kuranin famëlartë thotë: ***"....Vërtet Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli derisa ata të ndryshojnë gjendjen e tyre..."*** *(Rad, 11).*

Po ashtu, një kontribut të madh kanë dhënë edhe institucionet fetare islame, si xhamitë, mejtepet, medresetë, teqetë etj., të cilat ishin çerdhe të përpjekjeve për mbijetesë dhe pavarësi të shqiptarëve, si Kompleksi i medresesë "Mehmed Pasha", xhamia "Sinan Pasha" në Prizren, medreseja "Pirinazir" e Prishtinës, Medreseja e Tiranës, medreseja e Isa begut dhe medreseja Meddah në Shkup, Medreseja e Madhe në Gjakovë etj. e deri tek kontributi që ka dhënë në dekadat e fundit medreseja "Alaudin" në Prishtinë, ku gjatë viteve '89-'99 u mbajtën 1230 tubime të karakterit politiko-shtetformues, nëpër të cilën kaluan kokat më të ngritura e të ditura, për ta bërë Kosovën shtet.[13]

[12] Prof dr. Hakif Bajrami, Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956 (3), revista Dituria Islame, nr.88, shkurt 1997. f.28.

[13] http://bislame.net/fjalimet/310-pvkfmyftiu, fjala e myftiut të Kosovës, Mr. Naim Tërnava, në hapje të konferencës shkencore "Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtarë", 28-29.09.2012, Tiranë,

## Eksodi po paralizon shtetin e ri të Kosovës

Në prag të shënimit të shtatëvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, shumicën e të rinjve i gjejmë të zhgënjyer dhe të dëshpëruar me rrjedhat dhe zhvillimet në vend. Ata, por edhe popullata jonë, kanë pritur që pas shpalljes së pavarësisë të krijohen kushte më të mira dhe perspektivë. Skenat nga ikja masive e qytetarëve tanë nga vendi janë më tmerrueset që po përjeton vendi ynë prej përfundimit të luftës së vitit 1999.

Foshnja, fëmijë, gra shtatzëna, të rinj e pleq, t'i shohësh çdo ditë që shtyhen për të hipur në autobus për Hungari, secilin nga ne duhet ta vrasë ndërgjegjja nëse është prej atyre që ia dëshiron të mirën këtij vendi. Faktorët e këtij migrimi janë të shumtë, ndoshta dikush edhe me arsye, por prapëseprapë nuk është në rregull të veprohet kështu.

Për çudi, ndoshta kjo nguti e qytetarëve tanë është edhe në esencën e krijimit të njeriut, e që Allahu e ka thënë edhe në Kuran: ***"Insani*** *(njeriu)* ***u krijua i ngutshëm".*** *(El Isra, 11).*

Edhe pse shkaqet që i shtyjnë këta njerëz për t'u larguar nga vendi janë të disa llojesh, sikurse është gjendja sociale, pakënaqësia me punën e institucioneve etj., disa prej të cilave edhe nuk duhet të ndodhin në vendin tonë.

Duke iu referuar një të përditshmeje, e cila publikoi shifra vërtet rrëqethëse të braktisjes së shkollave nga ana e nxënësve dhe së këtejmi emigrimi në vendet e BE-së, alarmi për këtë çështje vetëm se është ndezur. Mediet evropiane filluan të na krahasojnë me popujt nomadë, madje edhe të na fyejnë rëndë. Kjo nuk përkon me traditën dhe të kaluarën tonë historike.

Edhe gjigantët mediatikë i kushtuan rëndësi të theksuar eksodit që po ndodh në Kosovë. Kështu gazeta britanike "The Telegraph" në artikullin e saj të botuar shkruan për eksodin nga Kosova: Përse u larguan mijëra njerëz, shprehet se Kosova ka humbur rreth 50.000 njerëz gjatë

dy muajve të fundit, shumica prej tyre janë larguar me autobusë në drejtim të Gjermanisë. Çfarë është duke ndodhur në këtë cep të vogël të Ballkanit. Kosova, shteti më i ri i Evropës, e fitoi pavarësinë më 2008, pas vendimit të Tony Blairit dhe Bill Clintonit për ta bombarduar Serbinë, duke e detyruar të tërhiqej, më 1999. Kosova po ashtu është shteti më i varfër i Ballkanit, me një GDP vjetore për kokë banori prej 2.500 funtesh. Vende pune nuk ekzistojnë në shumë rajone, papunësia mesatare është 45%, derisa arrin në 60% tek ata të moshës deri në 24 vjet.

Por arsyeja pse po ndodh kjo tani mbetet mister, ndërsa gjendja ekonomike nuk është asgjë e re. Dhe disa dyshojnë se autoritetet serbe, që panë konvojet me autobusë duke u larguar nga Kosova, nuk hezituan t'i mbyllnin sytë para rënies së një shteti, pavarësinë e të cilit refuzojnë ta njohin, dezertimi masiv nga Kosova u shkonte për shtat qëllimeve të tyre politike. Plus, derisa mijëra njerëz hipnin në autobusë për në Beograd, e më pas në kufirin me Hungarinë, biznesi po lulëzonte për ndërmarrësit serbë, si të ligjshëm, ashtu edhe të paligjshëm.[14]

Edhe eksodi i fundit i ikjes masive nga Kosova ka alarmuar edhe institucionin e BIK-ut. Myftiu i Kosovës, Naim ef.Tërnava, në mbledhjen e 12 shkurtit 2015 me kryetarët dhe sekretarët e Këshillave të BIK-ut, u ka kërkuar Këshillave, e përmes këtyre edhe të gjithë imamëve anekënd vendit, që të angazhohen e të kontribuojnë në ndaljen e fenomenit të migrimit të popullatës nga vendi.

Myftiu Tërnava tha se fenomeni i ikjes nga vendi është një përjetim i rëndë. "Pamjet e fëmijëve, të rinjve e grave tona nëpër male e kampe janë të rënda e brengosëse, prandaj duhet që ne si shoqëri e popull të jemi përgjegjës për këtë që po ndodh dhe duhet të bëjmë më të mirën e

[14] Exodus from Kosovo: Why thousands have left the Balkans, http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/europe/kosovo/11426805/Exodus-from-Kosovo-Why-thousands-have-left-the-Balkans.html, By Harriet Alexander, Pristina 21 Feb 2015.

mundshme që ky fenomen të ndërpritet dhe popullit t'i rikthejmë besimin dhe t'i hapim perspektivën në vendin tonë", ka thënë myftiu Tërnava.

Tërnava gjithashtu tha se hoxhallarët, teologët e kanë për obligim-farz të bisedojmë me njerëzit tanë: "Pra të jemi pranë tyre dhe të ndikojmë tek ata aq sa është e munduar, që ata mos të marrin rrugën e migrimit ilegal. E bashkëndiejmë gjendjen dhe atmosferën që është krijuar në vendin tonë dhe në shoqërinë tonë, por duhet të japim maksimumin që tek populli ynë të rikthehet ndjenja e besimi në vendin tonë, në të ardhme tonë, në perspektivën tonë"[15].

## Përfundime

- Qëndrimi i ulemave rreth shpërnguljes së popullatës shqiptare prej Kosove në Turqi ishte shumë dinjitoz dhe pothuaj determinues në frenimin e shpërnguljes drejt Turqisë.
- Kjo ishte një vepër e tyre e lartë dhe një shërbim burrëror që ia bënë atdheut dhe tokës së Kosovës.
- Çfarëdolloj sfide e pengese, që u doli papara, me bindje e frymëzim patriotik e tejkaluan.
- Ngritën vetëdijen fetare e kombëtare me organizimin e ligjëratave, vaizeve e aktiviteteve tjera ngritën dhe mbajtën gjallë ardhmërinë e këtij populli.
- Organizuan dhe vazhduan të udhëheqin jetën fetare sipas mësimeve tona islame e kombëtare.
- Mbajtën kuvende, takime, shpërndanë literaturë etj., për të mbjellë edhe më shumë dashurinë ndaj atdheut dhe vendlindjes.
- Për secilin alim mund të përgatitet studim i veçantë që do të shërbente për frymëzim dhe udhëzim për gjeneratat e ardhshme.

[15] http://bislame.net/lajme/684-kkbi12215 qasja më 15.02.2015.

## Literatura:


- Hakif Bajrami, Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956, Kryesia e BIK në Prishtinë, revista Dituria Islame, nr.85, viti 12, tetor - nëntor, 1996. Prishtinë.
- Hakif Bajrami, Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956 (2), Dituria Islame nr. 87,1997.
- Hakif Bajrami, Planet sekrete për likuidimin e shqiptarëve nga Kosova 1950-1956 (3), revista Dituria Islame, nr.88., shkurt 1997.
- Fahrush Rexhepi, Periodiku shqiptar islam, gjysma e parë e shekullit XX, Dituria Islame, Prishtinë, 2013..
- Mexhid Yvejsi "Mulla Tahir ef. Thaçi", revista "Dituria Islame", nr.291, viti 28, BIRK, 2014, Prishtinë.
- Muhamet Pirraku, Shëmbëlltyrë e historisë sonë kombëtare-mulla Idriz Gjilani (1901-1949), Dituria Islame, nr.47, Prishtinë, viti 8, mars 1993.
- Naim Tërnava, fjala e myftiut të Kosovës, Mr. Naim Tërnava,në hapje të konferencës shkencore "Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtarë", 28-29.09.2012, Tiranë, http://bislame.net/fjalimet/310-pvkfmyftiu
- Nuredin Ahmeti Krerët fetarë në lëvizjen kombëtare shqiptare në vilajetin e Kosovës (1878-1912), Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011.
- Qemajl Morina, "Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtarë-Kontributi i hoxhë Kadri Prishtinës në mbrojtje të tërësisë së tokave shqiptare,", KMSH, BIK dhe BFIM, Tiranë, 28-29 shtator 2012.
- Shinazi Memedi, Kontributi i ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare,-Kontributi i Ulema-Mexhlisit të Shkupit në shpërnguljen e popullatës muslimane në Turqi (1930-1941), simpozium shkencor organizuar nga BFI e Maqedonisë, 17 nëntor, 2012, Shkup.
- Taxhudin Bislimi, Medreseja e Ataullah Efendiut dhe nxënësit e saj, Shkup, 2011.


## Websajte:


www.telegraph.co.uk

www.bislame.net

## SUMMARY

This scientific paper aims to illuminate and highlight the role and contribution of Islamic scholars and Islamic institutions in preventing the expulsion of Albanians from ancestral lands and the preservation of national existence, as well as in raising political and religious awareness.

Albanians during history timeline were faced with extremely serious situations, especially when dealing with Slavic projects to remove them from their lands to other countries through ethnic violence. Driven by religious feelings and teachings, where homeland is highly appreciated and valued, many Albanian ulema constantly lectured in their sermons, advices, meetings and in communicating with people, they expressed their statement to live in these lands and not to abandon the country. Their motto was to save homeland and religion.

Ulema openly opposed theinfamous implementationplan "Naçertanie" of IlijaGarashaninit, 1844, which foresaw the cleansing of Albanian territories. At that time a revolution era started by Ferhat Draga, in this side were participating national chiefs of Albanian religious leaders. Then he was followed by Mulla Idriz Gjilani, Shaban Efendi, Rexhep ef. Abdullau, Bedri ef. Hamidi, Kadri Berisha, Azem Hoxha, Idriz Cerceri, Akshi Sulejmani, Mulla Ahmad Lutfi, Zenel Ibrahim Strazimiri.etc.

As an illustration, the main slogan of Mulla Hamid of Dobërçan against the migration was:

"**Who goes to Turkey and leaves his country has no Iman**".

"**He who leaves the fatherland is shkja (has no religion)**".

In 1931 the Kingdom of Yugoslavia declared the law on the colonization of the southern provinces, and in 1937 "Serb Cultural Club of Belgrade" set a project for the forced expulsion of Albanians in Kosovo and Macedonia to Turkey and Albania. According to this project, the Yugoslav government, 29 -30 September 1938, signed an agreement with the Turkish government, known as "Turkish-Yugoslav agreement on the transfer of Albanians in Turkey." It should be emphasized that

these policies were Vasa Çubrilloviç's projects in 1936, when this discourse was followed by Ivo Andric,three years later. Belgrade authorities, make secret plans for the forced deportation of Albanians, but the opposite happened when the role of imams was more effective in convincing families not to leave the motherland, so during the years 1938-1941 migration fell to the minimum.

**Keywords:** migration, ulema, race, contribution, deportation, ethnic violence, ethnic cleansing

Mr. Vedat SHABANI & Besnik FETAHU (PhD)

# PROCESI I BOLONJËS: SFIDAT E FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME RRETH SIGURIMIT TË CILËSISË

## Hyrje

Fakulteti i Studimeve Islame është institucion i pavarur edukativo-arsimor dhe hulumtues, i cili organizon studime universitare dhe pasuniversitare për studentët. Misioni i Fakultetit të Studimeve Islame është edukimi dhe përgatitja e kuadrove profesionale e shkencore për nevojat e Bashkësisë Islame, të institucioneve dhe organeve të saj edukativo-arsimore, në frymën e parimeve shkencore dhe të vlerave bashkëkohore nga fusha e studimeve islame. Fakulteti i Studimeve Islame synon të kryejë dhe të zhvillojë punën pedagogjike, shkencore dhe hulumtuese akademike sipas standardeve bashkëkohore të përcaktuara me Deklaratën e Bolonjës.

E veçanta e Fakultetit të Studimeve Islame është orientimi kah fusha e dijes në teologji islame, filologjike, pedagogjike dhe në shkenca shoqërore-humane. Kështu synohet të plasohet oferta për studime universitare, por edhe për arsimim të atyre që janë të interesuar nga dija e fushës së studimeve islame dhe fushave të tjera shoqërore.

Fakulteti i Studimeve Islame, synon t'iu mundësojë të gjithë atyre që janë të interesuar për të marrë njohuri nga fusha specifike e progra-

mit të studimeve Islame, të mund të regjistrohen dhe t'i ndjekin studimet universitare, ashtu që ata të marrin dije të profilizuar dhe të dalin kuadro të denja profesionale nga fusha e studimeve islame.

Programi studimor "Teologji Islame" në Fakultetin e Studimeve Islame është nevojë e domosdoshme për shoqërinë kosovare dhe më gjerë. Ky program ka për qëllim që të përgatisë studentët në aspektin profesional për zhvillimin e veprimtarive arsimore, fetare, edukative, kulturore, akademike, shkencore dhe në rrafshe tjera të jetës shoqërore.

Programi master "Teologjia Islame në kontekstin Evropian" synon të bëjë rritjen e kapaciteteve dhe krijimin e kuadrit për hulumtime shkencore në lëmenjtë e shkencave teologjike. Ky program i studimit u mundëson studentëve rritjen e aftësive hulumtuese dhe komunikuese në përvetësimin e njohurive të reja nga fusha e teologjisë në përgjithësi.

**Fjalët kryesore:** sigurimi i cilësisë, akreditimi, procesi i Bolonjës, vlerësimet e brendshme dhe të jashtme.

## Si vepron procesi i Bolonjës?

Studimet universitare në Evropë janë duke iu nënshtruar një revolucioni. Institucionet evropiane të arsimit të lartë kanë pranuar sfidën dhe kanë ndërmarrë një rol kryesor për ndërtimin e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, nëpërmjet realizimit të procesit të Bolonjës, që numëron deri sot shtatë hapa të rëndësishëm dhe ku dokumentet më të rëndësishme janë:

- **Magna Charta Universitatum:** "Mbi rolin që duhet të luajnë Universitetet në një shoqëri gjithnjë e më të ndërkombëtarizuar" (Bolonjë, 18 shtator 1988).
- **Konventa e Lisbonës:** "Për njohjen e kualifikimeve profesionale të arsimit të lartë në rajonin e Evropës" përpiluar nga KE dhe UNESCO (8 -11 prill 1997).

- **Deklarata e Sorbonës:** 'Harmonizimi i arkitekturës së sistemit të arsimit të lartë evropian" Paris, Sorbonne, 25 maj 1998).
- **Deklarata e Bolonjës:** "Ndërtimi i Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë" (Bolonjë, 19 qershor 1999).
- **Kongresi i Salamankës:** "Formimi i Hapësirës Evropiane të Shkollimit të Lartë" Salamanka, 29 - 30 mars 2001.[1]

Procesi i Bolonjës ka filluar me Deklaratën e Bolonjës e cila është firmosur nga ministrat e Arsimit të 29 vendeve evropiane me rastin e Konfederatës/CRE të Konferencës së Rektorëve EU, mbajtur në Bolonjë, 18-19 qershor1999.

Tani janë 47 anëtarët në procesin e Bolonjës, së bashku me Komisionin Evropian së bashku me anëtarët konsultativë si Këshilli i Evropës, UNESCO, EUA, ESU, EURASHE, ENQA (Westerheijden, 2007). Çdo dy vjet organizohen konferenca në nivel ministror, me qëllim të trajtimit të progresit që është bërë brenda hapësirës së përbashkët evropiane të arsimit të lartë, si dhe të merren vendime lidhur me hapat e ardhshëm që duhet ndërmarrë për sigurimin e cilësisë dhe rritjen e performancës së institucioneve të arsimit për tregun e punës. Qëllimi i procesit të Bolonjës është dizajnimi dhe krahasueshmëria e programeve të studimit me standardet dhe cilësinë e kualifikimit brenda hapësirës së përbashkët evropiane të arsimit të lartë (Westerheijden, Don F., Bjørn Stensaker, and Maria João Rosa, eds, 2007). Korniza themelore e adoptuar nga vendet anëtare, përbëhet prej tri cikleve të studimit/kualifikimit të arsimit të lartë. Korniza e kualifikimeve përcakton kualifikimet në bazë të rezultateve të të nxënit. Sipas studiuesve të ndryshëm, kjo nënkupton se me përfundimin e studimeve studentët do të dinë se çka mund të bëjnë me përfundimin e studimeve të tyre. Një element i rëndësishëm i proce-

[1].http://www.arsimi.gov.al

sit të Bolonjës është edhe korniza e përdorimit dhe transferimit të Kredive Evropiane dhe Sistemit të Akumulimit të tyre (ECTS)[2]. Sipas procesit të Bolonjës, ne kemi tri cikle të studimeve, si në vijim: Cikli I i studimeve përbëhet nga 180-240 ECTS kredi[3], dhe zakonisht përfundojnë me dhënien e një diplome të nivelit bachelor. Cikli II i studimeve përbëhet zakonisht nga 90-120 ECTS kredi (një minimum prej 60 ECTS kredi ne nivelin e 2 të ciklit), këto studime përfundojnë me një diplomë të nivelit master. Cikli III paraqet shkallën e doktoraturës[4]. Në të shumtën e rasteve këto studime zgjasin 3-4 vjet studimet bachelor, 1-2 vjet studimet master, si dhe 3-4 vjet studimet e doktoraturës. Vlen të theksohet se procesi i Bolonjës e përcakton vitin akademik të korresponduar me 60 ECTS kredi, të cilat janë ekuivalente me 1500 - 1800 orë studimi (Stensaker, 2007).

Procesi i Bolonjës përbën një marrëveshje ndërqeveritare në mes të vendeve të Bashkimit Evropian dhe atyre jashtë BE-së. Andaj, kjo marrëveshje nuk e ka statusin e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, Deklarata e Bolonjës nuk është në vetvete traktat apo konventë, andaj edhe nuk ka detyrime ligjore për shtetet nënshkruese. Shkalla e pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit është plotësisht vullnetare. Deklarata e Bolonjës u krijua jashtë dhe pa institucionet evropiane, megjithatë Komisioni Evropian luan një rol aktiv dhe të rëndësishëm në zbatimin e procesit të Bolonjës përmes mbështetjes së projekteve evropiane (Tempus, Erasmus) lidhur me sigurimin e cilësisë.

---

[2]. ECTS (Europian Credit Transfer and Accumulation System) është sistem që ka për qëllim rritjen e transparencës në sistemet arsimore dhe lehtësimin e lëvizjes së studentëve nëpër Evropë nëpërmjet transferit të krediteve. Është i bazuar në supozimin se ngarkesa e përgjithshme për një vit akademik është 60 kredi, të cilat shpërndahen nëpër module (lëndë) dhe përshkruajnë ngarkesën e nevojshme të studentëve për të arritur objetivat e përcaktuara.

[3]. Krediti është një njësi matëse që mat ngarkesën e studentëve në kohën në të cilën ata e shpenzojnë për një lëndë/ semestër apo program.

[4]. Udhëzues për Sigurimin e Cilësisë 2014, aprovuar nga Këshilli Mësimor Shkencor i FSI-së në mbledhjen e datës 24.10.2014, fq. 2.

Në vitet e fundit, Bashkimi Evropian po përballet me një numër në rritje të sfidave të reja dhe të vështira: globalizimi i tregut të punës, integrimi i anëtarëve të rinj, si dhe transformimi i zonës së Evropës në një zonë ekonomike të bazuar në njohurit e fituara gjatë studimeve. Në përballje me këto sfida Bashkimi Evropian në vazhdimësi është duke nxitur shkëmbime shkencore dhe kulturore në të gjitha nivelet, duke mundësuar dhe promovuar lëvizjen maksimale të punëtorëve të kualifikuar, studentëve dhe hulumtuesve.

Për këtë arsye është i rëndësishëm procesi i Bolonjës, sepse mundëson harmonizimin e sistemeve universitare duke marrë në konsideratë kulturat dhe traditat akademike, lehtëson njohjen e kualifikimeve universitare, favorizon mobilitetin e studentëve dhe hulumtuesve si dhe mundëson zgjerimin e horizontit të tregut të punës në një shkallë evropiane.

## Rëndësia e sigurimit të cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë

Sigurimi i Cilësisë (QA) gjithnjë ka qenë e një rëndësie të veçantë, fillimisht në biznes, por tani edhe në institucionet e arsimit të lartë. Cilësia mbetet atributi më i rëndësishëm që krijon vlerë rreth shërbimit të studimeve për studentët. Ajo është gjithashtu mjeti me të cilin Institucionet e arsimit të lartë e dallojnë veten nga konkurrentët e tyre. Rezultatet dhe praktikat e metodave të sigurimit të cilësisë u ndihmojnë institucioneve të arsimit të lartë në krijimin e standardeve më të larta të cilësisë në procesin e tyre të mësimdhënies dhe mësimnxënies, për të përmirësuar problemet e natyrës si rënia e numrit të studentëve, financimin dhe njohjen e programeve të studimit dhe kualifikimet e tyre (Craft, 2003).

Sot institucionet e arsimit të lartë përballen me kërkesa në rritje nga studentët, tregu i punës, shoqëria në tërësi për cilësi më të mirë. Këto

presione bëhen edhe më serioze për institucionet e arsimit të lartë të cilat nuk kanë mjete financiare dhe infrastrukturore, përballen me një konkurrencë të fortë qoftë vendore ashtu edhe ndërkombëtare. Institucionet e arsimit të lartë shprehin dëshirën dhe gatishmërinë për realizimin e një kulture të cilësisë, e cila merr në konsiderim nevojat e studentëve dhe stafit akademik, si dhe përcjell trendet e fundit nga fusha ekonomike dhe sociale, me qëllim të mbajtjes së cilësisë së lartë akademike brenda institucionit. Institucionet të cilat ofrojnë cilësi dhe vlera në shërbimet e tyre arsimore ka të ngjarë të rriten shpejt. Kjo rritje e tyre shoqërohet me studentë cilësorë dhe besnikëri të stafit akademik dhe administrativ, aftësi për të siguruar fonde të tjera financiare përmes projekteve hulumtuese si dhe më shumë autonomi në zhvillimin e politikave mësimore (Coates, 2005).

Studiues të ndryshëm konceptin e cilësisë e përshkruajnë shpesh si tërësi të tipareve dhe karakteristikave të një shërbimi, e cila e bënë atë të pranueshme për nevojat e shpallura apo të nënkuptuara. Cilësia në arsimin e lartë, sipas nenit 11 të Deklaratës Botërore për Arsimin e Lartë të Kombeve të Bashkuara, është një koncept shumëdimensional, i cili duhet të përqafojë të gjitha funksionet e tij dhe aktivitetet si në vijim: Mësimdhënie dhe programe studimore, kërkimore dhe akademike, personel, studentë, ndërtesa, fakultete, pajisje, shërbime të komunitetit dhe mjedis akademik (Barnett, 2012). Ajo duhet të marrë formën e brendshme të vetëvlerësimit dhe rishikimit të jashtëm, i kryer në mënyrë të hapur nga ekspertë të pavarur, në qoftë se është e mundur me ekspertizë ndërkombëtare, e cila është jetike për përmirësimin e cilësisë. Organet e pavarura kombëtare duhet të vendosen si dhe standardet krahasuese të cilësisë, të njohura në nivel ndërkombëtar, duhet të përcaktohen. Vëmendja e duhur duhet t'i kushtohet kontekseve specifike institucionale, kombëtare dhe rajonale në mënyrë që të marrin diversitetin dhe për të shmangur uniformitetin. Palët e interesuara duhet të jenë pjesë integrale e procesit të vlerësimit institucional. Cilësia gjith-

ashtu kërkon që arsimi i lartë duhet të karakterizohet nga dimensioni i saj ndërkombëtar: shkëmbimi i njohurive, rrjeteve interaktive, mobilitetit të mësimdhënësve dhe studentëve, si dhe projektet kërkimore ndërkombëtare, duke marrë parasysh vlerat dhe rrethanat kombëtare kulturore.

## Vlerësimi i brendshëm dhe sigurimi i cilësisë

Sigurimi i cilësisë është një ndër komponentët më të rëndësishëm në institucionet e arsimit të lartë. Është një prej standardeve bashkëkohore që duhet arritur, sepse me këtë garantohet cilësia në mësimdhënie, kërkime shkencore si dhe kuadro të kualifikuara për tregun e punës (Billing, 2004). Fakulteti i Studimeve Islame (FSI) e ka në qendër të aktiviteteve të saj sigurimin e cilësisë duke e adaptuar atë si kulturë të punës dhe si zhvillim të sistemit të menaxhimit të përgjithshëm të cilësisë. FSI me sukses është duke e menaxhuar punën në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe me praktikat më të mira, veçanërisht në lidhje me trendet e fundit nga Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë dhe udhëzimet e Bolonjës. Politikat, procedurat, proceset dhe iniciativat e cilësisë përqendrohen në përmirësimin e vazhdueshëm përmes vetëvlerësimit të rregullt me objektivat, standardet, kriteret e performancës, rishikimin e progresit dhe vlerësimin e përgjithshëm. Në nivel institucional dhe të programeve, udhëheqësit akademikë dhe administrativë bëjnë prioretizimin dhe artikulojnë anët e forta, të dobëta dhe prioritetet në planveprimet të cilat modelohen në nivel të gjerë dhe shpërndahen e përdoren në mënyrë aktive (Stensaker, 2007).

Fakulteti i Studimeve Islame në mënyrë të rregullt dhe me sukses realizon procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve dhe lëndëve përkatëse të tyre. Ky vlerësim i brendshëm bëhet në mënyrë periodike për çdo semestër në të cilin, studentët shprehin opinionin e tyre, gjithmonë në kushte të anonimitetit të plotë, për performancën e

mësimdhënësit për lëndën e caktuar. Nga vlerësimi i fundit i bërë, performanca e mësimdhënësve është vlerësuar në shkallën mesatare prej 4.5 nga maksimalja e mundshme prej 5. Me qëllim të familjarizimit me standardet e sigurimit të cilësisë, Fakulteti i Studimeve Islame në vazhdimësi promovon kulturën për sigurimin e cilësisë në të cilën departamentet dhe individët e shohin përmirësimin e cilësisë si përgjegjësi personale dhe institucionale. Për çështje relevante lidhur me sigurimin e cilësisë njoftohen të gjitha palët për t'u siguruar se të gjithë janë të përfshirë në zhvillimin e një kulture të cilësisë në të cilën arritjet njihen dhe shpërblehen kurse performanca menaxhohet në mënyrë efektive.

Çdo institucion i arsimit të lartë ka për mision menaxhimin e cilësisë me synimet kryesore si: përsosmëria, barazia, transparenca dhe efikasiteti (Craft, 2003). Fakulteti i Studimeve Islame ka për qëllim realizimin e këtyre synimeve të sipërpërmendura përmes planeve strategjike dhe politikave për sigurimin e cilësisë, në të cilat janë të përcaktuara qartë rolet dhe aktivitetet e vlerësimit të brendshëm. Fillimisht Fakulteti i Studimeve Islame harton planveprimet të cilat janë të aprovuara nga menaxhmenti dhe nga një staf i kualifikuar, të cilët kanë për detyrë vlerësimin e arritjeve dhe implementimin e prioriteteve kyçe për përmirësimin e cilësisë. Përveç performancës në mësimdhënie, rëndësi e veçantë i kushtohet edhe kërkimit shkencor, dhe kjo matet në bazë të numrit të hulumtimeve dhe publikimeve që janë bërë brenda një periudhe kohore. Institucionet e arsimit të lartë, i përdorin këto standarde të vlerësimit dhe performancës edhe për zhvillimin e stafit të tyre dhe promovimin e imazhit pozitiv të institucionit në tregun e punës.

Këshilli mësimor i Fakultetit të Studimeve Islame miraton planin strategjik dhe ka përgjegjësinë përfundimtare për sigurimin e cilësisë. Dekani i Fakulteti drejton procesin e sigurimit të cilësisë dhe është përgjegjës ndaj Këshillit mësimor. Sekretari i Fakulteti, apo prodekani, mbikëqyr dhe këshillon për procedurat kryesore për cilësinë, performancën dhe iniciativat si dhe përkrah kulturën e përgjithshme të cilësisë.

Ai gjithashtu përgatit raportin vjetor për këshillin mësimor për shqyrtim kritik. I tërë procesi duhet ta ketë edhe mbështetjen teknike e cila sigurohet nga zyrtarët kompetentë për sigurim të cilësisë.

Ekipet e sigurimit të cilësisë në Institucionet e arsimit të lartë, janë përgjegjëse për procesin e vetëvlerësimit dhe implementimit të planveprimeve për sigurimin e cilësisë në korniza të fushës së tyre. Këto ekipe në institucionet e arsimit të lartë kanë këtë përbërje: dekani, prodekanët, përfaqësues të stafit akademik, përfaqësues të studentëve dhe nga një anëtar i jashtëm (stakeholder). Mandati i këtij ekipi është njëvjeçar me mundësi të ripërtëritjes nga Këshilli i Fakultetit. Stafi akademik dhe administrativ, studentët dhe stakeholderët inkurajohen të marrin pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e modeleve vlerësues si dhe në operimin dhe rishikimin e këtyre modeleve.

Institucionet e arsimit të lartë për zhvillimin e një kulture të cilësisë, përdorin një varg mekanizmash të brendshëm të cilat do të jenë të lidhura me mekanizmat e jashtëm në mënyrë të përshtatshme duke përfshirë, por pa u kufizuar në zhvillimin dhe miratimin e kurrikulave në përputhje me udhëzimet strikte. Agjencitë e akreditimit bëjnë vlerësimin dhe miratimin e programeve studimore. Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies ruhet dhe zhvillohet nëpërmjet një skeme vjetore të vëzhgimit të mësimdhënies, vlerësimeve vjetore nga studentët, vlerësimi individual i stafit dhe nga mundësitë e zhvillimit profesional. Institucionet e arsimit të lartë i përdorin këto procedura vjetore të vlerësimit të stafit edhe si një vegël e rëndësishme për vlerësimin e performancës individuale, si bazë për rinovimin e kontratës, për progresin dhe promovimin akademik.

Fakulteti i Studimeve Islame, sikurse edhe institucionet e tjera të arsimit të lartë performancën e mësimdhënësve në lëndët e caktuara e mat me tregues të ndryshëm; duke filluar nga ndërtimi i syllabusit, vijueshmëria në ligjërata (të cilat dokumentohen me lista evidentuese të vijueshmërisë së studentëve në ligjërata) si dhe mësimdhënësi është i

obliguar të dorëzojë procesin dhe evidencën e ndërtimit të notës për secilin student duke u bazuar në format standarde të vlerësimit.

Në mënyrë që studentëve t'u jepet mundësi për vlerësimin e stafit akademik, lëndëve dhe efektivitetin e shërbimeve administrative, studentët në FSI-së plotësojnë pyetësorin e vlerësimit dy herë në vit. Kjo, aplikohet në mënyrë konfidenciale dhe anonime në mënyrë që ne të marrim komente të sinqerta dhe konstruktive për të na ndihmuar në përmirësimin e mëtejmë. Rezultatet e anketës jepen për secilin anëtar të stafit akademik dhe departamentet administrative, dhe përmbledhjet janë në dispozicion për fakultetin/qendrat për analizë dhe përdorim. Rezultatet individuale përdoren si pjesë e procedurës së vlerësimit stafit.

## Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi

Fakulteti i Studimeve Islame tanimë ka një përvojë të theksuar në procesin e vlerësimit të jashtëm që i bëhet institucionit me rastin e aplikimit për akreditim/riakreditim qoftë institucional, qoftë të programeve të studimit nga ana e Agjencisë Kosovare për Akreditim. Procesi i vlerësimit të performancës së cilësisë në nivel institucional dhe të programeve nga ekspertët e jashtëm të fushës, ka qenë sfidues dhe përfitues për Fakultetin e Studimeve Islame. Vërejtjet dhe rekomandimet e ekspertëve të jashtëm kanë ndihmuar në rritjen e performancës dhe zhvillimin e kurrikulave të brendshme sipas kritereve të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Deri më tani në mënyrë të suksesshme Fakulteti i studimeve islame, u është nënshtruar katër vlerësimeve të jashtme, me ç'rast ka marrë akreditimit/riakreditim institucional dhe të programeve të studimit. Gjatë periudhës kohore 2011, Fakulteti i Studimeve Islame, i është nënshtruar për herë të parë aplikimit në Agjencinë Kosovare për Akreditim, për akreditim institucional dhe të një programi studimor të nivelit themelor. Agjencia Kosovare për Akredi-

tim gjatë kësaj periudhe të vlerësimit lëshon vendimin për akreditim institucional dhe të programit për një periudhë trevjeçare. Ky ishte një sukses i jashtëzakonshëm i Fakultetit të Studimeve Islame, ku përherë të parë fakulteti u bë pjesë e proceseve të përbashkëta të Institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Së fundi, Fakulteti i Studimeve Islame i është nënshtruar procesit të riakredimit institucional, por tani me dy programe të studimit për nivelin themelor dhe atë master, dhe me sukses ka arritur ta përfundojë këtë proces. Agjencia Kosovare e Akreditimit për herë të parë bënë akreditimin e programit master në FSI, program i cili u mundëson studentëve vazhdimin e studimeve të avancuara në këtë fakultet dhe përgatitjen e tyre të mëtutjeshme akademike dhe shkencore për tregun e punës.

---

**Literatura:**

Barnett, R. (2012). *Improving Higher Education: Total Quality Care.* Bristol: Open University Press.

Billing, D. (2004). *"International comparisons and trends in external quality assurance of higher education: Commonality or diversity?".* Higher Education 47.1.

Coates, H. (2005). *"The value of student engagement for higher education quality assurance.".* Quality in Higher Education 11.1.

Craft, A. (2003). *Quality assurance in higher education.* London: Routledge.

Ramsden, P. (2003). *Learning to teach in higher education.* London: Routledge.

Stensaker, B. (2007). *"Quality as fashion: Exploring the translation of a management idea into higher education." Quality assurance in higher education.* Springer Netherlands.

Westerheijden, Don F., Bjørn Stensaker, and Maria João Rosa, eds. (2007). *Quality assurance in higher education: Trends in regulation, translation and transformation.* Springer Science & Business Media.

Westerheijden, S. R. (2007). "States and Europe and quality of higher education." Quality assurance in higher education. Netherlands: Springer.

## SUMMARY

The Bologna Process is a major reform of the European education system, established with a view of finding answers to issues such as public liability for higher education and research, governance in higher education, the social dimension of higher education and research, and also values and the role of higher education and research in modern, globalized and evermore complex societies.

Although the higher education system in Kosovo is striving to implement all criteria and standards of the Bolona Process, Kosovo is yet to become member to the process. Since 2012, the Faculty of Islamic Studies has been subject to the accreditation system, and it has pursued all higher education policies, based on the Law on Higher Education in the Republic of Kosovo, and all internal regulations of the ICK and the FIS.

In terms of quality assurance and development in higher education, FSI also subjects to quality assessment processes. By the end of each semester, the Faculty management verifies these matters, by assessing academic staff members under a questionnaire, with questions related to quality assurance in education. Also, FSI has been subject to external assessment, which is performed every three years, by external experts of the higher education area.

# Përmbajtja

Prof. asoc. dr. Fahrush REXHEPI
EBU BEKRI NJË JETË NË SHOQËRIM TË PEJGAMBERIT A.S.. 5

Mr. hfz. Safet HOXHA
INSTITUCIONI I HIFZIT
Metodat dhe teknikat e memorizimit të Kuranit ..... 27

Prof. ass. dr. Xhabir HAMITI
ORIENTALIZMI DHE ORIENTALISTËT VIS-A-VIS KURANIT .. 51

Prof. ass. dr. Lulzim ESATI
LLOJET E UDHËZIMIT NË KURANIN FAMËLARTË ..... 63

Prof. asoc. Dr. Sulejman OSMANI
DASHURIA PËR MUHAMEDIN A.S.
NË VARGJET E HAFIZ IBRAHIM DALLIUT ..... 75

Prof. ass. dr. Musa VILA
KUPTIMI I HADITHIT PËR NDARJEN E UMETIT NË 73 GRUPE . 99

Dr. Ajni SINANI
PËRHAPJA E MEDHHEBIT HANEFI NË BALLKAN ..... 121

Prof. dr. Hysen MATOSHI
RRËFIMET KURANORE NË LETRAT SHQIPE ..... 145

Mr. Qemajl MORINA
ARABISHTJA NË DRITËN E GJUHËVE SEMITE..... 157

Dr. Sadik MEHMETI
MBISHKRIMI I XHAMISË SË KATIB SINANIT
NË PRIZREN DHE AUTORI I TIJ..... 183

Mr. Rexhep SUMA
KONTRIBUTI I ULEMAVE PËR PENGIMIN
E MIGRIMIT TË SHQIPTARËVE..... 201

Mr. Vedat SHABANI & Besnik FETAHU (PhD)
PROCESI I BOLONJËS: SFIDAT E FAKULTETIT
TË STUDIMEVE ISLAME RRETH SIGURIMIT TË CILËSISË . 217

Përmbajtja ..... 229